



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KUVENDI**

**LIGJ**

**Nr. 52/2014**

**PËR VEPRIMTARINË E SIGURIMIT DHE RISIGURIMIT<sup>1</sup>**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**K U V E N D I**

**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**V E N D O S I:**

**K R E U I**

**DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

---

<sup>1</sup> Direktiva e parë e Këshillit 73/239/KEE, datë 24 korrik 1973, për bashkërendimin e akteve ligjore, nënligjore dhe administrative që kanë të bëjnë me fillimin dhe ndjekjen e veprimtarisë tregtare të sigurimit të drejtpërdrejtë me përjashtim të sigurimit të jetës, Numri CELEX: 31973L0239, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Europian, Seria L, Nr. 228, datë 16.8.1973, faqe 3–19;

Direktiva e Këshillit 73/240/KEE, datë 24 korrik 1973, që heq kufizimet mbi lirinë e vendosjes në veprimtarinë tregtare të sigurimit të drejtpërdrejtë me përjashtim të sigurimit të jetës, Numri CELEX: 31973L0240, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Europian, Seria L, Nr. 228, datë 16.8.1973, faqe 20–22;

Direktiva e dytë e Këshillit 88/357/KEE, datë 22 qershor 1988, për bashkërendimin e akteve ligjore, nënligjore dhe administrative në lidhje me sigurimet e drejtpërdrejta me përjashtim të sigurimit të jetës, ku parashikohen dispozitat për mundësimin e ushtrimit të efektshëm të lirisë për të ofruar shërbime dhe ku ndryshohet direktiva 73/239/KEE, Numri CELEX: 31988L0357, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Europian, Seria L, Nr. 172, datë 4.7.1988, faqe 1–2;

Direktiva e Këshillit 92/49/KEE, datë 18 qershor 1992, për bashkërendimin e akteve ligjore, nënligjore dhe administrative në lidhje me sigurimet e drejtpërdrejta me përjashtim të sigurimit të jetës, dhe për ndryshimin e Direktivës 73/239/KEE dhe Direktivës 88/357/KEE (Direktiva e tretë për sigurimet jojetë), Numri CELEX: 31992L0049, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Europian, Seria L, Nr. 228, datë 11.8.1992, faqe 1–23;

Direktiva 2002/13/KE e Parlamentit Europian dhe e Këshillit, datë 5 mars 2002, për ndryshimin e Direktivës së Këshillit 73/239/KEE në lidhje me kërkesat për nivelin e aftësisë paguese për ndërmarrjet e sigurimeve jojetë, Numri CELEX: 32002L0013, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Europian, Seria L, Nr. 77, datë 20.3.2002, faqe 17–22;

Direktiva 98/78/KE e Parlamentit Europian dhe e Këshillit, datë 27 tetor 1998, për mbikëqyrjen shitesë të ndërmarrjeve të sigurimeve në grupin e sigurimeve, Numri CELEX: 31998L0078, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Europian, Seria L, Nr. 330, datë 5.12.1998, faqe 1–12;

Direktiva 2002/92/KE e Parlamentit Europian dhe e Këshillit, datë 9 dhjetor 2002, për ndërmjetësimin në sigurime, Numri CELEX: 32002L0092, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Europian, Seria L, Nr. 9, datë 15.1.2003, faqe 3–10;

Direktiva 2005/68/KE e Parlamentit Europian dhe e Këshillit, datë 16 nëntor 2005, për risigurimin dhe për ndryshimin e direktivave të Këshillit 73/239/KEE, 92/49/KEE, si dhe direktivave 98/78/KE dhe 2002/83/KE (Tekst që lidhet me ZEE-në), Numri CELEX: 32005L0068, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Europian, Seria L, Nr. 323, datë 9.12.2005, faqe 1–50;

Direktiva 2002/83/KE e Parlamentit Europian dhe e Këshillit, datë 5 nëntor 2002, për sigurimin e jetës, Numri CELEX: 32002L0083, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Europian, Seria L, Nr. 345, datë 19.12.2002, faqe 1–51;

Direktiva 2001/17/KE e Parlamentit Europian dhe e Këshillit, datë 19 mars 2001, për riorganizimin dhe likuidimin e ndërmarrjeve të sigurimeve, Numri CELEX: 32001L0017, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Europian, Seria L, Nr. 110, datë 20.4.2001, faqe 28–39.

## Neni 1

### **Objekti**

Ky ligj rregullon krijimin, veprimtarinë dhe mbikëqyrjen e shoqërive të sigurimit, risigurimit dhe ndërmjetësimit, me qëllim që tregu i sigurimeve të veprojë në një mjedis të sigurt, të qëndrueshëm dhe transparent, në mbrojtje të të drejtave dhe interesave të konsumatorit.

## Neni 2

### **Fusha e zbatimit**

Ky ligj zbatohet për personat fizikë dhe juridikë që ushtrojnë veprimtarinë e sigurimit dhe të risigurimit, të ndërmjetësimit në sigurime dhe risigurime, si dhe operacioneve që lidhen drejtpërsëdrejti me veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit në Republikën e Shqipërisë.

## Neni 3

### **Autoriteti përgjegjës**

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare është autoriteti përgjegjës për mbikëqyrjen e zbatimit të këtij ligji.

## Neni 4

### **Përkufizime**

I. Në këtij ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. “Administrator” është personi i përcaktuar në nenin 158, të ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, të ndryshuar.
2. “Administrimi i rrezikut” është tërësia e metodave dhe e rregullave që përdoren nga shoqëria e sigurimit për identifikimin, vlerësimin, monitorimin dhe administrimin e rreziqeve të mundshme, me qëllim shmangien e humbjeve financiare.
3. “Aksionar influencues” është aksionari, i cili ka pjesëmarrje influencuese.
4. “Akt i Autoritetit” është rregullorja, udhëzimi, manuali apo metodologjia e miratuar nga Bordi i Autoritetit në zbatim të kompetencave të parashikuara në këtë ligj dhe në legjislacionin përkatës në fuqi për përmbushjen e funksioneve rregullatore dhe mbikëqyrëse.
5. “Aktuari” është personi i licencuar nga Autoriteti, sipas përcaktimeve të këtij ligji, i cili, ndër të tjera, ka si detyrë kryesore llogaritjen e tarifave të primeve, tabelave të probabilitetit, provigjoneve dhe dividendëve, duke u mbështetur në teori shkencore që lidhen me investimet, statistikën, matematikën, financën dhe demografinë.
6. “Anuiteti” është kontratë sigurimi, nga e cila përfitohen të ardhura për një periudhë kohe, e përcaktuar në numër vitesh ose për gjithë jetën.
7. “Autoriteti” është Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare.

8. “Autoriteti mbikëqyrës përgjegjës” është autoriteti i vendit anëtar apo të huaj, i autorizuar, sipas legjislacionit përkatës, të ushtrojë mbikëqyrjen mbi veprimtarinë e sigurimit, risigurimit dhe ndërmjetësimit.

9. “Bashkësigurim” është shërbimi i ofruar nga disa sigurues me anë të një kontrate të vetme për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga rreziqet e specifikuar në këtë kontratë për një prim të përgjithshëm ose që ofron përfitime, sipas kushteve të kontratës, në masën e paracaktuar, si dhe që kërkon krijimin dhe administrimin e provigjoneve nga çdo sigurues, në përputhje me pjesën e tyre përkatëse të detyrimit.

10. “Cedim” është kalimi i një pjese të rrezikut të siguruar nga një shoqëri sigurimi në një shoqëri risigurimi.

11. “Delegim” është transferimi i një ose disa funksioneve të veprimtarisë së shoqërisë së sigurimit te një person tjetër.

12. “Dëmshpërblim i sigurimit” është çdo shumë, për të cilën siguruesi i detyrohet të siguroarit, përfituesit ose ndonjë pale tjetër të dëmtuar, e cila rrjedh si e drejtë nga një kontratë sigurimi apo veprimtari sigurimi, sipas klasave të parashikuara në aneksin I, të këtij ligji, përfshirë këtu edhe shumat e vëna mënjanë për personat e lartpërmendur, kur disa elemente të detyrimit nuk janë ende të njohura.

13. “Funksionar kryesor” është drejtori i departamentit ose drejtorisë, aktuari dhe drejtuesi i njësisë së auditimit të brendshëm të shoqërisë së sigurimit.

14. “Familjarë të afërm” janë personat e përcaktuar në nenin 13, pika 3, shkronjat “a”, “b”, “c” dhe “ç”, të ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, të ndryshuar.

15. “Grup” është një grup shoqërisht tregtare i përbërë nga shoqëria mëmë, shoqëritë e kontrolluara të saj, si dhe të gjitha subjektet, mbi të cilat shoqëria mëmë apo shoqëria e kontrolluar e saj ushtron ndikim influencues apo ku zotëron pjesëmarrje.

16. “Institucion financiar” është:

a) një bankë, sipas nenit 4, pika 1.1, dhe/ose një subjekt financiar jo bankë sipas nenit 4, pika 1.31, shkronja “i”, të ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006, “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar;

b) një shoqëri sigurimi dhe/ose risigurimi;

c) një shoqëri komisionere, sipas përcaktimit të nenit 44, të ligjit nr. 9879, datë 21.2.2008, “Për titujt”;

ç) një shoqëri administruese e sipërmarrjeve të investimeve kolektive, sipas përcaktimit të nenit 2, pika 25, të ligjit nr. 10 198, datë 10.12.2009, “Për sipërmarrjet e investimeve kolektive”;

d) një shoqëri administruese e fondeve të pensionit vullnetar, sipas përcaktimeve të nenit 4, shkronja “th”, të ligjit nr. 10 197, datë 10.12.2009, “Për fondet e pensionit vullnetar”.

17. “Interes i siguruashëm” është interesi dhe nevoja për t’u mbrojtur nga pasojat e ndodhjes së një ngjarjeje të siguruar.

18. “Joekzekutiv” është anëtari i këshillit të administrimit, i cili nuk është punonjës i shoqërisë së sigurimit dhe nuk është përfshirë në administrimin e saj, si dhe nuk ka asnjë lloj lidhjeje tjetër me shoqërinë e sigurimit.

19. “Klasë sigurimi” është klasifikimi i një grupi të ngjashëm rreziqesh ose operacionesh, që përcakton veprimtarinë që shoqëria e sigurimit mund të ushtrojë në bazë të licencës.

20. “Konsumator” është çdo person që përdor ose përfiton nga shërbimet e ofruara nga siguruesi ose nga shërbimet e ndërmjetësimit.

21. “Kontrollues kryesor” është çdo person fizik, i cili ushtron ndikim tek i licencuari, drejtpërdrejt ose tërthorazi, nëpërmjet një pale të tretë. Këtu përfshihet pa kufizim çdo person, në bazë të drejtimit ose udhëzimeve të të cilit veprojnë anëtarët e këshillit të administrimit/mbikëqyrës, administratori/anëtari i bordit të drejtorëve dhe funksionarët kryesorë të shoqërisë së sigurimit dhe mendimet e të cilit ndikojnë në procesin vendimmarrës të shoqërisë.

22. “Mbrojtje e interesave të të siguruarve” është ruajtja e qëndrueshmërisë financiare të shoqërive të sigurimit dhe e të drejtave ligjore të të siguruarve.

23. “Ngjarje e siguruar” është ngjarja e parashikuar në kontratën e sigurimit që ndodh brenda kushteve dhe periudhës së mbuluar nga sigurimi.

24. “Periudhë e mbulimit nga sigurimi” është periudha për të cilën një sigures mbulon ndodhjen e rrezikut të sigurimit.

25. “Person” është personi fizik dhe/ose juridik.

26. “Përfitues” është personi i tretë, në dobinë e të cilit është lidhur kontrata e sigurimit apo që përfiton nga kjo e fundit.

27. “Pjesëmarrje e cilësuar” është zotërimi i drejtpërdrejtë ose i tërthortë i aksioneve me të drejtë vote të një shoqërie sigurimi nga një person juridik ose fizik, i cili, i vetëm apo në bashkëpunim, zotëron 20 për qind ose më shumë të aksioneve me të drejtë vote të kapitalit të shoqërisë së sigurimit.

28. “Pjesëmarrje influencuese” është zotërimi i drejtpërdrejtë ose i tërthortë i aksioneve me të drejtë vote të kapitalit të një shoqërie sigurimi nga një person juridik ose fizik, i cili, i vetëm apo në bashkëpunim, zotëron 10 për qind ose më shumë të aksioneve me të drejtë vote të kapitalit të shoqërisë së sigurimit, përfshirë edhe rastin kur personi juridik ose fizik zotëron më pak se 10 për qind, por ushtron ndikim mbi administrimin e shoqërisë së sigurimit.

29. “Portofol sigurimi” është tërësia e kontratave të sigurimit të një klase ose disa klasave të sigurimit të nënshkruara nga një shoqëri sigurimi.

30. “Produkt sigurimi” është kontrata (polica) specifike e përgatitur dhe e lëshuar nga shoqëria e sigurimit për të mbuluar një rrezik specifik ose një numër rreziqesh të veçanta, sipas kushteve të parapërcaktuara.

31. “Provigjon teknik” është shuma e llogaritur në bazë të një parashikimi dhe sipas mënyrave aktuariale të caktuara, e cila mbahet nga siguresi për të mbuluar përgjegjësitë që rrjedhin nga kontratat e sigurimit.

32. “Provigjon teknik bruto” është shuma totale e provigjoneve teknike që përbëhet nga provigjonet teknike të llogaritura nga siguresi dhe provigjonet teknike për rreziqet e mbuluara nga risigurimi.

33. “Provigjon matematik” është shuma e llogaritur në bazë të një parashikimi dhe sipas metodave të caktuara aktuariale, e cila mbahet nga siguresi për të mbuluar përgjegjësitë që rrjedhin vetëm nga kontratat e sigurimit të jetës.

34. “Retrocedim” është kalimi i një pjese të rrezikut të siguruar nga një shoqëri risigurimi në një shoqëri risigurimi tjetër.

35. “Risigurim” është pranimi i rreziqeve të ceduara nga një shoqëri sigurimi/risigurimi në një shoqëri tjetër risigurimi.

36. “Rrezik sigurimi” është mundësia objektive e ekzistencës së humbjes pasurore dhe/ose jopasurore, e cila ndodh në rrethana të pasigurta, të panjohura dhe të pavarura nga vullneti i personit të siguruar.

37. “Sigurim” është transferimi i një rreziku të mundshëm, i një humbjeje pasurore dhe/ose jopasurore nga i siguruari te siguresi, sipas një kontrate sigurimi.

38. “Sigurim jete” është sigurimi i rrezikut, sipas klasave të përcaktuara në aneksin I, seksioni B, bashkëlidhur këtij ligji.

39. “Sigurim jojete” është sigurimi i rrezikut, sipas klasave të përcaktuara në aneksin I, seksioni A, bashkëlidhur këtij ligji.

40. “I siguruar” është personi, humbja e mundshme pasurore dhe/ose jopasurore e të cilit është objekt i një kontrate sigurimi. Në kontratat e sigurimit të jetës i siguruari është personi, për jetën e të cilit është lëshuar një kontratë sigurimi.

41. “Sigurues” është shoqëria e sigurimit, e cila merr përsipër sigurimin e një rreziku sipas kontratës së sigurimit.

42. “Shoqatë” është shoqata e shoqërive të sigurimit dhe risigurimit.

43. “Shoqëri sigurimi” është personi juridik i licencuar për të ushtruar veprimtari sigurimi dhe operacione të tjera të lidhura në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë me veprimtarinë e sigurimit, sipas përcaktimeve të këtij ligji.

44. “Shoqëri sigurimi/risigurimi vendase” është shoqëri sigurimi/risigurimi e themeluar në Republikën e Shqipërisë.

45. “Shoqëri risigurimi” është personi juridik i licencuar për të ushtruar veprimtari risigurimi, sipas përcaktimeve të këtij ligji.

46. “Shumë e sigurimit” (kufiri i përgjegjësisë) është vlera, për të cilën është rënë dakord midis palëve në kontratën e sigurimit, apo është përcaktuar aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi për sigurimin e detyrueshëm dhe që përfaqëson kufirin maksimal të përgjegjësisë së siguruesit kundrejt të siguruarit/përfituesit.

47. “Vend anëtar” është vendi anëtar i Bashkimit Europian ose një vend tjetër që i përket Zonës Ekonomike Europiane.

48. “Vend i huaj” është çdo vend përveç Republikës së Shqipërisë dhe vendit anëtar.

49. “Veprimtari sigurimi” është përgatitja, ofrimi, nënshkrimi dhe zbatimi i kontratave të sigurimit të jetës dhe jojetës nga shoqëria e sigurimit.

50. “Veprimtari risigurimi” është përgatitja, ofrimi, nënshkrimi dhe zbatimi i kontratave të risigurimit për kalimin nga shoqëria e sigurimit në një shoqëri risigurimi të një pjese apo të të gjithë rrezikut të marrë përsipër nëpërmjet kontratës së sigurimit.

51. “Zotërues i tërthortë” është një person i cili, në emër të personit tjetër zotërues i drejtpërdrejtë, ka përfituar aksione, të drejtë vote ose të drejta të tjera që i japin mbajtësit të tyre të drejtën e pjesëmarrjes në administrim. Një person konsiderohet zotërues i tërthortë nëse zotëruesi i drejtpërdrejtë është i lidhur me atë person.

52. “QKR” është Qendra Kombëtare e Regjistrimit.

53. “SNRF” janë Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar.

54. “OECD” është Organizata për Bashkëpunimin dhe Zhvillimin Ekonomik.

II. Për qëllim të këtij ligji, përveçse kur është përcaktuar ndryshe:

1. Sa herë që në ligj përmendet termi “shoqëri sigurimi”, kuptohet edhe “shoqëri sigurimi dhe/ose risigurimi”.

2. Sa herë që në ligj përmendet termi “ndërmjetësim në sigurime”, kuptohet edhe “ndërmjetësim në sigurime dhe/ose risigurime”.

3. Sa herë që në ligj përmendet termi “provigjone teknike”, kuptohet “provigjone teknike dhe/ose matematike”.

## Neni 5

### **Klasifikimi i rreziqeve**

1. Klasifikimi i rreziqeve në klasa sigurimi përcaktohet në aneksin I, seksionet A dhe B, bashkëlidhur këtij ligji.
2. Klasifikimi në grupe sigurimi përcaktohet në aneksin II, bashkëlidhur këtij ligji.
3. Klasifikimi i rreziqeve të mëdha përcaktohet në aneksin III, bashkëlidhur këtij ligji.

## Neni 6

### **Veprimtaritë e shoqërisë së sigurimit/risigurimit**

1. Shoqëria e sigurimit ushtron veprimtari sigurimi në përputhje me klasat, për të cilat është licencuar nga Autoriteti, dhe përjashtohet nga çdo veprimtari tjetër tregtare.
2. Shoqëria e sigurimit, që ushtron veprimtari sigurimi për klasat e sigurimit të jetës, nuk ushtron në të njëjtën kohë veprimtari sigurimi për klasat e sigurimit të jojetës dhe anasjelltas.
3. Shoqëria e sigurimit mund të ushtrojë veprimtari në risigurime vetëm pasi të ketë marrë licencë të veçantë nga Autoriteti sipas parashikimeve të këtij ligji.
4. Përjashtimisht nga përcaktimi i pikës 2, të këtij neni, një shoqëri sigurimi, e licencuar për të ushtruar veprimtari sigurimi në klasat e jetës 19, 20 dhe 21 të seksionit B, aneksi I, mund të licencohet nga Autoriteti, për të ofruar sigurim në klasat 1 dhe 2 të seksionit A, aneksi I, bashkëlidhur këtij ligji, përkatësisht për rreziqet e dëmtimeve trupore, ku përfshihen paaftësia për punë, humbja e jetës, si rezultat i një aksidenti ose invaliditeti që rrjedh nga aksidenti a sëmundja. Në këtë rast, shoqëria e sigurimit administron ushtrimin e dy veprimtarive të ndara nga njëra-tjetra, në përputhje me rregullat e miratuara nga Autoriteti.
5. Shoqëria e sigurimit, e licencuar për të mbuluar një rrezik kryesor që i përket një apo disa klasave të jojetës, mund të ofrojë sigurim edhe për rreziqe plotësuese të përfshira në klasa të tjera të sigurimit të jojetës, për të cilat nuk është licencuar, nëse plotësohet një nga kushtet e mëposhtme:
  - a) Sigurimi mbulon një rrezik, i cili:
    - i) ka lidhje me rrezikun kryesor;
    - ii) ka lidhje me objektin e mbuluar nga rreziku kryesor;
    - iii) mbulohet nga e njëjta kontratë sigurimi;
  - b) Rreziku i parashikuar në klasën 17 të seksionit A, aneksi I, mund të quhet rrezik plotësues për klasën 18 të seksionit A, aneksi I, nëse përmbushen kushtet e përcaktuara në shkronjën “a”, të kësaj pike, si dhe nëse rreziku kryesor lidhet vetëm me dhënien e asistencës personave në vështirësi gjatë udhëtimit, kur ata ndodhen larg nga vendi i tyre apo vendi ku ata kanë vendqëndrimin;
  - c) Rreziku i parashikuar në klasën 17 të seksionit A, aneksi I, mund të quhet rrezik plotësues nëse përmbushen kushtet e përcaktuara në shkronjën “a”, të kësaj pike, si dhe nëse ka të bëjë me mosmarrëveshje ose rreziqe që rrjedhin apo lidhen me përdorimin e mjeteve lundruese detare.

6. Me përjashtim të përcaktimeve të parashikuara në shkronjën “b”, të pikës 5, të këtij neni, rreziqet e përfshira në klasat 14, 15 dhe 17, të seksionit A, të aneksit I, të këtij ligji, nuk mund të quhen si rreziqe plotësuese të klasave të tjera të sigurimit.

7. Përjashtimisht nga përcaktimi i pikës 1, të këtij neni, një shoqëri sigurimi mund të kryejë edhe operacione të tjera, të cilat janë të lidhura në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë me veprimtarinë e sigurimit, si më poshtë:

a) ndërmjetësimin në shitje ose shitjen e pronës së dëmtuar, që i përket sigurimit të pronës, e cila gjatë procesit të zgjidhjes së kërkesës për dëmshpërblim, është bërë pronë e shoqërisë së sigurimit;

b) marrjen e masave për minimizimin dhe parandalimin e rreziqeve që mund të kenë pasoja të dëmshme për personat dhe pronën e siguruar;

c) përcaktimin e primit të sigurimit;

ç) vlerësimin e nivelit të ekspozimit ndaj rrezikut të pronës së siguruar dhe vlerësimin e dëmit;

d) administrimin e fondeve dhe aktiveve të veta, që shërbejnë për të mbuluar provigjonet teknike dhe matematike;

dh) ofrimin e shërbimeve të përcaktuara në klasën 18, të seksionit A, aneksi I, bashkëlidhur këtij ligji, nëpërmjet angazhimit të punonjësve të shoqërisë së sigurimit dhe përdorimit të pajisjeve të veta;

e) përpunimin e automatizuar të të dhënave;

ë) kryerjen e shërbimeve intelektuale dhe teknike, të lidhura me veprimtarinë e sigurimit.

8. Veprimtaria e risigurimit ushtrohet nga shoqëria e risigurimit e licencuar nga Autoriteti. Shoqëria e risigurimit ushtron vetëm veprimtari risigurimi.

9. Shoqëria e risigurimit mund të ushtrojë veprimtari risigurimi për klasat e sigurimit të jetës, të jojetës ose njëkohësisht për të gjitha klasat e sigurimit të jetës dhe jojetës.

## Neni 7

### Personat ose palët e lidhura

1. Persona ose palë të lidhura quhen personat që janë të lidhur si:

a) familjarë të afërm;

b) anëtarë të këshillit të administrimit/mbikëqyrës ose përfaqësues apo familjarë të afërm të tyre;

c) aksionar influencues, si dhe familjarë të afërm të tyre;

ç) të punësuar sipas një kontrate pune, si dhe familjarët e tyre të afërm;

d) personat juridikë, në kapitalin e të cilëve personat e parashikuar në shkronjat “a” deri “ç”, të kësaj pike, zotërojnë më shumë se 20 për qind të kapitalit ose të aksioneve me të drejtë vote;

dh) personat juridikë, në kapitalin e të cilëve shoqëria e sigurimit zotëron më shumë se 20 për qind të kapitalit ose të aksioneve me të drejtë vote.

2. Përveç sa është parashikuar në pikën 1, të këtij neni, persona ose palë të lidhura janë edhe personat, marrëdhëniet e të cilëve janë të ndërlidhura në një nga mënyrat e mëposhtme, nëpërmjet:

a) administrimit, kapitalit apo një mënyre tjetër, ku, si rezultat i lidhjeve të tilla, ato bashkërisht krijojnë një politikë biznesi dhe veprojnë në një mënyrë të organizuar, me qëllim arritjen e objektivave të përbashkët të biznesit;

- b) ndikimit në marrjen e vendimeve në fushën e financimit dhe administrimit;
- c) ndikimit të rëndësishëm që veprimet apo pasojat e veprimeve të një personi mund të kenë në veprimet apo pasojat e veprimeve të një personi tjetër.

Neni 8

### **Sigurimi i detyrueshëm**

Veprimtaria e sigurimit të detyrueshëm rregullohet me ligje të veçanta.

Neni 9

### **Përfshirja nga detyrimi për rezervën ligjore**

Shoqëria e sigurimit përfshihet nga detyrimi për krijimin e rezervës ligjore të parashikuar në ligjin nr. 9901, datë 14.4.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", të ndryshuar.

## **KREU II**

### **SHOQËRIA E SIGURIMIT DHE RISIGURIMIT**

#### **Seksioni I**

#### **Themelimi i shoqërisë së sigurimit**

Neni 10

#### **Ushtrimi i veprimtarisë së sigurimit**

1. Veprimtaria e sigurimit ushtrohet vetëm nga personat e mëposhtëm:
  - a) shoqëria e sigurimit, me seli qendrore në Republikën e Shqipërisë;
  - b) dega e një shoqërie sigurimi e një vendi të huaj;
  - c) shoqëria e sigurimit e një vendi anëtar, e cila ka të drejtë të ushtrojë veprimtari sigurimi në Republikën e Shqipërisë në mënyrë të drejtpërdrejtë ose nëpërmjet degës së saj.
2. Shoqëria e sigurimit e një vendi të huaj nuk duhet të ofrojë dhe të kryejë sigurim të drejtpërdrejtë të një rreziku që i përket një personi, një sendi ose një përgjegjësie, që gjendet në territorin e Republikës së Shqipërisë.
3. Pika 2, e këtij neni, nuk zbatohet për sigurimin e rreziqeve të lidhura me transportin detar dhe ajror, risigurimin për investimet e huaja, për sigurimin e personit që nuk ka vendqëndrimin në Republikën e Shqipërisë apo kur është parashikuar ndryshe në marrëveshjet ndërkombëtare, në të cilat Republika e Shqipërisë është palë.



## Neni 11

### **Forma juridike e shoqërisë së sigurimit**

1. Shoqëria e sigurimit themelohet vetëm si shoqëri aksionare, me seli qendrore në Republikën e Shqipërisë, sipas ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, të ndryshuar, dhe dispozitave të këtij ligji.

2. Shoqëria e sigurimit regjistrohet në QKR, vetëm pasi të ketë marrë miratimin paraprak të Autoritetit për të ushtruar veprimtari sigurimi.

## Neni 12

### **Emri i shoqërisë së sigurimit dhe gjuha e përdorur**

1. Emri i shoqërisë së sigurimit duhet të përmbajë fjalën “sigurim” ose një derivat të saj në gjuhën shqipe.

2. Emri i shoqërisë së risigurimit duhet të përmbajë fjalën “risigurim” ose një derivat të saj në gjuhën shqipe.

3. Dokumentacioni dhe korrespondenca e mbajtur në Republikën e Shqipërisë nga personat, subjekt i këtij ligji, duhet të jenë në gjuhën shqipe.

4. Asnjë person, i cili nuk është i licencuar për të ushtruar veprimtari sigurimi/risigurimi, nuk përdor fjalët “sigurim”, “risigurim” ose derivate të tyre për publicitet apo veprimtari të tjera.

## Neni 13

### **Kapitali minimal fillestar**

1. Kapitali minimal fillestar i shoqërisë së sigurimit nuk mund të jetë më i vogël se shuma minimale e fondit të garancisë, të përcaktuar në nenin 81, të këtij ligji, dhe është tërësisht i pagueshëm në para.

2. Përveç kapitalit minimal fillestar, shoqëria e sigurimit duhet të ketë edhe një fond shtesë, i quajtur më poshtë fond për shpenzime nisjeje, për të mbuluar shpenzimet e themelimit, funksionimit dhe administrimit, i cili në çdo rast nuk duhet të jetë më i vogël se 5 për qind e kapitalit minimal fillestar.

3. Aksionarët depozitojnë për llogari të shoqërisë së sigurimit vlerën përkatëse në para të kapitalit minimal fillestar dhe fondit për shpenzime nisjeje në një llogari të veçantë garancie, në një nga bankat dhe/ose degët e bankave të huaja të Republikës së Shqipërisë. Kapitali, sipas pikës 1, të këtij neni, paguhet plotësisht përpara datës së depozitimit në Autoritet të kërkesës për licencim.

## Neni 14

### **Struktura aksionare**

Shoqëria e sigurimit themelohet nga persona fizikë apo juridikë, vendas apo të huaj, sipas dispozitave të parashikuara në këtë ligj.

## Neni 15

### **Aksionet**

1. Shoqëria e sigurimit emeton vetëm aksione të regjistruara. Çdo aksion ka të drejtën e një vote.

2. Aksionet e emetuara deri në vlerën e kapitalit minimal fillestar të shoqërisë paguhen vetëm në para.

3. Shoqëria e sigurimit në asnjë rast nuk jep hua dhe/ose nuk i lëshon garanci drejtpërsëdrejti ose tërthorazi personit, i cili kërkon të blejë aksione te kjo shoqëri sigurimi apo te një shoqëri tjetër tregtare.

Aksionarët nuk i përdorin si kolateral aksionet e shoqërisë së sigurimit. Për rastet e shkeljes së dispozitave të kësaj pike, veprimi konsiderohet i pavlefshëm.

## Neni 16

### **Burimi i kapitalit**

1. Çdo aksionar i shoqërisë së sigurimit jep informacion në Autoritet për burimin e kapitalit minimal fillestar të paguar për themelimin e shoqërisë, si dhe për çdo shtesë të kapitalit gjatë ushtrimit të veprimtarisë së shoqërisë së sigurimit.

2. Për të vërtetuar burimin e kapitalit minimal fillestar dhe shtesën e këtij kapitali, në Autoritet depozitohet informacioni dhe dokumentacioni i mëposhtëm:

a) Për personin juridik:

i) evidencë për burimin e krijimit të kapitalit, si raporti i audituesit të autorizuar, pasqyrat financiare vjetore, dhurata apo burime të tjera të destinuara për t'u përdorur në blerjen e aksioneve të shoqërisë së sigurimit;

ii) vërtetim i lëshuar nga autoritetet kompetente, i cili jep të dhëna për bilancin e shoqërisë dhe për përmbushjen e detyrimeve tatimore;

iii) vërtetim për gjendjen e kredive në sistemin bankar.

b) Për personin fizik:

i) evidencë për burimin e krijimit të kapitalit si blerje ose shitje, dhurata, paga, depozita monetare në banka dhe/ose degë të bankave të huaja apo vërtetime të tjera për burimin e krijimit të kapitalit;

ii) vërtetime që dëshmojnë përmbushjen e detyrimeve të tatim-taksave;

iii) vërtetim për gjendjen e kredive në sistemin bankar.

3. Kontributet për kapitalin e shoqërisë së sigurimit nuk duhet të burojnë nga fonde të marra hua nga publiku, kredi bankare, hua të tjera, nga fonde, origjina e të cilave është e paligjshme, ose paradhënie të paguara nga palë të treta.

4. Me qëllim parandalimin e pastrimit të parave, Autoriteti bashkëpunon me Drejtorinë e Përgjithshme të Parandalimit dhe Pastrimit të Parave, sipas modaliteteve dhe rregullave të përcaktuara në një marrëveshje të përbashkët ndërmjet dy institucioneve.

5. Procedurat dhe mënyrat e depozitimit të informacionit dhe dokumentacionit, të parashikuara në këtë nen, përcaktohen me rregullore të miratuar nga Autoriteti.

### **Kërkesat për përshtatshmëri dhe aftësi**

1. Çdo person, që është ose do të jetë aksionar influencues, anëtar i këshillit të administrimit/mbikëqyrës, administrator/anëtar i bordit të drejtorëve, kontrollues kryesor, funksionar kryesor i shoqërisë së sigurimit, duhet të plotësojë kërkesat për përshtatshmëri dhe aftësi në lidhje me pozicionin përkatës.

2. Autoriteti vlerëson nëse anëtari i këshillit të administrimit/mbikëqyrës, administratori/anëtari i bordit të drejtorëve, funksionari kryesor i shoqërisë së sigurimit apo kontrolluesi kryesor është i përshtatshëm dhe ka aftësi për të mbajtur pozicionin përkatës në shoqërinë e sigurimit, bazuar në kriteret e mëposhtme:

a) të zotërojë cilësitë e nevojshme për të përmbushur detyrat dhe përgjegjësitë e pozicionit përkatës në shoqërinë e sigurimit;

b) të ketë integritet, ndershmëri dhe përkushtim në përmbushjen e detyrave të tij;

c) të zotërojë kualifikimin e nevojshëm dhe të ketë eksperiencën profesionale, në përputhje me përgjegjësitë e pozicionit përkatës;

ç) të ruajë pavarësinë, në mënyrë që të mos cenohen interesat e shoqërisë nga konflikti i interesit që mund të krijohet gjatë ushtrimit të detyrës.

3. Autoriteti vlerëson nëse aksionari influencues është i përshtatshëm për të mbajtur pozicionin e tij, në qoftë se ai zotëron një gjendje financiare të shëndetshme dhe ka integritet.

4. Përveç sa më sipër, Autoriteti vlerëson sjelljen dhe veprimtaritë e mëparshme në biznes ose në çështje financiare të personave të përcaktuar në pikën 1 të këtij neni. Në mënyrë të veçantë, shqyrton nëse ka të dhëna që tregojnë se ky person është:

a) i dënuar me vendim të formës së prerë për organizimin dhe vënien në funksionim të skemave mashtruese dhe piramidale të huamartjes, për pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit;

b) i përfshirë ose i lidhur me humbje financiare, të shkaktuara nga veprimet e pandershme, të papërgjegjshme ose neglizhente, në lidhje me kryerjen e shërbimeve financiare dhe administrimin e shoqërive të tjera;

c) i angazhuar në praktika tregtare, të cilat Autoriteti i gjykon si praktika mashtruese, kërcënuese ose të papërshtatshme, ose që në një farë mënyre pasqyrojnë mangësi vlerash të një personi në kryerjen e shërbimeve financiare dhe veprimeve të tjera tregtare;

ç) i padënuar në 5 vitet e fundit për vepër tjetër penale.

5. Kërkesat për përshtatshmëri dhe aftësi të përcaktuara duhet të përmbushen nga personat e mësipërm gjatë gjithë kohës që janë në detyrë. Autoriteti ka të drejtë t'i kërkojë shoqërisë së sigurimit të vërtetojë përshtatshmërinë dhe aftësinë e tyre sa herë e vlerëson të arsyeshme.

6. Autoriteti përcakton rregulla të detajuara për mënyrën e vlerësimit të përmbushjes së kriteve, në përputhje me pozicionin dhe përgjegjësitë e çdo personi, subjekt i këtij neni, sipas standardeve ndërkombëtare në fushën e sigurimeve.

## Seksioni II

### **Administrimi i shoqërisë së sigurimit**

Neni 18

#### **Kriteret për organizimin e shoqërisë së sigurimit**

1. Shoqëria e sigurimit, e licencuar për të kryer veprimtari sigurimi, ushtron veprimtarinë e saj nëpërmjet një strukture të përshtatshme administrative dhe llogaridhënëse, një strukture të kontrollit të brendshëm e të administrimit të rrezikut, të cilat përputhen në përmasë e kapacitet me veprimtarinë që ajo kryen.

2. Struktura organizative e shoqërisë së sigurimit duhet të pasqyrojë një ndarje të përshtatshme dhe caktim të qartë të përgjegjësive, si dhe të ketë një sistem të brendshëm efektiv të shpërndarjes së informacionit.

Neni 19

#### **Organizimi i shoqërisë së sigurimit**

1. Shoqëria e sigurimit në statutin e saj parashikon mënyrën e organizimit të saj.

2. Organet e shoqërisë së sigurimit janë:

a) asambleja e përgjithshme;

dhe, në varësi të dispozitave të statutit,

b) këshilli i administrimit, si organ i vetëm administrimi, i cili ushtron, njëkohësisht, funksione administrimi e mbikëqyrjeje, të veprimtarisë së shoqërisë (sistemi me një nivel);

c) këshilli mbikëqyrës dhe administratori/bordi i drejtorëve, ku funksionet e administrimit e të mbikëqyrjes shpërndahen ndërmjet këtyre dy organeve (sistemi me dy nivele).

3. Në rastin e organizimit të shoqërisë së sigurimit, sipas sistemit me një nivel, statuti parashikon:

a) këshilli i administrimit i shoqërisë së sigurimit, përbëhet nga jo më pak se 5 anëtarë;

b) numri i anëtarëve të këshillit është gjithmonë tek;

c) administratori është pjesë e këshillit të administrimit;

ç) administratori është person fizik;

d) administratori është i ndryshëm nga kryetari i këshillit të administrimit;

dh) shumica e anëtarëve të këshillit të administrimit janë anëtarë joekzekutivë.

4. Në rastin e organizimit të shoqërisë së sigurimit, sipas sistemit me dy nivele, statuti parashikon:

a) këshilli mbikëqyrës ushtron funksione mbikëqyrjeje;

b) këshilli mbikëqyrës përbëhet nga jo më pak se 3 anëtarë;

c) numri i anëtarëve të këshillit mbikëqyrës është gjithmonë tek;

ç) administratori/bordi i drejtorëve ushtron funksione të administrimit;

d) bordi i drejtorëve përbëhet nga të paktën 3 anëtarë;

dh) një nga anëtarët e bordit të drejtorëve zgjidhet kryetar i bordit;

e) kryetari i bordit të drejtorëve mund të zgjidhet nga asambleja e aksionarëve ose nga vetë anëtarët e bordit;

ë) anëtarët e bordit të drejtorëve janë të ndryshëm nga anëtarët e këshillit mbikëqyrës.

## Neni 20

### **Kriteret për anëtarin e këshillit të administrimit/mbikëqyrës dhe administratorin/anëtarin e bordit të drejtorëve**

1. Kandidati për anëtar të këshillit të administrimit/mbikëqyrës dhe administrator/anëtar i bordit të drejtorëve duhet të përmbushë kriteret e mëposhtme:

a) të ketë diplomë universitare “Master profesional” dhe kualifikime profesionale, të nevojshme për administrimin e kujdesshëm të veprimtarisë së shoqërisë së sigurimit;

b) të ketë jo më pak se 5 vjet përvojë profesionale në një nga fushat që lidhet me sigurimet, kontabilitetin, jurisprudencën, financën, matematikën, statistikën, aktuaristikën, inxhinierinë, informatikën;

c) të mos ketë qenë ortak apo anëtar i një organi drejtues ose kontrollues apo administrator i një shoqërie, për të cilën janë hapur procedurat e falimentimit dhe/ose të një banke/dege të një banke të huaj të vendosur në likuidim në pesë vitet e fundit. Afati 5-vjeçar fillon nga data e vendimit të organit kompetent për hapjen e procedurave të falimentimit ose të likuidimit;

ç) të mos ketë qenë në pesë vitet e fundit ortak apo anëtar i një organi drejtues ose kontrollues, administrator i një shoqërie dhe/ose i një banke/dege të një banke të huaj, për të cilën janë vendosur procedurat e administrimit të përkohshëm. Afati 5-vjeçar fillon nga data e njoftimit të aktit nga organi kompetent për vendosjen e procedurave të administrimit të përkohshëm;

d) të mos ketë pasur në pesë vitet e fundit pozicione drejtuese apo kontrolluese në një shoqëri tregtare ose institucion financiar, të cilit i është hequr e drejta për të ushtruar një veprimtari të caktuar tregtare brenda apo jashtë vendit;

dh) të mos ketë dhënë kontribut ose të mos ketë ndihmuar në themelimin e veprimtarive të paautorizuara tregtare të pranimi dhe të grumbullimit të depozitave;

e) të mos ketë dhënë kontribut ose të mos ketë ndihmuar në ushtrimin e veprimtarive të paautorizuara të sigurimit dhe të ndërmjetësimit;

ë) të mos jetë anëtar i këshillit të administrimit/mbikëqyrës të një shoqërie tjetër sigurimi, përfaqësues apo punonjës i një shoqërie tjetër sigurimi apo ndërmjetësimi në sigurime;

f) të mos jetë auditues i brendshëm apo i jashtëm i një shoqërie sigurimi;

g) të mos i jetë refuzuar nga Autoriteti në 12 muajt e fundit kërkesa për t’u bërë anëtar i këshillit të administrimit/mbikëqyrës të një shoqërie, veprimtaria e së cilës është objekt i mbikëqyrjes nga Autoriteti.

2. Administratori/anëtari i bordit të drejtorëve, gjithashtu, nuk duhet të ketë qenë subjekt i procedurave të deklarimit të paaftësisë paguese të detyrimeve ndaj të tretëve.

## Neni 21

### **Miratimi i anëtarit të këshillit të administrimit/mbikëqyrës dhe administratorit/anëtarit të bordit të drejtorëve**

1. Anëtari i këshillit të administrimit/mbikëqyrës dhe administratori/anëtari i bordit të drejtorëve i një shoqërie sigurimi emërohet vetëm pasi të ketë marrë miratim nga Autoriteti.

2. Shoqëria e sigurimit depoziton në Autoritet kërkesën për miratim së bashku me dokumentacionin përkatës që vërteton përmbushjen e kriterëve të përcaktuara në nenet 17 dhe 20 të këtij ligji.

3. Autoriteti miraton rregulla për procedurën dhe dokumentacionin e nevojshëm për miratimin e anëtarit të këshillit të administrimit/mbikëqyrës apo administratorit/anëtarit të bordit të drejtorëve të shoqërisë së sigurimit.

4. Gjatë shqyrtimit të kërkesës, Autoriteti mund t'i kërkojë kandidatit të depozitojë programin e tij për administrimin dhe funksionimin e shoqërisë së sigurimit.

5. Autoriteti refuzon kërkesën nëse:

a) nga shqyrtimi i informacionit dhe dokumentacionit rezulton se nuk përmbushet një nga kriteret e përcaktuara në nenet 17 dhe 20 të këtij ligji;

b) nga shqyrtimi i programit vlerëson se administrimi dhe funksionimi i shoqërisë së sigurimit nuk do të kryhet në përputhje me dispozitat e këtij ligji apo legjislacionit në fuqi;

c) rezulton se kandidati, në kërkesën, dokumentacionin apo programin e administrimit, të depozituar në Autoritet, ka paraqitur të dhëna të rreme.

## Neni 22

### **Përgjegjësitë e këshillit të administrimit/mbikëqyrës dhe bordit të drejtorëve**

1. Përveç detyrave të përcaktuara në ligjin nr. 9901, datë 14.4.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", të ndryshuar, këshilli i administrimit i shoqërisë së sigurimit është përgjegjës edhe për:

a) zbatimin e legjislacionit në fuqi nga shoqëria e sigurimit;

b) administrimin e rrezikut, ndaj të cilit shoqëria e sigurimit ekspozohet gjatë ushtrimit të veprimtarisë së saj;

c) krijimin e sistemit të kontrollit dhe auditimit të brendshëm për të gjitha fushat e veprimtarisë së shoqërisë së sigurimit, si dhe funksionimin e tyre në përputhje me dispozitat e këtij ligji;

ç) mbajtjen e kontabilitetit, përgatitjen e raporteve financiare dhe statistikore të shoqërisë së sigurimit, si dhe raporteve të tjera të kërkuara nga Autoriteti, si dhe garantimin e vërtetësisë dhe saktësisë së të dhënave në përputhje me rregullat dhe metodat e përcaktuara;

d) raportimin dhe informimin e Autoritetit, sipas dispozitave të këtij ligji.

2. Përveç detyrave të përcaktuara në ligjin nr. 9901, datë 14.4.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", të ndryshuar, këshilli mbikëqyrës i shoqërisë së sigurimit është përgjegjës edhe për:

a) zbatimin e legjislacionit në fuqi nga shoqëria e sigurimit;

b) krijimin e sistemit të kontrollit dhe auditimit të brendshëm për të gjitha fushat e veprimtarisë së shoqërisë së sigurimit, si dhe funksionimin e tyre në përputhje me dispozitat e këtij ligji;

c) mbikëqyrjen e administrimit të rrezikut, ndaj të cilit shoqëria e sigurimit ekspozohet gjatë ushtrimit të veprimtarisë së saj;

ç) garantimin e vërtetësisë dhe saktësisë së të dhënave të raporteve financiare dhe statistikore të shoqërisë së sigurimit, si dhe raporteve të tjera të kërkuara nga Autoriteti;

d) raportimin dhe informimin e Autoritetit, sipas dispozitave të këtij ligji.

3. Përveç detyrave të përcaktuara në ligjin nr. 9901, datë 14.4.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, të ndryshuar, për administratorët e shoqërisë të organizuar, sipas sistemit me dy nivele, administratori/anëtari i bordit të drejtorëve është përgjegjës edhe për:

a) zbatimin e legjislacionit në fuqi nga shoqëria e sigurimit;

b) administrimin e rrezikut, ndaj të cilit shoqëria e sigurimit ekspozohet gjatë ushtrimit të veprimtarisë së saj;

c) mbajtjen e kontabilitetit, përgatitjen e raporteve financiare dhe statistikore të shoqërisë së sigurimit, si dhe raporteve të tjera të kërkuara nga Autoriteti, në përputhje me rregullat dhe metodat e përcaktuara;

ç) raportimin dhe informimin e Autoritetit, sipas dispozitave të këtij ligji.

4. Autoriteti mund të përcaktojë me rregullore përgjegjësi shtesë të organeve drejtuese të shoqërisë së sigurimit.

Neni 23

### **Konflikti i interesit dhe transaksionet me palë të lidhura**

1. Anëtarët e këshillit të administrimit/mbikëqyrës, administratori/anëtari i bordit të drejtorëve dhe funksionarët kryesorë duhet të shmangin interesin privat, i cili krijon konflikt me interesin e shoqërisë së sigurimit.

2. Administratori/anëtari i bordit të drejtorëve, anëtarët e këshillit të administrimit/mbikëqyrës dhe funksionarët kryesorë deklarojnë paraprakisht në këshillin e administrimit, nëse ata kanë interesa privatë të tillë që ndikojnë gjykimin e tyre për transaksione apo çështje të caktuara, duke krijuar konflikt interesi. Interesa privatë janë ato interesa që bazohen ose burojnë nga:

a) marrëdhënie pasurore ose tregtare të drejtpërdrejta a të tërthorta të çdo lloj natyre;

b) çdo marrëdhënie tjetër juridiko-civile;

c) dhurata, premtime, favore, trajtime preferenciale;

ç) negociime të mundshme për punësim apo për çdo lloj forme tjetër marrëdhëniesh me interes privat, të kryera nga administratori/anëtari i bordit të drejtorëve gjatë ushtrimit të detyrës së tij për përfitime në të ardhmen, pas lënies së kësaj detyre;

d) angazhime në veprimtari të tjera private, me qëllim fitimi, ose çdo lloj veprimtarie që krijon të ardhura;

dh) marrëdhënie me palë të lidhura.

3. Deklarimi i interesave privatë, sipas përcaktimeve të pikës 2, të këtij neni, i njoftohet me shkrim këshillit të administrimit/mbikëqyrës herë pas here, por jo më rrallë se një herë në vit.

4. Marrëdhëniet dhe transaksionet e biznesit me palë të lidhura dhe të tretë, në të cilat anëtari i këshillit të administrimit/mbikëqyrës ka interes, kryhen në përputhje me kushtet normale të tregut, ku nuk ka asnjë favorizim të padrejtë të fituar nga njëra palë në përfitim të palës tjetër.

5. Shoqëria e sigurimit duhet të ketë procedura për trajtimin e rasteve të konfliktit të interesit, të cilat duhet të përfshijnë informimin për konfliktin e mundshëm të interesit, kërkesa të veçanta për transaksionet që duhet të kryhen, në përputhje me kushtet normale të tregut, sipas të njëjtave kushte për çdo palë, si dhe kur gjykohet e përshtatshme marrja e miratimit paraprak të këshillit të administrimit/mbikëqyrës për kryerjen e këtyre transaksioneve.

6. Këshilli i administrimit/mbikëqyrës mund të ngrejë dhe të autorizojë komitete *ad hoc*, të përbëra nga anëtarët joekzekutivë të këtij këshilli, të cilët ngarkohen me përgjegjësinë për trajtimin, rast pas rasti, të konfliktit të interesit.

7. Shoqëria e sigurimit krijon një sistem të përshtatshëm kontrolli të brendshëm për transaksionet me persona ose palë të lidhura, ku përfshihet monitorimi i kontratave, marrëveshjeve afatgjata apo të një rëndësie të veçantë për siguruesin, për sa i përket konfliktit të interesit.

8. Në rastin e mosdeklarimit të konfliktit të interesit, sipas këtij neni, ose kur kontrata apo veprimi juridik është lidhur në kushtet e ekzistencës së konfliktit të interesit, merren masat e mëposhtme:

a) këshilli i administrimit/mbikëqyrës dhe çdo aksionar i shoqërisë së sigurimit mund t'i kërkojë gjykatës deklarimin e pavlefshmërisë së kontratës ose të veprimit juridik;

b) Autoriteti ka të drejtë të pezullojë nga detyra deri në një vit anëtarin e këshillit të administrimit/mbikëqyrës ose funksionarin kryesor apo t'i kërkojë shoqërisë së sigurimit shkarkimin e tyre.

## Neni 24

### **Përfundimi i miratimit**

Miratimi i personave të përcaktuar në pikën 1, të nenit 21, të këtij ligji, përfundon në rastet e mëposhtme:

a) kur brenda 6 muajve nga data e licencimit të shoqërisë së sigurimit, personi, për të cilin është dhënë miratimi për pozicionin e anëtarit të këshillit të administrimit/mbikëqyrës apo administratorit/anëtarit të bordit të drejtorëve, nuk ka filluar të ushtrojë kompetencat e pozicionit përkatës në shoqërinë e sigurimit;

b) kur brenda 3 muajve nga data e njoftimit të vendimit për miratimin e anëtarit të këshillit të administrimit/mbikëqyrës apo administratorit/anëtarit të bordit të drejtorëve, personi nuk është emëruar nga shoqëria e sigurimit;

c) në datën e përfundimit të mandatit të anëtarit të këshillit të administrimit/mbikëqyrës apo administratorit/anëtarit të bordit të drejtorëve.



## Neni 25

### **Ndryshimi i anëtarit të këshillit të administrimit/mbikëqyrës dhe administratorit/anëtarit të bordit të drejtorëve**

1. Shoqëria e sigurimit njofton dhe merr miratimin nga Autoriteti për çdo ndryshim të administratorit/anëtarit të bordit të drejtorëve dhe anëtarit të këshillit të administrimit/mbikëqyrës.

2. Shoqëria e sigurimit njofton me shkrim Autoritetin për çdo ndryshim të të dhënave, mbi bazën e të cilave është vlerësuar dhe miratuar anëtari i këshillit të administrimit/mbikëqyrës dhe administratori/anëtari i bordit të drejtorëve. Në këtë rast, Autoriteti, nëse e gjykon të nevojshme, rivlerëson personin në fjalë, në përputhje me parashikimet e neneve 17 dhe 20 të këtij ligji.

3. Shoqëria e sigurimit njofton Autoritetin në rastin e riemërimit të administratorit/anëtarit të bordit të drejtorëve dhe anëtarit të këshillit të administrimit/mbikëqyrës dhe në rastin e përfundimit apo marrjes të detyrës si anëtar i një organi drejtues apo kontrollues të një shoqërie tjetër.

4. Autoriteti përcakton me rregullore procedurat, afatet dhe informacionin shtesë në rastin e miratimit të ndryshimit të administratorit/anëtarit të bordit të drejtorëve dhe anëtarit të këshillit të administrimit/mbikëqyrës, në rastin e rivlerësimit të tij, si dhe në rastin e riemërimit, përfundimit apo marrjes së një detyre tjetër drejtuese.

## Neni 26

### **Komiteti i auditimit**

1. Shoqëria e sigurimit krijon komitetin e auditimit me jo më pak se tre anëtarë, shumica e të cilëve janë anëtarë joekzekutivë të këshillit të administrimit.

2. Të paktën një nga anëtarët e komitetit të auditimit duhet të ketë jo më pak se 3 vjet përvojë në fushën e kontabilitetit ose auditimit.

3. Komiteti i auditimit ndihmon këshillin e administrimit në përmbushjen e funksioneve të veta mbikëqyrëse kundrejt aksionarëve dhe palëve të interesit. Në përmbushje të këtij funksioni, komiteti i auditimit, ndër të tjera, ka këto detyra:

a) monitoron proceset e raportimit financiar dhe vlerëson integritetin e pasqyrave financiare të shoqërisë së sigurimit;

b) monitoron mjaftueshmërinë dhe efektshmërinë e sistemit të kontrolleve të brendshme të shoqërisë së sigurimit;

c) monitoron përshtatshmërinë dhe mjaftueshmërinë e proceseve të projektuara për të siguruar pajtueshmërinë me kërkesat ligjore dhe rregullatore;

ç) propozon drejtuesin e njësisë së auditimit të brendshëm dhe monitoron veprimtarinë e njësisë së auditimit të brendshëm;

d) propozon audituesin e jashtëm dhe shqyrton e monitoron pavarësinë e shoqërisë audituese.

4. Komiteti i auditimit mblidhet jo më pak se katër herë në vit në mbledhje të zakonshme, si dhe në mbledhje të jashtëzakonshme sa herë thirret nga këshilli i administrimit/mbikëqyrës të shoqërisë së sigurimit. Vendimet merren me shumicë votash të të gjithë anëtarëve të pranishëm. Abstenimi nuk lejohet.

5. Komiteti i auditimit, gjatë ushtrimit të funksioneve të tij, mund të ndihmohet nga ekspertë të jashtëm të zgjedhur prej tij.

6. Pagat dhe shpërblimet e anëtarëve të komitetit të auditimit përcaktohen nga Asambleja e Përgjithshme e shoqërisë së sigurimit.

7. Komiteti i auditimit i raporton këshillit të administrimit/mbikëqyrës dhe e ndihmon këtë të fundit gjatë procesit vendimmarrës dhe mbikëqyrës të shoqërisë së sigurimit.

8. Autoriteti mund të miratojë rregulla të tjera për mënyrën e funksionimit të komitetit të auditimit.

Neni 27

### **Sistemi i administrimit të rrezikut**

1. Shoqëria e sigurimit krijon sistemin e administrimit të rrezikut, i cili ka të bëjë me përcaktimin dhe kontrollin e rreziqeve, nëpërmjet politikave, procedurave të zbatimit dhe vendosjes së kufijve për monitorimin, kontrollin dhe, kur është e nevojshme, ndryshimin e cilësisë e të nivelit të veprimtarive, bazuar në strukturën e rreziqeve dhe të ardhurave, që bartet në flukset e ardhshme të parasë.

2. Politikat, procedurat e zbatimit, kufijtë dhe veprimtaritë që lidhen me administrimin e rrezikut duhet të jenë të mjaftueshme për të administruar aspekte të ndryshme të rreziqeve, të cilat krijohen gjatë ushtrimit të veprimtarisë së shoqërisë së sigurimit.

3. Autoriteti miraton rregulla për organizimin e sistemit të administrimit të rrezikut në shoqërinë e sigurimit.

## **KREU III**

### **USHTRIMI I VEPRIMTARISË SË SIGURIMIT**

#### **Seksioni I**

#### **Procedurat e licencimit**

Neni 28

#### **Licenca**

1. Shoqëria e sigurimit pajiset me licencë nga Autoriteti për të ushtruar veprimtari sigurimi brenda territorit të Republikës së Shqipërisë.

2. Licenca për veprimtarinë e sigurimit të jojetës jepet për klasa të veçanta në përputhje me aneksin I, seksioni A, bashkëlidhur këtij ligji. Licenca mbulon të gjithë klasën përkatëse, përveç rasteve kur shoqëria e sigurimit kërkon të mbulojë vetëm një pjesë të rrezikut të kësaj klase, siç përcaktohet në aneksin I, seksioni A. Licenca e dhënë për një klasë është e vlefshme edhe për mbulimin e rreziqeve plotësuese, të përfshira në një klasë tjetër, nëse përmbushen kushtet e përcaktuara në pikën 5, të nenit 6, të këtij ligji.

3. Licenca për veprimtarinë e jetës jepet veçmas nga licenca e veprimtarisë së jojetës, sipas klasave të veprimtarisë së sigurimit, në përputhje me aneksin I, seksioni B, bashkëlidhur këtij ligji.

4. Licenca jepet edhe sipas klasifikimit të parashikuar në aneksin II bashkëlidhur këtij ligji.

5. Licenca për veprimtarinë e risigurimit jepet për klasat e sigurimit të jetës, të jojetës ose njëkohësisht për të gjitha klasat e sigurimit të jetës dhe jojetës.

6. Licenca është e pakufizuar në kohë, e patransferueshme dhe e patregtueshme.

#### Neni 29

##### **Fazat e licencimit**

1. Licencimi i veprimtarisë së sigurimit përfshin dy faza:

- a) miratimin paraprak;
- b) dhënien e licencës.

2. E drejta për fillimin e ushtrimit të veprimtarisë së sigurimit lind vetëm pasi shoqëria e sigurimit pajiset me licencë nga Autoriteti.

#### Neni 30

##### **Kërkesa për marrjen e miratimit paraprak**

I. Kërkesa për marrjen e miratimit paraprak për ushtrim veprimtarie në sigurime depozitohet me shkrim dhe shoqërohet nga dokumentacioni i mëposhtëm:

1. Akti i themelimit dhe projektstatuti i shoqërisë aksionare.

2. Emri i propozuar dhe adresa e selisë qendrore.

3. Lista e aksionarëve, të dhëna për llojin e aksioneve, të dhëna për vlerën nominale të aksioneve, përqindja e pjesëmarrjes në kapitalin aksionar dhe personat apo palët e mundshme të lidhura.

4. Vërtetimi që kapitali minimal fillestar është paguar në para në një llogari të veçantë garancie në një nga bankat dhe/ose degët e bankave të huaja në territorin e Republikës së Shqipërisë.

5. Informacioni për burimin e kapitalit të aksionarëve, sipas përcaktimeve të nenit 16 të këtij ligji.

6. Politikat e brendshme që do të zbatohen nga shoqëria për qeverisjen e mirë të shoqërisë.

7. Plani i biznesit i hartuar në përputhje me nenin 31 të këtij ligji.

8. Propozimet për anëtarë të këshillit të administrimit/mbikëqyrës, administrator/anëtar të bordit të drejtorëve, si dhe funksionarë kryesorë, shoqëruar me informacionin përkatës, në përputhje me kërkesat e neneve 17 dhe 20 të këtij ligji.

9. Struktura organizative e shoqërisë dhe, në mënyrë të veçantë, funksionimi i auditimit të brendshëm, funksionimi i sistemit të administrimit të rrezikut, sistemet e brendshme të kontrollit, sistemet e teknologjisë së informacionit.

10. Politikat dhe procedurat e brendshme të shoqërisë për mënyrën e trajtimit të drejtë të konsumatorit.

11. Projekt-kontratat për delegimin e funksioneve të veçanta të veprimtarisë së shoqërisë së sigurimit, në qoftë se shoqëria ka planifikuar delegime të tilla.

12. Projekt-kontratat, duke përfshirë kushtet e përgjithshme dhe të veçanta të kontratës së sigurimit, në përputhje me klasën e sigurimit, për të cilën ka kërkuar të licencohet.

13. Të dhëna për produktet, primet dhe llogaritjen e primeve:
- a) të dhëna për produkte që mbulojnë rreziqe në klasat e jetës, si:
    - i) tabelat e vdekshmërisë;
    - ii) metodologjia për llogaritjen e primeve, tabelave të primeve;
    - iii) metodologjia për llogaritjen e provigjoneve të primeve të sigurimit të jetës;
    - iv) metodologjia e llogaritjes së vlerës monetare të dorëzimit të kontratës së sigurimit;
    - v) metodologjia e llogaritjes së reduktimit të primit në rastet kur kontrata e parashikon një opion të tillë;
    - vi) llogaritja e kthimit nga investimi, kthimit nga teprica, masa dhe mënyra e rimbursimit;
  - b) të dhëna për produkte që mbulojnë rreziqe për klasat e jojetës, si:
    - i) raporti dëme prime dhe indikatorë të tjerë të rrezikut, të cilët tregojnë të dhënat që do të përdoren për kontrollin e mëtejshëm të llogaritjeve;
    - ii) përshkrimi i bazave teknike të të dhënave të përdorura për llogaritjen e primit;
    - iii) përshkrimi i elementeve dhe parametrave të planifikuar për llogaritjen e primit, duke përfshirë tabelat e primit;

14. Program për zbatimin e masave për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit.

II. Kërkesa për licencim për të ushtruar veprimtari në sigurime shoqërohet edhe nga opinioni i një aktuari të autorizuar, në lidhje me të dhënat dhe llogaritjet e parashikuara në pikën 13, të paragrafit I, të këtij neni.

III. Përveç sa parashikohet më sipër, Autoriteti ka të drejtë të kërkojë dokumentacione dhe informacione të tjera shtesë. Autoriteti miraton rregulla në lidhje me dokumentacionin dhe informacionet shtesë që i kërkohen shoqërisë së sigurimit për licencim, përfshirë edhe dokumentacionin e kërkuar për aksionarët themelues të shoqërisë së sigurimit. Mosdhënia e këtij dokumentacioni dhe informacioni përbën shkak për refuzimin e miratimit paraprak të licencës.

## Neni 31

### **Plani i biznesit**

1. Plani i biznesit është dokument i detajuar që tregon objektivat e ushtrimit të veprimtarisë së sigurimit, aftësinë e shoqërisë së sigurimit për të përmbushur parashikimet dhe përgjegjësitë, për të paktën tri vitet e para të veprimtarisë, dhe përmban duke argumentuar:

- a) strukturën organizative të parashikuar;
- b) listën e klasave të sigurimeve, ku do të ushtrohet veprimtaria e sigurimit;
- c) pjesëmarrjen e pritshme në tregun e sigurimeve;
- ç) detajet për rrjetin e shpërndarjes;
- d) strategjinë e risigurimit;
- dh) vlerësime të shpenzimeve të themelimit, shpenzimeve të administrimit, duke përfshirë veçanërisht shpenzimet e përgjithshme dhe komisionet;
- e) vlerësime të shpenzimeve për ngritjen e strukturës administrative, për organizimin e mbrojtjes së biznesit, si dhe burimet financiare që do të përdoren për mbulimin e këtyre shpenzimeve;
- ë) detajet për sistemin e parashikuar të kontrollit të brendshëm dhe të administrimit të rrezikut;

- f) të dhëna për personelin dhe aktuarin;
  - g) elementet që përbëjnë kapitalin minimal fillestar, sipas parashikimeve të nenit 13 të këtij ligji;
  - gj) llojin e marrëveshjeve të risigurimit, të cilat shoqëria propozon të bëjë me shoqërinë risiguroese;
  - h) vlerësimin optimist dhe pesimist të primeve të mbledhura dhe rezultateve teknike për çdo klasë sigurimi, ku synojnë të ushtrojnë veprimtari;
  - i) parashikimin e pasqyrave financiare dhe llogarisë fitim/humbje;
  - j) vlerësimin e nivelit të kërkuar të aftësisë paguese dhe kapitalin minimal të kërkuar, bazuar në parashikimet e shkronjës “i”, të kësaj pike, si dhe metodat e përllogaritjes së këtyre vlerësimeve;
  - k) programin e planifikuar të risigurimit apo retrocedimit me tabelat e mbulimit maksimal për të gjitha klasat e veprimtarisë;
  - l) vlerësimin e burimeve financiare, të parashikuara për të mbuluar provigjonet teknike, kapitalin minimal të kërkuar dhe nivelin e kërkuar të aftësisë paguese, sipas parashikimeve të nenit 80 të këtij ligji.
2. Nëse shoqëria e sigurimit synon të ushtrojë veprimtari sigurimi në klasën 18, seksioni A, aneksi I, bashkëlidhur këtij ligji, plani i biznesit përmban edhe një përshkrim të fondeve të nevojshme për të mbuluar përgjegjësitë që lindin nga kjo klasë.

#### Neni 32

#### **Periudha e shqyrtimit**

1. Autoriteti, brenda 4 muajve nga data e marrjes së kërkesës për licencim për të ushtruar veprimtari në sigurime, jep apo refuzon miratimin paraprak të kërkesës së shoqërisë për licencim dhe e njofton me shkrim.
2. Periudha e shqyrtimit të kërkesës për zgjerimin e veprimtarisë është 2 muaj nga data e marrjes së kërkesës.
3. Për qëllim të pikave 1 dhe 2, të këtij neni, data e marrjes së kërkesës quhet data e depozitimit të kërkesës së bashku me dokumentacionin e plotë shoqërues, sipas kërkesave të këtij ligji.
4. Kur Autoriteti vëren mangësi në dokumentacionin e paraqitur apo e gjykon të nevojshme, i kërkon shoqërisë së sigurimit plotësim dokumentacioni dhe informacion shtesë brenda një afati, i cili nuk mund të jetë më shumë se 1 muaj. Në çdo rast, afati i shqyrtimit të kërkesës për licencim nuk është më shumë se 4 muaj nga data e marrjes së kërkesës.
5. Autoriteti refuzon kërkesën për licencim për të ushtruar veprimtari në sigurime, nëse shoqëria e sigurimit nuk depoziton në Autoritet, brenda afatit të përcaktuar nga ky i fundit, dokumentacionin e plotësuar apo informacionin shtesë.

#### Neni 33

#### **Miratimi paraprak**

Autoriteti jep miratimin paraprak për ushtrim veprimtarie në sigurime vetëm kur gjykon se:

- a) aksionarët përmbushin kërkesat e parashikuara në nenin 16 të këtij ligji;

b) çdo aksionar influencues, anëtar i këshillit të administrimit/mbikëqyrës, administrator/anëtar i bordit të drejtorëve, funksionar kryesor, kontrollues kryesor i shoqërisë së sigurimit përmbush kërkesat për përshtatshmëri dhe aftësi, në lidhje me pozicionin përkatës, sipas kërkesave të parashikuara në nenet 17 dhe 20 të këtij ligji;

c) nga dokumentacioni i depozituar dhe rrethanat e tjera të njohura, shoqëria e sigurimit ka aftësitë e duhura, përfshirë personelin, organizimin dhe çështjet teknike, për të plotësuar volumin e projektuar të biznesit, sipas planit të biznesit;

ç) statuti dhe i gjithë dokumentacioni i paraqitur janë në përputhje me këtë ligj dhe rregullat e nxjerra në zbatim të këtij ligji;

d) primet e llogaritura dhe provigjonet teknike ose matematike janë të mjaftueshme për mbulimin e përgjegjësive të shoqërisë së sigurimit;

dh) shoqëria e sigurimit përmbush çdo kërkesë tjetër të parashikuar nga ky ligj apo rregullore në zbatim të këtij ligji, në lidhje me ushtrimin e veprimtarisë në sigurime në klasat e sigurimit, për të cilat ka aplikuar.

#### Neni 34

### **Refuzimi i miratimit paraprak**

1. Autoriteti refuzon miratimin paraprak në rast se shoqëria nuk përmbush kushtet e përcaktuara nga ky ligj.

2. Autoriteti, kur e gjykon të nevojshme, mund të refuzojë miratimin paraprak edhe nëse për shkak të strukturës së shoqërisë së sigurimit apo grupit ose të marrëdhënieve të shoqërisë së sigurimit me persona apo palë të lidhura rrezikohet ushtrimi i mbikëqyrjes.

3. Vendimi i Autoritetit për miratim ose refuzim paraprak duhet të jetë i arsyetuar dhe i bëhet i ditur shoqërisë me shkrim brenda 10 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit.

4. Në rast të refuzimit të miratimit paraprak, shoqëria e sigurimit ka të drejtë të ankohet në gjykatën administrative, brenda afateve dhe sipas procedurave të parashikuara në ligjin nr. 49/2012, "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative".

#### Neni 35

### **Dhënia e licencës për të ushtruar veprimtari sigurimi**

1. Pas miratimit paraprak, shoqëria e sigurimit pajiset me licencë për ushtrim veprimtarie sigurimi, pasi të ketë depozituar në Autoritet dokumentacionin e mëposhtëm:

a) vendimin e regjistrimit në QKR, së bashku me statutin e shoqërisë së sigurimit;

b) vërtetimin e pronësisë ose të kontratës së qirasë për mjediset ku do të ushtrohet veprimtaria e sigurimit apo çdo lloj akti juridik që jep të drejtën e përdorimit e të shfrytëzimit të mjediseve;

c) vërtetimin e depozitimit të fondit për shpenzime nisjeje në emër të shoqërisë, të parashikuar në pikën 2, të nenit 13, të këtij ligji;

ç) vendimin e emërimit të anëtarëve të këshillit të administrimit/mbikëqyrës dhe administratorit/anëtarit të bordit të drejtorëve së bashku me një përshkrim të shkurtër të kompetencave të tyre dhe specimenet e nënshkrimit;

d) vendimin e caktimit të audituesit të jashtëm;

dh) projekt-kontratat e sigurimit, sipas klasave ku shoqëria e sigurimit kërkon të licencohet;

e) listën e punonjësve të shoqërisë së sigurimit, që merren me shitjen e policave, me dokumentacionin përkatës, sipas kërkesave të nenit 199 të këtij ligji.

2. Autoriteti shqyrton kërkesën për licencim dhe merr vendim brenda 2 muajve nga data e depozitimit të kërkesës së bashku me dokumentacionin e plotë shoqëruar, sipas kërkesave të këtij ligji.

3. Nëse shoqëria e sigurimit nuk plotëson të gjitha kërkesat e parashikuara në pikën 1, të këtij neni, brenda 6 muajve nga data e marrjes së vendimit për miratimin paraprak, Autoriteti refuzon pajisjen me licencë të shoqërisë, si dhe revokon vendimin për dhënien e miratimit paraprak shoqërisë së sigurimit.

4. Vendimi i Autoritetit për miratim ose refuzim të licencës duhet të jetë i arsyetuar dhe i bëhet i ditur shoqërisë me shkrim brenda 10 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit.

5. Në rastin e refuzimit të licencimit nga Autoriteti, shoqëria mund të paraqesë ankim në gjykatë.

#### Neni 36

### **Zgjerimi i veprimtarisë**

1. Shoqëria e sigurimit, e cila ka marrë licencë për të ushtruar veprimtari në klasa të caktuara të sigurimit dhe që kërkon të ushtrojë veprimtari në klasa të tjera të sigurimit, duhet të marrë licencë për zgjerim veprimtarie për këto klasa.

2. Nenet 31, 34, 35 dhe 38, të këtij ligji, zbatohen respektivisht edhe për licencën e zgjerimit të veprimtarisë për klasat e tjera të sigurimit.

3. Shoqëria e sigurimit paraqet në Autoritet dokumentacionin e mëposhtëm:

a) vendimin e asamblesë së aksionarëve për zgjerimin e veprimtarisë;

b) burimin për shtimin e kapitalit për klasat që kërkon të licencohet;

c) depozitimin e shtesës së kapitalit minimal, sipas klasave të sigurimit që kërkon të ushtrojë, sipas parashikimeve të nenit 81 të këtij ligji;

ç) raportin e fizibilitetit, sipas dispozitave të nenit 37 të këtij ligji;

d) planin e risigurimit;

dh) projektin për ndryshimin e statutit;

e) vërtetimin për zotërimin e fondit të garancisë, në përputhje me klasat që kërkon të licencohet;

ë) përllogaritjet për zotërimin e nivelit të aftësisë pagueuse, sipas parashikimeve të këtij ligji;

f) informacion të detajuar në lidhje me provigjonet teknike dhe matematike, si dhe në lidhje me mbulimin e tyre nga aktive të përshtatshme;

g) të dhëna për produktet, primet, të dhënat për llogaritjen e primeve, specimenin e kontratës së sigurimit që mbulon klasën e sigurimit, për të cilën shoqëria e sigurimit ka kërkuar licencë për zgjerim veprimtarie.

4. Autoriteti refuzon kërkesën për zgjerim veprimtarie në klasa të tjera siguri, në rastet e mëposhtme:

a) nëse e gjykon se veprimtaria, për të cilën është bërë kërkesa, do të ketë pasoja negative në veprimtarinë e shoqërisë së sigurimit, për sa u përket rregullave të administrimit të rrezikut;

b) nëse shoqëria e sigurimit nuk i përmbush kriteret e përcaktuara në këtë ligj për ushtrimin e veprimtarisë në klasat e sigurimit, për të cilën është kërkuar zgjerim veprimtarie.

#### Neni 37

### **Raporti i fizibilitetit**

Raporti i fizibilitetit i hartuar nga shoqëria e sigurimit për klasën e sigurimit, për të cilën kërkohet zgjerimi i veprimtarisë, i parashikuar në nenin 36 të këtij ligji, përmban:

a) objektin e veprimtarisë;

b) studimin e tregut;

c) strategjitë e veprimtarisë në lidhje me mbledhjen e primeve, marketingun dhe ndërmjetësit;

ç) parashikim për mbledhjen e primeve dhe rezultatet teknike për tri vitet e para të veprimtarisë për klasën përkatëse të sigurimit;

d) të dhëna për punonjësit e punësuar dhe pajisjet teknike, të cilat do të përdoren;

dh) risitë që sillen në sektorin e sigurimeve, produktet dhe shërbimet e reja që i përkasin klasës përkatëse të sigurimit;

e) vlerësimin e burimeve financiare, të parashikuara për të mbuluar përgjegjësitë e marra dhe nivelin e aftësisë paguese në klasën përkatëse të sigurimit.

#### Neni 38

### **Informimi për fillimin ose ndërprerjen e veprimtarisë së shoqërisë së sigurimit**

Shoqëria e sigurimit informon Autoritetin për fillimin ose ndërprerjen e ushtrimit të veprimtarisë së sigurimit për klasën e sigurimit, për të cilën ka marrë licencë, në përputhje me aneksin I, bashkëlidhur këtij ligji, brenda 8 ditëve kalendarike nga data e fillimit ose ndërprerjes së veprimtarisë së sigurimit.

#### Neni 39

### **Përfundimi i licencës**

1. Licenca për ushtrimin e veprimtarisë së shoqërisë së sigurimit përfundon kur:

a) shoqëria e sigurimit nuk fillon ushtrimin e veprimtarisë brenda 6 muajve nga data e marrjes së licencës. Shoqëria e sigurimit nuk ushtron më veprimtari sigurimi nga data e njoftimit të shpalljes së pavlefshme të licencës nga Autoriteti;

b) shoqëria e sigurimit nuk ushtron veprimtari për një periudhë më të gjatë se 6 muaj. Shoqëria e sigurimit nuk ushtron më veprimtari sigurimi nga data e njoftimit të shpalljes së pavlefshme të licencës nga Autoriteti;

c) është vendosur hapja e procedurave të falimentit ndaj shoqërisë së sigurimit. Shoqëria e sigurimit nuk ushtron më veprimtari sigurimi nga data e shpalljes së vendimit të gjykatës;



ç) shoqëria e sigurimit vendos të ndërpresë ushtrimin e veprimtarisë. Shoqëria e sigurimit nuk ushtron më veprimtari sigurimi nga data e miratimit të këtij vendimi nga Autoriteti;

d) transferohen të gjitha kontratat e sigurimit në një shoqëri tjetër sigurimi. Shoqëria e sigurimit nuk ushtron më veprimtari sigurimi nga data e marrjes së vendimit nga Autoriteti për transferimin e kontratave.

2. Shoqëria e sigurimit, licenca e së cilës është shpallur e pavlefshme, brenda 6 muajve transferon portofolat e klasave përkatëse, për të cilat është shpallur pavlefshmëria e licencës, sipas dispozitave të këtij ligji.

## Seksioni II

### **Lejimi i ushtrimit të veprimtarisë së sigurimit jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë**

#### Neni 40

#### **Ushtrimi i veprimtarisë së sigurimit në një vend të huaj**

1. Shoqëria e sigurimit, e themeluar në Republikën e Shqipërisë mund të ushtrojë veprimtari sigurimi në një vend të huaj nëpërmjet degës së saj ose shoqërisë së kontrolluar, në përputhje me legjislacionin e vendit ku do të ushtrohet veprimtaria, pasi ka marrë më parë miratimin e Autoritetit.

2. Kërkesa e shoqërisë së sigurimit paraqitet në Autoritet me shkrim dhe shoqërohet nga dokumentacioni i mëposhtëm:

a) vendimi i asamblesë së përgjithshme për shtrirjen e veprimtarisë në një vend të huaj;

b) të dhëna për shumën e investimit dhe burimin e financimit;

c) forma juridike (degë, shoqëri e kontrolluar);

ç) klasat e sigurimit ku kërkon të ushtrojë veprimtari;

d) dokumente të tjera të kërkuara nga Autoriteti.

3. Brenda 3 muajve nga data e kërkesës, Autoriteti shqyrton dhe merr vendim në lidhje me kërkesën e shoqërisë së sigurimit për ushtrim veprimtarie në një vend të huaj.

4. Autoriteti refuzon kërkesën për miratim, duke marrë parasysh legjislacionin e vendit në fjalë apo kur gjykon se mbikëqyrja e ushtrimit të veprimtarisë së degës nuk mund të kryhet sipas dispozitave të këtij ligji.

#### Neni 41

#### **Ushtrimi i veprimtarisë së sigurimit në një vend anëtar**

1. Shoqëria e sigurimit lejohet të ushtrojë veprimtari sigurimi në një vend anëtar, në përputhje me legjislacionin e vendit ku do të ushtrohet veprimtaria, nëpërmjet degës së saj ose në mënyrë të drejtpërdrejtë.

2. Autoriteti miraton rregulla për kriteret e procedurat, lidhur me fillimin dhe ushtrimin e veprimtarisë dhe mbikëqyrjen e një shoqërie sigurimi në një vend anëtar, nëpërmjet ofrimit të drejtpërdrejtë të shërbimeve apo themelimit të degës.

### Seksioni III

## **Ushtrimi i veprimtarisë së sigurimit nga shoqëria e sigurimit të vendit anëtar dhe vendit të huaj**

Neni 42

### **Licencimi i degës së shoqërisë së sigurimit të vendit të huaj**

1. Shoqëria e sigurimit e një vendi të huaj ushtron veprimtari sigurimi në territorin e Republikës së Shqipërisë nëpërmjet degës të regjistruar në Republikën e Shqipërisë.

2. Shoqëria e sigurimit e një vendi të huaj paraqet në Autoritet kërkesë me shkrim në gjuhën shqipe për licencimin e degës, të shoqëruar me:

a) vërtetim regjistrimi në regjistrin tregtar apo ndonjë regjistër tjetër të ngjashëm, sipas legjislacionit të vendit përkatës, ku ka selinë qendrore;

b) rregullat e brendshme të funksionimit të shoqërisë;

c) të dhëna për aksionarët dhe nivelin e pjesëmarrjes së tyre në shoqëri, nëse vërtetimi i përmendur në shkronjën “a”, të kësaj pike, nuk i përmban këto të dhëna;

ç) vërtetim regjistrimi në regjistrin tregtar apo ndonjë regjistër tjetër të ngjashëm, sipas legjislacionit të vendit përkatës të personave juridikë, të cilët zotërojnë një pjesëmarrje më shumë se 10 për qind në shoqërinë e huaj;

d) vendimin e organit më të lartë drejtues të shoqërisë për hapjen e degës në Republikën e Shqipërisë;

dh) vendimin e emërimit të administratorit të degës dhe kompetencat e tij për përfaqësimin në marrëdhëniet me palë të treta;

e) statutin e shoqërisë;

ë) licencën për ushtrimin e veprimtarisë së sigurimit, dhënë nga autoriteti përkatës në vendin ku ndodhet selia e saj;

f) miratimin zyrtar për hapjen e degës së shoqërisë së huaj, dhënë nga autoriteti mbikëqyrës përgjegjës i vendit ku ndodhet selia qendrore e saj;

g) planin e biznesit të degës, të hartuar sipas kërkesave të nenit 31 të këtij ligji;

gj) pasqyrat financiare të audituara të shoqërisë për tri vitet e fundit, sipas kriterëve të autoritetit mbikëqyrës përgjegjës në vendin ku ndodhet selia e saj;

h) vërtetim të mjaftueshmërisë së kapitalit në përputhje me kërkesat e këtij ligji;

i) vërtetim që disponon, në një llogari të veçantë garancie në një bankë dhe/ose degë të bankës së huaj që ndodhet në territorin e Republikës së Shqipërisë, kapitalin minimal fillestar sipas përcaktimeve të nenit 13 të këtij ligji;

j) deklaratën në lidhje me marrëdhëniet financiare midis degës dhe shoqërisë së huaj;

k) deklaratën e mbajtjes dhe ruajtjes së të gjithë dokumentacionit të brendshëm të degës në selinë e saj qendrore.

3. Dega e shoqërisë së huaj të sigurimit duhet të vërtetohet që ka punonjës dhe pajisje teknike të përshtatshme për ushtrimin e veprimtarisë së sigurimit.

4. Dega e shoqërisë së huaj mban kontabilitet të veçantë për veprimtarinë që ushtron në territorin e Republikës së Shqipërisë.

5. Dispozitat e neneve 31, 34, 35 dhe 38, të këtij ligji, janë të zbatueshme për vendimmarrjen e Autoritetit, në lidhje me licencimin e degës së shoqërisë së huaj të sigurimit.

6. Autoriteti refuzon miratimin e kërkesës për licencim të degës së shoqërisë së huaj të sigurimit kur:

- a) legjislacioni i vendit ku shoqëria e huaj ka selinë qendrore apo praktikën për zbatimin e këtij legjislacioni e vështirësojnë ushtrimin e mbikëqyrjes sipas këtij ligji;
- b) zbatohet parimi i reciprocitetit.

7. Të gjitha dispozitat e këtij ligji, të cilat zbatohen për shoqëritë e sigurimit, do të zbatohen, rast pas rasti, edhe për degën e shoqërisë së sigurimit të vendit të huaj.

#### Neni 43

### **Shoqëria e sigurimit e vendit anëtar**

1. Shoqëria e sigurimit, e cila ushtron veprimtari sigurimi në klasa të caktuara në një vend anëtar, mund të ushtrojë gjithashtu veprimtari sigurimi për ato klasa në territorin e Republikës së Shqipërisë në mënyrë të drejtpërdrejtë apo nëpërmjet degës së saj.

2. Autoriteti miraton rregulla për kriteret dhe procedurat, në lidhje me fillimin e ushtrimit të veprimtarisë dhe mbikëqyrjen e shoqërisë së sigurimit të një vendi anëtar, i cili ofron shërbime në sigurime në mënyrë të drejtpërdrejtë apo nëpërmjet degës.

3. Licencimi i degës së shoqërisë së një vendi anëtar bëhet sipas parashikimeve të nenit 42 të këtij ligji.

4. Të gjitha dispozitat e këtij ligji, të cilat zbatohen për shoqëritë e sigurimit, do të zbatohen, rast pas rasti, edhe për degën e shoqërisë së vendit anëtar.

#### Neni 44

### **Zyra e përfaqësimit**

1. Shoqëria e sigurimit e vendit të huaj/anëtar mund të hapë zyrë përfaqësimi në territorin e Republikës së Shqipërisë vetëm pas miratimit nga Autoriteti.

2. Shoqëria e sigurimit paraqet në Autoritet kërkesën me shkrim dhe të shoqëruar me:

- a) vendimin e organit më të lartë;
- b) aktin e themelimit dhe statutin e shoqërisë së huaj;
- c) licencën e shoqërisë së sigurimit, dhënë nga autoriteti mbikëqyrës kompetent i vendit ku ndodhet selia e saj;
- ç) vendimin e shoqërisë së sigurimit të vendit të huaj/anëtar për emërimin e përfaqësuesit të zyrës.

3. Autoriteti, brenda një periudhe njëmuajore, shqyrton dhe merr vendim në lidhje me kërkesën e shoqërisë së huaj të sigurimit për zyrë përfaqësimi në Republikën e Shqipërisë.

4. Autoriteti njofton me shkrim shoqërinë e sigurimit të vendit të huaj/anëtar brenda 10 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit për miratimin ose refuzimin e kërkesës.

5. Zyra e përfaqësimit regjistrohet në QKR pasi ka marrë miratimin nga Autoriteti.

## Seksioni IV

### **Transferimi i portofolit të sigurimit**

#### Neni 45

### **Transferimi i portofolit të sigurimit**

1. Shoqëria e sigurimit me miratim të Autoritetit mund të transferojë nëpërmjet një marrëveshjeje të një shoqëri tjetër sigurimi tërësinë ose një pjesë të kontratave të saj të sigurimit, të nënshkruara në një apo disa klasa të caktuara të sigurimit me të gjitha detyrimet dhe të drejtat. Shoqëria e sigurimit, e cila transferon kontratat e sigurimit, quhet shoqëri transferuese. Shoqëria e sigurimit, tek e cila transferohen kontratat e sigurimit, quhet shoqëri pranuese.

2. Shoqëria e sigurimit, përveç sa është parashikuar në pikën 1, të këtij neni, transferon edhe aktivet në mbulim të provigjoneve teknike dhe matematike, të barabarta me provigjonet teknike dhe matematike të përlllogaritura për të mbuluar përgjegjësitë e portofolit të sigurimit që do të transferohet.

3. Portofoli i sigurimit mund të transferohet vetëm pasi shoqëria pranuese ka marrë miratimin e Autoritetit.

4. Transferimi i kontratave të sigurimit nuk kërkon miratimin e të siguruarve.

5. Shoqëria pranuese njofton të siguruarit për transferimin e portofolit të sigurimit me anë të mjeteve publike të komunikimit në territorin ku ndodhet rreziku i mbuluar nga kontratat e sigurimit të transferuara, brenda 10 ditëve kalendarike nga data e hyrjes në fuqi të vendimit të Autoritetit për miratimin e transferimit të portofolit.

6. Shoqëria e sigurimit mund të transferojë portofolin e saj të sigurimit të:

a) një shoqëri sigurimi me seli qendrore në Republikën e Shqipërisë;

b) shoqëria e sigurimit e një vendi anëtar ose të dega e saj në Republikën e Shqipërisë apo në një vend anëtar;

c) dega e një shoqërie sigurimi të huaj në Republikën e Shqipërisë;

ç) dega e një shoqërie sigurimi të huaj në një vend anëtar, kur kontratat e sigurimit që do të transferohen mbulojnë rreziqe që ndodhen në atë vend anëtar.

7. Shoqëria transferuese transferon portofolin e saj të sigurimit të shoqëria pranuese brenda tre muajve nga data e marrjes së miratimit nga Autoriteti.

8. Miratimi për transferimin e portofolit të sigurimit përfundon pas mbarimit të afatit të përmendur në pikën 7 të këtij neni.

9. Shoqëria transferuese paraqet në Autoritet një dokument që vërteton transferimin të shoqëria pranuese brenda 30 ditëve kalendarike nga data e transferimit të portofolit.

10. Nëse shoqëria transferuese nuk përmbush kushtin e përcaktuar në pikën 9, të këtij neni, apo nga dokumentet e depozituara nuk mund të vërtetohet se portofoli është transferuar, Autoriteti vendos revokimin e vendimit për miratimin e transferimit të portofolit.

### **Kërkesa për transferimin e portofolit të sigurimit**

Shoqëria e sigurimit paraqet në Autoritet kërkesën me shkrim për transferimin e portofolit të sigurimit dhe të shoqëruar me:

- a) miratimin e transferimit nga asambleja e përgjithshme e aksionarëve dhe këshillit të administrimit/mbikëqyrës të shoqërisë transferuese;
- b) miratimin e transferimit të shoqërisë pranuese nga asambleja e përgjithshme e aksionarëve dhe këshillit të administrimit/mbikëqyrës;
- c) listën e kontratave të sigurimit, të ndara sipas klasave të sigurimit, së bashku me kushtet e veçanta dhe të përgjithshme të tyre, që kërkohen të transferohen, si dhe llogaritjet e provigjoneve teknike për klasat në fjalë;
- ç) listën e aktiveve në mbulim të provigjoneve teknike dhe matematike, përfshirë këtu vlerën e tyre përkatëse, si dhe të gjitha të dhënat që mund të përdoren për verifikimin e llogaritjes së këtyre vlerave;
- d) planin e ndryshuar të biznesit që nevojitet për transferimin e portofolit të sigurimit të shoqërisë pranuese;
- dh) kontratën e transferimit të portofolit të sigurimit.

### **Miratimi dhe refuzimi i kërkesës për transferimin e portofolit të sigurimit**

1. Autoriteti miraton transferimin e portofolit të sigurimit në qoftë se shoqëria transferuese ka plotësuar kërkesat e neneve 45 dhe 46, të këtij ligji, dhe shoqëria pranuese zotëron, duke marrë parasysh dhe transferimin e portofolit, nivelin e kërkuar të aftësisë paguese.

2. Në rastin kur shoqëria pranuese është degë e një shoqërie të huaj, Autoriteti merr vendim vetëm nëse autoriteti mbikëqyrës i vendit të origjinës jep miratimin me shkrim.

3. Autoriteti refuzon kërkesën për transferimin e portofolit të sigurimit në qoftë se:

a) shoqëria pranuese nuk plotëson kërkesat ligjore për klasat e sigurimeve që i përkasin portofolit që transferohet ose në qoftë se me pranimin e portofolit veprimtaria e shoqërisë pranuese, në lidhje me rregullat e administrimit të rrezikut, mund të përkeqësohet;

b) shoqëria pranuese nuk është e licencuar për ushtrimin e veprimtarisë në klasat e sigurimeve që i përkasin portofolit të sigurimit që transferohet;

c) vlera e aktiveve në mbulim të provigjoneve teknike dhe matematike e shoqërisë pranuese është më e ulët sesa vlera e provigjoneve që duhet të krijoheshin përkundrejt portofolit të sigurimit që do të transferohet.

4. Autoriteti, brenda 1 muaji nga data e depozitimit të kërkesës dhe dokumenteve, sipas parashikimeve të neneve 45 dhe 46, të këtij ligji, miraton ose refuzon transferimin e portofolit të sigurimit.

5. Autoriteti miraton rregulla për transferimin e portofolit të sigurimit në lidhje me vendet anëtare.

## Seksioni V

### **Pjesëmarrja influencuese**

#### Neni 48

#### **Kërkesat për pjesëmarrje influencuese**

1. Zotërimi i aksioneve në një shoqëri sigurimi, ku një aksionar, drejtpërsëdrejti ose tërthorazi, arrin ose tejkalon nivelin e pjesëmarrjes influencuese, bëhet vetëm me miratim të Autoritetit pas paraqitjes së kërkesës për pjesëmarrje influencuese. Kërkesa paraqitet në Autoritet e shoqëruar nga dokumentacioni i parashikuar në nenet 16 dhe 17 të këtij ligji.

2. Autoriteti, përveç sa është parashikuar në pikën 1, të këtij neni, miraton edhe çdo pjesëmarrje të mëtejshme që arrin ose tejkalon 20 për qind, 30 për qind, 50 për qind ose 75 për qind të të drejtave të votës ose pjesëmarrje në kapitalin e shoqërisë së sigurimit.

3. Aksionari, i cili ka marrë miratimin e parashikuar në pikat 1 dhe 2, të këtij neni, njofton paraprakisht Autoritetin nëse kërkon zvogëlimin e pjesëmarrjes së tij.

4. Autoriteti përcakton rregulla për pjesëmarrjen influencuese lidhur me vendet anëtare dhe bashkëpunimin me autoritetin mbikëqyrës përgjegjës të vendeve anëtare për çështjet që lidhen me pjesëmarrjen influencuese.

#### Neni 49

#### **Miratimi i pjesëmarrjes influencuese**

1. Autoriteti miraton pjesëmarrjen influencuese nëse plotësohen kërkesat e parashikuara në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe refuzon pjesëmarrjen influencuese nëse gjykon që:

a) veprimet e kryera nga aksionari i ardhshëm influencues apo personat/palët e lidhura me të mund të përkeqësojnë veprimtarinë e shoqërisë së sigurimit, në lidhje me rregullat e administrimit të rrezikut, apo mund të vështirësojnë ose ta bëjnë të pamundur ushtrimin e mbikëqyrjes nga Autoriteti;

b) në rastin e kërkesës për pjesëmarrje influencuese të një aksionari të huaj, zbatimi i legjislacionit apo praktikave të legjislacionit të vendit të tij vështirësojnë ose bëjnë të pamundur ushtrimin e mbikëqyrjes nga Autoriteti.

2. Autoriteti merr vendim brenda 2 muajve nga data e depozitimit të kërkesës dhe dokumentacionit të plotësuar për zotërimin e pjesëmarrjes influencuese.

#### Neni 50

#### **Njoftimi paraprak i pjesëmarrjes influencuese jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë**

1. Shoqëria e sigurimit, përpara zotërimin të pjesëmarrjes influencuese në një tjetër shoqëri sigurimi ose institucion financiar në një vend të huaj/vend anëtar, njofton me shkrim Autoritetin.

2. Shoqëria e sigurimit njofton paraprakisht me shkrim Autoritetin edhe për çdo pjesëmarrje të mëtejshme që arrin ose tejkalon 20 për qind, 30 për qind, 50 për qind ose 75 për qind të të drejtave të votës ose pjesëmarrje në kapitalin e një institucioni financiar të huaj.

3. Shoqëria e sigurimit njofton paraprakisht me shkrim Autoritetin, nëse kërkon zvogëlimin e pjesëmarrjes së saj nën nivelet e parashikuara në pikat 1 dhe 2 të këtij neni.

4. Njoftimi me shkrim, i parashikuar në pikën 1, të këtij neni, në rastin e institucioneve financiare, shoqërohet me:

a) listën e aksionarëve influencues së bashku me vërtetimin për pjesëmarrjen e tyre përkatëse;

b) vërtetim regjistrimi në regjistrin tregtar apo ndonjë regjistër tjetër të ngjashëm, sipas legjislacionit të vendit përkatës;

c) pasqyrat financiare vjetore për dy vitet e fundit;

ç) pasqyrat financiare vjetore të audituara së bashku me opinionin e audituesit për dy vitet e fundit, nëse legjislacioni vendas parashikon auditimin e detyrueshëm;

d) listën e personave/palëve të lidhura së bashku me sqarimet përkatëse;

dh) strategjinë e administrimit dhe analizën e kosto-përfitueshmërisë së investimeve.

5. Autoriteti, përveç sa është parashikuar në pikën 4, të këtij neni, me qëllim që të garantohet veprimtaria e shoqërisë së sigurimit, sipas parimeve dhe praktikave më të mira tregtare, si dhe qëndrueshmëria e saj financiare gjatë marrjes në zotërim të pjesëmarrjes influencuese, merr parasysh edhe kriteret e mëposhtme:

a) reputacionin e biznesit të shoqërisë së sigurimit, ku shoqëria e sigurimit kërkon të ketë pjesëmarrje influencuese;

b) reputacionin e biznesit dhe përvojën e personave që do të administrojnë veprimtarinë e shoqërisë së sigurimit, e cila kërkon të ketë pjesëmarrje;

c) qëndrueshmërinë financiare të shoqërisë së sigurimit, ku shoqëria e sigurimit kërkon të ketë pjesëmarrje;

ç) aftësinë e shoqërisë së sigurimit, që kërkon të ketë pjesëmarrje influencuese në një tjetër shoqëri sigurimi, për të vazhduar veprimtarinë e saj, në përputhje me dispozitat e këtij ligji. Nëse shoqëria do të bëjë pjesë në një grup sigurimi, grupi i sigurimit duhet të ketë strukturën e duhur që mundëson ushtrimin e përshtatshëm të mbikëqyrjes, shkëmbimin e përshtatshëm të informacionit ndërmjet autoriteteve mbikëqyrëse përgjegjëse, si dhe shpërndarjen e përgjegjësive ndërmjet këtyre autoriteteve;

d) parandalimin e rasteve të mundshme të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, që kanë të bëjnë me marrjen në zotërim të pjesëmarrjes influencuese.

Neni 51

### **Pasojat ligjore të pjesëmarrjes influencuese pa miratim**

Nëse një person merr në zotërim pjesëmarrje influencuese, në shkelje të dispozitave të nenit 48, të këtij ligji, veprimi juridik që ka sjellë zotërimi i pjesëmarrjes influencuese është i pavlefshëm.

## Neni 52

### **Kompetencat e Autoritetit**

Nëse një person, i cili ka pjesëmarrje influencuese në një shoqëri sigurimi, vepron në kundërshtim me rregullat e administrimit të kujdesshëm e të përshtatshëm të shoqërisë së sigurimit, Autoriteti merr masat e duhura në mbrojtje të interesave të siguruarave për përfundimin e kësaj situatë, duke përfshirë dhe ndërprerjen e ushtrimit të së drejtës së votës që rrjedh nga këto aksione.

## Seksioni VI

### **Miratime të tjera**

## Neni 53

### **Delegimi i funksioneve**

1. Shoqëria e sigurimit mund të delegojë funksionet e mëposhtme, pasi të ketë marrë miratimin e Autoritetit, për:

- a) trajtimin dhe vlerësimin e dëmeve;
- b) shërbimet aktuariale;
- c) shërbimet e promovimit dhe marketingut;
- ç) shërbimet e IT-së;
- d) mbajtjen e kontabilitetit;
- dh) administrimin e aktiveve në mbulim të provigjoneve teknike dhe matematike.

2. Funksionet e deleguara, sipas përcaktimeve të pikës 1, të këtij neni, kryhen vetëm nëpërmjet një kontrate, në bazë të cilës shoqëria e sigurimit transferon një pjesë të funksioneve të saj te një person tjetër.

3. Kontrata për delegimin e funksioneve përmban një dispozitë, e cila përcakton se shoqëria e sigurimit deleguese është përgjegjëse për funksionet e transferuara te një person tjetër.

4. Kontrata për delegimin e funksioneve duhet të përcaktojë se personi pranues i funksioneve të deleguara është i detyruar t'i japë shoqërisë së sigurimit informacionin e përmendur në nenin 55, pika 2, të këtij ligji, informacion të cilin shoqëria e sigurimit e përdor vetëm për qëllime mbikëqyrjeje.

5. Autoriteti miraton rregullore për përcaktimin e kriterëve, rregullave dhe procedurave për delegimin e funksioneve të shoqërisë së sigurimit.

## Neni 54

### **Miratimi i delegimit të funksioneve**

1. Autoriteti miraton delegimin e funksioneve të shoqërisë së sigurimit nëse plotësohen të gjitha kërkesat e parashikuara në nenin 53 të këtij ligji.

2. Autoriteti refuzon delegimin e funksioneve të shoqërisë së sigurimit nëse nuk përmbushen kërkesat e parashikuara në nenin 53, të këtij ligji, apo në rastet kur, duke u bazuar në llojin dhe volumin e funksioneve të deleguara, rrezikohen interesat e të



siguruarve apo, për shkak të delegimit të këtyre funksioneve, mund të rrezikohet apo të bëhet e pamundur mbikëqyrja e ushtrimit të funksioneve të deleguara.

3. Autoriteti, brenda një periudhe 2-mujore, shqyrton dhe merr vendim në lidhje me kërkesën e shoqërisë së sigurimit për delegimin e funksioneve të saj.

4. Autoriteti tërheq miratimin për delegimin e funksioneve të saj nëse:

a) rrezikohen interesat e të siguruarve;

b) nuk përmbushen kërkesat e këtij neni dhe nenit 53 të këtij ligji;

c) vështirësohet ose bëhet e pamundur mbikëqyrja e veprimtarisë së shoqërisë së sigurimit.

#### Neni 55

### **Mbikëqyrja e ushtrimit të funksioneve të deleguara**

1. Dispozitat e këtij ligji për mbikëqyrjen e shoqërive të sigurimit zbatohen rast pas rasti edhe për mbikëqyrjen e personit që do të ushtrojë funksionet e deleguara.

2. Shoqëria e sigurimit dhe personi që do të ushtrojë funksionet e deleguara, me kërkesën e Autoritetit, paraqet të dhëna për statusin juridik, gjendjen financiare dhe veprimtarinë e personit juridik, i cili ka nënshkruar kontratën për delegimin e funksioneve, si dhe çdo dokument dhe informacion tjetër të kërkuar nga Autoriteti.

3. Shoqëria audituese e shoqërisë së sigurimit ka të drejtë t'i kërkojë personit që do të ushtrojë funksionet e deleguara çdo informacion që lidhet me kryerjen e auditimit.

4. Personi që do të ushtrojë funksionet e deleguara duhet të bashkëpunojë me Autoritetin, në lidhje me mbikëqyrjen e parashikuar në pikën 1 të këtij neni.

#### Neni 56

### **Bashkimi dhe ndarja e shoqërisë së sigurimit**

1. Bashkimi ose ndarja e shoqërisë së sigurimit bëhet vetëm me miratimin e Autoritetit.

2. Shoqëria e sigurimit të jetës paraqet në Autoritet një raport të hartuar nga aktuari i autorizuar, që vërteton se bashkimi ose ndarja nuk është në kundërshtim me interesat e të siguruarve, shoqërisë së sigurimit dhe shoqërive të përfshira në këtë transaksion.

3. Autoriteti shqyrton kërkesën për bashkim ose ndarje dhe merr vendim pasi janë plotësuar kushtet dhe procedurat e përcaktuara me rregullore të Autoritetit.

4. Autoriteti vendos për bashkimin e shoqërive të sigurimit vetëm pasi shoqëria e sigurimit ka marrë miratimin për bashkim nga Autoriteti i Konkurrencës.

5. Për bashkimin dhe ndarjen e shoqërisë së sigurimit zbatohen edhe dispozitat e ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", të ndryshuar.

#### Neni 57

### **Miratimi ose refuzimi i ndryshimeve të statutit**

1. Shoqëria e sigurimit njofton Autoritetin për çdo ndryshim të statutit të saj brenda 10 ditëve kalendarike nga propozimi për ndryshim.

2. Çdo ndryshim i statutit të shoqërisë bëhet me miratimin paraprak të Autoritetit, brenda 10 ditëve nga depozitimi i tij.

3. Autoriteti përcakton rregulla për miratimin ose refuzimin e ndryshimeve thelbësore të statutit të shoqërisë së sigurimit.

4. Shoqëria e sigurimit, në rastin e rritjes së kapitalit, depoziton në Autoritet të dhëna për burimin e kapitalit, sipas parashikimeve të nenit 16 të këtij ligji.

5. Ndryshimet e statutit, të cilat nuk janë miratuar nga Autoriteti, nuk regjistrohen në QKR.

6. Dega e shoqërisë së huaj të sigurimit depoziton në Autoritet çdo ndryshim që i përket statutit të shoqërisë, degë e së cilës ajo është, brenda tre muajve nga data e ndryshimit. Në rast të ndryshimit të emrit të shoqërisë së huaj të sigurimit, dega e saj në Republikën e Shqipërisë njofton Autoritetin brenda 1 muaji nga data e ndryshimit të emrit.

7. Shoqëria e sigurimit depoziton në Autoritet statutin e ndryshuar brenda 10 ditëve kalendarike nga regjistrimi në QKR të ndryshimeve të statutit.

8. Dispozitat e këtij neni zbatohen edhe për degën e shoqërisë së sigurimit të vendit anëtar në Republikën e Shqipërisë.

## KREU IV

### MBROJTJA E KONSUMATORIT

#### Seksioni I

#### **Parime të përgjithshme**

##### Neni 58

#### **Detyrimet e shoqërisë së sigurimit dhe ndërmjetësit**

1. Shoqëria e sigurimit dhe ndërmjetësit detyrohen:

a) të ushtrojnë veprimtarinë e tyre me profesionalizëm, kujdes dhe përkushtim ndaj të siguruarve;

b) të veprojnë me mirëbesim dhe ndershmëri për respektimin e të drejtave të të siguruarve;

c) të informojnë të siguruarin për produktet e sigurimit, kushtet e përgjithshme e të veçanta të kontratave të sigurimit, përfitimet që rrjedhin nga kontrata e sigurimit, tarifat dhe primet që i siguruari duhet të paguajë;

ç) të kryejnë pagesën e dëmshpërblimit në masën dhe në afatin e duhur.

2. Shoqëria e sigurimit dhe ndërmjetësit nuk duhet të japin informata ose të bëjnë prezantime që keqinformojnë ose mashtrojnë konsumatorin.

##### Neni 59

#### **Trajtimi i kërkesave për dëmshpërblim dhe pagesa e dëmshpërblimit**

1. Në rastin e ndodhjes së ngjarjes së siguar, siguruesi është i detyruar t'i japë të siguruarit dëmshpërblimin apo shumën e sigurimit, sipas kontratës së sigurimit.

2. Siguruesi trajton çdo kërkesë për dëmshpërblim si dhe kryen pagesën brenda afatit të përcaktuar në kontratën e sigurimit.

3. Trajtimi i kërkesave për dëmshpërblim, nga ana e shoqërisë së sigurimit përfshin edhe vlerësimin e dëmeve nga vetë shoqëria.

4. Kërkesa për dëmshpërblim trajtohet nga siguruesi në kohë e përputhshmëri me kriteret e miratuara për këtë qëllim.

5. I siguruari, me ndodhjen e ngjarjes së siguar, gëzon të drejtën për dëmshpërblim.

6. Siguruesi krijon një sistem të brendshëm për trajtimin e kërkesave për dëmshpërblim, si dhe harton e miraton procedura të brendshme për trajtimin dhe zgjidhjen e këtyre kërkesave.

7. Siguruesi nuk është i detyruar të paguajë shumën, e cila tejkalon kufirin e shumës së sigurimit, përveçse kur parashikohet ndryshe nga palët në kontratë.

## Seksioni II

### **Informimi**

#### Neni 60

### **Detyrimi për informim**

Shoqëria e sigurimit dhe ndërmjetësit duhet të informojnë të siguarin përpara nënshkrimit të kontratës, në lidhje me subjektin e sigurimit, mbulimin dhe çështje të tjera. Detyrimi për informim fillon para nënshkrimit të kontratës dhe vazhdon gjatë periudhës së vlefshmërisë së kontratës.

#### Neni 61

### **Parimet e përgjithshme të detyrimit për informim**

1. Siguruesi garanton që informacioni i komunikuar të siguarit para nënshkrimit të kontratës të jetë i qartë dhe i mjaftueshëm.

2. Siguruesi, para nënshkrimit dhe gjatë periudhës së vlefshmërisë së kontratës, duke u mbështetur në parimin e mirëbesimit, ndihmon konsumatorin për të kuptuar aspektet teknike të mbulimit të sigurimit dhe elementet e tjera të kontratës së sigurimit, nëpërmjet dhënies së informacionit, me gojë dhe me shkrim, duke mos vepruar në mënyrë mashtruese dhe çorientuese.

3. Siguruesi, para nënshkrimit dhe gjatë periudhës së vlefshmërisë së kontratës, informon konsumatorin për çdo konflikt interesi që mund të ketë me një palë tjetër, duke përfshirë të gjitha lidhjet ekonomike dhe juridike, të cilat ndikojnë në përmbushjen e detyrimeve të siguresit ndaj konsumatorit.

4. Të gjitha detyrimet e siguresit, para nënshkrimit dhe gjatë periudhës së vlefshmërisë së kontratës, zbatohen edhe për ndërmjetësit.

5. Siguruesi përmbush detyrimin për informim edhe përkundrejt personave të tjerë që përfitojnë nga kontrata e sigurimit, në rast se kërkohet nga këta persona.

### **Pasojat juridike në rast të mospërmbushjes së detyrimit për informim**

Nëse siguruesi ose ndërmjetësit nuk përmbushin detyrimin për informim, japin informacion të natyrës mashtruese dhe çorientuese, nuk japin informacionin e duhur, në përputhje me nenin 63, të këtij ligji, ose informacioni i dhënë është në kundërshtim me faktet e ndodhura përpara nënshkrimit apo gjatë periudhës së vlefshmërisë së kontratës, si dhe nëse dhënia e këtij informacioni ndikon në vendimmarrjen e të siguruarit, ky i fundit ka të drejtë të zgjidhë kontratën dhe të kërkojë pagesën e dëmshpërblimit për dëmin e shkaktuar.

### **Detyrimi për informim përpara nënshkrimit të kontratës**

1. Siguruesi dhe ndërmjetësit detyrohen t'i japin me shkrim çdo konsumatori, përpara nënshkrimit të kontratës së sigurimit, të gjithë informacionin e nevojshëm në lidhje me llojin përkatës të sigurimit. Ky informacion përmban:

a) emrin e shoqërisë, formën juridike dhe strukturore të saj, si dhe adresën e selisë qendrore të shoqërisë;

b) adresën e selisë qendrore të degës, nëpërmjet së cilës bëhet nënshkrimi i kontratës së sigurimit;

c) procedurat e brendshme të trajtimit të kërkesave për dëmshpërblim, si dhe strukturën përgjegjëse për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve;

ç) rreziqet e mbuluara dhe të përjashtuara, si dhe mundësitë për ndryshimin e kontratës, në përputhje me kushtet e përgjithshme;

d) afatet dhe mënyrat e përfundimit të kontratës;

dh) metodën e llogaritjes të primit, afatet dhe mënyrat e pagesës së tij, pasojat e mospagesës së primit, si dhe pjesën e primit që i korrespondon mbulimit bazë dhe shtesë;

e) kërkesat dhe afatet për pagesën e dëmshpërblimit apo shumës së sigurimit;

ë) metodat e llogaritjes dhe shpërndarjes së bonuseve;

f) metodën e llogaritjes së vlerës së kompensueshme dhe reduktimin e shumës së sigurimit, në rastin e përfundimit të parakohshëm të pagesave, si dhe shumën deri ku këto janë garantuar nga kontrata e sigurimit;

g) në rastet e kontratës që lidhet me kuotat/aksionet e sipërmarrjeve të investimeve kolektive, listën e plotë të sipërmarrjeve të caktuara të investimeve kolektive, në të cilat fondet e kontratës së jetës mund të investohen, si dhe karakteristikat e aktiveve, nga të cilat përbëhen fondet e këtyre sipërmarrjeve;

gj) procedurat jashtëgjyqësore për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve ndërmjet palëve, në lidhje me kontratën e sigurimit, në përputhje me rregullat e brendshme të siguruesit pa ndikuar në të drejtën e ankimimit në gjykatë;

h) kushtet e përfundimit të njëanshëm të kontratës;

i) të dhëna të përgjithshme për taksat/tatimet dhe komisionet në lidhje me kontratën e sigurimit.

2. Përjashtimisht nga parashikimi i pikës 1, të këtij neni, nëse konsumatori kërkon mbulim të menjëhershëm, informacioni në fjalë mund të jepet verbalisht. Në këtë rast, menjëherë pas nënshkrimit të kontratës, siguruesi i jep konsumatorit edhe

informacionin me shkrim. Nënshkrimi i kontratës së sigurimit, kushteve apo anekseve të saj, nënkupton rënien dakord me informacionin e dhënë verbalisht dhe pranimin e kushteve të saj.

Neni 64

### **Informacioni i detyrueshëm në kushtet e kontratës**

1. Siguruesi dhe ndërmjetësit informojnë të siguarin për çdo ndryshim të legjislacionit të sigurimeve, falimentimit, bashkimit, zotërimit, likuidimit apo mbylljes së shoqërisë në çdo lloj mënyre, revokimit të licencës për një klasë të caktuar apo për të gjitha klasat e sigurimit, si dhe për çdo ndryshim apo ngjarje tjetër, e cila ndikon në të drejtat dhe detyrimet e të siguarit, brenda 10 ditëve kalendarike nga data e ndodhjes së ngjarjes.

2. Siguruesi dhe ndërmjetësi përmbushin detyrimin për informim gjatë periudhës së vlefshmërisë së kontratës, nëpërmjet faqes zyrtare, postës, faksit, telegrafit, postës elektronike, si dhe nënshkrimit elektronik të sigurt.

3. Detyrimi për informim, i kryer nëpërmjet telefonit ose shërbimit të qendrës së komunikimit, quhet i përmbushur nëse biseda telefonike regjistrohet nga një mjet magnetik apo digjital, si dhe siguruesi mund ta vërtetojë këtë gjë.

4. Autoriteti mund të miratojë rregulla në lidhje me informacione të tjera shtesë që duhen njoftuar përpara nënshkrimit dhe gjatë periudhës së vlefshmërisë së kontratës, duke përfshirë këtu edhe kontratën në distancë.

Neni 65

### **Përmbajtja e njoftimit**

1. Njoftimi i drejtohet të siguarit në gjuhën shqipe dhe përmbajtja e njoftimit, referuar në nenet 63 dhe 64, të këtij ligji, shprehet në mënyrë të qartë dhe të saktë.

2. Informacioni mund të jepet në një gjuhë tjetër, përveç gjuhës shqipe, nëse kërkohet nga i siguruari ose konsumatori dhe nëse siguruesi është dakord.

Seksioni III

### **Informimi i publikut**

Neni 66

### **Informimi i publikut**

1. Shoqëria e sigurimit merr të gjitha masat teknike dhe administrative për të krijuar infrastrukturën e teknologjisë së informacionit, në përputhje me rregullat e miratuara nga Autoriteti për informimin e të siguarit apo personave të tjerë të interesuar për sa u përket zhvillimeve dhe ndryshimeve ligjore në sektorin e sigurimeve.

2. Shoqëria e sigurimit, në përputhje me dispozitat e këtij ligji, krijon dhe mban faqe zyrtare interneti për të përmbushur në mënyrë efikase detyrimin për informim.

3. Shoqëria e sigurimit përgatit faqe zyrtare interneti dhe formate lehtësisht të lexueshme të informacioneve të mëposhtme, në një link të aksesueshëm veçmas nga

faqja kryesore e internetit, për përmbushjen e detyrimit për informimin e personave të interesuar:

a) informacione të përgjithshme rreth shoqërisë së sigurimit, aksionarëve dhe strukturës administrative, si dhe kapitalit;

b) klasat e sigurimit ku ushtron veprimtari, shërbimet e sigurimit dhe produktet e ofruara për ato klasa;

c) informacione për kushtet e veçanta, rreziqet dhe mbulimet që nuk ofrohen rregullisht për një produkt sigurimi, por që mund të përfshihen si shtesë në dispozitat e kushteve të veçanta;

ç) informacione për të drejtat dhe detyrimet e të siguruarit dhe palëve të tjera të interesuara, si dhe për procedurën që duhet ndjekur në rast të ndodhjes së rrezikut;

d) informacionin për taksat/tatimet e zbatueshme;

dh) adresën, adresën e postës elektronike, numrin e telefonit dhe faksit të të gjitha strukturave dhe njërive të shoqërisë së sigurimit, përfshirë edhe atë të selisë qendrore të saj;

e) procedurën për trajtimin e kërkesës për dëmshpërblim;

ë) formularët elektronikë që i lejojnë të siguruarit dhe palëve të tjera të interesuara të depozitojnë kërkesa për informacion dhe dëmshpërblim nëpërmjet internetit;

f) statistika dhe informacione të tjera të rëndësishme;

g) pasqyrat financiare më të fundit të audituara, së bashku me opinionin e audituesit.

4. Shoqëria e sigurimit krijon infrastrukturën teknologjike të informacionit që t'i mundësojë të siguruarit dhe palëve të tjera të interesuara, në mënyrë të përditësuar nëpërmjet internetit, informacionin e mëposhtëm:

a) për kontratën e sigurimit;

b) për kontratat e sigurimit të jetës për primet e llogaritura dhe të akumuluar, mbulimet e ofruara dhe shumat e tyre, zbritjet e mundshme, duke përfshirë këtu edhe komisionet, shpenzimet administrative dhe shpenzime të tjera, shumat e akumuluar dhe bonuset, nëse ka, shumën e dorëzimit të kontratës së sigurimit, bonuset dhe rabatet, statusin e kontratës objekt bonusi dhe rabati;

c) të dhëna të tjera për publikim të përcaktuara nga Autoriteti.

Neni 67

### **Veprimtaria promociionale**

1. Veprimtaria promociionale dhe informacionet rreth shoqërisë së sigurimit dhe produkteve që ofron në treg duhet të përmbajnë të dhëna të qarta, të vërteta dhe të plota.

2. Shoqëria e sigurimit është përgjegjëse për publikimin e informacioneve, sipas kritereve të pikës 1 të këtij neni.

3. Informacioni promociional përfshin të gjithë informacionin dhënë palëve të treta apo të siguruarve të mundshëm, nëpërmjet publicitetit në mediane dhe vizive, takimeve, telefonatave, internetit dhe medias elektronike, televizionit interaktiv, si dhe çdo mjet tjetër, nëpërmjet të cilit arrihet qëllimi i promociionit.

4. Dispozitat e këtij neni janë të detyrueshme edhe për ndërmjetësit, kur ata kryejnë aktivitete publicitare në mënyrë të pavarur.

### **Detyrimi i shoqërisë së sigurimit**

1. Kur shoqëria e sigurimit jep informacion promociional rreth saj dhe produkteve të ofruara në treg, ajo:

a) nuk duhet të fshehë apo të tregojë në mënyrë mashtruese e çorientuese qëllimin e promociionit dhe të informacionit;

b) duhet të japë një përshkrim të plotë, të saktë, të qartë dhe të vërtetë të produktit të sigurimit, të detyrimeve ligjore, të ardhurat e pritshme, si dhe një përshkrim të rrezikut që rrjedh nga këto produkte;

c) duhet të mbështetë faktet e dhëna me dokumente origjinale;

ç) nuk duhet të deklarojë tregues të rremë apo të pavërtetë për shoqërinë e sigurimit, pozicionin që ajo zë në treg dhe produktet e saj;

d) duhet të garantojë se informacioni është i njëjtë dhe konsekuent për nga pamja, përmbajtja dhe forma.

2. Autoriteti harton rregulla për njoftimin e informacionit promociional, para publikimit të tij nga shoqëria e sigurimit, si dhe rregulla për korrigjimin apo ndalimin e publikimit të këtij informacioni.

### **Ankimi**

1. Nëse i siguruari apo persona të tjerë të interesuar gjykojnë se shoqëria e sigurimit nuk u përmbahet kushteve të vendosura në kontratën e sigurimit, mund të paraqesë një ankesë pranë shoqërisë së sigurimit.

2. Shoqëria e sigurimit i përgjigjet çdo ankese të depozituar me shkrim apo në formë elektronike dhe jep çdo informacion të kërkuar që ka lidhje me kontratën e sigurimit, brenda 15 ditëve pune nga data e marrjes së kërkesës.

3. Shoqëria e sigurimit krijon një sistem të brendshëm për trajtimin e ankesave dhe procedura të brendshme për trajtimin dhe zgjidhjen e këtyre ankesave.

4. Ankesat trajtohen në mënyrë të paanshme dhe brenda afatit të përcaktuar në pikën 2 të këtij neni.

5. I siguruari apo personi tjetër i interesuar ka të drejtë t'i drejtohet Autoritetit për çdo pakënaqësi të trajtimit të ankesës së tij nga shoqëria e sigurimit. I siguruari apo personi tjetër i interesuar mund t'i drejtohet Autoritetit edhe për ankesa ndaj ndërmjetësve në sigurime apo vlerësuesve të dëmeve.

6. Autoriteti, kur e gjykon të nevojshme, i kthen për rishqyrtim shoqërisë së sigurimit çështjen e ankimit. Autoriteti, brenda kompetencave të tij mbikëqyrëse, ka të drejtë të kontrollojë nëse shoqëria e sigurimit zbaton kërkesat e ligjit dhe kushtet e kontratës së sigurimit.

7. Procedurat dhe shqyrtimi i ankimit përcaktohen me rregullore nga ana e Autoritetit.

## Neni 70

### **Zgjidhja e mosmarrëveshjeve**

1. Shoqëria e sigurimit harton dhe miraton procedura të brendshme të përshtatshme që do të zbatohen nga shoqëria e sigurimit në rastet kur palët bien dakord që mosmarrëveshjet ndërmjet të siguarve apo konsumatorëve me shoqërinë e sigurimit apo ndërmjetësit të zgjidhen në mënyrë jashtëgjyqësore.

2. Shoqëria e sigurimit publikon informacionin për rregullat e zgjidhjes jashtëgjyqësore të mosmarrëveshjeve si pjesë e kushteve të kontratës së sigurimit.

3. Në rastet e lindjes së mosmarrëveshjes, për shkak të paqartësive të krijuara nga gjuha e përdorur në hartimin e kushteve të kontratës së sigurimit, të hartuara nga siguruasi, zgjidhja e mosmarrëveshjeve do të bëhet duke interpretuar kushtet në favor të të siguarit.

4. Ekzekutimi i vlerës së dëmshpërblimit, që rrjedh nga kontrata e sigurimit vullnetar e të detyrueshëm dhe deklarimi formal i pranimit të vlerës nga pala e dëmtuar apo përfituese, shuajnë përfundimisht detyrimin e shoqërisë siguroese. Pala përfituese e dëmshpërblimit nuk ka të drejtë të kërkojë vlerë tjetër dëmshpërblimi, të ndryshme nga ajo që ka pranuar me vullnet të lirë nëpërmjet nënshkrimit të marrëveshjes dhe/ose deklaratës së pranimit të vlerës.

## KREU V

### SEKRETI PROFESIONAL

## Neni 71

### **Konfidencialiteti**

Shoqëria e sigurimit dhe ndërmjetësit janë të detyruar të ruajnë konfidencialitetin e të dhënave, fakteve dhe rrethanave që kanë të bëjnë me të siguarit, të dhëna me të cilat njihen gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre.

## Neni 72

### **Detyrimi për ruajtjen e konfidencialitetit**

1. Anëtarët e këshillit të administrimit/mbikëqyrës, administratori/anëtari i bordit të drejtorëve, funksionarët kryesorë, drejtorët, aksionarët, të punësuarit dhe çdo person tjetër i shoqërisë së sigurimit dhe ndërmjetësimit, si dhe Byroja Shqiptare e Sigurimit, të cilët gjatë ushtrimit të veprimtarisë përdorin të dhënat e përcaktuara në nenin 71, të këtij ligji, nuk duhet t'ia japin ato palëve të treta, t'i përdorin kundër interesave të shoqërisë së sigurimit dhe konsumatorëve të saj, apo të mundësojnë përdorimin e tyre nga palë të treta.

2. Detyrimi për ruajtjen e konfidencialitetit nuk zbatohet nëse:

- a) i siguarit miraton shprehimisht me shkrim nxjerrjen e tyre;
- b) të dhënat kërkohen në procese gjyqësore dhe një kërkesë e tillë është bërë me shkrim nga gjykata kompetente;
- c) të dhënat kërkohen në procese hetimore nga organi i prokurorisë;



ç) në rastet e parashikuara në ligjin nr. 9917, datë 19.5.2008, “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”, të ndryshuar, dhe aktet nënligjore në zbatim të tij;

d) informacioni kërkohet nga Autoriteti ose nga autoritetet e tjera mbikëqyrëse, me qëllim ushtrimin e mbikëqyrjes brenda kompetencave të tyre;

dh) informacioni kërkohet nga organet tatimore;

e) informacioni kërkohet sipas dispozitave të ligjit nr. 10 076, datë 12.2.2009, “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit”, të ndryshuar.

3. Detyrimi për ruajtjen e konfidencialitetit zbatohet edhe pasi personat e përmendur në pikën 1, të këtij neni, largohen nga shoqëria e sigurimit apo nëse nuk janë më aksionarë, anëtarë të këshillit të administrimit/mbikëqyrës, administratorë/anëtarë të bordit të drejtorëve apo drejtorë, me përjashtim të rasteve të parashikuara në pikën 2 të këtij neni.

4. Detyrimi për ruajtjen e konfidencialitetit zbatohet edhe për ndërmjetësit në sigurime.

5. Autoriteti, autoritetet e tjera mbikëqyrëse, organet hetimore dhe gjyqësore e përdorin informacionin e parashikuar në pikën 2, të këtij neni, vetëm për qëllimet për të cilat është dhënë informacioni.

Neni 73

### **Përdorimi i të dhënave personale**

Shoqëria e sigurimit mbledh, ruan, depoziton dhe përdor të dhënat personale, të cilat janë të nevojshme për nënshkrimin e policave të sigurimit dhe për zgjidhjen e ankesave që rrjedhin nga çdo çështje sigurimi, sipas këtij ligji, në përputhje me ligjin nr. 9887, datë 10.3.2008, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, të ndryshuar, dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.

## **KREU VI**

### **ADMINISTRIMI I RREZIKUT**

#### **Seksioni I**

### **Dispozita të Përgjithshme**

Neni 74

### **Rregullat e administrimit të rrezikut**

1. Shoqëria e sigurimit zotëron në çdo kohë një nivel të mjaftueshëm kapitali, në raport me volumin dhe klasat e sigurimit në të cilat ushtron veprimtari, si dhe natyrën e rreziqeve ndaj të cilave është e ekspozuar.

2. Shoqëria e sigurimit ushtron veprimtarinë e saj në mënyrë që të garantojë se rreziqet, ndaj të cilave shoqëria është e ekspozuar në një klasë të caktuar apo në të gjitha klasat e sigurimit, nuk tejkalojnë asnjëherë vlerat apo kufijtë e përcaktuar në këtë ligj apo në aktet e Autoritetit.

3. Shoqëria e sigurimit ushtron veprimtarinë e vet në mënyrë që të përmbushë detyrimet e saj, kur u vjen afati i pagimit (parimi i likuiditetit), si dhe të përmbushë në kohë e në vazhdimësi të gjitha detyrimet e saj (parimi i aftësisë paguese).

4. Shoqëria e sigurimit harton dhe miraton politika e procedura të qarta dhe të hollësishme për identifikimin, matjen, monitorimin dhe parandalimin e rreziqeve, ndaj të cilave ekspozohet gjatë ushtrimit të veprimtarisë.

## Seksioni II

### **Kapitali i shoqërisë së sigurimit**

#### Neni 75

### **Kapitali i shoqërisë së sigurimit**

1. Për qëllime të zbatimit të rregullave të administrimit të rrezikut, kapitali i shoqërisë së sigurimit, i quajtur më poshtë kapitali, llogaritet në përputhje me metodologjinë e përcaktuar në këtë ligj apo në aktet e Autoritetit.

2. Shoqëria e sigurimit, gjatë gjithë veprimtarisë së saj, zotëron një kapital të mjaftueshëm që përbën dhe aftësinë paguese të saj.

3. Aftësia paguese përbëhet nga aktivet e shoqërisë së sigurimit, të lira nga çdo përgjegjësi e parashikueshme, duke zbritur prej tyre çdo aktiv të patrupëzuar.

4. Për llogaritjen e kapitalit të shoqërisë së sigurimit merren parasysh elementet e kapitalit bazë, të përcaktuara në nenin 76, të këtij ligji, elementet e kapitalit shtesë të përmendur në nenin 77, të këtij ligji, si dhe elementet e zbritshme të përmendura në nenin 79 të këtij ligji.

#### Neni 76

### **Kapitali bazë**

1. Në llogaritjen e kapitalit bazë të shoqërisë së sigurimit përfshihen elementet e mëposhtme:

a) kapitali aksionar i shoqërisë së sigurimit, i cili përbëhet nga aksionet e zakonshme të emetuara;

b) rezervat e kapitalit, të cilat nuk i korrespondojnë detyrimeve që rrjedhin nga kontratat e sigurimit;

c) fitimi i pashpërndarë, i mbartur pas zbritjes së dividendëve të pagueshëm.

2. Në llogaritjen e kapitalit bazë të shoqërisë së sigurimit nuk përfshihen elementet e mëposhtme:

a) aksionet e veta të riblera;

b) investimet në aktive të patrupëzuara;

c) humbjet e mbartura dhe humbja e vitit ushtrimor;

ç) diferenca midis provigjoneve të dëmeve të skontuara dhe të paskontuara.

3. Përrjashtimisht nga rregulli i parashikuar në shkronjën “ç”, të pikës 2, të këtij neni, diferenca midis provigjoneve teknike të skontuara dhe të paskontuara nuk quhet element i zbritshëm në llogaritjen e kapitalit bazë për klasat e sigurimit, të përcaktuara

në aneksin I, seksionin A, klasat 1 dhe 2 dhe as për provigjonet e anuiteteve të përcaktuara në seksionin B, klasa 22, të këtij ligji.

4. Autoriteti mund të miratojë rregulla për përcaktimin e metodës dhe llojeve të elementeve të veçanta që merren parasysh në llogaritjen e kapitalit bazë, sipas këtij neni.

#### Neni 77

### **Kapitali shtesë**

1. Në llogaritjen e kapitalit shtesë të shoqërisë së sigurimit përfshihen elementet e mëposhtme:

a) kapitali aksionar i shoqërisë së sigurimit, i cili përbëhet nga aksionet me përparësi të akumuluar;

b) instrumente të borxhit të varur;

c) rezerva kapitali që lidhen me aksionet me përparësi të akumuluar;

ç) elemente të tjera.

2. Instrumente të borxhit të varur janë titujt dhe instrumentet e tjera financiare, të cilat i japin të drejtë mbajtësit të tyre që, në rast të falimentimit apo likuidimit të emetuesit, të paguhet vetëm pas shlyerjes së kërkesave për dëmshpërblim të kreditorëve të tjerë.

3. Elemente të tjera, të përmendura në shkronjën “ç”, të pikës 1, të këtij neni, janë rezervat e lindura nga vlerësimi i aktiveve që nuk kanë natyrë të jashtëzakonshme.

4. Autoriteti mund të miratojë rregulla për përcaktimin e metodës dhe llojeve të zërave të tjerë që do të përfshihen në llogaritjen e kapitalit shtesë, si dhe të tipareve të instrumenteve të borxhit të varur.

#### Neni 78

### **Investimet**

1. Shoqëria e sigurimit harton, miraton dhe zbaton politika investimi dhe huadhënieje, standarde dhe procedura, që një person profesionist i arsyeshëm dhe i kujdesshëm do të zbatonte në lidhje me portofolin e investimeve dhe huave, me qëllim shmangien e rrezikut të tepërt të humbjes dhe arritjen e një kthimi të arsyeshëm nga investimi. Këto politika duhet të jenë të shkruara, të disponueshme për inspektim dhe shqyrtohen të paktën një herë në vit.

2. Shoqëria e sigurimit investon vetëm në aktive dhe instrumente në lidhje me portofolin e aktiveve në tërësi, rreziqet e të cilave shoqëria mund t'i identifikojë në mënyrën e duhur, t'i masë, t'i monitorojë, t'i administrojë, t'i kontrollojë e t'i raportojë, si dhe t'i marrë parasysh në mënyrë të përshtatshme në vlerësimin e kërkesave të aftësisë paguese.

3. Të gjitha aktivet investohen në mënyrë që të garantohen siguria, cilësia, likuiditeti dhe fitueshmëria e portofolit si i tërë dhe të jenë lehtësisht të disponueshme për inspektim nga Autoriteti.

4. Aktivët duhet të jenë të diversifikuara në mënyrë të përshtatshme për të shmangur përqendrimin e tepërt mbi një aktiv, emetues ose grup shoqërisht, ose hapësirë gjeografike të veçantë, si dhe grumbullimin e tepërt të rrezikut në portofolin si i tërë.

5. Investimet dhe aktivet, të cilat nuk janë të tregtueshme në tregjet financiare të rregulluara, mbahen në një nivel të kujdesshëm, sipas kufizimeve të përcaktuara në rregulloret e Autoritetit.

6. Autoriteti miraton rregulla, në lidhje me kategoritë e investimeve të lejuara, si dhe kufijtë që zbatohen për investimin e aktiveve.

7. Përfundimisht, nga pikat 1 deri 6, të këtij neni, në rastin e aktiveve të mbajtura për kontratat e sigurimit të jetës, ku rreziku i investimit mbahet nga vetë i siguruari, zbatohen përcaktimet e nenit 104 të këtij ligji.

## Neni 79

### Elementet e zbritshme në llogaritjen e kapitalit

1. Në llogaritjen e kapitalit të shoqërisë së sigurimit, vlera që rezulton nga shuma e kapitalit bazë dhe kapitalit shtesë zvogëlohet me elementet e mëposhtme:

a) pjesëmarrje dhe instrumente të borxhit të varur në një tjetër shoqëri sigurimi, risigurimi, grupi kontrollues sigurimi, banka dhe/ose degë të bankave të huaja, shoqëri komisionere, shoqëri administruese dhe institucione të tjera financiare, në të cilat shoqëria e sigurimit zotëron pjesëmarrje influencuese mbi 10 për qind;

b) investime të tjera në personat e parashikuar në shkronjën “a”, të kësaj pike, që janë përfshirë në llogaritjen e kapitalit të personave përkatës;

c) pjesëmarrjet dhe titujt e borxhit të varur, si dhe investime të tjera në një shoqëri tjetër sigurimi ose ente financiare, të tjera nga ato të parashikuara në shkronjën “a”, të kësaj pike, të cilat kalojnë masën 10 për qind të kapitalit të shoqërisë së sigurimit, e llogaritur përpara zbritjes së elementeve të përmendura në shkronjat “a” dhe “b” të kësaj pike;

ç) aktivet jolikuide.

2. Aktive jolikuide janë:

a) aksionet e palistuara në tregje të rregulluara;

b) huatë/llogaritë e arkëtueshme me palë të lidhura;

c) huatë nga brokerat dhe agjentët;

ç) primet e arkëtueshme ose debitorë nga risigurimi, që kanë tejkaluar afatin 90-ditor;

d) debitorë të tjerë ose llogari të tjera të arkëtueshme, të cilat nuk rrjedhin drejtpërsëdrejti nga veprimtaria e sigurimit;

dh) inventari;

e) shpenzimet e shtyra të marrjes në sigurim;

ë) shpenzimet e parapaguara;

f) aktivet e tjera, të cilat nuk janë të lira nga çdo përgjegjësi apo detyrim i parashikuar;

g) aktivet e tjera, të cilat nuk janë lehtësisht të kthyeshme në para në momentin kur është e nevojshme përmbushja e detyrimeve financiare kur u vjen afati.

3. Autoriteti mund të miratojë rregulla më të detajuara për elementet e zbritshme në llogaritjen e kapitalit dhe klasat e aktiveve ku ato zbatohen.

## Seksioni III

### **Mjaftueshmëria e kapitalit**

#### Neni 80

#### **Niveli i kërkuar i aftësisë paguese**

1. Kapitali i shoqërisë së sigurimit, që ushtron veprimtari sigurimi dhe risigurimi gjatë gjithë veprimtarisë së shoqërisë, nuk duhet të jetë më i ulët se niveli i kërkuar i aftësisë paguese të shoqërisë.

2. Niveli i kërkuar i aftësisë paguese të shoqërisë së sigurimit është vlera më e lartë midis fondit të garancisë, sipas përcaktimeve të nenit 81, dhe 150 për qind të kufirit minimal të aftësisë paguese, të llogaritur sipas parashikimeve të këtij ligji dhe akteve të Autoritetit.

3. Kufiri minimal i aftësisë paguese të shoqërisë së sigurimit, që ushtron veprimtari në klasat e jojetës, llogaritet sipas metodave të përcaktuara me rregullore nga Autoriteti. Kufiri minimal i aftësisë paguese të shoqërisë së sigurimit, që ushtron veprimtari sigurimi në klasat e jetës, llogaritet sipas metodave të përcaktuara me rregullore nga Autoriteti.

#### Neni 81

#### **Fondi i garancisë**

1. Fondi i garancisë i shoqërisë së sigurimit përbëhet nga kapitali bazë, i parashikuar në nenin 76, të këtij ligji, dhe kapitali shtesë, i parashikuar në nenin 77, pika 1, të këtij ligji, dhe miratohet nga Autoriteti.

2. Fondi i garancisë nuk duhet të jetë më pak se 1/3 e kufirit minimal të aftësisë paguese, të përcaktuar në nenin 80 të këtij ligji.

3. Pavarësisht nga përcaktimet në pikat 1 dhe 2 të këtij neni:

a) fondi i garancisë së një shoqërie sigurimi jojete nuk mund të jetë më i ulët se 260 milionë lekë. Në rastin kur një ose disa rreziqe përfshihen në klasat 10 deri në 15 të seksionit A, të aneksit I, bashkëlidhur këtij ligji, fondi i garancisë nuk mund të jetë më i ulët se 370 milionë lekë;

b) fondi i garancisë së një shoqërie sigurimi nuk mund të jetë më i ulët se 370 milionë lekë, nëse shoqëria e sigurimit ushtron veprimtari sigurimi të jetës, sipas klasifikimit të seksionit B, të aneksit I, bashkëlidhur këtij ligji;

c) fondi i garancisë së një shoqërie risigurimi nuk mund të jetë më i ulët se 370 milionë lekë;

ç) kufiri minimal i fondit të garancisë së shoqërisë së sigurimit, që mbulon rreziqet e disa klasave të sigurimit të jojetës, duhet të jetë i barabartë me vlerën e kufirit minimal të fondit të garancisë të klasës së sigurimeve, për të cilin është parashikuar kufiri më i lartë;

d) kufiri minimal i fondit të garancisë së shoqërisë së sigurimit, që mbulon më shumë se një nga veprimtaritë e përmendura në shkronjat “a”, “b”, dhe “c”, të kësaj pike, në përputhje me dispozitat e këtij ligji, është sa shuma e kufijve minimalë që i korrespondon çdonjëres prej këtyre veprimtarive, në përputhje me klasat, për të cilat shoqëria është e autorizuar.

4. Fondi i garancisë mbahet në një llogari bankare qëllimore garancie, të emërtuar “llogaria e fondit të garancisë”, në njërën nga bankat dhe/ose degët e bankave të huaja në territorin e Republikës së Shqipërisë.

5. Fondi i garancisë investohet vetëm në bono thesari dhe/ose depozita bankare, me afat maturimi jo më të vogël se 1 vit, dhe ka përshkrimin që nuk mund të preket pa miratimin paraprak të Autoritetit.

6. Çdo transaksion që ka të bëjë me fondin e garancisë nuk kryhet pa marrë miratimin paraprak të Autoritetit, pasi shoqëria e sigurimit të ketë paraqitur të gjitha informacionet e nevojshme të kërkuara nga Autoriteti. Çdo transaksion kryhet vetëm nëpërmjet transfertave bankare.

7. Autoriteti mund të miratojë rregulla për administrimin dhe rastet e ndërhyrjes në fondin e garancisë së shoqërisë së sigurimit.

#### Seksion IV

### **Masat e rimëkëmbjes financiare**

#### Neni 82

#### **Masat e marra nga këshilli i administrimit/mbikëqyrës të shoqërisë së sigurimit për të arritur nivelin e kërkuar të aftësisë paguese**

1. Nëse kapitali i shoqërisë së sigurimit nuk është i mjaftueshëm, për shkak të rritjes së nivelit të kërkuar të aftësisë paguese ose arsyeve të tjera, këshilli i administrimit/mbikëqyrës i shoqërisë së sigurimit merr menjëherë masat e nevojshme për të arritur nivelin e kapitalit të kërkuar ose propozon masa, sipas strukturave përgjegjëse të shoqërisë.

2. Këshilli i administrimit/mbikëqyrës të shoqërisë së sigurimit njofton Autoritetin për masat e propozuara, sipas pikës 1, të këtij neni, brenda tetë ditëve kalendarike nga data e propozimit të tyre.

#### Neni 83

### **Plani i rimëkëmbjes financiare**

1. Në rastet kur rrezikohen interesat e të siguruarve dhe/ose niveli i kapitalit nuk është i mjaftueshëm, sipas përcaktimeve të neneve 80 dhe 81, të këtij ligji, Autoriteti mund t'i kërkojë shoqërisë së sigurimit të depozitojë një plan rimëkëmbjeje financiare, të shoqëruar me masat riorganizative të propozuara për të paktën tri vitet e ardhshme financiare, i cili përmban një ose disa nga elementet e mëposhtme:

a) vlerësim të shpenzimeve administrative, si dhe krahasime me shpenzimet e përgjithshme aktuale dhe komisionet;

b) vlerësim të detajuar të të ardhurave dhe shpenzimeve që rrjedhin nga veprimtaria e drejtpërdrejtë e sigurimit dhe/ose vlerësim të detajuar të të ardhurave dhe shpenzimeve të pranimeve dhe cedimeve të risigurimit;

c) parashikim të pasqyrave financiare dhe të llogarisë fitim/humbje;

ç) llogaritjen e kapitalit dhe fondit të garancisë, sipas përcaktimeve të neneve 75 dhe 81 të këtij ligji;

d) llogaritjen e nivelit të kërkuar të aftësisë paguese, sipas përcaktimeve të nenit 80 të këtij ligji;

dh) vlerësim të burimeve financiare për mbulimin e nivelit të kërkuar të aftësisë paguese dhe për mbulimin e përgjegjësive nga marrja në sigurim;

e) strategjinë e përgjithshme të risigurimit apo të retrocedimit.

2. Në kuptim të këtij ligji, masat riorganizative nënkuptojnë masat që kanë qëllim mbajtjen apo rivendosjen e gjendjes së shëndoshë financiare të shoqërisë së sigurimit.

3. Plani i rimëkëmbjes financiare paraqitet për miratim në Autoritet, brenda afateve të përcaktuara nga Autoriteti. Autoriteti merr vendim për miratimin ose refuzimin e planit të rimëkëmbjes financiare, brenda 1 muaji nga data e paraqitjes së tij.

4. Në rast të refuzimit të planit të rimëkëmbjes financiare, Autoriteti merr një ose disa nga masat e tjera të mbikëqyrjes, të parashikuara në nenin 152 të këtij ligji.

## Seksioni V

### **Administrimi i likuiditetit**

Neni 84

### **Administrimi i likuiditetit**

1. Shoqëria e sigurimit administron burimet financiare dhe investimet e saj në mënyrë të tillë që të sigurojë në çdo kohë përmbushjen e përgjegjësive kur u vjen afati i pagesës.

2. Shoqëria e sigurimit, me qëllim mbrojtjen ndaj rrezikut të likuiditetit, miraton dhe zbaton politika për administrimin sistematik të likuiditetit, që përfshijnë:

a) planifikimin e fluksit monetar të pritshëm dhe të mundshëm;

b) monitorim sistematik të likuiditetit;

c) zbatim të masave të përshtatshme për parandalimin dhe eliminimin e shkaqeve të mungesës së likuiditetit.

3. Shoqëria e sigurimit llogarit shumat e fondeve likuide mbi baza ditore.

4. Shoqëria e sigurimit llogarit normat e likuiditetit dhe nivelin minimal të tyre mbi bazën e metodave të përcaktuara me rregullore nga Autoriteti.

Neni 85

### **Llogaritja dhe raportimi**

1. Shoqëria e sigurimit llogarit dhe harton periodikisht:

a) kapitalin;

b) fondin e garancisë;

c) nivelin e kërkuar të aftësisë paguese, të shoqëruar me opinionin e aktuarit të autorizuar;

ç) provigjonet teknike, të shoqëruara me opinionin e aktuarit të autorizuar;

d) vlerën dhe llojin e investimeve, të cilat nuk financohen nga primi i rrezikut;

dh) vlerën e aktiveve në mbulim të provigjoneve teknike;

e) tipin, shpërndarjen, përputhjen e aktiveve me detyrimet dhe vendndodhjen e aktiveve në mbulim të provigjoneve teknike dhe matematike;

- ë) normat e likuiditetit;
  - f) rreziqet e marra për çdo klasë sigurimi;
  - g) risigurimin e ceduar;
  - gj) të dhëna statistikore për sigurimin;
  - h) pasqyrat dhe raportet financiare mbi rezultatet e veprimtarisë së shoqërisë së sigurimit;
  - i) informacione të tjera të kërkuara nga Autoriteti.
2. Niveli i kërkuar i aftësisë paguese për çdo tremujor llogaritet sipas parashikimeve të nenit 80, të këtij ligji, ku kufiri minimal i aftësisë paguese për çdo tre mujor llogaritet sipas rregullores në zbatim të nenit 80 të këtij ligji.
3. Autoriteti miraton rregulla për metodën, mënyrën, përmbajtjen, formën dhe afatet e raportimeve, sipas parashikimeve të këtij neni.

## Neni 86

### **Ndalimi i shpërndarjes së fitimit**

Shoqëria e sigurimit ndalohe të shpërndajë fitime në formën e dividendëve ose të dividendëve të ndërmjetëm ose në formën e pagesave të bazuara në pjesëmarrjen në fitim të anëtarëve të këshillit të administrimit/mbikëqyrës të shoqërisë apo punonjësve të tjerë, në rastet kur:

- a) kapitali i shoqërisë së sigurimit është nën nivelin e kërkuar të aftësisë paguese, sipas përcaktimit të nenit 80 të këtij ligji;
- b) kapitali i shoqërisë së sigurimit, si rezultat i shpërndarjes së fitimit, bie nën nivelin e kërkuar të aftësisë paguese, sipas përcaktimit të nenit 80 të këtij ligji;
- c) shoqëria e sigurimit nuk garanton dot nivelin minimal të likuiditetit, sipas përcaktimit të nenit 84 të këtij ligji;
- ç) shoqëria e sigurimit, si rezultat i shpërndarjes së fitimit, nuk garanton dot nivelin minimal të likuiditetit, sipas përcaktimit të nenit 84 të këtij ligji;
- d) shoqëria e sigurimit nuk ka zbatuar masat e urdhëruara nga Autoriteti për korrigjimin e pasqyrit jo të saktë të zërave të aktiveve dhe përgjegjësive në pasqyrat financiare, që ndikojnë në rezultatin e veprimtarisë të shoqërisë.

## Seksioni VI

### **Primet e sigurimit**

## Neni 87

### **Primi i sigurimit të jojetës**

1. Primi i sigurimit të jojetës përbëhet nga:
- a) primi i rrezikut;
  - b) pjesa e llogaritur për mbulimin e shpenzimeve të marrjes në sigurim dhe shpenzimeve administrative, përfshirë dhe komisionet;
  - c) pjesa e llogaritur për fitimin e shoqërisë së sigurimit.
2. Primi i rrezikut është pjesa e primit, e llogaritur për pagimin e dëmeve, sipas dispozitave të përcaktuara në kontratat e sigurimit.



3. Shoqëria e sigurimit depoziton në Autoritet, me kërkesë të këtij të fundit, bazat teknike dhe vlerësimet aktuariale të përdorura për llogaritjen e primeve të sigurimit dhe për produktet e sigurimit të jojetës, të shoqëruara me opinionin e aktuarit të autorizuar të shoqërisë.

Neni 88

### **Primi i sigurimit të jetës**

1. Primi i sigurimit i jetës përbëhet nga:
  - a) primi i rrezikut;
  - b) pjesa e llogaritur e primit për provigjonet matematike – elementet e kursimit;
  - c) pjesa e llogaritur për mbulimin e shpenzimeve të marrjes në sigurim dhe shpenzimeve administrative, përfshirë dhe komisionet;
  - ç) pjesa e llogaritur për fitimin e shoqërisë së sigurimit, përfshirë këtu fitimin nga investimet, duke marrë parasysh rrezikun që i përket këtyre investimeve.
2. Autoriteti ka të drejtë të rekomandojë bazën e të dhënave statistikore dhe kufijtë për parametrat që përdoren në llogaritjen e primit për shoqëritë e sigurimit që ushtrojnë veprimtarinë e sigurimit të jetës.
3. Parashikimet e nenit 87, pika 3, të këtij ligji, zbatohen edhe për primet e sigurimit të jetës.

Seksioni VII

### **Provigjonet teknike**

Neni 89

### **Provigjonet teknike**

1. Shoqëria e sigurimit krijon dhe mban gjatë gjithë veprimtarisë së saj provigjone teknike të mjaftueshme për të mbuluar në kohë përgjegjësitë e nënshkuara dhe humbjet nga rreziqet, që rrjedhin nga kontratat e sigurimit. Provigjonet teknike llogariten bruto, pa zbritur risigurimet e ceduara, në përputhje me parimet aktuariale dhe rregullat e miratuara nga Autoriteti.
2. Shoqëria e sigurimit krijon llojet e mëposhtme të provigjoneve teknike:
  - a) provigjone për prime, të cilat përbëhen nga provigjonet për primet e pafituara dhe për rreziqe të paskaduara;
  - b) provigjone për bonuse dhe rabate;
  - c) provigjone teknike të dëmeve;
  - ç) provigjone për mbrojtjen për rrezikun ndaj investimit;
  - d) provigjone teknike të tjera.
3. Shoqëria e sigurimit mund të krijojë provigjoneve e barazimit të dëmeve, pasi të ketë marrë miratimin e Autoritetit.
4. Përjashtimisht nga përcaktimi i pikës 3, të këtij neni, shoqëria e sigurimit krijon provigjoneve e barazimit të dëmeve nëse ushtron veprimtari në klasën 14, të seksionit A, aneksi I, bashkëlidhur këtij ligji.
5. Provigjonet matematike krijohen nga shoqëria e sigurimit që ushtron veprimtari në sigurimin e jetës apo në klasa të tjera sigurimi, ku primet janë

grumbulluar në formën e një fondi kursimi ose një fondi për t'u përdorur për mbulimin e rreziqeve të viteve të ardhshme, të cilat janë të natyrës afatgjatë dhe janë subjekt i tabelave të probabilitetit dhe llogaritjeve të njëjta me ato të sigurimit të jetës.

6. Shoqëria e sigurimit krijon provigjone teknike të veçanta në rastet kur nënshkruan kontrata sigurimi, ku i siguruari mban rrezikun e investimit.

7. Pjesa e risiguruesit në provigjonet teknike përfshin provigjonet për primet e risigurimit dhe provigjonet e dëmeve të risigurimit dhe llogariten në përputhje me kushtet e kontratës së risigurimit, duke u bazuar në shumat bruto të provigjoneve teknike. Provigjonet e primeve, që lidhen me kontratat e ceduara në risigurim, llogariten sipas klasave të sigurimit, në përputhje me metodat e zgjedhura nga shoqëria e sigurimit për llogaritjen e provigjoneve të primeve bruto.

8. Provigjonet teknike të shoqërisë së sigurimit krijohen përpara nxjerrjes së rezultateve financiare të vitit financiar.

9. Shoqëria e sigurimit depoziton në Autoritet llogaritjen e provigjoneve teknike dhe matematike dhe Autoriteti miraton mjaftueshmërinë e tyre. Nëse Autoriteti gjykon se provigjonet teknike dhe matematike nuk janë të mjaftueshme, urdhëron shoqërinë e sigurimit të mbajë dhe të pasqyrojë provigjonet teknike dhe matematike në vlerën e miratuar nga Autoriteti.

10. Shoqëria e sigurimit, që ushtron njëkohësisht veprimtari sigurimi dhe risigurimi, krijon provigjone teknike për risigurimin në fund të çdo viti, në përputhje me përgjegjësitë e marra përsipër.

11. Në rastet e bashkësigurimit, provigjonet teknike krijohen nga palët në kontratën e bashkësigurimit, në përputhje me pjesën përkatëse të përgjegjësisë të marra përsipër nga ana e tyre.

12. Bazat dhe metodat e llogaritjes, mënyrat e mbajtjes së provigjoneve teknike dhe matematike, si dhe kriteret dhe procedurat e miratimit të tyre përcaktohen me rregullore të miratuar nga Autoriteti.

Neni 90

### **Provigjonet për primet**

1. Provigjonet për primet e pafituara dhe provigjonet për rreziqet e paskaduara përbëjnë së bashku provigjonet për primet.

2. Provigjonet për primet e pafituara për çdo klasë sigurimi krijohen në përpjesëtim me primet e shkruara që lidhen me mbulimet e sigurimit, të cilat janë ende të vlefshme pas përfundimit të periudhës financiare gjatë së cilës janë krijuar këto provigjone.

3. Përveç sa parashikohet në pikën 2, të këtij neni, shoqëria e sigurimit mund të krijojë provigjone për rreziqe të paskaduara. Nëse shoqëria e sigurimit mbulon rreziqe që lidhen me sigurimin e garancive dhe kredive, ngjarje të forcës natyrore, si dhe dëmtime të shkaktuara nga energjia bërthamore, ajo krijon provigjone shtesë për primet e pafituara për këto klasa, në përputhje me natyrën e veçantë të tyre.

## Neni 91

### **Provigjonet për bonuse dhe rabate**

Provigjonet për bonuse dhe rabate krijohen në nivel të njëjtë me shumën e pagesave që merr i siguruari bazuar në:

- a) të drejtën për përfitimet që rrjedhin nga kontratat e sigurimit ose të drejta të tjera (bonuse) që rrjedhin nga kontratat e sigurimit;
- b) të drejtën për reduktim të pjesshëm të primit të sigurimit (rabat);
- c) të drejtën e rimbursimit të një pjese të primit të sigurimit në rast të përfundimit të parakohshëm të kontratës së sigurimit.

## Neni 92

### **Provigjonet teknike të dëmeve**

1. Provigjonet teknike të dëmeve krijohen në nivel të njëjtë me përgjegjësitë e marra përsipër nga shoqëria e sigurimit nëpërmjet kontratave, kur ngjarja e siguar ndodh para përfundimit të periudhës financiare, duke përfshirë çdo shpenzim të pagueshëm nga shoqëria e sigurimit, të përcaktuar në kontratën e sigurimit.

2. Provigjonet teknike të dëmeve përfshijnë, gjithashtu, edhe përgjegjësitë për dëmet, të cilat kanë ndodhur, por nuk janë raportuar.

## Neni 93

### **Provigjonet matematike**

1. Provigjonet matematike krijohen në nivel të njëjtë me vlerën aktuale të detyrimeve të ardhshme, të vlerësuara nga shoqëria e sigurimit, që rrjedhin nga kontratat e sigurimit të jetës, duke zbritur vlerën aktuale të parashikuar për primet e ardhshme për t'u paguar sipas kontratës në fjalë.

2. Provigjonet matematike llogariten duke zbatuar vlerësimet e përshtatshme aktuariale, të cilat marrin parasysh të gjitha përgjegjësitë e ardhshme të shoqërisë së sigurimit që rrjedhin nga çdo kontratë e sigurimit të jetës, duke përfshirë:

- a) pagesa të garantuara, të cilat i siguruari ka të drejtë t'i përfitojë;
- b) bonuset, për të cilat i siguruari gëzon të drejtën kolektive ose individuale për t'i përfituar, pavarësisht nga forma e tyre;
- c) opsionet në dispozicion të të siguarit, të përcaktuara në kushtet e kontratës;
- ç) pjesën e llogaritur për mbulimin e shpenzimeve, përfshirë dhe komisione.

3. Gjatë përzgjedhjes së metodave të vlerësimit aktuarial, shoqëria e sigurimit merr parasysh, rast pas rasti, metodën e zbatuar për vlerësimin e aktiveve në mbulim të provigjoneve matematike.

4. Shoqëria e sigurimit llogarit provigjonet matematike për çdo kontratë sigurimi. Përafrimet ose përgjithësimet mund të zbatohen vetëm nëse gjykohet se zbatimi i tyre sjell një rezultat përafërsisht të njëjtë me atë të llogaritur veçmas.

5. Kur i siguruari, në bazë të kontratës së sigurimit, ka të drejtën e pagesës së vlerës së dorëzimit, provigjonet matematike, që krijohen duke iu referuar kësaj kontrate, nuk duhet të jenë nën vlerën e pagesës së dorëzimit.

6. Shoqëria e sigurimit, në shtojcën e raportit vjetor, shpjegon bazën teknike dhe metodën e përdorur për llogaritjen e provigjoneve matematike.

Neni 94

### **Provigjoni i barazimit të dëmeve**

1. Provigjoni i barazimit të dëmeve krijohet për balancimin e luhatjeve në rastin e ndodhjes së ngjarjeve që shkaktojnë dëme.

2. Shoqëria e sigurimit mund të krijojë provigjonin e barazimit të dëmeve për ato klasa të sigurimit, në të cilat ka një devijim të konsiderueshëm nga shumatat e zakonshme të dëmshpërblimeve të llogaritura mbi baza vjetore, devijim i cili, bazuar në të dhënat statistikore, është i pritshëm.

3. Provigjoni i barazimit të dëmeve krijohet bazuar në devijimin e masës së dëmshpërblimeve të pritshme për periudhën financiare nga masa mesatare e dëmshpërblimeve për të njëjtën periudhë.

Neni 95

### **Provigjone të tjera teknike**

Shoqëria e sigurimit krijon provigjone të tjera teknike, me qëllim për të mbuluar përgjegjësitë e pritshme dhe rreziqet për dëme të mëdha, të cilat rrjedhin nga sigurimi i përgjegjësisë për humbje nga rreziqe bërthamore, përgjegjësinë e prodhuesit të produkteve farmaceutike, rreziqet e përmbytjes dhe tërmetit, si dhe rreziqe apo përgjegjësi të tjera, për të cilat nuk krijohen provigjonet e përmendura në pikat 2, shkronjat “a”, “b” dhe “c”, 3 dhe 4, të nenit 89, të këtij ligji.

Seksioni VIII

### **Aktivet në mbulim të provigjoneve teknike**

Neni 96

### **Aktivet në mbulim të provigjoneve teknike**

1. Shoqëria e sigurimit duhet të mbajë aktive të mjaftueshme në mbulim të provigjoneve teknike, sipas parashikimeve të këtij seksioni.

2. Aktivitetet në mbulim të provigjoneve teknike janë aktivitetet e shoqërisë së sigurimit, të cilat shërbejnë për mbulimin e përgjegjësive të ardhshme që rrjedhin nga kontratat e sigurimit dhe që mbulojnë humbje, si pasojë e rreziqeve që lindin nga ushtrimi i veprimtarisë së shoqërisë së sigurimit, për të cilat kjo e fundit detyrohet të krijojë provigjone teknike.

3. Vlera e aktiveve në mbulim të provigjoneve teknike duhet në çdo kohë të jetë jo më e vogël se shumata bruto e provigjoneve teknike.

4. Aktivitetet në mbulim të provigjoneve teknike dhe matematike janë të barabarta me përgjegjësitë që rrjedhin nga kontratat e sigurimit, për sa i përket shumës dhe monedhës përkatëse.

### **Lloji i investimeve të lejuara të aktiveve në mbulim të provigjoneve teknike**

1. Shoqëria e sigurimit lejohet të mbulojë provigjonet teknike, të ndryshme nga ato matematike, me aktivet e listuara më poshtë:

a) tituj të emetuar nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë ose Banka e Shqipërisë;

b) obligacione dhe tituj të tjerë borxhi, të garantuar nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë;

c) obligacione dhe tituj të tjerë borxhi, të emetuar nga qeverisja vendore e Republikës së Shqipërisë;

ç) obligacione dhe tituj të tjerë borxhi, të shoqëruara nga garanci të emetuara nga qeverisja vendore e Republikës së Shqipërisë;

d) obligacione dhe tituj të tjerë borxhi, të tregtuar në tregje të rregulluara në Republikën e Shqipërisë

dh) obligacione dhe tituj të tjerë borxhi, të cilët nuk tregtohen në tregje të rregulluara në Republikën e Shqipërisë, nëse emetuesi i tyre është person juridik, me seli qendrore në Republikën e Shqipërisë;

e) aksione të tregtuara në tregje të rregulluara në Republikën e Shqipërisë;

ë) aksione, të cilat nuk tregtohen në tregje të rregulluara në Republikën e Shqipërisë, nëse emetuesi i tyre është person juridik, me seli qendrore në Republikën e Shqipërisë;

f) kuota/aksione të sipërmarrjeve të investimeve kolektive të regjistruara në Republikën e Shqipërisë;

g) hua të siguruara dhe të pasiguruara në Republikën e Shqipërisë, vetëm pas përmbushjes së kushteve të përcaktuara me rregullore nga Autoriteti;

gj) toka, ndërtesa dhe të drejta në pasuri të paluajtshme në Republikën e Shqipërisë nëse plotësohen njëkohësisht kërkesat e mëposhtme:

i) toka është e regjistruar nga Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme në emër të shoqërisë së sigurimit;

ii) pasuria e paluajtshme jep kthim nga investimi ose pritjet të japë kthim nga investimi;

iii) çmimi i blerjes është përcaktuar mbi bazën e vlerësimit të ekspertit përkatës;

iv) pasuria nuk është e vendosur si kolateral, apo nuk është vënë peng mbi të, si dhe është e lirë nga çdo barrë tjetër.

h) depozita në banka dhe/ose degë të bankave të huaja, me seli qendrore në Republikën e Shqipërisë.

2. Në zgjedhjen e llojit të investimeve të aktiveve në mbulim të provigjoneve teknike, shoqëria e sigurimit merr parasysh llojin e veprimtarisë së ushtruar, në mënyrë që të garantojë sigurinë, kthimin, likuiditetin dhe tregtueshmërinë e investimeve, si dhe të sigurojë diversifikimin dhe shpërndarjen e përshtatshme të tyre.

3. Me miratimin paraprak të Autoritetit, aktivet në mbulim të provigjoneve teknike, duke përjashtuar ato matematike, mund të investohen edhe në:

a) obligacione afatgjata dhe tituj borxhi afatgjatë të emetuar nga një vend anëtar ose vend anëtar i OECD-së;

b) obligacione afatgjata dhe tituj afatgjatë të emetuar nga një entitet joqeveritar i një vendi anëtar ose vendi anëtar të OECD-së;

c) aksione të emetuara nga një shoqëri aksionare e huaj, e cila tregton në tregje të rregulluara të kapitalit në një vend anëtar ose vend anëtar të OECD-së;

ç) kuota/aksione të sipërmarrjeve të investimeve kolektive, të cilat tregtohen në një vend anëtar ose vend anëtar të OECD-së.

4. Në raste të veçanta dhe me kërkesë të shoqërisë së sigurimit, Autoriteti mund të miratojë përkohësisht me një vendim të arsyetuar dhe lloje të tjera aktiveve për të mbuluar provigjonet teknike, nëse këto aktive kanë natyrë të sigurt dhe të cilat diversifikohen dhe shpërndahen në mënyrë të përshtatshme.

5. Autoriteti miraton rregulla në lidhje me llojet dhe karakteristikat e aktiveve në mbulim të provigjoneve teknike, kategori të tjera investimesh të aktiveve në mbulim të provigjoneve teknike, rregulla për diversifikimin dhe kufizimin në lidhje me investimin e këtyre aktiveve, si dhe rregulla për vlerësimin e këtyre aktiveve.

#### Neni 98

### **Përputhja e investimeve**

1. Shoqëria e sigurimit përputh në mënyrë të përshtatshme vlerën e investimeve të aktiveve në mbulim të provigjoneve teknike dhe matematike, të cilat janë të ekspozuara ndaj rreziqeve të humbjeve të mundshme, si rezultat i ndryshimeve në normat e interesit, kurset e këmbimit dhe rreziqeve të tjera të tregut, me përgjegjësitë që rrjedhin nga kontratat e sigurimit, niveli i të cilave varet nga të njëjtat ndryshime.

2. Gjatë investimit të aktiveve në mbulim të provigjoneve teknike dhe matematike, shoqëria e sigurimit merr parasysh afatin për përmbushjen e përgjegjësisë që rrjedhin nga kontratat veçanta të sigurimit.

3. Përfundimisht nga pika 1, e këtij neni, shoqëria e sigurimit përputh jo më pak se 80 për qind të aktiveve në mbulim të provigjoneve matematike me përgjegjësitë që rrjedhin nga kontratat e sigurimit, niveli i të cilave varet nga ndryshimet e kursit të këmbimit.

4. Autoriteti nxjerr rregullore në lidhje me përputhjen e aktiveve në mbulim të provigjoneve teknike dhe matematike.

#### Neni 99

### **Përdorimi i instrumenteve financiare derivative**

1. Shoqëria e sigurimit në investimin e aktiveve në mbulim të provigjoneve teknike mund të përdorë instrumente financiare derivative, nëse ato zvogëlojnë rrezikun e përcaktuar në nenin 98, pika 1, të këtij ligji, ose nëse ato mundësojnë administrimin më efikas të portofolit.

2. Shoqëria e sigurimit raporton në Autoritet për përdorimin e instrumenteve financiare derivative.

3. Autoriteti miraton rregulla të detajuara për përdorimin e instrumenteve financiare derivative.

## Neni 100

### **Aktivet në mbulim të provigjoneve matematike**

1. Aktivet në mbulim të provigjoneve matematike janë aktive që mbulojnë përgjegjësitë, të cilat rrjedhin nga klasat e sigurimit të jetës, për të cilat shoqëria e sigurimit duhet të krijojë provigjone matematike.

2. Aktivet në mbulim të provigjoneve matematike përdoren vetëm për pagesën e dëmeve që rrjedhin nga kontratat e sigurimit të jetës, për të cilat janë krijuar këto provigjone.

## Neni 101

### **Mbulimi i kërkuar**

1. Mbulimi i kërkuar për provigjonet matematike përfshin, përveç provigjoneve matematike, provigjonet për primet e pafituara, provigjonet teknike të dëmeve dhe provigjonet për bonuset dhe rabatat.

2. Mbulimi i kërkuar llogaritet i veçantë për çdo klasë sigurimi, sipas përcaktimeve të nenit 102, pika 1, të këtij ligji.

## Neni 102

### **Detyrimi për të mbajtur veçmas aktive në mbulim të provigjoneve matematike**

1. Shoqëria e sigurimit, e cila ushtron aktivitet në klasat e jetës, për të cilat ka krijuar provigjonet matematike përkatëse, duhet të ketë aktive në mbulim të provigjoneve matematike dhe duhet t'i mbajë e t'i administrojë veçmas këto aktive nga aktivet e tjera.

2. Shoqëria e sigurimit duhet të garantojë që vlera e aktiveve në mbulim të provigjoneve matematike të jetë në çdo kohë e njëjtë me shumën e mbulimit të kërkuar. Në fund të çdo tremujori shoqëria e sigurimit duhet të rritë aktivet për llogari të aktiveve në mbulim të provigjoneve matematike nëse është e nevojshme për përputhjen e aktiveve në mbulim të provigjoneve matematike me shumën e mbulimit të kërkuar.

## Neni 103

### **Lloji i investimeve të lejuara të aktiveve në mbulim të provigjoneve matematike**

1. Shoqëria e sigurimit lejohet të mbulojë provigjonet e saj matematike me llojet e investimeve të aktiveve të mëposhtme:

a) tituj të emetuar nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë dhe nga Banka e Shqipërisë;

b) obligacione dhe tituj të tjerë borxhi, të garantuar nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë;

c) obligacione dhe tituj të tjerë borxhi, të emetuar nga qeverisja vendore e Republikës së Shqipërisë;

ç) obligacione dhe tituj të tjerë borxhi, të shoqëruar nga garanci të emetuara nga qeverisja vendore e Republikës së Shqipërisë;

d) obligacione dhe tituj të tjerë borxhi, të tregtuar në tregje të rregulluara në Republikën e Shqipërisë;

dh) aksione të tregtuara në tregje të rregulluara në Republikën e Shqipërisë;

e) kuota/aksione të sipërmarrjeve të investimeve kolektive të regjistruara në Republikën e Shqipërisë;

ë) hua të siguruar në Republikën e Shqipërisë, sipas kushteve të përcaktuara me rregullore nga Autoriteti;

f) toka, ndërtesa dhe të drejta në pasuri të paluajtshme në Republikën e Shqipërisë nëse plotësohen njëkohësisht kushtet e mëposhtme:

i) toka është e regjistruar nga Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme në emër të shoqërisë së sigurimit;

ii) pasuria e paluajtshme sjell kthim nga investimi ose pritjet të sjellë kthim nga investimi;

iii) çmimi i blerjes është përcaktuar mbi bazën e vlerësimit të ekspertit përkatës;

iv) pasuria nuk është e vendosur si kolateral apo nuk është vënë peng mbi të, si dhe është e lirë nga çdo barrë tjetër.

g) depozita në banka dhe/ose degë të bankave të huaja, me seli qendrore në Republikën e Shqipërisë.

2. Në zgjedhjen e llojit të investimeve të aktiveve në mbulim të provigjoneve matematike, shoqëria e sigurimit merr parasysh llojin e veprimtarisë së ushtruar, në mënyrë që të garantojë sigurinë, kthimin, likuiditetin dhe tregtueshmërinë e investimeve, si dhe të sigurojë diversifikimin dhe shpërndarjen e përshtatshme të tyre.

3. Aktivitetet në mbulim të provigjoneve matematike, me miratimin paraprak të Autoritetit, mund të investohen edhe në:

a) obligacione afatgjata dhe tituj borxhi afatgjatë të emetuara nga një vend anëtar ose vend anëtar i OECD-së;

b) obligacione afatgjata dhe tituj borxhi afatgjatë të emetuar nga një entitet joqeveritar i një vendi anëtar ose vendi anëtar të OECD-së;

c) aksione të emetuara nga një shoqëri aksionare e huaj, e cila tregton në tregje të rregulluara të kapitalit në një vend anëtar ose vend anëtar të OECD-së;

ç) kuota/aksione të sipërmarrjeve të investimeve kolektive, të cilat tregtohen në një vend anëtar ose vend anëtar të OECD-së.

4. Në raste të veçanta dhe me kërkesë të shoqërisë së sigurimit, Autoriteti mund të miratojë përkohësisht me një vendim të arsyetuar dhe lloje të tjera aktive për të mbuluar provigjonet matematike, nëse këto aktive kanë natyrë të sigurt dhe diversifikohen e shpërndahen në mënyrë të përshtatshme.

5. Autoriteti miraton rregulla në lidhje me tipat dhe karakteristikat e aktiveve në mbulim të provigjoneve matematike, lloje të tjera investimesh të aktiveve në mbulim të provigjoneve matematike, rregulla për diversifikimin dhe kufizimin në lidhje me investimin e këtyre aktiveve, si dhe rregulla për vlerësimin e këtyre aktiveve.

Neni 104

### **Investimi i aktiveve në mbulim të provigjoneve të veçanta për klasat e sigurimeve, ku i siguruari mban rrezikun e investimit**

1. Shoqëria e sigurimit nuk investon aktivet në mbulim të provigjoneve matematike në një sipërmarrje të investimeve kolektive nëse ajo është palë e lidhur me shoqërinë administruese të këtij fondi.



2. Nëse të drejtat e të siguruarve, që rrjedhin nga kontrata e sigurimit të jetës, janë drejtpërsëdrejti të varura nga vlera e kuotave/aksioneve në një sipërmarrje të investimeve kolektive, investimet e aktiveve në mbulim të provigjoneve matematike të krijuara nga shoqëria e sigurimit në lidhje me këto kontrata të sigurimit të jetës përfshijnë në maksimumin e mundshëm investimet në tituj, duke përfaqësuar këto kuota/aksione të sipërmarrjeve të investimeve kolektive.

3. Nëse të drejtat e të siguruarve, që rrjedhin nga kontrata e sigurimit të jetës, janë të lidhura drejtpërsëdrejti me ndryshimet e indeksit të titujve apo të vlerave të tjera referuese, investimet në aktivet në mbulim të provigjoneve matematike të krijuara nga shoqëria e sigurimit në lidhje me këto kontrata të sigurimit të jetës përfshijnë në maksimumin e mundshëm investimet në tituj të përshtatshëm, karakteristikat dhe tregtueshmëria e të cilëve korrespondon me titujt që janë marrë për bazë në përcaktimin e indeksit apo vlerës referuese.

4. Autoriteti përcakton në mënyrë të hollësishme me rregullore llojet e investimeve dhe kufizimet e investimeve të aktiveve në mbulim të provigjoneve matematike, sipas klasave të sigurimit të jetës, ku i siguruari mban rrezikun e investimit dhe kur të drejtat që rrjedhin nga kontrata e sigurimit të jetës të të siguruarit janë drejtpërsëdrejti të lidhura me vlerën e aktiveve në mbulim të provigjoneve matematike.

Neni 105

### **Ndarja e aktiveve në mbulim të provigjoneve matematike nga aktivet e tjera të shoqërisë së sigurimit**

1. Shoqëria e sigurimit ndan aktivet në mbulim të provigjoneve matematike nga aktivet e tjera, sipas mënyrës së përcaktuar në nenet e mëposhtme të këtij ligji, në përputhje me llojet e aktiveve.

2. Përdorimi i aktiveve në mbulim të provigjoneve matematike, referuar pikës 1, të këtij neni, lejohet vetëm për të mundësuar zgjidhjen e kërkesave për dëmshpërblim të të siguruarve, sipas kontratës së sigurimit të jetës, për të cilën janë krijuar aktivet përkatëse në mbulim të provigjoneve matematike.

3. Në rast të klasave të sigurimit të jetës dhe të klasave të tjera të sigurimit, për të cilat përdoren tabelat e probabilitetit dhe llogaritje të njëjta me ato të jetës, përdorimi i aktiveve në mbulim të provigjoneve matematike kufizohet vetëm për atë pjesë të aktiveve, vlera e të cilave:

a) është në raport të njëjtë me pjesën e mbulimit të kërkuar në lidhje me kontratat e sigurimit të jetës, nga të cilat rrjedh e drejta për dëmshpërblim, ashtu sikurse vlera totale e aktiveve në mbulim të provigjoneve matematike i korrespondon vlerës së mbulimit të kërkuar për të gjitha kontratat e sigurimit të jetës, të nënshkruara nga shoqëria e sigurimit, sipas klasave të sigurimit të jetës, për të cilat janë krijuar aktivet përkatëse në mbulim të provigjoneve matematike;

b) nuk tejkalon mbulimin e kërkuar në lidhje me kontratën e sigurimit të jetës, nga e cila ka lindur e drejta për dëmshpërblim.

## Neni 106

### **Llogaria e aktiveve në mbulim të provigjoneve matematike**

Shoqëria e sigurimit mban një llogari të veçantë për marrjen dhe kryerjen e pagesave në lidhje me aktivet në mbulim të provigjoneve matematike në një bankë dhe/ose degë e bankës së huaj.

## Neni 107

### **Veçimi i investimeve në tituj**

1. Shoqëria e sigurimit, e cila mban titujt në një llogari kujdestarie pranë një banke kujdestare, gëzon të drejtën:

- a) e inspektimit të gjendjes së titujve në llogarinë e kujdestarisë;
- b) e përmbushjes së menjëhershme të detyrimit për transferim të titujve të kryer nga marrëveshjet tregtare, të mbyllura për llogari të aktiveve në mbulim të provigjoneve matematike me një shoqëri brokerimi, e cila administron investimet në tituj, sipas një kontrate delegimi e nënshkruar me shoqërinë e sigurimit.

2. Në lidhje me titujt, të cilët emetohen në formën e certifikatave dhe të cilët nuk tregtohen në tregje të rregulluara, shoqëria e sigurimit autorizon një bankë, e cila ushtron veprimtari si kujdestar titujsh për të gjitha veprimet që kanë lidhje me ruajtjen e këtyre titujve.

3. Pika 1, e këtij neni, zbatohet rast pas rasti për ruajtjen dhe mbajtjen e titujve të përcaktuar në pikën 2 të këtij neni.

4. Banka dhe/ose dega e bankës së huaj, e cila ushtron veprimtari si kujdestar titujsh, sipas përcaktimeve të pikave 1 dhe 2, të këtij neni, me kërkesë të Autoritetit, depoziton informacionin e kërkuar në lidhje me gjendjen e titujve që mbahen për llogari të shoqërisë së sigurimit dhe të cilat kanë lidhje me aktivet në mbulim të provigjoneve matematike.

## Neni 108

### **Investimet në depozita bankare dhe hua**

1. Në lidhje me investimin e aktiveve në mbulim të provigjoneve matematike, shoqëria e sigurimit detyrohet të nënshkruajë me bankën dhe/ose degën e bankës së huaj apo huamarrësin marrëveshje ku përcaktohet në mënyrë të qartë se investimi është për llogari të aktiveve në mbulim të provigjoneve matematike.

2. Në rastin kur huaja, sipas pikës 1, të këtij neni, sigurohet nga një garanci bankare kundrejt titujve apo mënyrave të tjera, shoqëria e sigurimit është e detyruar të lërë peng objektin e vënë si garanci në favor të aktiveve në mbulim të provigjoneve matematike.

## Seksion IX

### **Mbajtja e kontabilitetit dhe raportimi financiar**

#### Neni 109

### **Mbajtja e kontabilitetit dhe e dokumentacionit**

Shoqëria e sigurimit mban në mënyrë të vazhdueshme kontabilitetin, përgatit regjistrimet kontabël, vlerëson aktivet dhe detyrimet, përgatit pasqyrat financiare, mban dokumentacionin e veprimtarisë së sigurimit, si dhe të dhënat e tjera mbi administrimin ose veprimtarinë tregtare në një zyrë brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, në mënyrë që të mundësojë në çdo kohë kontrollin për kryerjen e veprimtarisë së sigurimit, në përputhje me rregullat e administrimit të rrezikut, legjislacionin në fuqi për metodologjitë e mbikëqyrjes dhe sipas rregullave të hartuara nga Autoriteti e standardeve profesionale.

#### Neni 110

### **Përgjegjësia e shoqërisë së sigurimit**

Shoqëria e sigurimit duhet të garantojë që informacioni, dokumentacioni dhe të dhënat e parashikuara në nenin 109, të këtij ligji, të jenë të sakta dhe të pasqyrojnë gjendjen e vërtetë financiare të shoqërisë.

#### Neni 111

### **Raportimi**

1. Shoqëria e sigurimit përgatit pasqyrat financiare dhe raporte të tjera të detajuara mbi veprimtarinë e saj, si dhe ia paraqet ato Autoritetit, në përputhje me formën, mënyrën, përmbajtjen, listën, periudhën, si dhe afatet kohore, të përcaktuara me rregullore nga Autoriteti.

2. Shoqëria e sigurimit përgatit për çdo vit kalendarik pasqyrat financiare dhe raportet e tjera të paaudituar për veprimtarinë e saj dhe i paraqet në Autoritet brenda 31 marsit të vitit të ardhshëm.

3. Shoqëria e risigurimit paraqet në Autoritet pasqyrat financiare dhe raportet e tjera mbi veprimtarinë e saj, të paaudituar jo më vonë se 4 muaj pas mbarimit të vitit kalendarik për të cilin hartohen raportet.

4. Shoqëria e sigurimit/risigurimit, mëmë e një grupi sigurimi, përgatit dhe paraqet pasqyra financiare të konsoliduara brenda afateve kohore të përcaktuara në pikat 2 dhe 3 të këtij neni.

5. Shoqëria e sigurimit/risigurimit përgatit dhe paraqet raporte financiare dhe raporte të tjera të veprimtarisë së saj për periudha kohore më të shkurtra se një vit kalendarik, në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi dhe aktet e Autoritetit.

## Neni 112

### **Raporti dhe opinionin i aktuarit të autorizuar**

Shoqëria e sigurimit, brenda 14 ditëve kalendarike nga data e depozitimit të dokumenteve kontabël, të përcaktuara në nenin 111, të këtij ligji, gjithashtu paraqet në Autoritet raportin e aktuarit të autorizuar, të përcaktuar në nenin 225, të këtij ligji, së bashku me opinionin e tij që tregon se llogaritja e tarifave të primit, krijimi i provigjoneve teknike, aktivet në mbulim të provigjoneve teknike, fondi i garancisë, niveli i kërkuar i aftësisë paguese dhe risigurimi i ceduar janë në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe rregulloret në zbatim të tij.

## Neni 113

### **Transaksionet financiare**

1. Transaksionet financiare, përfshirë edhe pagesat e dëmeve nga shoqëria e sigurimit, kryhen nëpërmjet bankave dhe/ose degëve të bankave të huaja në Republikën e Shqipërisë.

2. Transaksionet financiare të ndërmjetësve në sigurime, vlerësuesve të dëmeve, si dhe të gjithë personave, subjekt të këtij ligji, kryhen nëpërmjet bankave dhe/ose degëve të bankave të huaja në Republikën e Shqipërisë.

3. Shoqëria e sigurimit dhe personat e përmendur në pikën 2, të këtij neni, depozitojnë në Autoritet emrin e bankave dhe/ose degëve të bankave të huaja, llogaritë bankare dhe referencat e tyre përkatëse, me të cilat ato operojnë në përputhje me pikat 1 dhe 2 të këtij neni.

## Seksioni X

### **Masa të tjera të administrimit të rrezikut**

## Neni 114

### **Ndalimi i transaksioneve të zvogëlimit të aktiveve**

1. Shoqëria e sigurimit, kapitali i së cilës zotërohet si pjesëmarrje, nuk mund të blejë, të pranojë si garanci, të japë kredi apo hua në këmbim të aksioneve të shoqërisë së sigurimit, pjesëmarrëse në kapitalin e tyre.

2. Marrëdhëniet e borxhit apo të huas, si dhe blerjet ose shitjet e aktiveve, që nuk kanë të bëjnë me veprimtarinë e sigurimeve dhe që tejkalojnë 20 për qind të kapitalit të shoqërisë së sigurimit, midis shoqërive të sigurimit apo shoqërive të tjera brenda të njëjtut grup, duhet të jenë subjekt miratimi paraprak nga Autoriteti.

3. Shoqëria e sigurimit merr gjithashtu miratim nga Autoriteti para emetimit të titujve afatshkurtër dhe afatgjatë dhe instrumenteve financiare të tregtueshme të ngjashme.

4. Autoriteti merr vendim për miratimin apo refuzimin e kërkesave të parashikuara në pikat 2 dhe 3, të këtij neni, brenda 30 ditëve kalendarike nga data e depozitimit të kërkesës.

5. Aksionarët, anëtarët e këshillit të administrimit/mbikëqyrës, administratori/anëtari i bordit të drejtorëve, audituesit e brendshëm dhe punonjësit e shoqërisë së sigurimit nuk përdorin drejtpërdrejt apo tërthorazi burimet e shoqërisë, përveç pagesave, mbështetjes financiare dhe paradhënieve që i jepen punonjësve, sipas parashikimeve të përcaktuara në statutin e shoqërisë apo në vendimet e asamblesë së përgjithshme apo të këshillit të administrimit/mbikëqyrës. Këta persona nuk mund të kryejnë transaksione në kundërshtim me rregullat e mbarëvajtjes së veprimtarisë, si dhe transferta të fshehta të çdo lloji biznesi, të cilat zvogëlojnë vlerën e aktiveve. Shoqëria e sigurimit nuk mund të lërë peng si kolateral aktivet e saj për përfitime të punonjësve, aksionarëve, personave që kanë pjesëmarrje apo çdo personi tjetër, si dhe nuk mund të kryejë veprime të tjetra, si të japë garanci, kredi, përveç rasteve kur ato rrjedhin nga detyrimet e tyre apo të vetë shoqërisë së sigurimit.

Neni 115

### **Risigurimi**

1. Shoqëria e sigurimit mund të risigurojë përgjegjësitë e kontraktuara me të siguruarin te një shoqëri risigurouese vendase apo e huaj.
2. Shoqëria e sigurimit, e cila risiguron përgjegjësitë e kontraktuara, është përgjegjëse e vetme ndaj të siguruarit, si dhe i siguruari nuk ka të drejtë të ndërmarrë drejtpërdrejt veprime juridike ndaj risiguroesit.

Neni 116

### **Detyrimi për risigurim**

1. Shoqëria e sigurimit është e detyruar të risigurojë në një shoqëri risigurimi pjesën e rreziqeve të siguruara që tejkalojnë mbulimin maksimal, sipas përcaktimeve të këtij neni.
2. Shoqëria e sigurimit nuk mund të sigurojë përgjegjësi, të cilat tejkalojnë mbulimin maksimal të saj.
3. Shoqëria e sigurimit risiguron përgjegjësitë e saj me një shoqëri risigurimi, në përputhje me rregullat e përcaktuara nga Autoriteti.
4. Mbulimi maksimal i shoqërisë së sigurimit për çdo rrezik të siguar nuk mund të tejkalojë 10 për qind të vlerës së kapitalit të përcaktuar në nenin 75 të këtij ligji.
5. Mbjajtja neto e mbulimit maksimal agregat të rreziqeve të një shoqërie sigurimi, që rrjedhin nga kontratat e sigurimit të tërmeteve, nuk tejkalon mbajtjen neto për sigurimin e tërmeteve të vetë shoqërisë, të përcaktuar si diferenca ndërmjet aftësisë paguese të shoqërisë dhe nivelit të kërkuar të aftësisë paguese.
6. Autoriteti miraton rregulla për përcaktimin dhe llogaritjen e mbajtjes neto të mbulimit maksimal agregat të rreziqeve që rrjedhin nga kontratat e sigurimit të tërmeteve.
7. Autoriteti, gjithashtu, miraton rregulla shtesë në lidhje me mbulimin maksimal për rreziqe të tjera agregate dhe të akumuluar për kontratat e nënshkruara nga shoqëria e sigurimit.

### **Programi i planifikuar i risigurimit**

1. Shoqëria e sigurimit, për çdo vit financiar, harton dhe zbaton programin e nevojave për risigurim, në varësi të strukturës së portofolit të sigurimit, si dhe përcakton marrëveshjet e risigurimit, sipas të cilave ajo duhet të sigurojë tejkalimin e mbulimit maksimal të rreziqeve.

2. Programi i planifikuar i risigurimit përmban:

a) llogaritjen e rreziqeve të mbajtura për çdo klasë sigurimi;

b) tabelën e mbulimeve maksimale, të hartuar në bazë të llogaritjeve të përmendura në shkronjën “a” të kësaj pike;

c) vlerësimin e mbajtjes neto të mbulimit maksimal agregat të rreziqeve të një shoqërie sigurimi, që rrjedhin nga kontratat e sigurimit të tërmeteve dhe vlerësimin e mbajtjes maksimale për rreziqe të tjera agregate dhe të akumuluar, në përputhje me nenin 116, të këtij ligji, dhe aktet e Autoritetit;

ç) procedurat, bazat teknike dhe kriteret e përcaktimit të mbajtjes maksimale për rreziqe të tjera agregate dhe të akumuluar për kontrata të nënshkruara nga shoqëria e sigurimit, në rastet kur nuk janë të përcaktuara me aktet e Autoritetit.

3. Në llogaritjet referuar pikën 2, shkronja “a”, të këtij neni, shoqëria e sigurimit merr parasysh:

a) nivelin e kapitalit dhe nivelin e kërkuar të aftësisë paguese;

b) volumin total të veprimtarisë;

c) primet e shkruara të sigurimit, të ndara për çdo klasë sigurimi;

ç) peshën specifike të çdo klase sigurimi në bazat teknike, referuar shkronjave “b” dhe “c” të kësaj pike;

d) përshtatjet si pasojë e shmangieve brenda klasave të veçanta të sigurimeve.

4. Llogaritjet për rreziqet agregate, të lidhura me sigurimin nga katastrofat natyrore, kryhen në përputhje me rregullat e përcaktuara në nenin 116 të këtij ligji.

5. Shoqëria e sigurimit depoziton në Autoritet programin e planifikuar të risigurimit, jo më vonë se 60 ditë kalendarike para mbylljes së vitit financiar.

6. Autoriteti, pasi shqyrton programin e planifikuar të risigurimit, jep opinion brenda 45 ditëve kalendarike nga data e depozitimit të informacionit të plotë në Autoritet.

7. Autoriteti mund të përcaktojë rregulla të mëtejshme për përmbajtjen e programit të risigurimit, afatin e depozitimit të tij, si dhe kriteret për vlerësimin e programit.

### **Mbulimi i rreziqeve të mëdha**

1. Dy apo më shumë shoqëri sigurimi mund të krijojnë një grupim të veçantë për mbulimin e rreziqeve të mëdha, me qëllim përballimin e mbulimit të këtyre rreziqeve, si dhe ofrimin e një niveli më të lartë mbulimi.

2. Dispozitat e këtij ligji zbatohen rast pas rasti edhe për këto grupime. Autoriteti mund të miratojë rregulla shtesë për këto grupime.

## Neni 119

### **Bashkësigurimi**

1. Një shoqëri sigurimi mund të bashkësigurojë me një ose disa shoqëri sigurimi rreziqe të klasave të sigurimit, për të cilat ajo është licencuar për të ushtruar veprimtari sigurimi.

2. Shoqëria e sigurimit nuk mund të bashkësigurojë pjesën e rrezikut të marrë përsipër, që tejkalon mbajtjen e saj, të përcaktuar për çdo klasë sigurimi, në përputhje me mbulimin maksimal të parashikuar në nenin 116 të këtij ligji.

3. Shoqëria e sigurimit njofton Autoritetin brenda 15 ditëve kalendarike nga data e lidhjes së kontratës së bashkësigurimit.

4. Autoriteti mund të përcaktojë rregulla të tjera shtesë në lidhje me bashkësigurimin.

5. Shoqëria e sigurimit mund të bashkësigurojë rreziqe që ndodhen në vendet anëtare, në përputhje me rregullat e miratuara nga Autoriteti.

## Neni 120

### **Statistika të shoqërive të sigurimit**

1. Shoqëria e sigurimit mban të dhëna statistikore për veprimtarinë e sigurimit, rreziqet e mbuluara, ngjarjet e siguruara dhe dëmet.

2. Shoqëria e sigurimit përpunon të dhënat e përmendura në pikën 1 dhe i raporton në Autoritet, sipas parashikimeve të nenit 111 të këtij ligji.

## KREU VII

### **KONTROLLI I BRENDSHËM DHE AUDITIMI**

#### Seksioni I

#### **Sistemi i kontrollit të brendshëm**

## Neni 121

#### **Sistemi i kontrollit të brendshëm**

1. Shoqëria e sigurimit krijon sistemin e kontrollit të brendshëm për monitorimin dhe zbatimin e politikave e të procedurave të brendshme, për vlerësimin e efektivitetit të veprimtarisë së shoqërisë së sigurimit, si dhe për monitorimin e ushtrimit të veprimtarisë, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

2. Objektivat e sistemit të kontrollit të brendshëm janë identifikimi i llojeve të rreziqeve, ndaj të cilave shoqëria e sigurimit është e ekspozuar, si dhe matja, administrimi dhe monitorimi i nivelit të tyre.

3. Shoqëria e sigurimit harton politika në lidhje me administrimin e rrezikut, kontrollin e brendshëm, auditimin e brendshëm dhe, kur është e nevojshme, për delegimin e funksioneve të përcaktuara në nenin 53 të këtij ligji. Këshilli i administrimit/mbikëqyrës i shoqërisë së sigurimit miraton dhe duhet të garantojë një

mbikëqyrje të matur për zbatimin e politikave, strategjive dhe sistemeve të administrimit të rrezikut.

4. Politikat e hartuara sipas përcaktimeve të pikës 3, të këtij neni, rishikohen të paktën një herë në vit dhe janë subjekt i miratimit paraprak nga këshilli i administrimit/mbikëqyrës të shoqërisë së sigurimit, duke pasur parasysh ndryshimet e rëndësishme të sistemit dhe fushës në fjalë.

5. Sistemi i kontrollit të brendshëm i një shoqërie sigurimi përbëhet nga tërësia e procedurave, rregullave dhe strukturave që janë pjesë e tij.

6. Veprimtaria e kontrollit të brendshëm është pjesë përbërëse e veprimtarisë së përditshme të shoqërisë së sigurimit dhe përfshin kontrollin e çdo njësie organizative të saj, verifikime fizike të aktiveve dhe informim, monitorimin e ushtrimit të veprimtarisë, në përputhje me legjislacionin në fuqi, kontrole të sistemit të verifikimit dhe bashkërendimit të informacioneve financiare, si dhe rishqyrtim periodik të efektivitetit të kontroleve të mëparshme.

7. Sistemi i qeverisjes së shoqërive të sigurimit dhe vlerësimi i rreziqeve të evidentuara rishtazi nga shoqëria e sigurimit e që mund të ndikojnë në mbarëvajtjen financiare mund të jenë subjekt i shqyrtimit të Autoritetit, sipas metodologjive të përcaktuara nga Autoriteti.

8. Autoriteti përcakton me rregullore procedurat dhe parimet minimale në lidhje me kontrollin e brendshëm dhe aspekte të tjera të sistemit të informimit të shoqërisë së sigurimit.

## Neni 122

### **Auditimi i brendshëm**

1. Shoqëria e sigurimit krijon njësinë e auditimit të brendshëm si pjesë përbërëse e sistemit të kontrollit të brendshëm, e cila ka për detyrë të ushtrojë një metodë të integruar dhe të disiplinuar për vlerësimin dhe përmirësimin e proceseve të qeverisjes, administrimit të rrezikut dhe kontroleve të shoqërisë.

2. Auditimi i brendshëm krijohet si një njësi që funksionon në mënyrë të pavarur dhe objektive për të dhënë opinion të specializuar, si dhe për të përmirësuar veprimtarinë e shoqërisë së sigurimit.

3. Njësia e auditimit të brendshëm kryen auditimin e brendshëm të veprimtarisë së shoqërisë, në përputhje me parimet profesionale dhe standardet ndërkombëtare të auditimit të brendshëm, kodin ndërkombëtar të etikës profesionale për audituesit e brendshëm dhe praktikat për ta.

4. Auditimi i brendshëm duhet të ketë akses në të gjitha njësitë funksionale dhe mbështetëse të shoqërisë së sigurimit, si dhe në të gjitha funksionet që delegohen nga shoqëria e sigurimit.

5. Auditimi i brendshëm duhet të ketë status, politika dhe praktika të mjaftueshme për të raportuar gjetjet dhe rekomandimet te këshilli i administrimit/mbikëqyrës pasi janë shqyrtuar paraprakisht nga komiteti i auditimit, si dhe për të ndjekur në bashkëpunim me drejtuesit e lartë të shoqërisë së sigurimit zbatueshmërinë e tyre.

6. Autoriteti miraton rregullore për ushtrimin e funksionit të auditimit të brendshëm në shoqërinë e sigurimit.



## Seksioni II

### **Auditimi ligjor**

#### Neni 123

#### **Shoqëria audituese**

1. Asambleja e përgjithshme e shoqërisë së sigurimit emëron shoqërinë audituese të shoqërisë së sigurimit, shoqëri e cila është person juridik i licencuar për të ushtruar veprimtari audituese në Republikën e Shqipërisë.

2. Shoqëria e sigurimit miraton shoqërinë audituese dhe kërkon miratimin paraprak për çdo ndryshim të shoqërisë audituese nga Autoriteti.

3. Shoqëria e sigurimit njofton Autoritetin në rastin kur kërkon zëvendësimin e shoqërisë audituese dhe vetë shoqëria audituese njofton Autoritetin në rastin e dorëheqjes.

4. Audituesi i shoqërisë së sigurimit ose ortaku kryesor i auditimit, i cili është përgjegjës për kryerjen e auditimit ligjor për llogari të shoqërisë audituese, i miratuar nga Autoriteti, kryen auditimin në të njëjtën shoqëri sigurimi për një periudhë jo më të gjatë se 4 vjet në vazhdim nga data e miratimit të saj dhe mund të rimarrë pjesë në auditimin e shoqërisë së sigurimit pas mbarimit të afatit kohor prej të paktën 2 vjetësh.

5. Ortaku kryesor i auditimit, i cili është përgjegjës për kryerjen e auditimit ligjor për llogari të shoqërisë audituese, nuk lejohet të ketë pozicione drejtuese apo administrative në shoqërinë e sigurimit të audituar përpara përfundimit të periudhës 2-vjeçare që nga data e dorëzimit të detyrës si ortaku kryesor i auditimit përgjegjës për kryerjen e auditimit ligjor për llogari të shoqërisë audituese.

6. Autoriteti miraton rregulla për përcaktimin e kriterëve dhe kërkesave për përzgjedhjen e shoqërisë audituese.

#### Neni 124

#### **Auditimi i pasqyrave financiare**

1. Për auditimin e pasqyrave financiare, përveçse kur parashikohet ndryshe në këtë ligj, zbatohen dispozitat e ligjit nr. 10 091, datë 5.3.2009, "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar".

2. E njëjta shoqëri audituese nuk kryen apo nuk angazhohet nga shoqëria e sigurimit për auditimin e saj, nëse në vitin paraardhës kjo shoqëri audituese ka përfituar më shumë se gjysmën e të ardhurave të saj nga auditimi i llogarive të shoqërisë së sigurimit në fjalë.

#### Neni 125

#### **Raporti i shoqërisë audituese**

1. Shoqëria audituese e dërgon raportin e auditimit në asambleenë e përgjithshme dhe komitetin e auditimit të shoqërisë së sigurimit ose autoritetin përkatës mbikëqyrës të shoqërisë së huaj, në rastet e degës së shoqërisë së sigurimit të huaj/vendit anëtar.

2. Shoqëria audituese jep opinionin e saj nëse llogaritë vjetore të shoqërisë së sigurimit të konsoliduara dhe të pakonsoliduara janë në përputhje me standardet dhe rregullat profesionale në fuqi.

3. Shoqëria audituese raporton menjëherë në Autoritet çdo fakt që lidhet me shoqërinë e sigurimit, për të cilin shoqëria audituese është vënë në dijeni gjatë kryerjes së detyrave të saj për:

a) shkelje të ligjeve, akteve nënligjore në fuqi, akteve të Autoritetit ose akteve administrative, që kanë të bëjnë me kushtet, në bazë të të cilave i është dhënë licenca për të ushtruar veprimtari sigurimi;

b) mashtrim ose përvetësim, vjedhje, pastrim parash apo financim të terrorizmit;

c) shkelje të rregullave të brendshme të shoqërisë së sigurimit;

ç) ndryshim të rëndësishëm të rezultatit financiar të paraqitur në llogaritë vjetore të paaudituar;

d) fakte dhe rrethana të tjera shtesë, të cilat mund të kenë ndikim mbi veprimtarinë e mëtejshme të shoqërisë së sigurimit;

dh) çdo transaksion të shoqërisë së sigurimit me palë të lidhura që përbën rrezik për likuiditetin dhe për rregullat e administrimit të rrezikut.

4. Raporti i auditimit, që përmban opinionin për pasqyrat financiare, shoqërohet nga raporti i aktuarit të shoqërisë audituese, i cili jep opinion për mjaftueshmërinë e provigjoneve teknike të shoqërisë së sigurimit, sipas këtij ligji dhe akteve të Autoritetit, duke u bazuar në teknikat e duhura aktuariale.

5. Raportimi, informimi dhe dhënia e çdo fakti, sipas pikave 3 dhe 4, të këtij neni, nga ana e shoqërisë audituese nuk përbën shkelje të kufizimeve për dhënie të informacionit, të përcaktuara në kontratë ose në legjislacionin në fuqi dhe personat janë të çliruar nga çdo lloj përgjegjësie.

6. Autoriteti mund t'i kërkojë shoqërisë audituese shpjegime shtesë për auditimin e kryer dhe raportin e auditimit, si dhe çdo informacion tjetër që Autoriteti e gjykon të nevojshëm në funksion të ushtrimit të mbikëqyrjes.

7. Nëse gjatë kryerjes së detyrave shoqëria audituese konstaton se shoqëria e sigurimit ka shkelur rregullat e administrimit të rrezikut dhe si pasojë cenohen interesat e të siguruarve, si dhe rrezikohen likuiditeti apo vijueshmëria e veprimtarisë së saj, informon menjëherë Autoritetin.

8. Shoqëria e sigurimit depoziton në Autoritet një kopje të raportit të auditimit dhe letrën për drejtimin, brenda 15 ditëve kalendarike nga data e marrjes së tyre, por jo më vonë se data 30 prill e vitit pasardhës. Nëse shoqëria e sigurimit përgatit llogari të konsoliduara, raporti i mësipërm depozitohet jo më vonë se data 31 maj e vitit pasardhës.

Neni 126

### **Përmbajtja e raportit të auditimit**

1. Shoqëria audituese auditon dhe vlerëson pajtueshmërinë e pasqyrave financiare të shoqërisë së sigurimit në përputhje me SNRF-të dhe legjislacionin në fuqi.

2. Autoriteti përcakton me rregullore e formatin e detajuar, minimumin e objektit dhe të përmbajtjes së raportit të auditimit, bazuar në natyrën specifike të veprimtarisë së shoqërisë së sigurimit.

## Neni 127

### **Ribërja e auditimit ligjor**

1. Nëse auditimi apo raporti i auditimit nuk kryhet ose hartohet në përputhje me kërkesat e këtij ligji apo standardeve kombëtare dhe/ose ndërkombëtare të auditimit, si dhe nuk pasqyron situatën e vërtetë dhe të drejtë financiare të shoqërisë së sigurimit, Autoriteti nuk e pranon raportin në fjalë dhe ka të drejtë të kërkojë riauditimin nga një tjetër shoqëri audituese me shpenzimet e shoqërisë së sigurimit.

2. Në rastet e parashikuara në pikën 1, të këtij neni, Autoriteti ka të drejtë të ndalojë shoqërinë audituese të auditojë shoqëritë e sigurimit për një periudhë deri në 5 vjet.

## Neni 128

### **Publikimi i pasqyrave financiare të audituara**

1. Shoqëria e sigurimit publikon raportin vjetor, i cili përmban pasqyrat financiare të audituara dhe opinionin e audituesit, dhe e vendos në faqen zyrtare të internetit jo më vonë se 6 muaj nga përfundimi i vitit kalendarik.

2. Autoriteti nxjerr rregullore për përmbajtjen e publikimit të parashikuar në pikën 1 të këtij neni.

## KREU VIII

### **MBIKËQYRJA E SHOQËRIVE TË SIGURIMIT**

#### Seksioni I

### **Dispozita të përgjithshme**

## Neni 129

### **Mbikëqyrja e shoqërive të sigurimit**

1. Autoriteti mbikëqyr veprimtarinë e shoqërive të sigurimit, me qëllim që të kontrollojë, të vlerësojë dhe të shqyrtojë përmbushjen nga shoqëritë e sigurimit të rregullave të administrimit të rrezikut, rregullave të përcaktuara në aktet e Autoritetit, si dhe në legjislacionin e zbatueshëm në fushën e sigurimeve dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.

2. Autoriteti mbikëqyr personat juridikë të lidhur me një shoqëri siguri, nëse një gjë e tillë është e nevojshme për mbikëqyrjen e veprimtarisë së shoqërisë së sigurimit.

3. Nëse për mbikëqyrjen e personave të përmendur në pikën 2, të këtij neni, është kompetent një autoritet tjetër mbikëqyrës apo organizëm, atëherë mbikëqyrja e veprimtarisë së personit juridik kryhet nga Autoriteti në bashkëpunim me autoritetin mbikëqyrës apo organizmin kompetent, sipas modaliteteve dhe rregullave të përcaktuara në një marrëveshje të përbashkët midis dy institucioneve.

4. Mbikëqyrja e veprimtarisë së shoqërisë së sigurimit mund të kryhet edhe nga institucione të tjera, në përputhje me kompetencat që u jepen nga ligjet përkatëse të fushës.

5. Dispozitat në lidhje me mbikëqyrjen e shoqërisë së sigurimit zbatohen rast pas rasti për mbikëqyrjen e personave të tjerë objekt të mbikëqyrjes.

6. Për qëllime të këtij ligji, persona të tjerë, subjekt të mbikëqyrjes, janë: shoqëria e risigurimit, grupi i sigurimit, dega e shoqërisë së sigurimit të vendit të huaj/anëtar, brokeri, shoqëria e brokerimit, agjenti, shoqëria e agjentëve, si dhe çdo person fizik apo juridik, veprimtaria e të cilëve, sipas këtij ligji, mbikëqyret nga Autoriteti.

7. Autoriteti bashkëpunon me mbikëqyrës të tjerë vendas dhe të huaj dhe autoritete të tjera kompetente, si dhe me organizata ndërkombëtare, me qëllim mbikëqyrjen e veprimtarisë së subjekteve të përcaktuara në këtë nen.

Neni 130

### **Metoda e mbikëqyrjes**

1. Mbikëqyrja e shoqërisë së sigurimit ushtrohet nga Autoriteti nëpërmjet:

a) monitorimit, mbledhjes dhe verifikimit të raporteve dhe njoftimeve të depozituara nga shoqëritë e sigurimit dhe persona të tjerë, të cilët, sipas legjisllacionit në fuqi, kanë detyrimin për të raportuar në Autoritet apo për ta njoftuar atë për çdo fakt ose rrethanë të veçantë;

b) kontrollit në vend të veprimtarisë së shoqërisë së sigurimit;

c) vendosjes së masave mbikëqyrëse në përputhje me këtë ligj.

2. Autoriteti ushtron funksionet e tij mbikëqyrëse bazuar në legjisllacionin në fuqi dhe metodologjinë me fokus rreziku.

3. Autoriteti mund të hartojë metodologji dhe manuale në mbështetje të pikës 2 të këtij neni.

Seksioni II

### **Raportimi**

Neni 131

#### **Raportimi periodik dhe raportimi sipas kërkesës së Autoritetit**

1. Shoqëria e sigurimit raporton në Autoritet faktet dhe rrethanat e mëposhtme:

a) regjistrimin e çdo ndryshimi të të dhënave të regjistruara në QKR;

b) mbledhjen e asamblesë së përgjithshme të aksionarëve dhe vendimet e marra;

c) listën e aksionarëve të shoqërisë së sigurimit, pjesëmarrjet influencuese apo ndryshime të tyre, sipas nenit 48 të këtij ligji;

ç) bazën e të dhënave statistikore të përdorura për llogaritjen e primeve dhe provigjoneve matematike në rast të sigurimit të jetës;

d) bazën e të dhënave statistikore të përdorura për llogaritjen e tarifave të primeve dhe provigjoneve teknike në rast të sigurimit të jojetës, duke përfshirë edhe tarifatat e primeve;

- dh) emërimin dhe shkarkimin e administratorit/anëtarit të bordit të drejtorëve, anëtarëve të këshillit të administrimit/mbikëqyrës dhe funksionarëve kryesorë;
  - e) emërimin dhe shkarkimin e aktuarit të autorizuar;
  - ë) ndryshimin e mënyrës së funksionimit të auditimit të brendshëm;
  - f) fillimin e planifikuar të veprimtarisë, ndryshimin e zyrave, mbylljen apo ndërprerjen e përkohshme të veprimtarisë së degës apo çdo ndryshim në llojet e veprimtarisë së ushtruar nga dega;
  - g) investimet, në bazë të të cilave shoqëria e sigurimit ka fituar në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë, pjesëmarrje influencuese në një tjetër person juridik, si dhe çdo investim të mëtejshëm në atë person juridik;
  - gj) ndryshimet e rëndësishme në strukturën e kapitalit;
  - h) informacion në lidhje me personat apo palët e lidhura, si dhe ndryshimet e këtij informacioni;
  - i) ndërprerjen e veprimtarive në një klasë të caktuar të sigurimit;
  - j) kontratat e risigurimit të nënshkruara me risiguruesit;
  - k) materiale publicitare dhe promocionale;
  - l) planet e biznesit, sipas afateve të përcaktuara nga Autoriteti;
  - ll) kontratat me agjentët, shoqëritë e agjentëve, brokerat, shoqëritë e brokerimit, vlerësuesit e dëmeve dhe aktuarin e autorizuar.
2. Shoqëria e sigurimit njofton Autoritetin për bazën teknike të përdorur për llogaritjen e primit, përsirë tarifën dhe komisionet.
3. Këshilli i administrimit/mbikëqyrës të shoqërisë së sigurimit njofton menjëherë Autoritetin nëse:
- a) rrezikohet likuiditeti ose aftësia paguese e shoqërisë së sigurimit;
  - b) ka baza të mjaftueshme për përfundimin apo revokimin e licencës për të ushtruar veprimtari sigurimi;
  - c) gjendja financiare e shoqërisë së sigurimit përkeqësohet në atë masë sa që ajo nuk është në gjendje të mbajë nivelin e kërkuar të aftësisë paguese, të përcaktuar në nenin 80, të këtij ligji, dhe/ose nivelin e fondit të garancisë të përcaktuar në nenin 81, të këtij ligji, apo në akte të Autoritetit, që përcaktojnë mënyrat e llogaritjes së nivelit të kërkuar të aftësisë paguese apo fondit të garancisë.
4. Në kuadër të ushtrimit të mbikëqyrjes, Autoriteti kërkon nga personat e mbikëqyrur çdo informacion dhe dokumentacion që lidhet me veprimtarinë e tyre. Personat e mbikëqyrur janë të detyruar t'i japin Autoritetit çdo dokument dhe informacion të kërkuar.
5. Autoriteti përcakton me rregullore, në mënyrë të detajuar, përmbajtjen e raportit, mënyrën, formën e afatin kohor të raportimit dhe njoftimit.

### Seksioni III

#### **Inspektimi i veprimtarisë së shoqërisë së sigurimit**

Neni 132

#### **Personat e autorizuar**

1. Inspektimi i veprimtarisë së shoqërisë së sigurimit kryhet nga punonjësi i Autoritetit, i autorizuar për kryerjen e inspektimeve.

2. Autoriteti, për qëllime të kryerjes së inspektimeve të veprimtarisë së shoqërisë së sigurimit, mund të autorizojë auditues të autorizuar, aktuarë të autorizuar apo persona të tjerë të specializuar, sipas parashikimeve të seksionit V të këtij kreu.

3. Gjatë kryerjes së inspektimit të veprimtarisë, personat e përmendur në pikën 2, të këtij neni, kanë të njëjtat kompetenca me punonjësën e autorizuar të Autoritetit.

Neni 133

### **Kryerja e inspektimit**

1. Shoqëria e sigurimit lejon personat e autorizuar nga Autoriteti që, për qëllime të kryerjes së inspektimeve, të kenë akses në të gjitha librat tregtarë/kontabël, dosjet dhe çdo dokument tjetër të printuar nga kompjuteri, si dhe në versionet origjinale, kopjet e të dhënave të ndryshme të mbajtura nga shoqëria etj.

2. Me kërkesë të personave të autorizuar nga Autoriteti, anëtarët e këshillit të administrimit/mbikëqyrës dhe punonjësit e shoqërisë së sigurimit vënë në dispozicion të tyre raportet dhe informacionet për të gjitha çështjet e ushtrimit të veprimtarisë që lidhen me ushtrimin e mbikëqyrjes.

3. Personat e autorizuar mund të inspektojnë, gjithashtu, veprimtarinë e personave juridikë të lidhur me shoqërinë e sigurimit, nëse një gjë e tillë është e nevojshme për të pasur një informacion më të hollësishëm në lidhje me veprimtarinë e shoqërisë së sigurimit.

Neni 134

### **Raportimi dhe informimi**

1. Autoriteti i kërkon subjektit të mbikëqyrur të depozitojë informacion për çdo çështje që e gjykon të rëndësishme, me qëllim përmbushjen e detyrave mbikëqyrëse për të vlerësuar nëse vepron në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe aktet e Autoritetit.

2. Autoriteti mund të kërkojë raportet dhe informacionet e parashikuara në pikën 1, të këtij neni, edhe nga anëtarët e këshillit të administrimit/mbikëqyrës dhe punonjësit e subjektit të mbikëqyrur.

3. Autoriteti kërkon nga personat e përmendur në pikën 2, të këtij neni, të përgatitin, brenda një afati kohor prej 5 ditëve pune, një raport me shkrim për sa është parashikuar në pikën 1, të këtij neni, apo kërkon prej tyre deklarime verbale për çështjet në fjalë.

4. Informacioni i parashikuar në pikën 1, të këtij neni, duhet të pasqyrojë natyrën, shkallën dhe tërësinë e veprimtarisë së subjektit të mbikëqyrur. Informacioni duhet të jetë i besueshëm, i kuptueshëm, konkret, i aksesueshëm, i plotë, i qëndrueshëm dhe i përputhshëm në kohë.

Neni 135

### **Inspektimi i veprimtarisë së shoqërisë së sigurimit**

1. Subjekti i mbikëqyrur, me kërkesë të punonjësit të autorizuar të Autoritetit, i mundëson inspektimin e veprimtarive në selinë qendrore dhe në çdo ambient tjetër të tij

apo me kërkesë të personit, të cilit subjekti i mbikëqyrur i ka deleguar veprimtaritë që Autoriteti mbikëqyr.

2. Subjekti i mbikëqyrur, me kërkesë të punonjësit të autorizuar të Autoritetit, i mundëson inspektimin e dokumentacionit të veprimtarisë së shoqërisë së sigurimit, si dhe të dhënat tregtare e administrative të saj, në masën e nevojshme për kryerjen e inspektimit apo në masën e përcaktuar nga ligji, metodologjia, manualët ose udhëzuesit për kryerjen e funksioneve mbikëqyrëse, të miratuara nga Autoriteti.

3. Subjekti i mbikëqyrur, me kërkesë të punonjësit të autorizuar të Autoritetit, i vë në dispozicion dokumentet e mbajtura në mënyrë elektronike dhe të printuara nga kompjuteri ose kopje të librave tregtarë/kontabël, dokumenteve dhe të dhëna të tjera administrative dhe tregtare.

4. Pas përfundimit të inspektimit të shoqërisë së sigurimit, punonjësi i autorizuar i Autoritetit harton një raport për inspektimin e kryer dhe i dorëzon shoqërisë së sigurimit një letër për drejtuesit, ku paraqiten rezultatet e inspektimit.

Neni 136

### **Programi i inspektimit të veprimtarisë së shoqërisë së sigurimit**

1. Autoriteti i dërgon subjektit të mbikëqyrur programin e inspektimit të veprimtarisë, jo më vonë se 10 ditë kalendarike përpara fillimit të inspektimit.

2. Përfundimisht nga rregulli i përcaktuar në pikën 1, të këtij neni, nëse gjykohet e domosdoshme, programi i inspektimit mund t'i njoftohet subjektit në momentin e fillimit të inspektimit.

3. Programi i inspektimit të veprimtarisë së shoqërisë së sigurimit duhet të përmbajë objektin e inspektimit.

4. Autoriteti, gjatë inspektimit të veprimtarisë së shoqërisë së sigurimit, mund të zgjerojë programin e inspektimit dhe të zgjatë periudhën kohore të planifikuar. Për shtesën e programit të inspektimit të veprimtarisë së shoqërisë zbatohen pikat 1, 2 dhe 3 të këtij neni.

5. Autoriteti kryen inspektim edhe në bashkëpunim me institucione të tjera të zbatimit të ligjit, sipas programeve të përbashkëta të inspektimit të miratuara ndërmjet tyre.

Neni 137

### **Kushtet për kryerjen e inspektimit**

Subjekti i mbikëqyrur krijon për punonjësit e autorizuar të Autoritetit ambient pune të veçantë e të përshtatshëm për kryerjen e inspektimit pa ndërhyrjen apo praninë e personave të tjerë.

Neni 138

### **Inspektimi i dokumentacionit dhe i të dhënave të informatizuara**

1. Subjekti i mbikëqyrur, që përpunon dhe mban librat e biznesit dhe të dhëna të tjera të veprimtarisë së shoqërisë së sigurimit, me anë të një sistemi kompjuterik, me kërkesë të punonjësit të autorizuar të Autoritetit, jep ndihmën e duhur teknike për

shqyrtimin e dokumentacionit dhe të dhënave të informatizuara të veprimtarisë së shoqërisë, si dhe për verifikimin e librave të biznesit dhe të dhënave të përpunuara në mënyrë elektronike.

2. Subjekti i mbikëqyrur vë në dispozicion të Autoritetit dokumentet që tregojnë një përshkrim të hollësishëm të veprimeve të sistemit kompjuterik. Dokumentet duhet të tregojnë dhe çdo sistem tjetër apo skedar të lidhur me sistemin kompjuterik, si dhe të mundësojnë inspektimin:

- a) e programit kompjuterik;
- b) e procedurave, brenda qëllimit të programit kompjuterik;
- c) e kontrolleve, të cilat sigurojnë përpunim të saktë dhe të sigurt të të dhënave;
- ç) kontrolleve të cilat parandalojnë ndërhyrjen e paautorizuar, si shtimin, ndryshimin apo fshirjen e të dhënave të ruajtura në kompjuter.

3. Çdo ndryshim i programit kompjuterik, të përmendur në pikën 2, të këtij neni, dokumentohet sipas rendit kronologjik të ndryshimeve të bëra, përfshirë këtu edhe datën e ndryshimit. Dokumentet tregojnë edhe çdo ndryshim të formës së skedarëve.

Neni 139

### **Konstatimi i shkeljeve dhe parregullsive**

Nëse Autoriteti, gjatë ushtrimit të mbikëqyrjes, konstaton veprime të kryera në kundërshtim me këtë ligj, me aktet e Autoritetit apo me dispozita të legjislacionit në fuqi, të zbatueshëm nga subjekti i mbikëqyrur, merr vendim duke urdhëruar subjektin të eliminojë shkeljet dhe parregullsitë ose merr ndonjë masë tjetër mbikëqyrëse apo sanksion, sipas parashikimeve të këtij ligji.

Seksioni IV

### **Mbikëqyrja e grupit**

Neni 140

### **Mbikëqyrja e grupit**

1. Autoriteti ushtron mbikëqyrje plotësuese ndaj shoqërive të sigurimit të strukturuar në grup sigurimi, sipas dispozitave të këtij seksioni. Autoriteti ushtron, gjithashtu, mbikëqyrje plotësuese edhe për personat juridikë të lidhur me shoqërinë e sigurimit ose pjesëmarrëse në të apo për personat e lidhur të shoqërisë pjesëmarrëse në shoqërinë e sigurimit në Republikën e Shqipërisë, në një vend anëtar apo të huaj, të cilët kanë selinë qendrore në Republikën e Shqipërisë.

2. Përveç sa parashikohet në pikën 1, të këtij neni, shoqëri pjesëmarrëse është një shoqëri mëmë ose një shoqëri që zotëron pjesëmarrje apo është anëtare e një grupi horizontal. Grup horizontal quhet grupi, në të cilin një shoqëri është e lidhur me një ose më shumë shoqëri të tjera në një nga mënyrat e mëposhtme:

a) janë subjekt i kontrollit të përbashkët, sipas dispozitave të një marrëveshjeje apo statutit ose të një kontrate;

b) strukturat e tyre administrative, drejtuese dhe mbikëqyrëse janë të përbëra kryesisht nga të njëjtët persona që mbajnë ato pozicione gjatë vitit financiar, me kusht



që shoqëritë të përgatitin apo mund t'u duhet të përgatitin pasqyra financiare të konsoliduara.

3. Ushtrimi i mbikëqyrjes plotësuese ndaj shoqërive të sigurimit, të cilat zotërohen nga e njëjta shoqëri kontrolluese financiare, grup kontrollues sigurimesh i përzier, shoqëri kontrolluese sigurimi, shoqëri kontrolluese sigurimi me aktivitet të përzier, shoqëri kontrolluese financiare me aktivitet të përzier, shoqëri sigurimi e një vendi të huaj, të cilat ushtrojnë veprimtari sigurimi në dy ose më shumë vende anëtare, ushtrohet nga autoritetet mbikëqyrëse përgjegjëse të vendeve anëtare, të cilat mund të lidhin marrëveshje, që njëri prej tyre, i ashtuquajtur koordinatar, ushtron mbikëqyrje plotësuese dhe u shpërndan të tjerëve rezultatet e mbikëqyrjes.

4. Autoriteti mbikëqyrës kompetent i vendit anëtar mund, gjithashtu, të kryejë mbikëqyrje plotësuese të shoqërive dhe subjekteve të lidhura me shoqërinë e sigurimit, të cilat kanë pjesëmarrje në shoqërinë e sigurimit apo që janë të lidhura me shoqërinë pjesëmarrëse në shoqërinë e sigurimit në Republikën e Shqipërisë, vendin anëtar ose në një vend të huaj dhe që kanë selinë qendrore në vendin anëtar.

5. Autoriteti mund të ushtrojë mbikëqyrje plotësuese të një shoqërie sigurimi, shoqërie risigurimi, grupi kontrollues sigurimesh të përzier, shoqërie kontrolluese sigurimi me aktivitet të përzier, të cilat ndodhen në një vend të huaj.

Neni 141

### **Grupi i sigurimit**

1. Grupi i sigurimit, për qëllime të mbikëqyrjes, sipas këtij ligji, përbëhet nga dy ose më shumë persona juridikë ku të paktën njëri është shoqëri sigurimi dhe tjetri ka ndikim të rëndësishëm në shoqërinë e sigurimit. Ndikimi i rëndësishëm përcaktohet bazuar në kriterin e pjesëmarrjes së drejtpërdrejtë ose të tërthortë, ndikimit dhe/ose detyrimeve të ndryshme kontraktuale, lidhjet brenda grupit, ekspozimit ndaj rrezikut, përqendrimit të rrezikut, transferimit të rrezikut, përqindjes së zotërimit të pronësisë dhe/ose transaksionet brenda grupit. Grupi i sigurimit ekziston kur një shoqëri sigurimi ose një shoqëri risigurimi a një grup kontrollues sigurimi i përzier, shoqëri kontrolluese financiare, shoqëri kontrolluese sigurimi, shoqëri kontrolluese sigurimi me aktivitet të përzier, shoqëri kontrolluese financiare me aktivitet të përzier, me seli qendrore në Republikën e Shqipërisë, është shoqëri mëmë e një ose disa shoqërive sigurimi a risigurimi, me seli qendrore respektivisht në Republikën e Shqipërisë, vend anëtar ose vend të huaj.

2. Shoqëria e sigurimit ose e risigurimit apo grupi kontrollues i sigurimeve i përzier, shoqëria kontrolluese financiare, shoqëria kontrolluese e sigurimit, shoqëria kontrolluese e sigurimit me aktivitet të përzier, shoqëria kontrolluese financiare me aktivitet të përzier quhet shoqëria mëmë e një shoqërie sigurimi, në kuptim të pikës 1, të këtij neni, nëse:

a) zotëron pjesëmarrje të cilësuar, sipas përcaktimit të nenit 4, pika 27, të këtij ligji;

b) ka shumicën e të drejtave të votës në një shoqëri tjetër;

c) ka të drejtën e emërimit apo shkarkimit të shumicës së anëtarëve të këshillit të administrimit/mbikëqyrës të një shoqërie tjetër;

ç) ka të drejtë të ushtrojë influencë dominuese mbi një shoqëri tjetër, bazuar në një kontratë biznesi apo mbi dokumente të tjera ligjore;

d) shumica e anëtarëve të këshillit të administrimit/mbikëqyrës të shoqërisë, që kanë kryer ato funksione në vitin e parë financiar dhe që vazhdojnë t'i kryejnë ato për qëllime të përgatitjes së raporteve të konsoliduara, ishin emëruar ekskluzivisht për qëllime të ushtrimit të të drejtave të votës në shoqërinë mëmë;

dh) është aksionar ose partner në një tjetër shoqëri dhe nëse, bazuar në marrëveshjet me aksionarët apo partnerët e asaj shoqërie, kontrollon shumicën e së drejtës së votës në atë shoqëri.

3. Grupi i sigurimit ekziston, gjithashtu, në rastet kur një grup kontrollues sigurimi i përzier, shoqëri kontrolluese financiare, shoqëri kontrolluese sigurimi, shoqëri kontrolluese sigurimi me aktivitet të përzier, shoqëri kontrolluese financiare me aktivitet të përzier, që ka selinë qendrore në një vend anëtar, është shoqëri mëmë e të paktën e një shoqërie sigurimi, me seli qendrore në Republikën e Shqipërisë, në një nga mënyrat e përcaktuara në pikën 2 të këtij neni.

4. Përfshihet nga rregulli i përcaktuar në pikën 2, të këtij neni, shoqëria e sigurimit, me seli qendrore në Republikën e Shqipërisë, që është njëkohësisht shoqëri e kontrolluar nga një tjetër shoqëri sigurimi, me seli qendrore në Republikën e Shqipërisë, nuk do të quhet shoqëri sigurimi mëmë në një grup sigurimi.

#### Neni 142

### **Termet në lidhje me grupin e sigurimit**

1. Shoqëri kontrolluese financiare është një person juridik:

a) i ndryshëm nga një shoqëri sigurimi ose risigurimi;

b) i cili kontrollon të paktën një shoqëri sigurimi ose risigurimi;

c) veprimtaria kryesore e të cilit është blerja ose zotërimi i pjesëmarrjeve influencuese ose ofrimi i shërbimeve të tjera financiare.

2. Grup kontrollues sigurimesh i përzier është një person juridik:

a) i ndryshëm nga një shoqëri sigurimi apo risigurimi; dhe

b) i cili kontrollon ekskluzivisht ose në mënyrë mbizotëruese shoqëritë e sigurimit dhe/ose të risigurimit ndërmjet shoqërive të kontrolluara të tij, ku kriteri për përcaktimin e shoqërive të kontrolluara nuk është numri, por volumi i kapitalit të tyre, vlera kontabël e pjesëmarrjeve dhe kritere të tjera ekonomike.

3. Shoqëri risigurimi e lidhur është një shoqëri risigurimi, e cila zotërohet nga një institucion financiar i ndryshëm nga një shoqëri sigurimi a risigurimi, ose e cila zotërohet nga një grup sigurimi apo një person juridik jofinanciar. Qëllimi i shoqërisë së risigurimit të lidhur është që të ofrojë mbulim risigurimi për rreziqet e një ose më shumë personave juridikë që e zotërojnë atë ose të anëtarëve të grupit ku ajo bën pjesë.

4. Shoqëri e lidhur është një shoqëri e kontrolluar ose një shoqëri tjetër, në të cilën zotërohet pjesëmarrje, apo një shoqëri e lidhur me një shoqëri tjetër me marrëdhënie të njëjta, sipas përcaktimeve të nenit 140, pika 2, të këtij ligji.

5. Shoqëri kontrolluese sigurimi është një person juridik, i cili është shoqëri mëmë, veprimtaria kryesore e së cilës është të blejë dhe të zotërojë pjesëmarrje në shoqëri të kontrolluara, ku këto shoqëri të kontrolluara janë ekskluzivisht ose kryesisht shoqëri sigurimi ose risigurimi apo shoqëri sigurimi ose risigurimi të vendeve të huaja, ku të paktën një nga këto shoqëri të kontrolluara është shoqëri sigurimi ose risigurimi dhe e cila nuk është shoqëri kontrolluese financiare me aktivitet të përzier.

6. Shoqëri kontrolluese sigurimi me aktivitet të përzier është një person juridik që është shoqëri mëmë, veprimtaria kryesore e së cilës është e ndryshme nga një shoqëri

sigurimi, shoqëri risigurimi, shoqëri kontrolluese sigurimi ose shoqëri kontrolluese financiare me aktivitet të përzier dhe që përfshin të paktën një shoqëri sigurimi ose risigurimi midis shoqërive të kontrolluara të saj.

7. Shoqëri kontrolluese financiare me aktivitet të përzier është një person juridik që është shoqëri mëmë, e ndryshme nga një subjekt i rregulluar nga ky ligj, që së bashku me shoqëritë e kontrolluara të saj, ku të paktën njëra është një subjekt i rregulluar nga ky ligj, me seli qendrore në Republikën e Shqipërisë dhe së bashku me subjektet e tjera formon një konglomerat financiar.

8. Shoqëri kontrolluese financiare me aktivitet të përzier është gjithashtu një person juridik që është shoqëri mëmë, e ndryshme nga një subjekt i rregulluar nga ky ligj, që së bashku me shoqëritë e kontrolluara të saj, ku të paktën njëra është një subjekt i rregulluar nga ky ligj, me seli qendrore në një vend anëtar, dhe së bashku me subjektet e tjera formon një konglomerat financiar.

#### Neni 143

### **Detyrimet e një shoqërie sigurimi në një grup sigurimi**

1. Shoqëritë e sigurimit, të cilat përbëjnë një grup sigurimi, i paraqesin shoqërisë së sigurimit mëmë, shoqërisë kontrolluese financiare, shoqërisë kontrolluese të sigurimit, shoqërisë kontrolluese të sigurimit me aktivitet të përzier, shoqërisë kontrolluese financiare me aktivitet të përzier të gjitha të dhënat dhe informacionin që i kërkohet për të përmbushur detyrimet ndaj Autoritetit ose ndaj autoritetit kompetent mbikëqyrës në lidhje me mbikëqyrjen e grupit të sigurimit.

2. Shoqëria e sigurimit mëmë në një grup sigurimi është përgjegjëse për përmbushjen e detyrimeve të të gjithë grupit të sigurimit.

3. Autoriteti, gjatë ushtrimit të mbikëqyrjes plotësuese, ka akses në çdo informacion, i cili është i rëndësishëm për qëllimin e mbikëqyrjes së shoqërisë, subjekt i mbikëqyrjes plotësuese. Autoriteti mund t'i kërkojë drejtpërsëdrejti shoqërisë së lidhur të shoqërisë së sigurimit ose pjesëmarrëse në shoqërinë e sigurimit apo shoqërisë së lidhur të shoqërisë pjesëmarrëse në shoqërinë e sigurimit për marrjen e informacionit të nevojshëm, vetëm nëse ky informacion është kërkuar nga shoqëria e sigurimit dhe kjo e fundit nuk e ka dhënë atë.

4. Shoqëritë e sigurimit, të cilat formojnë një grup sigurimi, duhet të kenë procedura të përshtatshme të kontrollit të brendshëm, me qëllim verifikimin e saktësisë të të dhënave dhe informacionit referuar pikës 1 të këtij neni.

#### Neni 144

### **Raportimi i transaksioneve brenda grupit**

1. Në mënyrë që të sigurohet mbikëqyrja e transaksioneve të biznesit brenda një grupi sigurimi, nëse ato janë kryer sipas kushteve normale të tregut, shoqëria e sigurimit në një grup sigurimi i raporton Autoritetit për të gjitha transaksionet e rëndësishme brenda grupit, për të cilat është rënë dakord ose të cilat janë kryer ndërmjet shoqërisë së sigurimit dhe personave, si më poshtë:

- a) personave apo palëve të lidhura të shoqërisë së sigurimit;
- b) shoqërive pjesëmarrëse në shoqërinë e sigurimit;
- c) shoqërive të lidhura të shoqërisë pjesëmarrëse në shoqëritë e sigurimit;

ç) personave fizikë pjesëmarrës në:

i) shoqërinë e sigurimit apo në shoqëritë e lidhura me to;

ii) shoqëritë pjesëmarrëse në shoqërinë e sigurimit;

iii) shoqëritë e lidhura të shoqërisë pjesëmarrëse në shoqërinë e sigurimit.

Këto transaksione duhet të kryhen në përputhje me parimin e administrimit të kujdesshëm dhe të ndërgjegjshëm, duke marrë parasysh interesat e të siguruarve.

2. Transaksion brenda grupit është çdo transaksion, nëpërmjet të cilit shoqëria e sigurimit lidhet në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë me një nga personat e përmendur në pikën 1, të këtij neni, për përmbushjen e një detyrimi kontraktual apo jokontraktual, i cili mund të jetë me ose pa pagesë.

3. Përveç sa është parashikuar në pikën 2, të këtij neni, transaksione të rëndësishme brenda grupit quhen:

a) huatë;

b) garancitë dhe transaksionet jashtë bilancit;

c) elemente, të cilat përfshihen në llogaritjen e aftësisë paguese;

ç) investimet;

d) operacionet e risigurimit dhe retrocedimit;

dh) marrëveshjet për ndarjen e shpenzimeve.

4. Transaksionet e përmendura më sipër kryhen në mënyrë të matur, duke marrë parasysh interesat e të siguruarve.

5. Shoqëria e sigurimit, e cila është subjekt i mbikëqyrjes plotësuese, i paraqet Autoritetit një raport vjetor mbi transaksionet e rëndësishme, sipas kuptimit të pikave 1 dhe 3 të këtij neni. Shoqëria informon menjëherë Autoritetin në lidhje me transaksionet, sipas kuptimit të pikave 1 dhe 3, të këtij neni, të cilat rrezikojnë aftësinë paguese të shoqërisë së sigurimit.

6. Autoriteti, në mënyrë që të vërtetojë saktësinë e të dhënave në lidhje me transaksionet brenda grupit të sigurimit, mund të verifikojë transaksionet e kryera nga personat e përcaktuar në pikën 1 të këtij neni.

7. Nëse ka pengesa ligjore për komunikimin e informacionit të kërkuar, Autoriteti, gjatë ushtrimit të mbikëqyrjes plotësuese të grupit të sigurimit, nuk përfshin personat juridikë, përcaktuar në nenin 140, të këtij ligji, të cilët kanë seli qendrore në një vend të huaj.

8. Autoriteti mund të kryejë vetë ose nëpërmjet një personi të autorizuar verifikimet në vend të informacionit të përcaktuar në nenin 143, pika 3, të këtij ligji, të shoqëria e sigurimit subjekt i mbikëqyrjes plotësuese, shoqëritë e kontrolluara të kësaj shoqërie sigurimi, shoqëritë mëmë të kësaj shoqërie sigurimi apo shoqëria e kontrolluar e shoqërisë mëmë të kësaj shoqërie sigurimi.

9. Në raste të veçanta, Autoriteti i kërkon autoritetit kompetent mbikëqyrës të vendit anëtar të verifikojë informacionin e rëndësishëm të shoqërisë, referuar pikës 6, të këtij neni, e cila ndodhet në një vend tjetër anëtar dhe që është subjekt i mbikëqyrjes plotësuese. Autoriteti mund të marrë pjesë në verifikimin e këtij informacioni.

10. Shoqëria e sigurimit, e cila është subjekt i mbikëqyrjes plotësuese, ka mekanizma të kontrollit dhe të administrimit të rrezikut, duke përfshirë sistemet raportuese dhe standarde kontabël të duhura, të cilat janë të përshtatshme për ruajtjen, përcaktimin e sasisë dhe monitorimin e transaksioneve, të përcaktuara në pikën 3 të këtij neni.

11. Autoriteti mund të përcaktojë me rregullore përmbajtjen e detajuar të raporteve të parashikuara në pikën 3, të këtij neni, si dhe afatet kohore dhe metodën e raportimit.

## Neni 145

### **Organet drejtuese të grupit kontrollues të sigurimit të përzier dhe grupit kontrollues të sigurimit**

1. Personat, të cilët administrojnë veprimtarinë e grupit kontrollues të sigurimit të përzier dhe grupit kontrollues të sigurimit, duhet të kenë reputacion të mirë dhe përvojë të mjaftueshme për ushtrimin e këtyre detyrave.

2. Autoriteti miraton rregullore në lidhje me kriteret që duhet të përmbushin personat e sipërpërmendur.

## Neni 146

### **Mjaftueshmëria e kapitalit në një grup sigurimi**

1. Grupi kontrollues financiar, grupi kontrollues i sigurimit i përzier, grupi kontrollues i sigurimit, grupi kontrollues i sigurimit me aktivitet të përzier, grupi kontrollues financiar i përzier ose shoqëria siguruese ose risiguruese mëmë në një grup sigurimi duhet të llogarisë mjaftueshmërinë e kapitalit në një grup sigurimi dhe të përfshijë raporte financiare mbi mjaftueshmërinë e kapitalit të grupit të sigurimit.

2. Shoqëritë e sigurimit të kontrolluara i paraqesin shoqërisë kontrolluese financiare, shoqërisë kontrolluese të sigurimit, shoqërisë kontrolluese të sigurimit me aktivitet të përzier, shoqërisë kontrolluese financiare me aktivitet të përzier ose një shoqërie sigurimi mëmë në një grup sigurimi të gjitha të dhënat e kërkuara në llogaritjen e mjaftueshmërisë së kapitalit të një grupi sigurimi.

3. Grupi kontrollues financiar, grupi kontrollues i sigurimit i përzier, grupi kontrollues i sigurimit, grupi kontrollues i sigurimit me aktivitet të përzier, grupi kontrollues financiar i përzier ose shoqëria siguruese apo risiguruese mëmë i raporton Autoritetit mbi mjaftueshmërinë e kapitalit të grupit të sigurimit.

4. Dispozitat e seksionit II, të kreut VII, të këtij ligji, në lidhje me auditimin e pasqyrave financiare të shoqërisë së sigurimit, zbatohen rast pas rasti për auditimin e raporteve financiare për mjaftueshmërinë e kapitalit të grupit kontrollues financiar, grupit kontrollues të sigurimit të përzier, grupit kontrollues të sigurimit, grupit kontrollues të sigurimit me aktivitet të përzier, grupit kontrollues financiar të përzier ose shoqërisë siguruese apo risiguruese mëmë në një grup sigurimi.

5. Autoriteti përcakton metodën e llogaritjes së mjaftueshmërisë së kapitalit të një grupi sigurimi, përmbajtjen e detajuar të raporteve, si dhe afatet kohore dhe mënyrën e raportimit.

## Neni 147

### **Masat në rast të pamjaftueshmërisë së aftësisë paguese**

Autoriteti merr masat e mbikëqyrjes, të parashikuara në seksionin V, të kreut VIII, të këtij ligji, nëse nga llogaritja e kryer ose nga raporti i depozituar në përputhje me nenin 146, të këtij ligji, konstatohet se aftësia paguese e grupit të sigurimit është e pamjaftueshme ose rrezikon të bëhet e pamjaftueshme.

### **Raportimi në Autoritet dhe dhënia e informacionit**

1. Shoqëria e sigurimit njofton rregullisht Autoritetin për çdo fakt ose rrethanë që mund të jetë e rëndësishme për të përcaktuar nëse subjekti është një grup sigurimi, sipas përcaktimeve të këtij ligji.

2. Shoqëria e sigurimit në një grup sigurimi përgatit një aneks të veçantë të raportit vjetor, duke dhënë të gjitha të dhënat mbi shoqëritë mëmë dhe të kontrolluara të grupit të sigurimit.

3. Autoriteti mund të përcaktojë përmbajtjen e detajuar të raporteve, afatet kohore dhe mënyrën e raportimit.

### Seksioni V

#### **Masat e mbikëqyrjes**

#### Neni 149

#### **Masat e mbikëqyrjes**

1. Me qëllim parandalimin, korrigjimin apo ndërprerjen e rrethanave të parashikuara në nenet 150 dhe 151, të këtij ligji, apo veprimeve që përbëjnë shkelje të dispozitave të këtij ligji ose akteve të nxjerra në zbatim të tij, Autoriteti merr masat e mbikëqyrjes të parashikuara në këtë seksion të këtij ligji.

2. Në rastet kur Autoriteti çmon se mospërbushja e masës së mbikëqyrjes mund të sjellë dëm serioz për të siguruarit, ankimi mund të kushtëzohet në ofrimin nga ana e shoqërive të sigurimit të garancive të përshtatshme për ekzekutimin paraprak dhe të menjëhershëm të masës së mbikëqyrjes.

#### Neni 150

#### **Rrethanat për marrjen e masave të mbikëqyrjes**

1. Autoriteti merr masat e mbikëqyrjes, të parashikuara në nenin 152, të këtij ligji, nëse:

a) vlerëson se shoqëria e sigurimit apo personi përgjegjës në shoqërinë e sigurimit është duke kryer apo është gati të kryejë një veprim apo po ndjek ose është gati të ndjekë një sjellje etike biznesi, që përbën praktikë të rrezikshme apo të paqëndrueshme për veprimtarinë e shoqërisë;

b) shoqëria e sigurimit është ose pritet të jetë, sipas vlerësimit të Autoritetit, e paaftë të përmbushë detyrimet e saj kur ju vjen afati apo bëhen të kërkueshme;

c) vlerëson se aktivet e shoqërisë nuk janë të mjaftueshme për të garantuar një mbrojtje të përshtatshme për të siguruarit dhe kreditorët;

ç) vlerëson se aktivet e pasqyruara në librat kontabël të shoqërisë së sigurimit apo aktivet që mbahen nën administrimin e saj nuk janë kontabilizuar saktë;

d) vlerëson se rrezikohen interesat e të siguruarve dhe/ose niveli i kapitalit nuk është i mjaftueshëm, sipas përcaktimeve të neneve 80 dhe 81, të këtij ligji, apo po

zvogëlohet në mënyrë të tillë që mund të ndikojë negativisht ndaj të siguarve apo kreditorëve;

dh) vlerëson se shoqëria e sigurimit gjendet në një situatë të tillë që mund të dëmtohen interesat e të siguarve, kreditorëve apo zotëruesve të aktiveve nën administrimin e shoqërisë, duke përfshirë këtu edhe rastin e hapjes së procedurave të falimentimit në Shqipëri, apo diku tjetër, në rast kur kemi të bëjmë me grup;

e) shoqëria e sigurimit nuk ka zbatuar urdhrin e dhënë, sipas nenit 153, pika 1, shkronja "I", të këtij ligji;

ë) shoqëria e sigurimit është apo pritet të jetë e paaftë të përmbushë kërkesat për mjaftueshmërinë e kapitalit sipas nenit 80, të këtij ligji, përfshirë kërkesat për fondin e garancisë sipas nenit 81 të këtij ligji;

f) shoqëria e sigurimit nuk vijon të përmbushë një ose disa nga kërkesat fillestare të marrjes së licencës;

g) personi i përcaktuar në nenin 17, të këtij ligji, nuk vijon të përmbushë në vazhdimësi një ose disa nga kërkesat për përshtatshmëri dhe aftësi për të mbajtur pozicionin e caktuar;

gj) shoqëria e sigurimit shkel dispozitat e këtij ligji apo akteve të Autoritetit në fushën e sigurimeve;

h) shoqëria e sigurimit nuk përmbush ose mund të mos përmbushë kushtet për ushtrimin e veprimtarisë së sigurimit;

i) shoqëria e sigurimit shkel rregullat e administrimit të rrezikut;

j) shoqëria e sigurimit shkel rregullat mbi mbajtjen e librave të kontabilitetit dhe/ose regjistrave tregtarë, si dhe ato që lidhen me raportimin periodik, auditimin e brendshëm apo auditimin e pasqyrave vjetore;

k) shoqëria e sigurimit shkel detyrimin për raportim dhe njoftim në përputhje me dispozitat e këtij ligji;

l) shoqëria e sigurimit shkel rregullat në lidhje me emërimin e aktuarit të autorizuar;

ll) anëtarë i këshillit të administrimit/mbikëqyrës nuk ka marrë miratimin, sipas kërkesave të nenit 21 të këtij ligji.

2. Vlerësimi i rrethanave për marrjen e masave të mbikëqyrjes bëhet bazuar në parimet dhe kriteret e përcaktuara në aktet e Autoritetit.

## Neni 151

### **Shkelje të rënda të rregullave të administrimit të rrezikut**

Shoqëria e sigurimit quhet se ka kryer shkelje të rënda të rregullave të administrimit të rrezikut nëse, midis të tjerave, dhe duke mos përjashtuar përcaktimet e nenit 150, pika 1, të këtij ligji:

a) nuk arrin kërkesat e kapitalit të përcaktuar në nenet 80 dhe 81, të këtij ligji, ose nuk zbaton masat e përcaktuara në nenin 82, të këtij ligji, ose nuk mban nivelin minimal të kërkuar të treguesit të likuiditetit, sipas parashikimeve të nenit 84, pika 4, të këtij ligji;

b) nuk organizon veprimtarinë e saj ose nuk mban librat e kontabilitetit dhe/apo regjistrat tregtarë, dokumentet e biznesit dhe të dhëna të tjera administrative dhe tregtare, në mënyrë të tillë që në çdo kohë bëjnë të mundur verifikimin nëse shoqëria e sigurimit ushtron veprimtarinë e saj në përputhje me rregullat e administrimit të rrezikut;

c) nuk arrin të miratojë masat dhe të krijojë rregullat për vlerësimin e duhur të zërave të bilancit dhe jashtë bilancit apo nëse i vlerëson këto zëra në kundërshtim me këtë ligj ose aktet e Autoritetit;

ç) shkel dispozitat e nenit 116 të këtij ligji;

d) shkel dispozitat e neneve 96-108 të këtij ligji;

dh) shpërndan dividendë në kundërshtim me parashikimet e nenit 86 të këtij ligji;

e) shkel në mënyrë të përsëritur detyrimin për raportim të saktë dhe në kohë të përcaktuar në këtë ligj ose në aktet e Autoritetit;

ë) kryen transaksione fiktive, me qëllim raportimin jo të saktë të gjendjes financiare të shoqërisë së sigurimit;

f) kryen veprimtari të tjera, të cilat mund të rrezikojnë likuiditetin dhe aftësinë paguese të shoqërisë së sigurimit;

g) kryen veprimtari në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji.

## Neni 152

### **Marrja e masave të mbikëqyrjes**

1. Në rastet kur Autoriteti vlerëson se shoqëria e sigurimit ndodhet në një apo disa prej rrethanave të përcaktuara në nenin 150, të këtij ligji, merr ndaj shoqërisë së sigurimit një ose disa nga masat e mbikëqyrjes të mëposhtme:

a) urdhëron shoqërinë e sigurimit apo personin përgjegjës të ndalojë të kryejë një veprim të caktuar ose të ndjekë një sjellje etike biznesi të caktuar apo e urdhëron që të kryejë një veprim të caktuar që, sipas gjykimit të Autoritetit, është i nevojshëm për përmirësimin e situatës dhe/ose për parandalimin ose korrigjimin e shkeljeve të këtij ligji dhe akteve të Autoritetit;

b) nxjerr urdhër për eliminimin e shkeljeve dhe parregullsive;

c) i kërkon shoqërisë së sigurimit të depozitojë një plan rimëkëmbjeje financiare, të përcaktuar në nenin 83, të këtij ligji, për përmbushjen e kërkesave të mjaftueshmërisë së kapitalit;

ç) i kërkon shoqërisë së sigurimit të auditojë veprimtarinë financiare nga një auditues i zgjedhur nga Autoriteti, por me shpenzimet e shoqërisë së sigurimit, ose urdhëron shoqërinë e sigurimit të shkarkojë një auditues dhe të emërojë një tjetër, sipas kushteve të përcaktuara nga Autoriteti ose i kërkon audituesit të jashtëm të zgjerojë objektin e auditimit apo të kryejë procedura të tjera dhe të përgatitë një raport për Autoritetin;

d) përveç përcaktimeve të pikës 1, shkronja “ç”, të këtij neni, Autoriteti mund të kërkojë nga audituesi i jashtëm, me shpenzimet e shoqërisë së sigurimit, të kryejë një auditim të veçantë që lidhet me përshtatshmërinë e procedurave të shoqërisë së sigurimit për të mbrojtur kreditorët, aksionarët dhe të siguruarit e saj apo çdo auditim tjetër në interes të publikut dhe t’i raportojë Autoritetit për këtë;

dh) i kërkon shoqërisë së sigurimit që, me shpenzimet e saj, të emërojë një person të miratuar nga Autoriteti që të këshillojë shoqërinë e sigurimit për kryerjen e veprimtarisë së saj në mënyrën e duhur dhe i cili i raporton Autoritetit brenda 3 muajve nga data e emërimit të tij;

e) mund të kërkojë një rivlerësim të vlerës së aktiveve, të cilat janë marrë parasysh në llogaritjen e kapitalit të shoqërisë së sigurimit, në rastin kur ka pasur një



ndryshim të konsiderueshëm të vlerës së tregut për këto elemente në krahasim me vitin paraardhës financiar;

ë) i kërkon shoqërisë së sigurimit të kryejë vlerësim të disa apo të gjithë aktiveve të saj apo të ndonjë prej shoqërive të kontrolluara të saj. Ky vlerësim mund të kryhet nga Autoriteti ose nga një ekspert i emëruar nga Autoriteti me shpenzimet e shoqërisë së sigurimit;

f) i kërkon shoqërisë së sigurimit informacion shtesë në çdo kohë dhe në formën që Autoriteti e gjykon të nevojshme dhe/ose kërkon rritjen e shpeshtësisë së raportimit në Autoritet dhe/ose kryen inspektimet përkatëse që lidhen me raportimet në fjalë;

g) kërkon shqyrtim të jashtëm, nëpërmjet një aktuari të autorizuar të pavarur, të metodave dhe supozimeve aktuariale të përdorura nga shoqëria e sigurimit, me shpenzimet e mbuluara nga kjo e fundit, ose mund të urdhërojë shoqërinë e sigurimit të modifikojë metodat apo supozimet e saj aktuariale, duke bërë rivlerësim të provigjoneve, ose mund të kërkojë që një aktuar i pavarur apo i jashtëm të kryejë shqyrtimin e mjaftueshmërisë së provigjoneve të shoqërisë së sigurimit;

gj) i kërkon shoqërisë së sigurimit të rishikojë kthimet e ofruara në produktet e anuitetit;

h) i kërkon shoqërisë së sigurimit të kalojë në risigurim përgjegjësitë, të cilat tejkalojnë mbulimin maksimal, sipas përcaktimeve të nenit 116 të këtij ligji;

i) i kërkon shoqërisë të zgjerojë objektin dhe të rritë dhe shpeshtësinë e inspektimeve në vend, në përputhje me dispozitat e nenit 136, të këtij ligji, ose të caktojë punonjësit e autorizuar për inspektim në shoqërinë e sigurimit për të monitoruar situatën në vazhdimësi nëse Autoriteti e shikon të nevojshme;

j) mund të kërkojë rilloaritjen e nivelit të kërkuar të aftësisë paguese të shoqërisë së sigurimit, duke u bazuar mbi risigurimin apo retrocedimin, nëse natyra apo cilësia e kontratave të risigurimit apo retrocedimit kanë ndryshuar në mënyrë të konsiderueshme, krahasuar me vitin e mëparshëm financiar, ose nëse këto kontrata nuk mundësojnë një transferim të ekuilibruar të rrezikut;

k) vendos shoqërinë e sigurimit apo aktivet e saj në administrim të përkohshëm, cakton drejtuesit e rinj të shoqërisë dhe merr menjëherë nën kontroll aktivet e shoqërisë;

l) kërkon revokim të plotë apo të pjesshëm të licencës.

2. Në përputhje me pikën 1, të këtij neni, nëse vlera e aktiveve të përcaktuara si të përshtatshme nga Autoriteti ndryshon nga vlera e aktiveve të vendosura nga shoqëria e sigurimit apo shoqëria e kontrolluar e saj, atëherë Autoriteti i dërgon shoqërisë, audituesit, aktuarit dhe komitetit të auditimit të shoqërisë së sigurimit një njoftim me shkrim të vlerës së përshtatshme të aktiveve të përcaktuara nga Autoriteti.

3. Autoriteti mund të këshillojë shoqërinë e sigurimit të ndërmarrë veprime të caktuara ose të rregullojë linjën e disa veprimeve të saj, përveç atyre të përcaktuara në këtë nen dhe në nenet 150 dhe 151, të këtij ligji, nëse kjo gjë është në përputhje me dispozitat e këtij ligji.

## Neni 153

### Urdhrat

1. Urdhrat e nxjerrë nga Autoriteti, në përputhje me nenin 152, të këtij ligji, mund të përmbajnë një ose më shumë nga kufizimet apo kërkesat e mëposhtme:

a) urdhëron këshillin e administrimit/mbikëqyrës të shoqërisë së sigurimit për të zbatuar një plan veprimi, i cili garanton nivelin e fondit të garancisë;

b) i kërkon shoqërisë së sigurimit të ndërmarrë ose të ndërpresë kryerjen e veprimeve të caktuara, të zbatojë kryerjen e një ose disa veprimeve të caktuara ose të kufizojë veprimtarinë e saj në fusha të caktuara;

c) urdhëron këshillin e administrimit/mbikëqyrës të shoqërisë së sigurimit të thërrasë mbledhjen e përgjithshme të asamblesë dhe t'i propozojë marrjen e vendimeve përkatëse;

ç) ndalon shoqërinë e sigurimit të lidhë kontrata të reja sigurimi në një ose disa klasa sigurimi ose të kërkojë që shoqëria e sigurimit të mbajë një nivel të caktuar primesh në raport me aftësinë paguese të shoqërisë apo të konsiderojë faktorë të tjerë në varësi të situatës;

d) ndalon shoqërinë e sigurimit të kryejë lloje të caktuara pagesash, të kryejë pagesa personave të caktuar, të hyjë në marrëdhënie të caktuara transaksionesh apo të hyjë në to me kushte të ndryshme nga ato të përcaktuara më parë;

dh) ndalon shoqërinë e sigurimit të kryejë transaksione me aksionarë të caktuar të saj, anëtarë të këshillit të administrimit/mbikëqyrës, palë të lidhura ose fonde investimi të administruara nga shoqëri administruese fondesh që është palë e lidhur me shoqërinë e sigurimit;

e) urdhëron këshillin e administrimit/mbikëqyrës të shoqërisë së sigurimit të miratojë dhe të zbatojë masa të përshtatshme me qëllim:

i) përmirësimin e procedurave të administrimit të rrezikut;

ii) ndryshimin e objektivave të veprimtarisë së shoqërisë së sigurimit;

iii) kufizimin e dhënies së huave;

iv) përmirësimin e procedurave për mbledhjen e kërkesave të arkëtueshme të vonuara;

v) vlerësimin e drejtë dhe të saktë të zërave të bilancit dhe zërave jashtë bilancit;

vi) përmirësimin e sistemit të teknologjisë së informacionit;

vii) përmirësimin e procedurave të kontrollit të brendshëm dhe auditimit të brendshëm;

viii) marrjen e çdo mase tjetër të nevojshme për zbatimin e rregullave të administrimit të rrezikut;

ë) ndalon ose kufizon përdorimin e lirë të një pjese apo të të gjithë aktiveve, duke përfshirë dhe veprimtarinë që lidhet me dhënien e huave dhe investimeve, sipas rregullave të miratuara nga Autoriteti;

f) mban në territorin e Republikës së Shqipërisë aktive në vlerën që Autoriteti e gjykon të nevojshme për të garantuar përmbushjen e përgjegjësisë të marra përsipër nga shoqëria e sigurimit në fjalë;

g) ndalon shoqërinë e sigurimit të ndërmarrë detyrime financiare për llogari të palëve të treta;

gj) ndalon shoqërinë e sigurimit, e cila është subjekt i pretendimeve të palëve të treta, të paguajë ose të transferojë çdo shumë të ndonjë person tjetër apo të marrë përsipër detyrimin për të bërë këtë;

h) ndalon shoqërinë e sigurimit të marrë hua, të paguajë dividendë dhe/ose tarifa të tjera të administrimit dhe/ose t'u transferojë përgjegjësitë palëve të treta ose një personi, lidhja e të cilit me shoqërinë e sigurimit është e tillë që e detyron atë të plotësojë kërkesat për përshtatshmëri dhe aftësi;

i) urdhëron këshillin e administrimit/mbikëqyrës të shoqërisë së sigurimit të shkarkojë ose të zëvendësojë administratorin/anëtarin e bordit të drejtorëve, funksionarët kryesorë të shoqërisë së sigurimit ose urdhëron ristrukturimin funksional të saj;

j) në përputhje me pikën 1, shkronja “i”, të këtij neni, Autoriteti urdhëron shkarkimin e administratorit/anëtarit të bordit të drejtorëve nëse:

i) shoqëria e sigurimit nuk vepron në përputhje me urdhrin për eliminimin e shkeljeve dhe parregullsive;

ii) shoqëria e sigurimit nuk zbaton masat e parashikuara në nenin 152 dhe pikën 1 të këtij neni;

iii) shoqëria e sigurimit në mënyrë të përsëritur nuk njofton ose nuk raporton saktë dhe në kohë Autoritetin apo pengon në çdo mënyrë ushtrimin e mbikëqyrjes nga Autoriteti.

k) i kërkon shoqërisë së sigurimit ose aksionarit influencues të shesë të gjitha ose një pjesë të aksioneve të tij në shoqërinë e sigurimit, brenda një periudhe kohore të përcaktuar nga Autoriteti, nëse shkelen dispozitat e parashikuara në nenin 150, pika 1, shkronjat “d”, “e” dhe “g”, dhe nëse janë ezauruar masat e tjera të nevojshme;

l) urdhëron shoqërinë e sigurimit të transferojë një pjesë apo të gjitha kontratat e sigurimit ose të risigurojë një pjesë ose të gjitha rreziqet e marra përsipër nga këto kontrata, në përputhje me kushtet e vendosura nga Autoriteti.

2. Shoqëria e sigurimit, aksionari influencues, kontrolluesi kryesor zbatojnë urdhrat e dhënë nga Autoriteti, sipas nenit 152 të këtij ligji.

3. Në përputhje me dispozitat e neneve 150, 151 dhe 152, të këtij ligji, Autoriteti mund t'i kërkojë shoqërisë së sigurimit të paraqesë një plan biznesi, i cili reflekton masat e duhura korrigjuese, të cilat do të korrigjojnë problemet brenda një periudhe kohore siç është përcaktuar nga Autoriteti.

4. Autoriteti, në urdhrin sipas nenit 152, të këtij ligji, dhe pikën 1, të këtij neni, përcakton afatet kohore për eliminimin e shkeljeve apo parregullsive.

#### Neni 154

### **Raportimi mbi zbatimin e urdhrin**

1. Shoqëria e sigurimit depoziton në Autoritet një raport të detajuar për masat e marra për korrigjimin e rrethanave të përmendura në nenin 150, të këtij ligji, brenda afateve të përcaktuara nga Autoriteti në urdhrin përkatës. Së bashku me raportin shoqëria e sigurimit depoziton çdo dokument apo provë tjetër, që vërteton se janë eliminuar shkeljet apo parregullsitë. Nëse Autoriteti e gjykon të nevojshme, shoqëria e sigurimit depoziton në Autoritet raportin e detajuar për masat e marra për korrigjimin e rrethanave të përmendura në nenin 150, të këtij ligji, të shoqëruar me raportin e audituesit të autorizuar.

2. Autoriteti, menjëherë pas marrjes së raportit nga shoqëria e sigurimit, verifikon korrigjimin e shkeljeve, sipas përcaktimeve të pikës 1, të këtij neni. Autoriteti përpara marrjes së vendimit mund të kryejë një inspektim tjetër të veprimtarisë së shoqërisë së sigurimit, i cili është i nevojshëm për të verifikuar nëse janë eliminuar shkeljet dhe parregullsitë.

3. Nëse raporti është i paplotë apo provat bashkëngjitur këtij raporti nuk tregojnë që janë eliminuar shkeljet dhe parregullsitë e identifikuar, Autoriteti urdhëron shoqërinë e sigurimit të plotësojë raportin e përmendur në pikën 1, të këtij neni, brenda një afati kohor të caktuar.

4. Autoriteti shqyrton dhe vendos për raportin për korrigjimin e shkeljeve brenda 30 ditëve kalendarike nga data e marrjes së informacionit të plotë për të gjykuar.

## Seksioni VI

### **Revokimi i licencës**

#### Neni 155

#### **Rastet e revokimit të licencës**

Autoriteti i revokon licencën e shoqërisë së sigurimit për të ushtruar veprimtari sigurimi nëse:

- a) licenca është bazuar në të dhëna jo të vërteta;
- b) shoqëria e sigurimit nuk ka arritur të korrigjojë rrethanat e përmendura në nenin 150, të këtij ligji, brenda afateve të përcaktuara nga Autoriteti në urdhrin përkatës;
- c) shoqëria e sigurimit kryen veprimtari të tjera tregtare, përveç veprimtarisë për të cilën është licencuar;
- ç) shoqëria e sigurimit nuk përmbush më kushtet, për të cilat është licencuar;
- d) shuma totale e përgjegjësive të shoqërisë së sigurimit, përfshirë provigjonet teknike ose matematike, të llogaritura në përputhje me këtë ligj dhe aktet e Autoritetit, tejkalojnë shumën totale të aktiveve të saj;
- dh) kur anëtarët e këshillit të administrimit/mbikëqyrës dhe administratori/anëtari i bordit të drejtorëve janë deklaruar fajtorë me vendim të formës së prerë për vepra penale kundër pasurisë dhe në sferën ekonomike dhe vepra penale të kryera në shoqëritë tregtare;
- e) kur ka prova të besueshme dhe konstaton që anëtarët e këshillit të administrimit dhe administratori janë përfshirë në transaksione, të cilat nuk janë në përputhje me ligjin, kur veprimet dhe/ose mosveprimet e tyre nuk përbëjnë vepra penale;
- ë) kur ndaj shoqërisë së sigurimit merren në mënyrë të përsëritur masa administrative ose dënohet me vendim të formës së prerë për shkelje të legjislacionit për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit;
- f) kur shoqëria dënohet me vendim të formës së prerë për veprat penale të kryera në sferën ekonomike dhe vepra penale në shoqëritë tregtare;
- g) ndaj shoqërisë së sigurimit janë hapur procedurat e falimentimit ose shoqëria e sigurimit prishet;
- gj) shoqëria e sigurimit zbaton praktika të brendshme tregtare, që cenojnë në mënyrë të kundraligjshme të drejtat e të siguruarve.

#### Neni 156

### **Revokimi i pjesshëm i licencës**

Përbashimisht nga përcaktimet e nenit 155, pika 1, të këtij ligji, Autoriteti revokon licencën vetëm për një ose disa klasa të caktuara të shoqërisë së sigurimit, nëse rastet e përmendura në nenin 155, pika 1, të këtij ligji, i referohen veprimtarisë së shoqërisë në ato klasa sigurimi. Dispozitat e zbatueshme për revokimin e plotë të licencës zbatohen edhe për revokimin e licencës vetëm në një ose disa klasa të caktuara.

## Neni 157

### **Paralajmërim për revokim licence**

1. Autoriteti, për rastet e përmendura në nenin 155, pika 1, shkronjat “b” dhe “ç”, të këtij ligji, mund të paralajmërojë shoqërinë e sigurimit për revokim licence, me kusht që shoqëria e sigurimit, brenda periudhës kohore të përcaktuar nga Autoriteti me vendim, të mos kryejë shkelje apo parregullsi të tjera, të njëjta me ato për të cilat është marrë vendimi për paralajmërim të revokimit të licencës.

2. Përveç sa është parashikuar në pikën 1, të këtij neni, Autoriteti, në vendimin për paralajmërimin e revokimit të licencës, mund të urdhërojë shoqërinë e sigurimit brenda afatit të përcaktuar në vendim të eliminojë shkeljet dhe parregullsitë ose të zbatojë masat, të cilat kanë qenë shkak për marrjen e vendimit të paralajmërimin të revokimit të licencës. Autoriteti përcakton kufizimet apo kushtet për t’u përmbushur nga shoqëria e sigurimit gjatë periudhës kohore të përcaktuar nga Autoriteti.

## Neni 158

### **Revokimi i licencës pas paralajmërimin**

Nëse shoqëria e sigurimit kryen shkelje apo parregullsi të reja, të njëjta me ato, të cilat kanë qenë shkak për marrjen e vendimit për paralajmërim të revokimit të licencës ose nuk përmbush kushtet e përcaktuara në nenin 157, pika 2, të këtij ligji, Autoriteti ka të drejtë të revokojë licencën.

## Neni 159

### **Njoftimi për revokimin e licencës**

1. Vendimi i Autoritetit për revokimin i njoftohet shoqërisë së sigurimit brenda 10 ditëve kalendarike nga data e marrjes së këtij vendimi.

2. Shoqëria e sigurimit, pasi është njoftuar për revokimin e licencës nuk kryen sa më poshtë:

- a) nënshkrimin e kontratave të reja të sigurimit;
- b) rinovimin e kontratave të sigurimit;
- c) zgjatjen e mbulimit të sigurimit për kontratat në fuqi;
- ç) rritjen e primit të sigurimit.

3. Shoqëria e sigurimit depoziton licencën në Autoritet brenda 10 ditëve kalendarike nga data e marrjes së njoftimit të vendimit për revokim licence.

4. Shoqëria e sigurimit vazhdon të jetë subjekt i dispozitave të këtij ligji edhe pas revokimit të licencës nga ana e Autoritetit. Revokimi i licencës nuk e përjashton shoqërinë e sigurimit nga detyrimet e kontratave ekzistuese.

5. Në rast të revokimit të licencës nga Autoriteti, shoqëria e sigurimit ka të drejtë të ankohet në gjykatën administrative, brenda afateve dhe sipas procedurave të parashikuara në ligjin nr. 49/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

Neni 160

### **Publikimi i vendimit për revokim licence**

Vendimi për revokim licence botohet në Fletoren Zyrtare dhe në një ose më shumë gazeta kombëtare me tirazh më të madh.

## **KREU IX**

### **ADMINISTRIMI I PÛRKOHSHËM DHE PRISHJA E SHOQËRISË SË SIGURIMIT**

#### **Seksioni I**

### **Administrimi i përkohshëm**

Neni 161

### **Vendimi për administrimin e përkohshëm**

1. Autoriteti, me qëllim që të rikthejë shoqërinë e sigurimit në një situatë financiare të qëndrueshme, merr vendim për administrimin e përkohshëm të shoqërisë së sigurimit, në përputhje me shkronjën “k”, të pikës 1, të nenit 152, të këtij ligji, në rastet kur:

a) shoqëria e sigurimit, e urdhëruar të marrë masat e mbikëqyrjes, të përcaktuara në nenet 152 dhe 153, të këtij ligji, nuk ka filluar zbatimin e këtyre masave ose nuk i ka zbatuar ato brenda afatit kohor të përcaktuar nga Autoriteti;

b) shoqëria e sigurimit, pavarësisht zbatimit të masave të mbikëqyrjes, të përcaktuara në nenet 152 dhe 153, të këtij ligji, nuk ka arritur ende nivelin e kërkuar të aftësisë paguese ose nuk përmbush përcaktimet e dispozitave të neneve 80 dhe/ose 81 të këtij ligji;

c) veprimtaria e mëtejshme e shoqërisë së sigurimit rrezikon likuiditetin, aftësinë paguese të saj ose sigurinë e të siguruarit.

2. Në rastet kur shoqëria e sigurimit ndodhet në një nga rrethanat e përcaktuara në shkronjat “b”, “c”, “ç”, “d” e “dh”, të nenit 150, të pikës 1, të këtij ligji, Autoriteti, sipas përcaktimeve të këtij ligji dhe kur gjykon se nuk cenohet interesi i publikut, mund të vendosë administrimin e përkohshëm të aktiveve të shoqërisë së sigurimit dhe aktiveve të tjera nën administrimin e saj, ose në rast të një shoqërie të huaj aktivitet e saj në Shqipëri, duke përfshirë këtu të gjitha shumat e marra ose për t’u marrë nga veprimtaria e saj në sigurime në Shqipëri.

3. Autoriteti përcakton periudhën kohore për administrimin e përkohshëm.

4. Në rastet e një situatë kritike vendimi i përmendur në pikën 2, të këtij neni, merret nga kryetari i Autoritetit për një periudhë kohore jo më shumë se 16 ditë. Bordi i Autoritetit, sapo të jetë e mundur, por jo më vonë se 16 ditë kalendarike nga marrja e vendimit të kryetarit, vendos për ndërprerjen apo zgjatjen e administrimit të përkohshëm të aktiveve të shoqërisë së sigurimit dhe aktiveve të tjera nën administrimin e saj ose, në rast të një shoqërie të huaj, të aktiveve të saj në Shqipëri, duke përfshirë këtu të gjitha shumat e marra ose për t’u marrë nga veprimtaria e saj në sigurime në Shqipëri.

Neni 162

### **Administratorët e përkohshëm**

Autoriteti emëron dy ose më shumë administratorë të përkohshëm dhe përcakton llojet e qëllimit të detyrave të ushtruara nga çdo administrator i përkohshëm, brenda 10 ditëve kalendarike nga marrja e vendimit, të cilët duhet të plotësojnë kërkesat e përcaktuara në nenet 17 dhe 20 të këtij ligji.

Neni 163

### **Regjistrimi në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit**

1. Autoriteti nxjerr vendim për emërimin e administratorëve të përkohshëm, i cili regjistrohet në regjistrin e QKR-së.

2. Kërkesa për regjistrim, e parashikuar në pikën 1, të këtij neni, kryhet nga administratori i përkohshëm, brenda 3 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit. Vendimi i Autoritetit për administrimin e përkohshëm i bashkëngjitet kërkesës për regjistrim.

Neni 164

### **Pasojat juridike të administrimit të përkohshëm**

1. Duke filluar nga data e marrjes së vendimit të administrimit të përkohshëm deri në emërimin e administratorit, kompetencat e këshillit të administrimit/mbikëqyrës i transferohen Autoritetit. Të gjitha përgjegjësitë dhe kompetencat e anëtarëve të këshillit të administrimit/mbikëqyrës dhe asamblesë së përgjithshme përfundojnë, me përjashtim të kompetencave për rritjen e kapitalit, sipas parashikimit të pikës 2, të nenit 167, dhe emërimin të anëtarëve të këshillit të administrimit, sipas parashikimit në dhënë në pikën 4, të nenit 168, të këtij ligji.

2. Administratori i përkohshëm, i emëruar nga Autoriteti, merr përsipër të gjitha përgjegjësitë e anëtarit të këshillit të administrimit/mbikëqyrës të shoqërisë së sigurimit.

3. Përveç sa është parashikuar në pikën 2, të këtij neni, Autoriteti u jep administratorëve të përkohshëm edhe udhëzime të detyrueshme për t'u zbatuar, në lidhje me riorganizimin dhe administrimin e shoqërisë së sigurimit. Autoriteti e shkarkon administratorin e përkohshëm nëse nuk vepron në përputhje me këto udhëzime.

Neni 165

### **Kompetencat e administratorit të përkohshëm**

1. Anëtarët e këshillit të administrimit/mbikëqyrës të shoqërisë së sigurimit, që kanë ushtruar atë detyrë deri në datën e vendimit të administrimit të përkohshëm, detyrohen të vënë në dispozicion të administratorit të përkohshëm të gjitha të dhënat tregtare dhe dokumentet e tjera të shoqërisë së sigurimit, duke përfshirë edhe një raport të gjendjes financiare, si dhe të përgatitin një raport për detyrat që i dorëzohen administratorit të përkohshëm.

2. Me kërkesë të administratorit të përkohshëm, personat e përmendur në pikën 1, të këtij neni, i vënë atij në dispozicion të gjitha shpjegimet dhe raportet shtesë mbi veprimtarinë e shoqërisë së sigurimit.

3. Administratori i përkohshëm ka të drejtë të shkarkojë çdo person që pengon punën e tij dhe që nuk jep informacionin e kërkuar.

Neni 166

### **Raportimi i administratorit të përkohshëm**

1. Administratori i përkohshëm përgatit dhe depoziton në Autoritet, çdo 3 muaj, një raport mbi gjendjen financiare si dhe ecurinë e veprimtarisë së shoqërisë së sigurimit në kushtet e administrimit të përkohshëm.

2. Administratori i përkohshëm përgatit dhe depoziton në Autoritet, brenda 9 muajve nga data e emërimit, një raport mbi gjendjen financiare dhe ecurinë e veprimtarisë së shoqërisë së sigurimit, në kushtet e administrimit të përkohshëm, së bashku me një vlerësim të qëndrueshmërisë dhe mundësive për vazhdimësinë ose jo të veprimtarisë së shoqërisë së sigurimit. Ky raport përfshin:

a) vlerësimin dhe pasojat e pranimit nga aksionarët të humbjeve të shoqërisë së sigurimit;

b) mundësinë e shpërndarjes së humbjeve të tjera të shoqërisë së sigurimit;

c) çdo shpenzim të mundshëm, i cili mund të ndikojë në përgjegjësitë e shoqërisë së sigurimit;

ç) vlerësimin e masave të mundshme për eliminimin e vështirësive financiare të shoqërisë së sigurimit, duke përfshirë dhe transferimin e kontratave të sigurimit së bashku me një vlerësim të kostove që rrjedhin nga zbatimi i këtyre masave;

d) vlerësimin e kushteve për likuidim apo falimentim të shoqërisë së sigurimit.

Neni 167

### **Rritja e kapitalit bazë për sigurimin e qëndrueshmërisë financiare**

1. Autoriteti, duke u bazuar në raportet e administratorit të përkohshëm, urdhëron këtë të fundit të thërrasë mbledhjen e asamblesë së përgjithshme të shoqërisë së sigurimit dhe të propozojë rritjen e kapitalit, nëse gjykon se kjo është e nevojshme.

2. Administratori i përkohshëm thërret mbledhjen e asamblesë së përgjithshme për të vendosur rritjen e kapitalit, jo më vonë se 8 ditë kalendarike pas marrjes së urdhrat të Autoritetit, sipas pikës 1, të këtij neni.

3. Administratori i përkohshëm vë në dijeni asamblenë e përgjithshme të aksionarëve që, në rast se refuzohet rritja e kapitalit, sipas pikës 1, të këtij neni, shoqëria e sigurimit do të kalojë në falimentim, sipas parashikimeve të nenit 183 të këtij ligji.

Neni 168

### **Vlerësimi i rezultateve të administrimit të përkohshëm**

1. Autoriteti vlerëson rezultatet e administrimit të përkohshëm, të paktën, një herë në 3 muaj.



2. Autoriteti pranon vlerësimin përfundimtar të rezultateve të administrimit të përkohshëm jo më vonë se 3 muaj pas marrjes së raportit të përmendur në pikën 2, të nenit 166, të këtij ligji.

3. Nëse Autoriteti vlerëson se gjatë administrimit të përkohshëm gjendja financiare e shoqërisë së sigurimit është përmirësuar në atë masë sa shoqëria ka arritur nivelin e kërkuar të aftësisë paguese dhe është në gjendje të përmbushë detyrimet e saj në kohë, merr vendim, në bazë të të cilit administratorit të përkohshëm i kërkohet që, brenda 8 ditëve kalendarike nga marrja e vendimit, të thërrasë mbledhjen e asamblesë së përgjithshme të shoqërisë së sigurimit. Kjo mbledhje mbahet brenda 2 muajve nga data e marrjes së vendimit të Autoritetit.

4. Në rastet e përmendura në pikën 3, të këtij neni, mbledhja e asamblesë së përgjithshme emëron anëtarët e këshillit të administrimit/mbikëqyrës, të cilët rimarrin kompetencat dhe përgjegjësitë e tyre, të përmendura në pikën 2, të nenit 164, të këtij ligji. Detyrat e administratorit të përkohshëm përfundojnë në datën e emërimit të anëtarëve të këshillit të administrimit/mbikëqyrës.

5. Nëse Autoriteti gjykon se gjatë mandatit të administratorit të përkohshëm gjendja financiare e shoqërisë së sigurimit nuk është përmirësuar në atë masë sa shoqëria të arrijë nivelin e kërkuar të aftësisë paguese, ose të jetë në gjendje të përmbushë detyrimet e saj në kohë, mund të vendosë zgjatjen e administrimit të përkohshëm dhe mandatit të administratorit të përkohshëm. Kjo zgjatje mund të bëhet vetëm nëse shoqëria e sigurimit nuk ndodhet në kushtet për fillimin e procedurave të likuidimit dhe nëse Autoriteti gjykon se shoqëria e sigurimit do të arrijë nivelin e kërkuar të aftësisë paguese. Nëse Autoriteti nuk merr vendim për zgjatjen e administrimit të përkohshëm, atëherë vendos për revokimin e licencës për të ushtruar veprimtari sigurimi.

## Seksioni II

### Likuidimi vullnetar i shoqërisë së sigurimit

#### Neni 169

#### **Vendimi i asamblesë së përgjithshme për likuidimin vullnetar**

1. Asambleja e përgjithshme e shoqërisë së sigurimit vendos për prishjen e shoqërisë apo ndryshimin e veprimtarisë së saj vetëm pas miratimit paraprak të Autoritetit.

2. Këshilli i administrimit/mbikëqyrës paraqet në Autoritet kërkesën për likuidim vullnetar.

3. Kërkesa për likuidimin vullnetar shoqërohet me dokumentet e mëposhtme:

a) një kopje të vendimit të asamblesë së përgjithshme të shoqërisë së sigurimit në lidhje me likuidimin;

b) arsyet e likuidimit;

c) emrat e propozuar të likuidatorëve;

ç) një raport të detajuar në lidhje me trajtimin e kërkesave për dëmshpërblim gjatë likuidimit, të ardhurat dhe shpenzimet, si dhe një parashikim të kohëzgjatjes së procesit.

4. Autoriteti merr vendim mbi kërkesën e paraqitur, sipas pikave 2 e 3, të këtij neni, brenda 30 ditëve kalendarike nga data e marrjes së kërkesës.

5. Nëse Autoriteti refuzon miratimin e kërkesës së shoqërisë së sigurimit për likuidim vullnetar, brenda afatit të parashikuar në pikën 4, të këtij neni, vendimi për prishjen e shoqërisë apo ndryshimin e veprimtarisë së saj nuk mund të miratohet nga mbledhja e asamblesë së përgjithshme.

6. Nëse mbledhja e asamblesë së përgjithshme miraton vendimin në kundërshtim me pikat 1 dhe 5, të këtij neni, vendimi në fjalë është i pavlefshëm dhe nuk regjistrohet.

#### Neni 170

### **Likuidatorët e shoqërisë së sigurimit**

1. Shoqëria e sigurimit duhet të ketë, të paktën, dy likuidatorë të miratuar nga Autoriteti, të cilët përfaqësojnë së bashku shoqërinë e sigurimit.

2. Likuidatorët janë persona fizikë, të cilët përmbushin kërkesat e përcaktuara në nenin 20 të këtij ligji.

#### Neni 171

### **Kufizimi i licencës për të ushtruar veprimtari sigurimi**

1. Anëtarët e këshillit të administrimit/mbikëqyrës ose likuidatorët e shoqërisë së sigurimit i njoftojnë Autoritetit vendimin e përcaktuar në pikën 1, të nenit 169, të këtij ligji, ditën e parë të punës pas datës së miratimit të vendimit.

2. Autoriteti, pas marrjes së njoftimit, vendos për:

a) kufizimin e vlefshmërisë së licencës për të ushtruar veprimtari sigurimi, vetëm në veprimtari të nevojshme për kryerjen e procedurave të likuidimit të shoqërisë së sigurimit; dhe

b) përcaktimin se deri në çfarë mase zbatohen rregullat e administrimit të rrezikut në shoqërinë e sigurimit në likuidim.

3. Pas hapjes së procedurave të likuidimit, shoqëria e sigurimit në fjalë mund të vazhdojë të kryejë vetëm veprimtaritë e përcaktuara në vendimin e Autoritetit, sipas pikës 2, të këtij neni, dhe veprimtari, të cilat janë të nevojshme për transferimin e kontratave të sigurimit në një shoqëri tjetër sigurimi.

4. Nëse vendimi i parashikuar në pikën 2, të këtij neni, i referohet një shoqërie sigurimi me degë në një vend anëtar, Autoriteti, përpara nxjerrjes së këtij vendimi, njofton autoritetin kompetent mbikëqyrës të vendit anëtar. Njoftimi përmban, gjithashtu, të gjitha pasojat juridike apo pasoja të tjera që rrjedhin nga marrja e tij.

5. Kur zbatimi i menjëhershëm i vendimit të përcaktuar në pikën 4, të këtij neni, është i domosdoshëm, për arsye të mbrojtjes së interesave të konsumatorëve të shoqërisë së sigurimit apo të interesave publikë, Autoriteti njofton menjëherë pas zbatimit të tij Autoritetin kompetent mbikëqyrës.

#### Neni 172

### **Procedurat e likuidimit vullnetar**

Përveçse kur parashikohet ndryshe në këtë ligj, dispozitat e ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, të ndryshuar, për likuidimin e

shoqërive aksionare zbatohen lidhur me procedurat e likuidimit të shoqërive të sigurimit.

Neni 173

### **Ndodhja në kushtet e falimentimit**

Nëse likuidatorët gjykojnë se shoqëria e sigurimit ndodhet në kushtet e falimentimit, njoftojnë dhe paraqesin menjëherë në Autoritet propozimin për hapjen e procedurave të falimentimit.

Neni 174

### **Rinovimi i licencës për të ushtruar veprimtari sigurimi**

1. Nëse mbledhja e asamblesë së përgjithshme të shoqërisë vendos që shoqëria e sigurimit duhet të vazhdojë veprimtarinë e saj, kjo e fundit mund të ushtrojë përsëri veprimtari sigurimi vetëm nëse rimerr nga Autoriteti licencën përkatëse.

2. Kërkesa për regjistrimin në QKR të vendimit të përmendur në pikën 1, të këtij neni, shoqërohet me licencën e re, të lëshuar nga Autoriteti për të ushtruar veprimtari sigurimi.

Seksioni III

### **Likuidimi i detyrueshëm i shoqërisë së sigurimit**

Neni 175

### **Hapja e procedurave të likuidimit të detyrueshëm**

1. Autoriteti vendos hapjen e procedurave të likuidimit të detyrueshëm të shoqërisë së sigurimit në rastet kur:

a) është revokuar licenca për kryerjen e veprimtarisë së sigurimit, sipas neneve 155 dhe 168, pika 5, të këtij ligji;

b) bazuar në raportin e përmendur në pikën 2, të nenit 166, të këtij ligji, vlerëson se gjatë periudhës së administrimit të përkohshëm gjendja financiare e shoqërisë nuk përmirësohet në atë masë që shoqëria e sigurimit të arrijë nivelin e aftësisë paguese të përcaktuar në nenin 80 të këtij ligji;

c) mbledhja e asamblesë së përgjithshme e shoqërisë së sigurimit, sipas pikës 2, të nenit 167, të këtij ligji, nuk miraton vendimin për rritjen e kapitalit të shoqërisë së sigurimit ose e miraton atë, por dështon shitja e parë e aksioneve.

2. Autoriteti vendos për revokimin e licencës për të ushtruar veprimtari sigurimi brenda 8 ditëve kalendarike:

a) nga data e përfundimit të afatit kohor për pranimin e raportit përfundimtar mbi rezultatet e vlerësimit të administratorëve të përkohshëm, siç përcaktohet në pikën 2, të nenit 168, të këtij ligji, për rastet e përmendura në shkronjën “b”, të pikës 1, të këtij neni;

b) nga data kur mbledhja e asamblesë së përgjithshme refuzon miratimin e vendimit të propozuar, sipas pikës 1, të nenit 167, të këtij ligji, ose nga data e

përfundimit të afatit kohor për nënshkrimin dhe pagesën e aksioneve, sipas shitjes së parë të dështuar, për rastet e parashikuara në shkronjën “c”, të pikës 1, të këtij neni.

3. Autoriteti mund të hartojë rregulla të detajuara në lidhje me likuidimin e detyrueshëm të degës të shoqërive të sigurimit të huaja dhe të vendeve anëtare.

Neni 176

### **Likuidatorët**

1. Autoriteti, bazuar në vendimin për revokimin e licencës së shoqërisë së sigurimit për të ushtruar veprimtari sigurimi, emëron dy a më shumë likuidatorë, të cilët përfaqësojnë shoqërinë e sigurimit, dhe përcakton llojin dhe qëllimin e detyrave të secilit prej tyre.

2. Likuidatorët janë persona fizikë, të cilët përmbushin kërkesat e përcaktuara në nenin 20 të këtij ligji.

Neni 177

### **Njoftimi i kreditorëve për hapjen e procedurave të likuidimit të detyrueshëm**

1. Likuidatorët njoftojnë të gjithë kreditorët e njohur të shoqërisë së sigurimit.

2. Njoftimi i kreditorëve të njohur përmban informacionin e mëposhtëm:

a) emrin dhe adresën e autoritetit e të likuidatorit që udhëheq procedurat e likuidimit të detyrueshëm, si dhe të autoritetit ku depozitohen pretendimet;

b) afatin kohor për depozitim të pretendimeve dhe pasojat juridike për mosdepozitim të tyre nga kreditorët;

c) të drejtat dhe detyrimet e kreditorëve gjatë procesit të likuidimit të detyrueshëm, në veçanti radhën e pagesave të pretendimeve të kreditorëve;

ç) efektet e hapjes së procedurave të likuidimit të detyrueshëm mbi kontratat e sigurimit, në veçanti datën, në të cilën kontratat e sigurimit përfundojnë efektet, dhe të drejtat e detyrimet e personave të siguruar dhe siguruesve në lidhje me kontratën në fjalë.

3. Autoriteti mund të përcaktojë me rregullore formën dhe përmbajtjen e detajuar të informimit të kreditorëve të njohur të shoqërisë së sigurimit.

Neni 178

### **Pasojat juridike të likuidimit të detyrueshëm**

1. Me hyrjen në fuqi të vendimit të likuidimit të detyrueshëm, të gjitha kompetencat dhe përgjegjësitë e anëtarëve të këshillit të administrimit/mbikëqyrës të shoqërisë së sigurimit, si dhe të gjitha përgjegjësitë e asamblesë së përgjithshme pushojnë së ekzistuari, përveç kompetencës për të depozituar ankimin në gjykatë ndaj vendimit të Autoritetit, të parashikuar në nenin 175 të këtij ligji.

2. Gjatë procesit të likuidimit të detyrueshëm, kompetencat e anëtarëve të këshillit të administrimit/mbikëqyrës dhe asamblesë së përgjithshme të shoqërisë së sigurimit, përveç atyre të përmendura në pikën 1, të këtij neni, i transferohen Autoritetit.

Neni 179

### **Procedurat e likuidimit të detyrueshëm**

Përveçse kur parashikohet ndryshe në këtë ligj, dispozitat e ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, për likuidimin e shoqërive aksionare zbatohen në lidhje me procedurat e likuidimit të detyrueshëm të shoqërive të sigurimit.

Neni 180

### **Kufizimi i veprimtarisë së sigurimit**

1. Shoqëria e sigurimit, me marrjen e njoftimit për fillimin e procedurave të likuidimit, ndalohe:

- a) të lidhë kontrata të reja sigurimi;
- b) të ripërtërijë kontrata sigurimi.

2. Pavarësisht parashikimit të pikës 1, të këtij neni, shoqëria e sigurimit mund të lidhë kontrata të nevojshme për kthimin e aktiveve në likuiditet, me miratimin paraprak të likuidatorit, si dhe mund të ushtrojë veprimtari që lidhen me transferimin e kontratave të një tjetër shoqëri sigurimi.

Neni 181

### **Përgatitja e bilancit nga likuidatori**

1. Likuidatori përgatit bilanc dhe raport sqarues lidhur me zërat e bilancit të shoqërisë së sigurimit në likuidim brenda 30 ditëve kalendarike nga data e fillimit të procedurave të likuidimit.

2. Likuidatori paraqet në gjykatën kompetente dhe në Autoritet bilancin dhe raportin, sipas pikës 1, të këtij neni, brenda 15 ditëve kalendarike nga përfundimi i afatit të përcaktuar në pikën 1 të këtij neni.

Seksioni IV

### **Falimentimi**

Neni 182

### **Dispozita të zbatueshme për falimentimin**

Përveç sa parashikohet në këtë ligj, falimentimi i shoqërisë së sigurimit rregullohet nga ligji nr. 8901, datë 23.5.2002, “Për falimentimin”, i ndryshuar.

Neni 183

### **Rastet e falimentimit**

Autoriteti propozon hapjen e procedurave të falimentimit në rastet e mëposhtme:

a) nëse, bazuar në raportin e përmendur në pikën 2, të nenit 166, të këtij ligji, vlerëson se gjendja financiare e shoqërisë së sigurimit nuk është përmirësuar gjatë administrimit të përkohshëm dhe nëse shoqëria e sigurimit nuk është në gjendje të përmbushë përgjegjësitë e saj aktuale;

b) nëse gjatë ushtrimit të mbikëqyrjes së shoqërisë së sigurimit, edhe pas marrjes së masave të mbikëqyrjes, të parashikuara në seksionin V, të kreut VIII, të këtij ligji, konstatohet se aktivet e saj janë të pamjaftueshme për të përmbushur detyrimet e kreditorëve;

c) nëse shoqëria e sigurimit ndodhet në gjendjen e mbingarkesës me borxhe dhe, për pasojë, nuk ka mundësi të vazhdojë veprimtarinë e të përmbushë detyrimet e kreditorëve kur u vjen afati;

ç) nëse asambleja e përgjithshme e aksionarëve refuzon propozimin e parashikuar në pikën 1, të nenit 167, të këtij ligji;

d) nëse gjatë ushtrimit të mbikëqyrjes së shoqërisë së sigurimit konstaton ndonjë rast tjetër të falimentimit, sipas përcaktimeve të këtij ligji.

Neni 184

### **Kontratave të sigurimit**

Në momentin e hapjes së procedurave të falimentimit të shoqërisë së sigurimit, të siguruarit apo përfituesit, sipas kontratave të sigurimit, të nënshkruara nga një shoqëri sigurimi, do të quhen kreditorë dhe pretendimet e tyre kanë përparësi ndaj detyrimeve të tjera të shoqërisë së sigurimit.

Neni 185

### **Informimi i Autoritetit**

Vendimi për pezullimin e procedurave të falimentimit, si dhe vendimi për përfundimin e procedurave të falimentimit të një shoqërie sigurimi depozitohet në Autoritet nga administratori i falimentimit.

Neni 186

### **Radha e pagesave të pretenduara**

Pagesat e pretenduara të kreditorëve, sipas parashikimeve të nenit 184, të këtij ligji, realizohen sipas radhës së mëposhtme:

a) pretendimet e kontratave të sigurimit të jetës dhe kontratave të tjera të sigurimit, të cilat janë subjekt i të njëjtave tabela të probabilitetit dhe llogaritjeve si ato të zbatueshme për sigurimin e jetës, të cilat nuk mund të paguhen nga aktivet në mbulim të provigjoneve matematike;

b) pretendimet e kontratave të sigurimit të jojetës dhe kontratave të tjera të sigurimit, për të cilat nuk janë krijuar provigjonet matematike në lidhje me kompensimin e humbjes, të ndodhur përpara hapjes së procedurave të falimentimit, dhe kthimin e një pjese të primit të paguar për periudhën para përfundimit të kësaj kontrate sigurimi;

c) pretendime që rrjedhin nga Byroja Shqiptare e Sigurimeve për pagesat nga fondi i kompensimit, përcaktuar në ligjin nr. 10 076, datë 12.2.2009, “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit”, të ndryshuar, dhe që lidhen me kompensimin e shumës së paguar të dëmeve, për të cilat personat e dëmtuar nuk mund të dëmshpërblehen nga shoqëria e sigurimit për shkak të hapjes së procedurave të falimentimit ndaj kësaj shoqërie.

#### Seksioni V

### **Dispozita të veçanta për pagesat e pretendimeve që rrjedhin nga klasat e sigurimit, për të cilat janë krijuar provigjonet matematike**

#### Neni 187

#### **Dispozita të zbatueshme**

1. Dispozitat e këtij seksioni zbatohen për pretendimet e kreditorëve, sipas kontratave të sigurimit të jetës dhe kontratave të tjera të sigurimit, të cilat janë subjekt i të njëjtave tabela të probabilitetit dhe llogaritjeve si ato të zbatueshme për sigurimin e jetës.

2. Kreditorët e parashikuar në pikën 1, të këtij neni, kanë të drejtën e shlyerjes së veçantë të pretendimeve nga aktivet në mbulim të provigjoneve matematike ose nga fondet e krijuara nga kthimi në likuiditet i aktiveve në mbulim të provigjoneve matematike.

3. Aktivet në mbulim të provigjoneve matematike përdoren vetëm për pagesat për shlyerjen e përgjegjësisë që burojnë nga kontratat e sigurimit të jetës.

4. Aktivet në mbulim të provigjoneve matematike përfaqësojnë aktivet e një shoqërie sigurimi, të cilat janë të veçuara nga aktivet e tjera të shoqërisë së sigurimit, krijohen në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe lidhen me detyrimin për të krijuar aktive në mbulim të provigjoneve matematike, sipas përcaktimeve të nenit 102 të këtij ligji.

#### Neni 188

#### **Shlyerja e pretendimeve nga aktivet në mbulim të provigjoneve matematike**

1. Në datën e hapjes së procedurave të falimentimit, kreditorët e parashikuar në pikën 1, të nenit 187, të këtij ligji, kanë të drejtën e pagesës së pretendimeve kundrejt aktiveve në mbulim të provigjoneve matematike.

2. Pretendimet e kontratave të sigurimit të jetës dhe kontratave të tjera të sigurimit, ku përgjegjësitë e marra prej tyre janë subjekt i rregullave të sigurimit të jetës, kanë të drejtën e pagesës nga aktivet në mbulim të provigjoneve matematike dhe kanë përparësi përkundrejt pagesës së pretendimeve të tjera që u përkasin klasave të caktuara të sigurimit të jetës, të cilat paguhen nga aktivet në mbulim të provigjoneve matematike. Këto pretendime llogariten në një shumë të barabartë me mbulimin e kërkuar nga kontratat e sigurimit të jetës, nga të cilat rrjedhin këto pretendime.

3. Nëse, aktivet në mbulim të provigjoneve matematike nuk janë të mjaftueshme për siguruar pagesën e plotë të pretendimeve të përcaktuara në pikën 2, të këtij neni, pagesa e pretendimeve zvogëlohet në një shumë të barabartë në proporcion midis vlerës

totale të aktiveve në mbulim të provigjoneve matematike dhe mbulimit të kërkuar për të gjitha kontratat e sigurimit të jetës, të lidhura nga shoqëria e sigurimit, për të cilat janë krijuar aktivet në mbulim të provigjoneve matematike.

4. Pretendimet e tjera të kreditorëve, të përcaktuar në nenin 187, të këtij ligji, paguhen nga aktivet në mbulim të provigjoneve matematike të mbetura pas shlyerjeve të pretendimeve të përcaktuara në pikën 2 të këtij neni.

5. Nëse aktivet në mbulim të provigjoneve matematike nuk janë të mjaftueshme për pagesën e plotë të pretendimeve të përcaktuara në pikën 4, të këtij neni, këto pretendime paguhen në mënyrë proporcionale nga aktivet në mbulim të provigjoneve matematike.

6. Bilanci i shoqërisë së sigurimit, në datën e hapjes së procedurave të falimentimit, shërben si bazë për përcaktimin e shumave të pretendimeve dhe të shumës totale të mbulimit të detyrueshëm.

#### Neni 189

##### **Llogaria e veçantë e aktiveve në mbulim të provigjoneve matematike**

1. Përveç llogarisë së përgjithshme të mbajtjes së debitorëve të falimentimit, administratori i falimentimit krijon një llogari të veçantë në para për aktivet në mbulim të provigjoneve matematike, për kryerjen e pagesave të pretendimeve.

2. Administratori i falimentimit administron të gjitha transaksionet në para, të marra nga kthimi në likuiditet i aktiveve në mbulim të provigjoneve matematike, nëpërmjet një llogarie të veçantë në para për aktivet në mbulim të provigjoneve matematike.

#### Neni 190

##### **Përfaqësuesi i kreditorëve të sigurimit të jetës**

Kreditorët përcaktuar në nenin 187, të këtij ligji, mund të emërojnë një përfaqësues të tyre në këshillin e administrimit/mbikëqyrës.

#### Neni 191

##### **Depozitimi i pretendimeve**

Pretendimet që rrjedhin nga kontratat e sigurimit i bëhen të ditura administratorit të falimentimit, në përputhje me rregullat e përcaktuara me ligjin nr. 8901, datë 23.5.2002, “Për falimentimin”, të ndryshuar.



## KREU X

### NDËRMJETËSIT, AKTUARËT DHE VLERËSUESIT E DËMEVE

#### Seksioni I

#### **Ndërmjetësimi në sigurime dhe risigurime**

##### Neni 192

#### **Ndërmjetësimi në sigurime dhe risigurime**

1. Ndërmjetësimi në sigurime dhe risigurime është veprimtaria e prezantimit, propozimit dhe kryerjes së aktiviteteve të tjera përgatitore deri në nënshkrimin e kontratës së sigurimit ose risigurimit, si dhe dhënia e asistencës gjatë periudhës së vlefshmërisë së kontratës, veçanërisht në rast dëmi.

2. Veprimtaritë e mëposhtme nuk do të quhen ndërmjetësim në sigurime dhe risigurime:

a) veprimtaria e kryer drejtpërsëdrejti nga shoqëria e sigurimit/risigurimit dhe punonjësit e saj;

b) ofrimi i informacionit në mënyrë rastësore gjatë ushtrimit të një veprimtarie tjetër profesionale, nëse qëllimi i kësaj veprimtarie nuk është dhënia e asistencës në nënshkrimin ose zbatimin e kontratave të sigurimit;

c) veprimtaria e trajtimit të kërkesave për dëmshpërblim, nëse kryhet në kushtet e punësimit;

ç) veprimtaria e vlerësimit të dëmeve.

##### Neni 193

#### **Ndërmjetësit në sigurime dhe risigurime**

1. Ndërmjetës në sigurime dhe risigurime janë të gjithë personat fizikë apo juridikë që ushtrojnë veprimtarinë e ndërmjetësimit, të përcaktuar në nenin 192, të këtij ligji, si veprimtari tregtare kundrejt pagesave dhe komisioneve, sipas dispozitave të këtij ligji.

2. Autoriteti licencon dhe mbikëqyr veprimtarinë e ndërmjetësve në sigurime dhe risigurime. Dispozitat e këtij ligji për mbikëqyrjen e shoqërive të sigurimit zbatohen rast pas rasti edhe për mbikëqyrjen e ndërmjetësve në sigurime dhe risigurime.

## Seksioni II

### **Agjenti dhe shoqëria e agjentëve në sigurime**

Neni 194

#### **Veprimtaria e agjentit në sigurime**

1. Veprimtaria e agjentit në sigurime kryhet në emër dhe për llogari të shoqërisë së sigurimit dhe përfshin prezantimin, propozimin dhe aktivitete të tjera përgatitore mbi kontratën e sigurimit, si dhe nënshkrimin e saj nga i siguruari.
2. Veprimtaria e agjentit në sigurime mund të kryhet edhe në emër të disa shoqërive të sigurimit, nëse shoqëritë e sigurimit kanë rënë dakord me marrëveshje të shkruar midis tyre.
3. Veprimtaria e agjentit kryhet nga agjenti ose shoqëria e agjentëve.
4. Veprimtaria e agjentit mund të kryhet edhe nga bankat, degët e bankave të huaja ose subjektet financiare jobanka, pasi të kenë marrë më parë miratimin nga Banka e Shqipërisë, si dhe subjekte të tjera, sipas rregullave të përcaktuara nga Autoriteti.
5. Veprimtaria e agjentit për sigurimin e jetës është e ndarë veçmas nga ajo e jojetës.

Neni 195

#### **Agjenti në sigurime**

Agjenti në sigurime është personi fizik i miratuar nga Autoriteti për të ushtruar veprimtari, sipas pikës 1, të nenit 194, të këtij ligji.

Neni 196

#### **Shoqëria e agjentëve në sigurime**

1. Shoqëria e agjentëve në sigurime është personi juridik, veprimtaria e vetme tregtare e të cilit është veprimtaria e përmendur në pikën 1, të nenit 194, të këtij ligji.
2. Shoqëria e agjentëve licencohet nga Autoriteti. Licenca është me afat të pacaktuar.
3. Shoqëria e agjentëve themelohet sipas dispozitave të ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, të ndryshuar, si shoqëri aksionare apo shoqëri me përgjegjësi të kufizuar.
4. Shoqëria e agjentëve, pas marrjes së licencës, regjistrohet në QKR.
5. Shoqëria e agjentëve në emrin e vet përdor fjalët “veprimtari agjenti në sigurime/risigurime” ose derivate të tyre.
6. Emri i shoqërisë së agjentëve nuk duhet të përmbajë emrin e plotë ose të pjesëshëm të asnjë prej shoqërive të sigurimit apo risigurimit që janë të licencuara për të ushtruar veprimtari sigurimi.
7. Autoriteti mund të përcaktojë rregulla për kriteret e organizimit dhe funksionimit të shoqërisë së agjentëve.

## Neni 197

### **Sigurimi i përgjegjësive profesionale dhe garancia financiare e agjentit/shoqërisë së agjentëve në sigurime**

1. Agjenti/shoqëria e agjentëve në sigurime siguron në një shoqëri sigurimi përgjegjësitë profesionale të saj ndaj palëve të treta.

2. Shoqëria e agjentëve në sigurime detyrohet të ketë, në mënyrë të vazhdueshme, një garanci financiare në masën 4 për qind të shumës së primeve vjetore të mbledhura, e cila nuk duhet të jetë më e vogël se 500 000 lekë. Garancia financiare depozitohet në një nga bankat dhe/ose degët e bankave të huaja që veprojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë, në emër të shoqërisë së sigurimit për të cilën vepron.

3. Autoriteti përcakton me rregullore shumën e mbulimit të policës së sigurimit të përgjegjësive, të përcaktuar në pikën 1 të këtij neni.

## Neni 198

### **Përgjegjësitë e shoqërisë së sigurimit dhe agjentit/shoqërisë së agjentëve**

1. Shoqëria e sigurimit, në emër të së cilës vepron agjenti apo shoqëria e agjentëve, është përgjegjëse e vetme për veprimet ose mosveprimet e agjentit apo shoqërisë së agjentëve në lidhje me të siguruarin.

2. Agjenti apo shoqëria e agjentëve është përgjegjëse ndaj shoqërisë së sigurimit për dëmet e shkaktuara të siguruarit si rezultat i veprimeve apo mosveprimeve të tij/të saj.

3. Agjenti apo shoqëria e agjentëve në sigurime kryen vetëm ato veprimtari, për të cilat është miratuar apo licencuar.

4. Agjenti apo shoqëria e agjentëve nuk ka të drejtë të autorizojë asnjë person tjetër që të nënshkruajë kontratën e sigurimit në emër dhe për llogari të tij/të saj.

5. Agjenti apo shoqëria e agjentëve në sigurime nuk mundet që në emër ose për llogari të tij/të saj të mbledhë primet e sigurimit apo çdo shumë tjetër monetare nga i siguruari.

6. Autoriteti përcakton rregulla për transferimin e parave nga konsumatori te shoqëria e sigurimit dhe anasjelltas nëpërmjet një ndërmjetësi në sigurime.

## Neni 199

### **Miratimi/ndalimi i agjentëve në sigurime**

1. Shoqëria e sigurimit depoziton në Autoritet listën e agjentëve së bashku me dokumentacionin përkatës, për të cilët kërkohet miratim.

2. Autoriteti miraton listën e agjentëve për ushtrimin e veprimtarisë së agjentit në sigurime nëse përmbushen kriteret e përcaktuara.

3. Autoriteti përcakton me rregullore kriteret e profesionalizmit, etikës, të besueshmërisë dhe kërkesat financiare që duhet të plotësojë agjenti në sigurime, si dhe rastet e mospranimit të regjistrimit të tij.

4. Agjenti në sigurime, gjatë gjithë kohës së ushtrimit të veprimtarisë, duhet të përmbushë kërkesat e këtij neni dhe të rregullores përkatëse.

5. Autoriteti ndalon ushtrimin e veprimtarisë së agjentit në sigurime dhe e çregjistron atë nga regjistri, nëse:

- a) miratimi është marrë mbi bazën e të dhënave jo të vërteta;
- b) dënohet me vendim të formës së prerë për veprat penale kundër pasurisë dhe në sferën ekonomike, veprat penale të kryera në shoqëritë tregtare, veprat penale në lidhje me taksat dhe tatimet dhe vepra penale të tjera;
- c) ndaj tij merren masa administrative ose dënohet me vendim të formës së prerë për shkelje të legjislacionit për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit;
- ç) kryen mashtrime gjatë ushtrimit të veprimtarisë në fushën e sigurimeve;
- d) shkel dispozitat e këtij ligji dhe ligjeve të tjera të fushës së sigurimeve;
- dh) janë konstatuar shkelje të kodit të etikës dhe rregullave profesionale.

6. Autoriteti, kur i gjykon të arsyeshme shkeljet e dispozitave të këtij ligji, mund të vendosë të pezullojë ushtrimin e veprimtarisë së agjentit për një periudhë deri në 6 muaj.

7. Kërkesave të këtij neni u nënshtrohen të gjithë punonjësit e shoqërisë së sigurimit që merren me shitjen e policave.

Neni 200

### **Ushtrimi i veprimtarisë së agjentit nga shoqëria e agjentëve**

1. Veprimtaria e agjentit ushtrohet nga:

- a) shoqëria e agjentëve, me seli qendrore në Republikën e Shqipërisë, e licencuar për të ushtruar këtë veprimtari nga Autoriteti;
- b) shoqëria e agjentëve nga një vend i huaj, e cila e ushtron këtë veprimtari ose nëpërmjet degës;
- c) shoqëria e agjentëve nga një vend anëtar, e cila e ushtron këtë veprimtari ose nëpërmjet degës ose drejtpërsëdrejti.

2. Shoqëria e agjentëve e ushtron veprimtarinë nëpërmjet agjentit të miratuar, i cili punësohet me kohë të plotë në bazë të një kontrate punësimit.

3. Dispozitat e këtij kreu, të cilat zbatohen për shoqëritë e agjentëve zbatohen edhe për degët e shoqërive të huaja të agjentëve.

4. Autoriteti mund të miratojë rregulla për licencimin dhe lejimin e ushtrimit të veprimtarisë së degës së shoqërisë së agjentëve të një vendi të huaj.

5. Autoriteti miraton rregulla për kryerjen e veprimtarisë së agjentit në vendet anëtare si dhe për kryerjen e kësaj veprimtarie në Republikën e Shqipërisë nga persona që ushtrojnë veprimtari agjenti të licencuar në një vend anëtar.

Neni 201

### **Licenca e shoqërisë së agjentëve dhe revokimi i saj**

1. Shoqëria e agjentëve paraqet në Autoritet kërkesën për licencim dhe dokumentet përkatëse, që vërtetojnë përmbushjen e kushteve të përcaktuara në pikën 2, të këtij neni. Autoriteti përcakton me rregullore kërkesat, procedurat dhe afatet e licencimit të shoqërisë së agjentëve, si dhe rastet e refuzimit.

2. Shoqëria e agjentëve duhet:

- a) të ketë kapital minimal të paguar në para në shumën 1 000 000 lekë;

b) të ketë të punësuar, të paktën, një agjent në sigurime;  
c) të mos jetë palë e lidhur me një shoqëri sigurimi, shoqëri tjetër agjentësh apo shoqëri brokerimi në sigurime dhe risigurime.

3. Vendimi i Autoritetit për miratimin ose refuzimin e licencës duhet të jetë i arsyetuar dhe t'i bëhet i njohur me shkrim shoqërisë brenda 10 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit.

4. Autoriteti revokon licencën e shoqërisë së agjentëve për të ushtruar veprimtari agjenti, nëse:

a) licenca është marrë mbi bazën e të dhënave jo të vërteta;

b) shoqëria e agjentëve nuk zotëron policën e sigurimit të përgjegjësive profesionale;

c) shoqëria e agjentëve nuk zbaton vendimin e Autoritetit për eliminimin e shkeljeve dhe parregullsive brenda afateve kohore të përcaktuara;

ç) shoqëria e agjentëve vepron në kundërshtim me dispozitat e nenit 194 të këtij ligji;

d) nuk përmbush më kushtet e pikës 1, të këtij neni, për të cilat i është dhënë licenca;

dh) ndaj shoqërisë merren masa administrative ose dënohet me vendim të formës së prerë për shkelje të legjislacionit për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit;

e) shoqëria dënohet me vendim të formës së prerë për veprat penale kundër pasurisë dhe në sferën ekonomike, veprat penale të kryera në shoqëritë tregtare, veprat penale në lidhje me taksat dhe tatimet dhe vepra penale të tjera;

ë) shkel dispozitat e këtij ligji dhe ligjeve të tjera të fushës së sigurimeve.

5. Në rast të revokimit të licencës nga Autoriteti, shoqëria e agjentëve ka të drejtë të ankohet në gjykatën administrative brenda afateve dhe sipas procedurave të parashikuara në ligjin nr. 49/2012, "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative".

6. Licenca e shoqërisë së agjentëve përfundon nëse:

a) shoqëria e agjentëve nuk e fillon aktivitetin e saj brenda 6 muajve nga data e marrjes së licencës;

b) janë hapur procedurat e falimentimit;

c) merret vendimi për përfundimin e veprimtarisë së shoqërisë së agjentëve.

7. Autoriteti, kur e gjykon të nevojshme, për shkelje të dispozitave të këtij ligji, përpara revokimit të licencës mund të vendosë të pezullojë licencën për një periudhë deri në 6 muaj.

### Seksioni III

#### **Brokëri dhe shoqëria e brokerimit në sigurime**

##### Neni 202

#### **Veprimtaria e brokerimit në sigurime**

1. Veprimtaria e brokerimit në sigurime përfshin të gjitha ato veprimtari, si prezantimi, propozimi, apo aktivitete të tjera përgatitore, të cilat kanë të bëjnë me negociimin me shoqërinë e sigurimit në emër dhe për llogari të konsumatorit, për t'i mundësuar nënshkrimin e një kontrate sigurimi, sipas kërkesave dhe nevojave të tij.

2. Përveç sa parashikohet në pikën 1, të këtij neni, veprimtaria e brokerimit përfshin edhe asistencën për ushtrimin e të drejtave që rrjedhin nga kontrata e sigurimit, veçanërisht zgjidhjen e kërkesave për dëmshpërblim nga shoqëria e sigurimit, në emër dhe për llogari të konsumatorit.

3. Veprimtaria e brokerimit kryhet nga brokeri në sigurime, person fizik, dhe nga shoqëria e brokerimit në sigurime, person juridik.

Neni 203

### **Brokeri në sigurime**

Brokeri në sigurime është personi fizik i licencuar nga Autoriteti për të ushtruar veprimtarinë e brokerimit në sigurime.

Neni 204

### **Shoqëria e brokerimit në sigurime**

1. Shoqëria e brokerimit është personi juridik, veprimtaria e vetme tregtare e të cilit është veprimtaria e ofrimit të shërbimeve të brokerimit në sigurime. Shoqëria e brokerimit licencohet nga Autoriteti për të ushtruar veprimtarinë e brokerimit. Licenca është me afat të pacaktuar.

2. Shoqëria e brokerimit në sigurime themelohet si shoqëri aksionare në përputhje me dispozitat e ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, të ndryshuar, dhe dispozitave të këtij ligji.

3. Shoqëria e brokerimit, pas marrjes së licencës, regjistrohet në QKR.

4. Shoqëria e brokerimit në emrin e saj përdor fjalët “veprimtari brokerimi në sigurime” ose derivate të tyre.

5. Veprimtaria e brokerimit mund të kryhet edhe nga bankat dhe/ose degët e bankave të huaja pasi të kenë marrë më parë miratimin nga Banka e Shqipërisë, sipas rregullave të përcaktuara nga Autoriteti.

6. Autoriteti mund të përcaktojë rregulla për kriteret e organizimit dhe funksionimit të shoqërisë së brokerimit.

Neni 205

### **Sigurimi i përgjegjesisë profesionale dhe garancia financiare e brokerit/shoqërisë së brokerimit në sigurime**

1. Brokeri/shoqëria e brokerimit siguron në një shoqëri sigurimi përgjegjësitë profesionale të tij/të saj ndaj palëve të treta, në një shumë jo më të vogël se 30 000 000 lekë, për çdo dëm të shkaktuar si rezultat i ushtrimit të veprimtarisë së brokerimit, dhe jo më të vogël se 100 000 000 lekë, për të gjitha dëmet në një vit kalendarik.

2. Brokeri/shoqëria e brokerimit ka të drejtë të grumbullojë prime nga i siguruari dhe t'i arkëtojë ato për llogari të shoqërisë së sigurimit. Brokeri/shoqëria e brokerimit përdor një llogari bankare të veçantë, të hapur për këtë qëllim dhe të ndarë veçmas nga llogaria e tij e biznesit.

3. Brokeri/shoqëria e brokerimit në sigurime detyrohet të ketë, në mënyrë të vazhdueshme, një garanci financiare në masën 4 për qind të shumës të primeve vjetore

të mbledhura, e cila nuk duhet të jetë më e vogël se 1 000 000 lekë. Garancia financiare depozitohet në një llogari qëllimore në një nga bankat dhe/ose degët e bankave të huaja që veprojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Neni 206

### **Përgjegjësitë e brokerit/shoqërisë së brokerimit në sigurime**

1. Brokëri/shoqëria e brokerimit ushtron veprimtarinë e brokerimit duke mbrojtur interesat e të siguruarve.

2. Për të përmbushur detyrimet e përcaktuara në pikën 1, të këtij neni, brokëri/shoqëria e brokerimit në sigurime:

a) kryen analizë rreziku të përshtatshme dhe përcakton parimet bazë të mbulimit të kërkuar;

b) jep shpjegim me shkrim dhe arsyeton propozimet e bëra, si dhe informon të siguruarin për nivelin e komisioneve të përcaktuara për nënshkrimin e një kontrate sigurimi;

c) kryen shërbime brokerimi në emër të të siguruarve për nënshkrimin e kontratave të sigurimit, të cilat janë në përputhje me kërkesat e të siguruarit për sa i përket mbulimit në sigurime. Këto shërbime brokerimi mund të kufizohen në shërbime të veçanta sigurimi nëse brokëri e ka informuar shprehimisht më parë të siguruarin për këtë gjë;

ç) informon shoqërinë e sigurimit se një i siguruar i mundshëm po kërkon oferta, me qëllim nënshkrimin e një kontrate sigurimi;

d) u shpërndan të siguruarve kontratën e sigurimit, si dhe dokumente të tjera në lidhje me këtë kontratë;

dh) kontrollon përmbajtjen e kontratës së sigurimit;

e) i ofron të siguruarit asistencë gjatë periudhës së vlefshmërisë së kontratës së sigurimit, para dhe pas ndodhjes së ngjarjes së siguruar dhe, në veçanti, sigurohet që veprimet juridike, të cilat janë të rëndësishme për ruajtjen dhe ushtrimin e të drejtave, që lindin nga kontrata e sigurimit, janë ndërmarrë nga i siguruari sipas kushteve të kontratës brenda afatit kohor të përcaktuar për të ndërmarrë këto veprime juridike;

ë) shqyrton në mënyrë të vazhdueshme kontratat e nënshkruara nga i siguruari nëpërmjet veprimtarisë së tij të brokerimit dhe propozon ndryshime të këtyre kontratave, me qëllim mbrojtjen më të mirë të të siguruarit.

Neni 207

### **Mbrojtja e interesave të konsumatorëve**

1. Gjatë kryerjes së veprimtarisë së brokerimit, brokëri/shoqëria e brokerimit mbron interesat e personave të siguruar.

2. Brokëri/shoqëria e brokerimit është përgjegjës/e ndaj të siguruarve për dëmet që pësojnë ata, kur këto shkaktohen nga veprimet apo mosveprimet e tij.

3. Brokëri/shoqëria e brokerimit duhet të kontrollojë përmbajtjen e kontratës së sigurimit përpara lidhjes së saj.

4. Gjatë ushtrimit të veprimtarisë së brokerimit, brokëri/shoqëria e brokerimit mbron ata interesa të shoqërisë së sigurimit, të cilët janë të lidhur me të siguruarin përpara dhe pas përfundimit të kontratës së sigurimit. Gjatë kryerjes së veprimeve

përgatitore për nënshkrimin e kontratës së sigurimit, brokeri duhet të informojë shoqërinë e sigurimit për çdo rrezik, për të cilin ka ose mund të kishte dijeni.

5. Brokeri/shoqëria e brokerimit duhet të informojë të siguruarin për lidhjet ekonomike dhe juridike që mund të ketë me një shoqëri sigurimi të caktuar, të cilat mund të ndikojnë në përmbushjen e detyrimeve të brokerit ndaj të siguruarit.

6. Marrëdhënie juridike dhe ekonomike, në kuptim të pikës 5, të këtij neni, quhen marrëveshjet e brokerit/shoqërisë së brokerimit të përfunduara me një shoqëri sigurimi, në bazë të të cilave një broker/shoqëri brokerimi ka të drejtën e një komisioni brokerimi të veçantë ose më të lartë për klasa ose shoqëri të caktuara sigurimi.

Neni 208

### **Kufizimet e veprimtarisë së brokerimit**

1. Brokeri/shoqëria e brokerimit ndërmjetëson për lidhjen e kontratave të sigurimit vetëm me shoqëritë e sigurimit të licencuara, në përputhje me dispozitat e këtij ligji.

2. Brokeri/shoqëria e brokerimit nuk lejohet të ndërmjetësojë në lidhjen e kontratave të sigurimit ose risigurimit, të cilat janë në kundërshtim me parashikimet e Kodit Civil për kontratat e sigurimit.

3. Brokeri/shoqëria e brokerimit nuk mund të jetë aksionar i një shoqërie sigurimi dhe anasjelltas.

Neni 209

### **Licenca e brokerit në sigurime dhe revokimi i saj**

1. Veprimtaria e brokerit në sigurime mund të kryhet vetëm nga personat fizikë, të cilët kanë marrë një licencë si broker për të ushtruar këtë veprimtari.

2. Autoriteti përcakton me rregullore kriteret, procedurat dhe afatet e licencimit për të ushtruar veprimtari brokerimi si broker, si dhe rastet e refuzimit.

3. Vendimi i Autoritetit për miratimin ose refuzimin e licencës duhet të jetë i arsyetuar dhe t'i bëhet i njohur, me shkrim, personit, brenda 10 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit.

4. Autoriteti revokon licencën e brokerit nëse:

a) licenca është dhënë mbi bazën e të dhënave jo të vërteta;

b) dënohet me vendim të formës së prerë për vepra penale kundër pasurisë dhe në sferën ekonomike, veprat penale të kryera në shoqëritë tregtare, veprat penale në lidhje me taksat dhe tatimet dhe vepra penale të tjera;

c) nuk disponon policën e përgjegjësisë profesionale, sipas dispozitave të nenit 205 të këtij ligji;

ç) ka shkelje të rënda të kodit të etikës dhe rregullave profesionale;

d) ndaj tij merren masa administrative ose dënohet me vendim të formës së prerë për shkelje të legjislacionit për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit;

dh) shkel dispozitat e këtij ligji dhe ligjeve të tjera të fushës së sigurimeve.

5. Në rast të revokimit të licencës nga Autoriteti, brokeri ka të drejtë të ankohet në gjykatën administrative brenda afateve dhe sipas procedurave të parashikuara në



ligjin nr. 49/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

6. Autoriteti, për shkelje të dispozitave të këtij ligji, mund të vendosë të pezullojë licencën për një periudhë deri në 6 muaj.

7. Brokëri në sigurime duhet të përmbushë në mënyrë të vazhdueshme kushtet dhe procedurat e përcaktuara në këtë nen.

#### Neni 210

### **Ushtrimi i veprimtarisë së shoqërisë së brokerimit**

1. Veprimtaria e shoqërisë së brokerimit mund të kryhet nga:

a) shoqëria e brokerimit me seli në Republikën e Shqipërisë dhe që zotëron licencë të lëshuar nga Autoriteti për të ushtruar veprimtari brokerimi;

b) shoqëria e brokerimit nga një vend i huaj, e cila e ushtron këtë veprimtari nëpërmjet degës;

c) shoqëria e brokerimit e një vendi anëtar, e cila, sipas dispozitave të këtij ligji, ka të drejtë të ushtrojë veprimtari brokerimi në territorin e Republikës së Shqipërisë në mënyrë të drejtpërdrejtë ose nëpërmjet degës.

2. Dispozitat e këtij kreu, të cilat zbatohen për shoqëritë e brokerimit, zbatohen edhe për degët e shoqërive të huaja të brokerimit.

3. Autoriteti mund të miratojë rregulla për licencimin e degës së shoqërisë së brokerimit të një vendi të huaj.

4. Autoriteti miraton rregulla për kryerjen e veprimtarisë së brokerimit në Republikën e Shqipërisë nga persona që ushtrojnë veprimtari brokerimi të licencuar në një vend anëtar.

#### Neni 211

### **Licenca e shoqërisë së brokerimit dhe revokimi i saj**

1. Shoqëria e brokerimit, e cila ushtron veprimtari brokerimi në sigurime, paraqet në Autoritet kërkesën për licencim së bashku me dokumentet përkatëse, që vërtetojnë përmbushjen e kushteve të mëposhtme:

a) të ketë kapitalin bazë të paguar në para prej, të paktën, 3 000 000 lekësh;

b) të ketë, të paktën, një broker të punësuar me kohë të plotë, sipas një kontrate punësimi;

c) të mos jetë palë e lidhur me një shoqëri sigurimi.

2. Autoriteti përcakton, me rregullore, kërkesa të tjera shtesë, përveç atyre të parashikuara në pikën 1, të këtij neni, procedurat dhe afatet e licencimit për të ushtruar veprimtari si shoqëri brokerimi, si dhe rastet e refuzimit.

3. Vendimi i Autoritetit për miratimin ose refuzimin e licencës duhet të jetë i arsyetuar dhe t’i bëhet i njohur shoqërisë, me shkrim, brenda 10 ditëve kalendarike, nga data e marrjes së vendimit përkatës.

4. Autoriteti revokon licencën e shoqërisë së brokerimit në rastet kur:

a) licenca është marrë mbi bazën e të dhënave jo të vërteta;

b) shoqëria e brokerimit nuk disponon policën e përgjegjësisë profesionale, sipas parashikimeve të nenit 205 të këtij ligji;

c) shoqëria e brokerimit nuk zbaton vendimin e Autoritetit për eliminimin e shkeljeve dhe parregullsive brenda afateve kohore të përcaktuara;

ç) nuk përmbush më kushtet, për të cilat i është dhënë licenca;

d) ndaj shoqërisë merren masa administrative ose dënohet me vendim të formës së prerë për shkelje të legjislacionit për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit;

dh) dënohet me vendim të formës së prerë për veprat penale kundër pasurisë dhe në sferën ekonomike, veprat penale të kryera në shoqëritë tregtare, veprat penale në lidhje me taksat dhe tatimet dhe vepra penale të tjera;

e) shkel dispozitat e këtij ligji dhe ligjeve të tjera të fushës së sigurimeve.

5. Në rast të revokimit të licencës nga Autoriteti, shoqëria e brokerimit ka të drejtë të ankohet në gjykatën administrative brenda afateve dhe sipas procedurave të parashikuara në ligjin nr. 49/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

6. Licenca për të ushtruar veprimtari brokerimi në sigurime përfundon nëse:

a) shoqëria e brokerimit nuk fillon veprimtarinë e saj brenda 6 muajve nga data e marrjes së licencës;

b) janë hapur procedurat e falimentimit;

c) merret vendimi për përfundimin e veprimtarisë së shoqërisë së brokerimit.

7. Nëse ndodh një nga rastet e përcaktuara në pikën 4, të këtij neni, Autoriteti e shpall licencën si të pavlefshme.

8. Autoriteti, për shkelje të dispozitave të këtij ligji, mund të vendosë të pezullojë licencën për një periudhë deri në 6 muaj.

#### Seksioni IV

### **Dispozita të tjera për ndërmjetësit**

#### Neni 212

### **Marrja në kontroll dhe bashkimi**

1. Shoqëria e agjentëve dhe shoqëria e brokerimit, e cila merr nën kontroll një tjetër shoqëri agjentësh ose shoqëri brokerimi, përpara se të kryejnë regjistrimin e vendimit për marrjen nën kontroll në QKR, marrin miratimin e Autoritetit.

2. Shoqëria e agjentëve dhe shoqëria e brokerimit që kërkojnë të bashkohen, përpara se të kryejnë regjistrimin e vendimit të bashkimit në QKR, marrin miratimin e Autoritetit për bashkim, si dhe licencën për të ushtruar veprimtari ndërmjetësimi në sigurime për shoqërinë e re të agjentëve e shoqërinë e re të brokerimit.

3. Duke filluar nga data e regjistrimit në QKR të shoqërisë së re të agjentëve ose të brokerimit, shoqëritë e agjentëve ose të brokerimit që janë bashkuar vlerësohen si të prishura dhe licencat përkatëse të tyre për ushtrimin e veprimtarisë nuk janë më të vlefshme.

## Neni 213

### **Detyrimi i brokerit dhe agjentit për të dhënë informacion**

1. Përpara nënshkrimit të kontratave të sigurimit dhe në momentin e ndryshimit ose zgjatjes së tyre, agjenti dhe brokeri vënë në dispozicion të të siguarit informacionin e mëposhtëm:

- a) emrin, mbiemrin, adresën dhe të dhëna për licencën;
- b) regjistrin, në të cilin është regjistruar dhe mënyrat për verifikimin e tij;
- c) shoqërinë e agjentëve ose shoqërinë e brokerimit ku ai është punësuar;
- ç) emrin e shoqërisë së sigurimit, me të cilën ka lidhur një marrëveshje;
- d) informacionin e parashikuar në nenin 63 të këtij ligji;

dh) informacion mbi çështjet e zgjidhura në rrugë jashtëgjyqësore ndërmjet personave të siguar, konsumatorëve dhe shoqërisë së sigurimit, ofruesit të shërbimeve të sigurimit dhe procedurat e brendshme për zgjidhjen e ankesave të konsumatorëve, të përmendura në nenin 70 të këtij ligji.

2. Brokeri është i detyruar të kryejë analizat përkatëse, të përmendura në shkrojtën “a”, të pikës 2, të nenit 206, të këtij ligji, mbi bazën e një numri të mjaftueshëm kontratash të hedhura në treg për t'i mundësuar atij përgatitjen e rekomandimeve, në përputhje me kriteret profesionale, sipas të cilave kontrata është e përshtatshme për të përmbushur nevojat dhe kërkesat e të siguarve.

3. Përpara nënshkrimit të çdo kontrate brokeri përcakton, bazuar në informacionet e dhëna nga personat e siguar, nevojat dhe kërkesat e këtyre personave, si dhe arsyet kryesore për çdo këshillim të dhënë personave të siguar në lidhje me atë kontratë sigurimi.

## Neni 214

### **Mënyra e informimit**

1. Informacioni i përmendur në nenin 213, të këtij ligji, u komunikohet të siguarve:

- a) me shkrim ose me çdo mënyrë tjetër të vlefshme dhe të verifikueshme nga i siguruari;
- b) në mënyrë të kuptueshme dhe të qartë;
- c) në gjuhën shqipe, përveç se kur është rënë dakord ndryshe.

2. Përgjashtimisht nga përcaktimi i pikës 1, të këtij neni, informacioni në fjalë mund të jepet me gojë, nëse kërkohet nga konsumatori, nëse ky i fundit kërkon mbulim të menjëhershëm. Në këtë rast, menjëherë pas nënshkrimit të kontratës, siguruari i jep konsumatorit edhe informacionin me shkrim. Nënshkrimi i kontratës së sigurimit, kushteve apo anekseve të saj nënkupton rënien dakord me informacionin e dhënë me gojë dhe pranimin e kushteve të saj.

## Neni 215

### **Detyrimet e shoqërisë së sigurimit, shoqërisë së agentëve dhe shoqërisë së brokerimit**

1. Shoqëria e sigurimit lidh kontratë ndërmjetësimi vetëm me personat e përmendur në nenet 194, pika 3, dhe 202, pika 3, të këtij ligji.
2. Shoqëria e agentëve nuk duhet të lejojë që veprimtaria e agentit për llogari të saj të kryhet nga persona të tjerë, përveç atyre të përmendur në nenin 195 të këtij ligji.
3. Shoqëria e brokerimit nuk duhet të lejojë që veprimtaria e brokerimit për llogari të saj të kryhet nga persona të tjerë, përveç atyre të përmendur në nenin 203 të këtij ligji.

## Neni 216

### **Komisionet e ndërmjetësit**

1. Shoqëria e agentëve ose agjenti nuk kanë të drejtë të kërkojnë pagesa apo komisione nga i siguruari.
2. Shoqëria e brokerimit ose brokeri nuk kanë të drejtë të kërkojnë pagesën e komisioneve apo ndonjë lloj tjetër pagese nga i siguruari, përveçse kur është rënë dakord ndryshe, me shkrim, nëpërmjet një kontrate.
3. Shoqëria e brokerimit ose brokeri, pas nënshkrimit të kontratës së sigurimit, të cilën e ka ndërmjetësuar, nuk mund të ndryshojë metodat e llogaritjes së komisionit dhe nivelin e tij.

## Neni 217

### **Raportet dhe librat tregtarë**

1. Shoqëria e agentëve dhe shoqëria e brokerimit mbajnë librat tregtarë, hartojnë dokumentet e kontabilitetit, vlerat e aktiveve e përgjegjësi dhe përgatisin pasqyrat financiare, sipas ligjeve nr. 9901, datë 14.4.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, të ndryshuar, nr. 9228, datë 29.4.2004, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, e akteve të tjera ligjore e nënligjore, dhe në përputhje me standardet e kontabilitetit e ato financiare, si dhe me parimet e metodat e përgjithshme të kontabilitetit, përveç rasteve kur është parashikuar ndryshe në këtë ligj.
2. Shoqëria e agentëve dhe shoqëria e brokerimit përgatisin pasqyra financiare 6-mujore dhe vjetore, si dhe raporte statistikore.
3. Shoqëria e agentëve dhe shoqëria e brokerimit depozitojnë në Autoritet pasqyrat financiare vjetore, jo më vonë se 3 muaj pas mbarimit të vitit kalendarik, për të cilin po hartohen këto pasqyra, dhe pasqyrat financiare 6-mujore, jo më vonë se 30 ditë kalendarike nga data e përfundimit të periudhës për të cilën po hartohen këto pasqyra.
4. Shoqëria e agentëve dhe shoqëria e brokerimit depozitojnë në Autoritet një raport statistikor jo më vonë se 30 ditë kalendarike nga përfundimi i periudhës 3-mujore, për të cilën është përgatitur ky raport. Raporti statistikor vjetor paraqitet brenda 3 muajve pas mbarimit të vitit kalendarik.
5. Autoriteti mund të përcaktojë, me rregullore, formën dhe përmbajtjen e pasqyrave dhe raporteve të referuara në pikat 2 dhe 4 të këtij neni.

Neni 218

### **Raportimi**

1. Shoqëria e agjentëve dhe shoqëria e brokerimit raportojnë gjithashtu në Autoritet për:

- a) çdo ndryshim të të dhënave të regjistruara në QKR;
- b) strukturën dhe volumin e veprimtarisë së ndërmjetësimit të kryer brenda një viti, të ndarë për çdo shoqëri sigurimi;
- c) përmbushjen e detyrimeve, të përcaktuara në nenet 197 dhe 205 të këtij ligji.

2. Autoriteti përcakton formën, përmbajtjen e raporteve, si dhe afatet kohore dhe mënyrat e raportimit.

Neni 219

### **Regjistri për ndërmjetësit**

1. Autoriteti mban regjistër publik për:

- a) shoqëritë e agjentëve, të licencuara;
- b) shoqëritë e brokerimit, të licencuara;
- c) agjentët në sigurime;
- ç) brokerat në sigurime.

2. Regjistrat për shoqëritë e agjentëve dhe shoqëritë e brokerimit përmbajnë informacione për personat e miratuar apo të licencuar të këtyre shoqërive.

3. Autoriteti përcakton formën, përmbajtjen dhe rregullat për mbajtjen e regjistrave.

Neni 220

### **Përjashtime për veprimtarinë e ndërmjetësimit**

Dispozitat e këtij ligji nuk zbatohen për personat që kryejnë veprimtari ndërmjetësimi, nëse përmbushen njëkohësisht të gjitha kushtet e mëposhtme:

a) kontrata e sigurimit kërkon vetëm vënien në dijeni të mbulimit me sigurim të ofruar;

b) veprimtaria kryesore e këtyre personave është e ndryshme nga veprimtaria e ndërmjetësimit në sigurime;

c) kontrata e sigurimit nuk është kontratë sigurimi jete;

ç) kontrata e sigurimit nuk mbulon rreziqe përgjegjësie;

d) sigurimi plotëson produktin apo shërbimin e ofruar, në rastet kur ky sigurim mbulon:

i) rreziqe të prishjes, humbjes apo dëmtimit të mallrave; ose

ii) rreziqe të dëmtimit apo humbjes së bagazheve dhe rreziqe të tjera të lidhura me rezervimin e udhëtimeve nga agjencia e udhëtimeve, edhe nëse sigurimi mbulon sigurimin e jetës apo të rreziqeve të përgjegjësisë, me kusht që mbulimi me sigurim është rrezik plotësues i rrezikut kryesor që lidhet me udhëtimin;

dh) shuma totale e primeve vjetore nuk tejkalon shumën prej 75 000 lekësh dhe periudha e vlefshmërisë së kontratës, përfshirë edhe rinovimet, nuk tejkalon periudhën prej 5 vjetësh.

Neni 221

### **Veprimtaria e ndërmjetësimit në vendet anëtare/të huaja**

1. Shoqëria e ndërmjetësimit, e licencuar në Republikën e Shqipërisë, mund të ushtrojë veprimtari ndërmjetësimi në vendet anëtare nëpërmjet degës ose drejtpërsëdrejti dhe në vendet e huaja vetëm nëpërmjet degës.

2. Autoriteti miraton rregulla për lejimin e ushtrimit të veprimtarisë së ndërmjetësimit në vendet e huaja/anëtare nga personat e licencuar në Republikën e Shqipërisë për të ushtruar këtë veprimtari.

Seksioni V

### **Aktuarët**

Neni 222

### **Aktuarët e autorizuar**

1. Për qëllime të këtij ligji, shërbimet aktuariale kryhen nga aktuarët e autorizuar.

2. Aktuari i autorizuar është personi i licensuar nga Autoriteti për të ushtruar detyrat e aktuarit të autorizuar dhe mbikëqyret nga Autoriteti.

3. Autoriteti licencon aktuarin për të ushtruar veprimtari nëse përmbush të gjitha kërkesat e mëposhtme:

a) të ketë diplomë universitare në programin “Master i shkencave” në një nga këto fusha: aktuaristikë, matematikë, statistikë, ekonometri, administrim risku, investime, financë apo demografi;

b) të ketë kualifikim profesional afatgjatë për shkencë aktuariale, të vërtetuara me diplomë apo certifikatë, lëshuar prej një universiteti apo organizate të njohur profesionale, që vërteton kryerjen me sukses të ciklit të plotë të kualifikimit aktuarial;

c) të ketë përvojë, të paktën, 5-vjeçare në fushën e aktuaristikës;

ç) të kalojë me sukses testin mbi njohuritë e legjislacionit, etikës profesionale dhe praktikave më të mira të tregut të sigurimeve në Republikën e Shqipërisë;

d) të mos jetë i dënuar për ndonjë vepër penale gjatë 5 viteve të fundit, para datës së kërkesës për licencë;

dh) të mos ketë detyrime të papaguara në afat.

4. Autoriteti përcakton rregulla për trajnimin profesional dhe vlerësimin e njohurive teknike të nevojshme për ushtrimin e detyrave të aktuarit të autorizuar.

5. Afati i vlefshmërisë së licencës është 3 vjet, me të drejtë rinovimi, pas paraqitjes së dëshmimeve për trajnime të vazhdueshme profesionale. Autoriteti miraton rregulla për rinovimin e licencës të aktuarit.

6. Vendimi i Autoritetit për miratimin ose refuzimin e licencës duhet të jetë i arsyetuar dhe i bëhet i ditur aktuarit me shkrim brenda 10 ditëve kalendarike, nga data e marrjes së vendimit përkatës.

7. Autoriteti revokon licencën e aktuarit të autorizuar në rast se:
- a) licenca është marrë mbi bazën e të dhënave të rreme;
  - b) aktuari i autorizuar kryen një shkelje të rëndë të rregullave të profesionit aktuarial dhe kodit të etikës;
  - c) shkel dispozitat e nenit 224 të këtij ligji;
  - ç) nuk përmbush kërkesat e përcaktuara në pikën 3 të këtij neni.
8. Autoriteti informon shoqërinë e sigurimit, në të cilën aktuari i autorizuar kryen shërbime aktuariale në lidhje me revokimin e licencës së aktuarit.
9. Mbikëqyrja e aktuarit të autorizuar kryhet nga Autoriteti. Dispozitat e neneve 129, 130, 150 dhe 154, të këtij ligji, zbatohen rast pas rasti për mbikëqyrjen e aktuarit të autorizuar.
10. Autoriteti mund të pezullojë licencën e aktuarit të autorizuar për një periudhë kohore nga 1 deri në 3 vjet, nëse ai kryen shkelje të rënda të rregullave të profesionit aktuarial dhe kodit të etikës.
11. Autoriteti harton dhe miraton kodin e etikës të aktuarit.

#### Neni 223

##### **Emërimi i aktuarit të autorizuar**

1. Shoqëria e sigurimit, përpara fillimit të veprimtarisë, cakton një aktuar të autorizuar dhe i mundëson atij ushtrimin e detyrave, sipas përcaktimeve të nenit 225 të këtij ligji.
2. Shoqëria e sigurimit njofton Autoritetin për emërimin ose shkarkimin e aktuarit të autorizuar brenda 8 ditëve kalendarike nga data e emërimit ose e shkarkimit.
3. Nëse shoqëria e sigurimit nuk emëron aktuarin e autorizuar brenda 2 muajve pas marrjes së licencës ose emëron një person, i cili nuk është i licencuar sipas dispozitave të këtij ligji, atëherë Autoriteti emëron aktuarin e autorizuar dhe shpenzimet për këtë emërim mbahen nga shoqëria e sigurimit.
4. Nëse aktuari i autorizuar ndërpret veprimtarinë e tij në një shoqëri sigurimi, informon Autoritetin brenda 8 ditëve kalendarike nga data e ndërprerjes.
5. Nëse aktuari i autorizuar ndërpret veprimtarinë e tij në një shoqëri sigurimi, shoqëria e sigurimit, brenda 30 ditëve kalendarike, emëron një aktuar tjetër të autorizuar dhe njofton Autoritetin për këtë emërim.
6. Autoriteti mund të nxjerrë rregulla më të detajuara për emërimin, shkarkimin dhe rregulla të tjera në lidhje me aktuarin e autorizuar.

#### Neni 224

##### **Kufizimet e veprimtarisë së aktuarit të autorizuar**

Aktuari i autorizuar nuk lejohet të kryejë veprimtari aktuariale në një shoqëri sigurimi nëse:

- a) ka aksione të drejtpërdrejta ose të tërthorta në kapitalin e shoqërisë së sigurimit;
- b) është anëtar i këshillit të administrimit/mbikëqyrës, administrator/anëtar i bordit të drejtorëve ose funksionar kryesor i shoqërisë së sigurimit;
- c) është anëtar i auditimit të brendshëm në shoqërinë e sigurimit;
- ç) vepron si agjent, broker ose vlerësues dëmsh.

### **Detyrat e aktuarit të autorizuar**

1. Aktuari i autorizuar ka për detyrë:
  - a) llogaritjen e provigjoneve teknike, për të cilën duhet:
    - i) të vlerësojë nëse shoqëria e sigurimit mban të dhënat e duhura për llogaritjen e provigjoneve teknike, si dhe të shqyrtojë vërtetësinë e këtyre të dhënave;
    - ii) të shqyrtojë nëse metodat dhe bazat e përdorura për llogaritjen e provigjoneve teknike janë në përputhje me rregullat e profesionit aktuarial dhe legjislacionit në fuqi;
    - iii) të vlerësojë nëse provigjonet teknike janë llogaritur në mënyrë që të garantojnë mbulimin gjatë gjithë kohës të përgjegjësive të shoqërisë së sigurimit, sipas kontratave të sigurimit;
  - b) shqyrtimin nëse tarifat e primit të sigurimit janë llogaritur në përputhje me rregullat e profesionit të aktuarit dhe legjislacionit në fuqi, në mënyrë që të garantojnë mbulimin gjatë gjithë kohës të përgjegjësive të shoqërisë së sigurimit, sipas kontratave të sigurimit.
2. Shoqëria e sigurimit i vë në dispozicion aktuarit të autorizuar të gjitha të dhënat e nevojshme për të ushtruar detyrat e përcaktuara në pikën 1 të këtij neni.
3. Aktuari i autorizuar, i emëruar nga shoqëria e sigurimit, i paraqet këshillit të administrimit/mbikëqyrës raportin dhe opinionin, sipas përcaktimit të nenit 112 të këtij ligji. Raporti, në veçanti, përfshin arsyet për dhënien nga ana e aktuarit të një opinionit pozitiv, negativ apo të një opinionit me rezerva.
4. Nëse aktuari i autorizuar, gjatë ushtrimit të detyrave të tij, konstaton se primet nuk janë llogaritur dhe provigjonet teknike nuk janë krijuar në përputhje me dispozitat e këtij ligji, ose nëse ato janë llogaritur apo krijuar në një mënyrë që kërcënon përmbushjen afatgjatë të përgjegjësive të shoqërisë së sigurimit, që lindin nga kontratat e sigurimit, njofton menjëherë këshillin e administrimit/mbikëqyrës të shoqërisë së sigurimit.
5. Këshilli i administrimit/mbikëqyrës merr masat e nevojshme për rregullimin e veprimtarisë, në përputhje me raportin e aktuarit të autorizuar, të përcaktuar në pikën 3 të këtij neni.
6. Nëse këshilli i administrimit/mbikëqyrës nuk merr masat e nevojshme, sipas raportit të përcaktuar në pikën 3, të këtij neni, aktuari i autorizuar njofton menjëherë Autoritetin.
7. Autoriteti, nëse e gjykon të nevojshme, mund t'i kërkojë aktuarit çdo informacion tjetër në funksion të ushtrimit të mbikëqyrjes.



## Seksioni VI

### Vlerësuesit e dëmeve

#### Neni 226

#### Veprimtaria e vlerësuesit të dëmeve

1. Veprimtaria e vlerësuesit të dëmeve përfshin mbledhjen e të dhënave dhe përlllogaritjen e shumës që duhet të paguhet nga shoqëria e sigurimit për dëmet, si rezultat i ndodhjes së rrezikut të siguruar.
2. Veprimtaria e vlerësuesit të dëmeve mund të ushtrohet nga persona të licencuar nga Autoriteti, të cilët e ushtrojnë veprimtarinë e vlerësimit të dëmeve si punonjës të shoqërisë ose si vlerësues të pavarur dëmsh.
3. Veprimtaria e vlerësuesit të pavarur të dëmeve ushtrohet nga një person fizik ose juridik i licencuar nga Autoriteti.
4. Vlerësuesit e dëmeve, të licencuar, regjistrohen në regjistrin përkatës, i cili mbahet nga Autoriteti.

#### Neni 227

#### Licencimi i vlerësuesit të dëmeve

1. Autoriteti licencon vlerësuesin e dëmeve nëse përmbush kushtet dhe kualifikimet e mëposhtme:
  - a) të ketë diplomë universitare;
  - b) të ketë kualifikim profesional për vlerësues dëmsh, të vërtetuar me certifikatë, lëshuar nga një institucion apo organizatë e njohur profesionale;
  - c) të ketë përvojë, të paktën, trevjeçare pranë një vlerësuesi të licencuar, qoftë ky i pavarur, apo i punësuar pranë një shoqërie sigurimi;
  - ç) të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë gjatë 5 viteve të fundit për ndonjë vepër penale;
  - d) të mos jetë dënuar për organizimin dhe vënien në funksionim të skemave mashtruese e piramidale të huamarrjes;
  - dh) të kalojë me sukses testin e njohurive, të përcaktuar në pikën 2 të këtij neni;
  - e) të mos ketë detyrime të papaguara në afat.
2. Autoriteti përcakton rregulla në lidhje me kryerjen e testit të njohurive që duhet të kalojë aplikanti për marrjen e licencës si vlerësues dëmsh.
3. Licenca e vlerësuesit të dëmeve rinovohet sipas afateve dhe rregullave të përcaktuara nga Autoriteti, pas paraqitjes së dëshmive për trajnime të vazhdueshme profesionale dhe përditësim të dokumentacionit që lidhet me shkronjat “ç”, “d”, “dh” dhe “e”, të pikës 1, të këtij neni.
4. Autoriteti përcakton, me rregullore, procedurat dhe afatet për licencimin, rinovimin, refuzimin, revokimin, si dhe pezullimin e licencës së vlerësuesve të dëmeve, persona fizikë, si dhe në lidhje me arsimimin universitar e kualifikimet përkatëse, në varësi të ushtrimit të profesionit të vlerësuesit.
5. Autoriteti miraton rregulla për kërkesat dhe procedurat e licencimit të personave juridikë si vlerësues dëmsh, si dhe procedurat dhe rastet e refuzimit, revokimit apo pezullimit të licencës.

## Neni 228

### **Revokimi dhe pezullimi licencës**

1. Autoriteti revokon licencën, nëse vërteton se vlerësuesi i dëmeve në sigurime:
  - a) ka shkelur kushtet e licencimit ose kërkesat e këtij ligji dhe akteve të Autoritetit;
  - b) nuk ushtron veprimtari brenda 6 muajve nga data e marrjes së licencës;
  - c) ka bërë vlerësime të gabuara dhe subjektive;
  - ç) ka bërë vlerësime të pavërteta dhe shkelje të procedurave;
  - d) ka bërë vlerësime që bien në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi dhe me standardet profesionale;
  - dh) ka paraqitur dokumente të falsifikuara ose të rreme për marrjen e licencës;
  - e) heq dorë vullnetarisht nga ushtrimi i veprimtarisë.
2. Në rast të revokimit të licencimit, licenca depozitohet në Autoritet brenda 30 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit.
3. Autoriteti, për shkelje të dispozitave të këtij ligji, mund të pezullojë licencën e vlerësuesit të dëmeve për një periudhë kohore jo më të gjatë se 6 muaj.

## Neni 229

### **Sigurimi i përgjegjësisë profesionale të vlerësuesit të dëmeve**

Vlerësuesi i dëmeve mban një policë sigurimi të përgjegjësisë profesionale ose një lloj garancie tjetër të ngjashme, për dëmet e ndodhura si rezultat i veprimeve apo mosveprimeve të tij, jo më pak se 30 000 000 lekë për çdo dëm dhe jo më pak se 100 000 000 lekë për të gjitha dëmet në një vit kalendarik.

## Neni 230

### **Kufizimet**

1. Aksionarët e shoqërisë së sigurimit, agjentët dhe brokerat në sigurime, si dhe personat që merren me administrimin dhe auditimin e shoqërisë së sigurimit nuk mund të jenë:
  - a) vlerësues dëmsh;
  - b) anëtarë të këshillit të administrimit/mbikëqyrës apo komitetit të auditimit të një personi juridik që vepron si vlerësues dëmsh;
  - c) aksionarë ose punonjës të personit juridik që vepron si vlerësues dëmsh.
2. Kufizimet e përcaktuara në pikën 1, të këtij neni, zbatohen edhe për bashkëshortët dhe fëmijët, përfshirë dhe ato në kujdestari.
3. Vlerësuesi i dëmeve nuk duhet të angazhohet në veprimtari tjetër biznesi apo profesion që cenon integritetin, pavarësinë dhe aftësitë profesionale të tij.
4. Vlerësuesi i pavarur i dëmeve nuk mund të jetë punonjës i shoqërisë së sigurimit.
5. Vlerësuesi i dëmeve, në vlerësimin e dëmeve, i referohet treguesve dhe koeficientëve, të nxjerrë nga institucionet kompetente, sipas akteve ligjore e nënligjore në fuqi.

## Neni 231

### **Bashkëpunimi me palët e interesuara**

1. Vlerësuesi i dëmeve, gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tij, mund të kërkojë nga palët e interesuara dokumentet origjinale apo kopje të kontratave të sigurimit, si dhe dokumente të tjera të nevojshme, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Vlerësuesi i dëmeve ka të drejtën të mbajë kopje të këtyre dokumenteve.

2. Shoqëritë e sigurimit, ndërmjetësit, të siguruarit, si dhe palët e tjera të interesuara ndihmojnë vlerësuesin në kryerjen e detyrave të tij në mënyrë të pavarur dhe të drejtë.

## Neni 232

### **Eksperti këshillues**

1. Vlerësuesi i dëmeve, kur është e nevojshme, mund të këshillohet me ekspertë të ndryshëm. Përpara këshillimit vlerësuesi i dëmeve informon, me shkrim, palën e interesuar për identitetin dhe fushën e njohurive që mbulon eksperti përkatës. Eksperti duhet të jetë i pranishëm gjatë gjithë procesit të vlerësimit të dëmit.

2. Konkluzionet e ekspertit quhen të pavlefshme dhe nuk përfshihen në raportin e vlerësuesit të dëmeve nëse nuk zbatohen përcaktimet e pikës 1 të këtij neni.

## Neni 233

### **Paanshmëria**

1. Vlerësuesi i dëmeve duhet të jetë i paanshëm dhe i pavarur, duke respektuar parimin një vlerësim për një ngjarje sigurimi.

2. Vlerësuesi i dëmeve nuk duhet të kryejë veprimtarinë e vlerësimit të dëmeve nëse ka arsye të forta, të cilat mund të ndikojnë në paanshmërinë e tij në lidhje me një nga palët, ose nëse ka ndonjë lloj afërsie familjare apo lidhjeje biznesi me ndonjë nga palët.

3. Arsye të forta që mund të ndikojnë në paanshmërinë e vlerësuesit, sipas përcaktimit të pikës 2, të këtij neni, quhen rastet kur vlera e dëmit apo përfitimi i interesit të siguruarës i përket vlerësuesit të dëmeve ose nëse ka lidhje ndërmjet vlerësuesit dhe një prej palëve për blerje, dhurim, dhënie me qira, të drejtë përdorimi apo marrëdhënie krediti-debiti. Në këto raste palët mund të zgjedhin një tjetër vlerësues dëmsh.

4. Vlerësuesi i pavarur i dëmit nuk merr asnjë lloj përfitimi të drejtpërdrejtë ose të tërthortë që mund të rrezikojnë paanshmërinë e tij, përveç komisionit të vlerësimit të dëmit. Komisioni i vlerësimit të dëmit përcaktohet nga Autoriteti dhe transferohet vetëm në rrugë bankare.

5. Dispozitat e këtij seksioni zbatohen dhe për vlerësuesit e dëmeve, të punësuar nga personi juridik që kryen veprimtari të vlerësimit të dëmeve.

6. Raportet e vlerësimit të dëmit, të cilat hartohen në kundërshtim me dispozitat e këtij seksioni, quhen të pavlefshme.

## Neni 234

### **Standardet dhe etika profesionale**

1. Vlerësuesi i dëmeve vepron në përputhje me standardet dhe etikën profesionale dhe duhet të jetë i kujdesshëm në marrëdhëniet e tij profesionale.
2. Vlerësuesi i dëmeve ruan raportet e vlerësimit dhe dokumentet, mbi të cilat bazohen këto raporte për një periudhë 5-vjeçare.
3. Vlerësuesi i pavarur i dëmeve dhe personat që punojnë për të duhet të ruajnë konfidencialitetin e informacionit, për të cilin marrin dijeni gjatë ushtrimit të detyrave të tyre dhe nuk duhet ta përhapin këtë informacion pa marrë paraprakisht miratimin e palëve përkatëse. Ky detyrim përjashton vetëm rastet kur legjislacioni përkatës në fuqi e parashikon ndryshe.

## Neni 235

### **Mbikëqyrja e vlerësuesve të dëmeve**

1. Mbikëqyrja e aktivitetit të vlerësuesit të dëmeve ushtrohet nga Autoriteti.
2. Dispozitat e këtij ligji, që lidhen me mbikëqyrjen e shoqërive të sigurimit, zbatohen rast pas rasti edhe për mbikëqyrjen e përmendur në pikën 1 të këtij neni.

## KREU XI

### **BASHKËPUNIMI DHE SHKËMBIMI I INFORMACIONIT**

## Neni 236

### **Shkëmbimi i informacionit dhe përpunimi i të dhënave**

1. Autoriteti mund të lidhë marrëveshje apo memorandum bashkëpunimi me autoritete të tjera mbikëqyrëse, vendase apo të huaja, me autoritete mbikëqyrëse në sektorin financiar, agjenci ose institucione të parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, apo institucione të tjera, të njohura me ligj, për të bashkëpunuar ose shkëmbyer informacione.
2. Autoriteti mund të shkëmbejë me autoritetet dhe institucionet vendase apo të huaja:
  - a) informacionin e kërkuar për lëshimin e licencave;
  - b) informacionin e kërkuar për subjektet e mbikëqyrura;
  - c) informacionin e kërkuar, që lidhet me parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit;
  - ç) informacionin e kërkuar, që lidhet me mashtrimin gjatë ushtrimit të veprimtarisë në fushën e sigurimeve;
  - d) të dhëna të natyrës financiare;
  - dh) informacione për personat fizikë që mbajnë poste me përgjegjësi në këto subjekte.
3. Autoriteti bashkëpunon dhe bashkërendon punën me autoritete të tjera mbikëqyrëse apo institucione të tjera, të njohura me ligj, vendase apo të huaja, për

administrimin sa më efektiv të krizës në rastin e ofrimit të shërbimeve në sigurime nga një sigures i caktuar jashtë territorit të vendit ku ndodhet selia e tij qendrore. Autoriteti dhe autoritetet e tjera mbikëqyrëse këshillohen me palën dhënëse të informacionit përpara ndërmarrjes së veprimeve të mëtejshme.

4. Çdo informacion që merr Autoriteti, si dhe çdo informacion që i jepet një autoriteti tjetër mbikëqyrës trajtohet si konfidencial dhe përdoret vetëm për qëllime të mbikëqyrjes.

5. Autoriteti është përgjegjës për mbledhjen dhe përpunimin e informacionit rreth fakteve dhe rrethanave që lidhen me përmbushjen e detyrave të tij mbikëqyrëse dhe përgjegjësive të përcaktuara në këtë ligj.

6. Autoriteti mund të miratojë rregulla më të detajuara lidhur me shkëmbimin, përdorimin dhe përpunimin e informacionit të përcaktuar në këtë nen.

Neni 237

### **Shkëmbimi i informacionit me vendet anëtare**

1. Dispozitat e përcaktuara pikat 1, 2 dhe 3, të nenit 236, të këtij ligji, zbatohen edhe për shkëmbimin e informacionit me vendet anëtare.

2. Autoriteti miraton rregulla të mëtejshme për shkëmbimin e informacionit, njoftimin dhe përpunimin e të dhënave me autoritetet mbikëqyrëse të vendeve anëtare dhe Komisionin Europian.

## **KREU XII**

### **DISPOZITA TË NDRYSHME**

Neni 238

### **Shoqata**

1. Shoqëritë e sigurimit ose risigurimit mund të krijojnë shoqata sigurimi ose risigurimi që regjistrohen si shoqatë e sigurimeve ose risigurimeve.

2. Anëtarët e shoqatës nuk mund të bien në marrëveshje të shkruar ose verbale me shoqëri të tjera sigurimi apo shoqata sigurimi ose risigurimi, të cilat mund të kufizojnë parimet e ekonomisë për një treg të lirë ose konkurrencë të ndershme në fushën e sigurimeve.

3. Shoqëritë e agjentëve në sigurime, agjentët në sigurime, shoqëritë e brokerimit, brokerat, aktuarët, si dhe vlerësuesit e dëmeve mund të krijojnë shoqatat e tyre përkatëse. Dispozitat e këtij kreu zbatohen rast pas rasti edhe për këto shoqata.

Neni 239

### **Parimi i mirëbesimit**

1. Shoqëritë e sigurimit dhe ndërmjetësit hartojnë broshurat dhe artikujt shpjegues, dokumente të tjera dhe reklama, në mënyrë që të jenë të kuptueshme dhe të pasqyrohen qartë të drejtat e përfitimit e të siguruarve dhe nuk bëjnë deklarata të

pavërteta, çorientuese, mashtruese ose që krijojnë situatë të një konkurrence të pandershme.

2. Shoqëritë e sigurimit, ndërmjetësit dhe vlerësuesit e dëmeve janë të detyruar që të mos veprojnë në atë mënyrë që rrezikojnë të drejtat dhe përfitimet e të siguruarve. Ato veprojnë në përputhje me legjislacionin dhe parimet e veprimtarisë në sektorin e sigurimeve, si dhe me kërkesat e parimit të mirëbesimit.

3. Autoriteti merr të gjitha masat e nevojshme për të siguruar që shoqëritë e sigurimit, ndërmjetësit dhe vlerësuesit e dëmeve të veprojnë në përputhje me dispozitat e këtij neni.

#### Neni 240

### **Parandalimi i pastrimit të parave dhe mashtrimit gjatë ushtrimit të veprimtarisë në fushën e sigurimeve**

1. Shoqëria e sigurimit dhe ndërmjetësit marrin të gjitha masat e nevojshme për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit, sipas parashikimeve të ligjit nr. 9917, datë 19.5.2008, “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”, të ndryshuar.

2. Shoqëria e sigurimit dhe ndërmjetësit marrin të gjitha masat e nevojshme për zbulimin, parandalimin dhe ndreqjen e rasteve të mashtrimit gjatë ushtrimit të veprimtarisë në fushën e sigurimeve. Shoqëria e sigurimit dhe ndërmjetësit raportojnë menjëherë në Autoritet çdo fakt që përbën mashtrim gjatë ushtrimit të veprimtarisë në fushën e sigurimeve.

#### KREU XIII

### **KONTRIBUTET, KOMITETET DHE QENDRA E EDUKIMIT**

#### Neni 241

### **Tarifa e mbikëqyrjes dhe tarifa të tjera**

1. Shoqëritë e sigurimit, degët e shoqërive të sigurimit të vendeve të huaja/anëtare, për veprimtarinë e tyre gjatë periudhës së vlefshmërisë së licencës, paguajnë në Autoritet një tarifë mbikëqyrjeje, që përlllogaritet kundrejt volumit të primeve të shkruara bruto, sipas parashikimeve të ligjit nr. 9572 datë 3.7.2006, “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”. Tarifa e mbikëqyrjes paguhet çdo muaj brenda datës 15 të muajit pasardhës. Pagesa bëhet në llojin e monedhës, me të cilën arkëtohet primi i sigurimit. Autoriteti miraton procedurat e arkëtimit dhe rakordimit të tarifës së mbikëqyrjes.

2. Përveç tarifës së mbikëqyrjes, të përcaktuar në pikën 1, të këtij neni, shoqëritë e sigurimit, risigurimit, degët e shoqërive të sigurimit të vendeve të huaja/anëtare, ndërmjetësit, aktuarët, vlerësuesit e dëmeve që veprojnë në Republikën e Shqipërisë paguajnë në Autoritet tarifa për aplikim për dhënie apo rinovim licence, miratimi apo autorizimi.

3. Nëse licencimi, miratimi apo autorizimi refuzohet nga Autoriteti, tarifa e paguar nuk kthehet.

Neni 242

### **Tarifat e tjera**

Autoriteti miraton rregullore për tarifat e tjera, të parashikuara në nenin 241, të këtij ligji, elementet e përlogaritjes e nivelet e këtyre tarifave që u ngarkohen subjekteve të mbikëqyrura, si dhe procedurat e arkëtimit dhe rakordimit të tyre.

Neni 243

### **Komitetet e specializuara**

1. Autoriteti mund të krijojë komitete të specializuara, të përbëra nga persona me njohuri dhe ekspertizë në fushën e sigurimeve, për të kryer kërkime dhe analiza mbi tarifat e primeve dhe kontratat e sigurimeve, të përcaktuara në këtë ligj, si dhe për zhvillimin e sektorit të sigurimeve.

2. Rregullat, që kanë lidhje me krijimin dhe funksionimin e komiteteve të specializuara, përcaktohen nga Autoriteti.

Neni 244

### **Qendra e edukimit**

1. Qendra e edukimit ka si objekt organizimin e trajnimeve të nevojshme për formimin profesional të drejtuesve dhe profesionistëve për fushat që mbulon Autoriteti dhe përmbushjen e kërkesave për trajnime që rrjedhin nga marrëveshjet kombëtare e ndërkombëtare, si dhe qëllime të ngjashme me këto.

2. Qendra e edukimit mund të krijohet nga Autoriteti dhe veprimtaria e saj financohet nga subjektet e mbikëqyrura, personat fizikë e juridikë që përfitojnë nga trajnimet e qendrës, si dhe nga ndihmat financiare e donacionet.

3. Kriteret dhe procedurat e financimit e administrimit të qendrës përcaktohen me rregullore të Autoritetit.

4. Përfshirë nga pika 2, e këtij neni, qendra e edukimit mund të krijohet edhe nga persona të tjerë juridikë. Autoriteti miraton rregulla dhe procedura për kriteret që duhet të përmbushin këta persona për krijimin e qendrës së edukimit të Autoritetit, duke përfshirë edhe objektivat dhe qëllimin që synohet të arrihen nëpërmjet kësaj qendre, sipas pikës 1, të këtij neni.

## **KREU XIV**

### **SHKELJET E DISPOZITAVE**

Neni 245

### **Kundërvajtjet administrative**

1. Çdo shkelje me faj e dispozitave të këtij ligji, e kryer me veprim ose mosveprim, për të cilat parashikohen sanksione me gjobë, përbën kundërvajtje administrative.

2. Përveç masave të mbikëqyrjes, të parashikuara në këtë ligj, kundërvajtjet administrative, të parashikuara në nenet e mëposhtme, sanksionohen me gjobë.

3. Kur vendos sanksion me gjobë, Autoriteti siguron që ajo të jetë:

a) e efektshme dhe parandaluese; dhe

b) në përpjesëtim me gjendjen që e shkaktoi vendosjen e masës.

Autoriteti përcakton shumën e gjobës, në përputhje me dispozitat e këtij ligji, duke vlerësuar, gjithashtu, natyrën dhe fushën e veprimit të shkeljes dhe ndikimin mbi interesat e të siguruarve.

4. Autoriteti, gjatë vendosjes së sanksioneve, zbaton parimin e vazhdimësisë, sipas të cilit për shkelje të ngjashme vendosen sanksione të ngjashme.

## Neni 246

### **Sanksioni me gjobë ndaj shoqërisë së sigurimit**

1. Autoriteti vendos sanksion me gjobë nga 2 000 000 deri në 3 000 000 lekë ndaj shoqërisë së sigurimit nëse ajo:

a) ushtron aktivitet në kundërshtim me nenin 6 të këtij ligji;

b) nuk njofton paraprakisht, me shkrim, Autoritetin në rastin kur kërkon të zotërojë pjesëmarrje influencuese në një tjetër shoqëri sigurimi ose institucion financiar, me seli qendrore jashtë territorit të Shqipërisë, sipas përcaktimeve të nenit 50 të këtij ligji;

c) ushtron veprimtari sigurimi në klasat e sigurimit, për të cilat nuk është licencuar nga Autoriteti për ta ushtruar këtë veprimtari, sipas përcaktimeve të nenit 28 të këtij ligji;

ç) ushtron veprimtari sigurimi pa marrë licencën e dhënë nga Autoriteti, sipas përcaktimeve të shkronjës "b", të pikës 1, të nenit 29, të këtij ligji;

d) shkel dispozitat e parashikuara në nenet 57, 63, 64, 66 dhe 69 të këtij ligji;

dh) kryen veprimtari promocionale në kundërshtim me nenin 67 të këtij ligji;

e) nuk emëron aktuarin e autorizuar, sipas përcaktimeve të nenit 223 të këtij ligji;

ë) shkel parashikimet e nenit 226 të këtij ligji;

f) fillon veprimtarinë e sigurimit ose themelon degë të shoqërisë së sigurimit në një vend të huaj/anëtar pa marrë miratimin e Autoritetit, sipas përcaktimeve të neneve 40 dhe 41 të këtij ligji;

g) nuk ka politika e procedura të qarta dhe të hollësishme për identifikimin, matjen dhe monitorimin e rreziqeve, ndaj të cilave ekspozohet gjatë ushtrimit të veprimtarisë së saj, sipas përcaktimeve të pikës 4, të nenit 74, të këtij ligji;

gj) nuk ka investuar aktivet në mbulim të provigjoneve teknike, në përputhje me përcaktimet e neneve 96, 97 dhe 98 të këtij ligji;

h) ka risiguruar në kundërshtim me nenin 116 të këtij ligji;

i) shkel dispozitat e përcaktuara në pikat 1 dhe 5, të nenit 117, të këtij ligji;

j) shkel dispozitat e përcaktuara në nenet 100, 101, 102 dhe 103 të këtij ligji;

k) nuk mban librat e kontabilitetit, nuk vlerëson zërat e kontabilitetit dhe nuk harton pasqyrat financiare dhe dokumentet kontabël, në përputhje me përcaktimet e neneve 109 e 110 të këtij ligji;

l) nuk raporton, në përputhje me nenet 111 dhe 112 të këtij ligji;

ll) nuk ka krijuar funksionet e sistemit të administrimit të rrezikut dhe sistemit të kontrollit të brendshëm, në përputhje me përcaktimet e neneve 27 dhe 121 të këtij ligji;



- m) shkel dispozitat e parashikuara në pikën 3, të nenit 119, të këtij ligji;
- n) shkel dispozitat e parashikuara në nenet 261, 267 dhe 268 të këtij ligji;
- nj) nuk paraqet gjithë të dhënat dhe informacionin, në përputhje me përcaktimet e pikës 1, të nenit 143, të këtij ligji;
- o) lidh kontratë ndërmjetësimi në kundërshtim me pikën 1, të nenit 215, të këtij ligji.

2. Personi përgjegjës i shoqërisë së sigurimit sanksionohet me gjobë nga 300 000 deri në 400 000 lekë për shkeljet e përcaktuara në pikën 1 të këtij neni.

3. Autoriteti vendos sanksion me gjobë nga 1 000 000 deri në 1 200 000 lekë ndaj shoqërisë së sigurimit nëse ajo:

a) nuk njofton Autoritetin për shkarkimin e aktuarit të autorizuar, sipas përcaktimeve të pikës 2, të nenit 223, të këtij ligji;

b) nuk depoziton në Autoritet pasqyrat financiare dhe raportet e tjera të veprimtarisë së saj të paauditura, në përputhje me përcaktimet e pikës 2, të nenit 111, të këtij ligji;

c) nuk depoziton në Autoritet një kopje të raportit vjetor të audituar, brenda afatit kohor të përcaktuar në pikën 8, të nenit 125, të këtij ligji;

ç) pengon në çdo mënyrë personat e autorizuar të Autoritetit në ushtrimin e mbikëqyrjes, sipas përcaktimeve të neneve 130, 132, 133, 134, 135, 136, 137 dhe 138 të këtij ligji;

d) nuk raporton në Autoritet, në përputhje me përcaktimet e neneve 85 dhe 131 të këtij ligji;

dh) nuk raporton në Autoritet transaksionet brenda grupit, në përputhje me përcaktimet e nenit 144 të këtij ligji;

e) nuk informon Autoritetin për çdo fakt ose rrethanë që mund të jetë e rëndësishme për të përcaktuar nëse subjekti në fjalë është një grup sigurimi, sipas kuptimit të këtij ligji, në përputhje me përcaktimet e nenit 148 të tij;

ë) u mundëson kryerjen e veprimtarisë së ndërmjetësimit personave të tjerë, të ndryshëm nga ata të përcaktuar në nenet 195, 200, 203 dhe 210 të këtij ligji.

4. Personi përgjegjës i shoqërisë së sigurimit sanksionohet me gjobë nga 100 000 deri në 200 000 lekë për shkeljet e përcaktuara në pikën 3 të këtij neni.

#### Neni 247

#### **Sanksioni me gjobë ndaj anëtarit të këshillit të administrimit/mbikëqyrës**

Autoriteti vendos sanksion me gjobë nga 300 000 deri në 500 000 lekë ndaj anëtarit të këshillit të administrimit/mbikëqyrës nëse ai:

a) vepron në kundërshtim me përcaktimet e neneve 22 dhe 23 të këtij ligji;

b) nuk njofton menjëherë Autoritetin, në përputhje me përcaktimet e pikës 3, të nenit 131, të këtij ligji.

#### Neni 248

#### **Sanksioni me gjobë ndaj agentit dhe shoqërisë së agentëve**

1. Autoriteti vendos sanksion me gjobë nga 300 000 deri në 400 000 lekë ndaj shoqërisë së agentëve nëse ajo:

a) shkel dispozitat e neneve 63 dhe 64 të këtij ligji;

- b) nuk zotëron policën e përgjegjësive profesionale, në përputhje me përcaktimet e nenit 197 të këtij ligji;
- c) nuk ushtron veprimtari të shoqërisë së agjentëve, në përputhje me përcaktimet e pikës 2, të nenit 200, të këtij ligji;
- ç) merr në kontroll ose bashkohet me një shoqëri tjetër agjentësh, në kundërshtim me pikat 1 dhe 2, të nenit 212, të këtij ligji;
- d) kërkon pagesën e komisionit apo ndonjë pagesë tjetër nga personi i siguruar, në kundërshtim me pikën 1, të nenit 216, të këtij ligji;
- dh) nuk depoziton në Autoritet pasqyrat financiare vjetore ose 6-mujore brenda afateve kohore të përcaktuara në pikën 3, të nenit 217, të këtij ligji;
- e) nuk depoziton në Autoritet raportin statistikor brenda afateve kohore të përcaktuara në pikën 4, të nenit 217, të këtij ligji;
- ë) nuk raporton në Autoritet, në përputhje me përcaktimet e nenit 218 të këtij ligji;
- f) nuk njofton paraprakisht në Autoritet fillimin e veprimtarisë së agjentit në një vend anëtar/të huaj, sipas përcaktimeve të nenit 221 të këtij ligji;
- g) pengon personin e autorizuar nga Autoriteti për të ushtruar mbikëqyrje, sipas përcaktimeve të neneve 130, 132, 133, 134, 135, 136, 137 dhe 138 të këtij ligji;
- gj) në kundërshtim me pikën 2, të nenit 215, të këtij ligji, lejon kryerjen e veprimtarisë së agjentit për llogari të saj nga persona të tjerë, përveç atyre të përmendur në nenin 195 të këtij ligji.

2. Personi përgjegjës i shoqërisë së agjentëve sanksionohet me gjobë nga 50 000 deri në 100 000 lekë, për shkeljet e përcaktuara në pikën 1 të këtij neni.

3. Autoriteti vendos sanksion me gjobë nga 200 000 deri në 300 000 lekë ndaj agjentit nëse ai:

- a) ushtron veprimtari në kundërshtim me pikën 3, të nenit 198, të këtij ligji;
- b) nuk i jep informacion ose i jep informacion të pasaktë të siguruarit, në kundërshtim me pikën 1, të nenit 213, të këtij ligji, ose nuk e jep informacionin sipas mënyrës së përcaktuar në nenin 214 të tij;
- c) kërkon pagesën e komisionit apo ndonjë pagesë tjetër nga personi i siguruar, në kundërshtim me pikën 1, të nenit 216, të këtij ligji.

#### Neni 249

#### **Sanksioni me gjobë ndaj brokerit dhe shoqërisë së brokerimit**

1. Autoriteti vendos sanksion me gjobë nga 800 000 deri në 1 000 000 lekë ndaj shoqërisë së brokerimit nëse ajo:

- a) shkel dispozitat e neneve 63 dhe 64 të këtij ligji;
- b) nuk zotëron policën e përgjegjësive profesionale, në përputhje me përcaktimet e nenit 205 të këtij ligji;
- c) nuk ushtron veprimtari brokerimi si veprimtari të vetme, në përputhje me përcaktimet e pikës 1, të nenit 204, të këtij ligji;
- ç) merr në kontroll ose bashkohet me një shoqëri tjetër brokerimi, në kundërshtim me pikat 1 dhe 2, të nenit 212, të këtij ligji;
- d) kërkon pagesën e komisionit apo ndonjë pagesë tjetër nga personi i siguruar, në kundërshtim me pikën 2, të nenit 216, të këtij ligji;
- dh) shkel përcaktimet e pikës 3, të nenit 216, të këtij ligji;

e) nuk depoziton në Autoritet pasqyrat financiare vjetore ose 6-mujore brenda afateve kohore të përcaktuara në pikën 3, të nenit 217, të këtij ligji;

ë) nuk depoziton në Autoritet raportin statistikor brenda afateve kohore të përcaktuara në pikën 4, të nenit 217, të këtij ligji;

f) nuk raporton në Autoritet, në përputhje me përcaktimet e nenit 218 të këtij ligji;

g) nuk njofton paraprakisht në Autoritet fillimin e veprimtarisë së brokerimit në një vend anëtar, sipas përcaktimeve të nenit 221 të këtij ligji;

gj) pengon personin e autorizuar nga Autoriteti për të ushtruar mbikëqyrje, sipas përcaktimeve të neneve 130, 132, 133, 134, 135, 136, 137 dhe 138 të këtij ligji;

h) në kundërshtim me pikën 3, të nenit 215, të këtij ligji, lejon kryerjen e veprimtarisë së brokerimit për llogari të saj nga persona të tjerë, përveç atyre të përmendur në nenin 203 të tij.

2. Personi përgjegjës i shoqërisë së brokerimit sanksionohet me gjobë nga 50 000 deri në 100 000 lekë për shkeljet e përcaktuara në pikën 1 të këtij neni.

3. Autoriteti vendos sanksion me gjobë nga 500 000 deri në 800 000 lekë ndaj brokerit nëse ai:

a) nuk përmbush detyrimet e tij, në përputhje me nenin 206 të këtij ligji;

b) gjatë ushtrimit të veprimtarisë së brokerimit, vepron në kundërshtim me pikën 1, të nenit 207, të këtij ligji;

c) gjatë kryerjes së veprimeve përgatitore për nënshkrimin e kontratës, nuk informon shoqërinë e sigurimit për rreziqet që ka ose mund të kishte dijani, në kundërshtim me përcaktimet e pikës 4, të nenit 207, të këtij ligji;

ç) nuk është licencuar nga Autoriteti për të ushtruar veprimtari brokerimi, sipas përcaktimeve të pikës 1, të nenit 209, të këtij ligji;

d) nuk i jep informacion ose i jep informacion të rremë të siguruarit, në kundërshtim me pikën 1, të nenit 213, të këtij ligji, ose nuk e jep informacionin sipas mënyrës së përcaktuar në nenin 214 të tij;

dh) nuk bën analizën e rrezikut, në përputhje me përcaktimet e pikës 2, të nenit 213, të këtij ligji;

e) kërkon pagesën e komisionit apo ndonjë pagesë tjetër nga personi i siguruar, në kundërshtim me pikën 2, të nenit 216, të këtij ligji;

ë) shkel përcaktimet e pikës 3, të nenit 216, të këtij ligji.

## Neni 250

### **Sanksioni me gjobë ndaj grupit të sigurimit**

1. Autoriteti vendos sanksion me gjobë nga 2 000 000 deri në 3 000 000 lekë ndaj një grupi kontrollues financiar, grupi kontrollues të sigurimit të përzier, grupi kontrollues të sigurimit, grupi kontrollues të sigurimit me aktivitet të përzier, grupi kontrollues financiar të përzier apo shoqërie siguruuese ose risiguruuese mëmë në një grup sigurimi, nëse nuk raporton mbi mjaftueshmërinë e kapitalit të grupit të sigurimit, në përputhje me përcaktimet e nenit 146 të këtij ligji.

2. Personi përgjegjës i grupit kontrollues financiar, grupit kontrollues të sigurimit të përzier, grupit kontrollues të sigurimit, grupit kontrollues të sigurimit me aktivitet të përzier, grupit kontrollues financiar të përzier apo shoqëria siguruuese ose risiguruuese mëmë në një grup sigurimi sanksionohen me gjobë nga 300 000 deri në 400 000 lekë për shkeljet e përcaktuara në pikën 1 të këtij neni.

## Neni 251

### **Sanksioni me gjobë ndaj personave të tjerë**

1. Autoriteti vendos sanksion me gjobë nga 500 000 deri në 1 000 000 lekë ndaj personave të tjerë juridikë nëse ata:

a) ushtrojnë veprimtari sigurimi në kundërshtim me pikën 1, të nenit 10, të këtij ligji;

b) ushtrojnë veprimtari risigurimi në kundërshtim me pikën 8, të nenit 6, të këtij ligji;

c) ushtrojnë veprimtari ndërmjetësimi në kundërshtim me nenet 200 dhe 210 të këtij ligji;

ç) ushtrojnë veprimtari si vlerësues dëmsh në kundërshtim me nenet 226 dhe 227 të këtij ligji.

2. Personi përgjegjës i personit juridik sanksionohet me gjobë nga 300 000 deri në 400 000 lekë për shkeljet e përcaktuara në pikën 1 të këtij neni.

3. Autoriteti vendos sanksion me gjobë nga 200 000 deri në 400 000 lekë ndaj personave të tjerë fizikë nëse:

a) ushtrojnë veprimtari ndërmjetësimi në kundërshtim me nenet 199, 209 dhe 210 të këtij ligji;

b) ushtrojnë veprimtarinë e agjentit në kundërshtim me pikën 5, të nenit 200, të këtij ligji;

c) ushtrojnë veprimtari si vlerësues dëmsh në kundërshtim me nenet 226 dhe 227 të këtij ligji.

4. Autoriteti vendos sanksion me gjobë 200 000 lekë ndaj personave të palicencuar, sipas dispozitave të këtij ligji, të cilët përdorin emrin “sigurim ose risigurim” apo derivate të tij ose kryejnë veprimtari promovionale, me qëllim përfitimin e të mirave materiale.

## Neni 252

### **Sanksioni me gjobë ndaj aktuarit të autorizuar**

Autoriteti vendos sanksion me gjobë nga 200 000 deri në 400 000 lekë ndaj aktuarit të autorizuar nëse ai:

a) ka ushtruar veprimtari aktuariale në kundërshtim me nenin 224 të këtij ligji;

b) nuk njofton shoqërinë e sigurimit, në përputhje me përcaktimet e pikës 4, të nenit 225, të këtij ligji;

c) nuk njofton Autoritetin në përputhje me përcaktimet e pikave 6 dhe 7, të nenit 225, të këtij ligji.

## Neni 253

### **Sanksioni me gjobë ndaj vlerësuesit të dëmeve**

Autoriteti vendos sanksion me gjobë nga 100 000 deri në 300 000 lekë ndaj vlerësuesit të dëmeve në sigurime nëse ai:

- a) nuk zotëron policën e përgjegjësive profesionale, në përputhje me përcaktimet e nenit 229 të këtij ligji;
- b) shkel dispozitat e pikës 1, të nenit 230, të këtij ligji;
- c) ushtron veprimtarinë në kundërshtim me parimet e nenit 233 të këtij ligji;
- ç) ushtron veprimtarinë në kundërshtim me standardet e përcaktuara në nenin 234 të këtij ligji.

Neni 254

### **Sanksione me gjobë ndaj administratorit të përkohshëm**

Autoriteti vendos sanksion me gjobë nga 300 000 deri në 500 000 lekë ndaj administratorit të përkohshëm nëse ai:

- a) nuk depoziton në Autoritet raportin mbi gjendjen financiare dhe ecurinë e veprimtarisë së shoqërisë së sigurimit, në kushtet e administrimit të përkohshëm, sipas përcaktimeve të pikës 1, të nenit 166, të këtij ligji;
- b) nuk depoziton në Autoritet raportin mbi gjendjen financiare dhe ecurinë e veprimtarisë së shoqërisë së sigurimit, në kushtet e administrimit të përkohshëm, sipas përcaktimeve të pikës 2, të nenit 166, të këtij ligji;
- c) nuk thërret mbledhjen e asamblesë së përgjithshme të shoqërisë së sigurimit, sipas përcaktimeve të nenit 167 të këtij ligji.

Neni 255

### **Sanksioni me gjobë për ruajtjen e konfidencialitetit**

1. Autoriteti vendos sanksion me gjobë nga 200 000 lekë deri në 400 000 lekë ndaj personave të përmendur në pikën 1, të nenit 72, të këtij ligji, nëse shkelin detyrimin për ruajtjen e konfidencialitetit, sipas përcaktimeve të këtij neni.

2. Autoriteti vendos sanksion me gjobë nga 100 000 deri në 300 000 lekë ndaj personave të përmendur në pikën 4, të nenit 72, të këtij ligji, nëse shkelin detyrimin për ruajtjen e konfidencialitetit, sipas përcaktimeve të këtij neni.

3. Autoriteti vendos sanksion me gjobë nga 50 000 deri në 100 000 lekë ndaj personit përgjegjës, nëse shkel detyrimin për ruajtjen e konfidencialitetit, sipas përcaktimeve të nenit 72 të këtij ligji.

Neni 256

### **Shkelje të tjera**

1. Për çdo shkelje tjetër të këtij ligji, Autoriteti:

- a) vendos sanksion me gjobë nga 300 000 deri në 1 000 000 lekë;
  - b) urdhëron shoqërinë e sigurimit për shkarkimin e një ose të disa anëtarëve të këshillit të administrimit/mbikëqyrës dhe/ose administratorit/anëtarit të bordit të drejtorëve apo pezullimin e personave në fjalë për një periudhë të caktuar kohore.
2. Autoriteti, nëse e gjykon të arsyeshme, paralajmëron shoqërinë e sigurimit për shkarkimin apo pezullimin e personave të përcaktuar në pikën 1 të këtij neni.

Neni 257

### **Përsëritja e shkeljeve**

Autoriteti, në rast të përsëritjeve të shkeljeve, mund të vendosë dyfishimin e sanksioneve të parashikuara nga nenet 246 e në vijim të këtij ligji.

Neni 258

### **Njoftimi**

Autoriteti njofton shoqërinë e sigurimit, risigurimit, ndërmjetësit në sigurime dhe risigurime, degën e shoqërisë së sigurimit të vendit të huaj/anëtar, si dhe personat përgjegjës për çdo sanksion të dhënë, në përputhje me nenet 246 e në vijim, të këtij ligji, brenda 10 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit.

Neni 259

### **Ekzekutimi i vendimeve**

1. Sanksionet me gjobë, të parashikuara në nenet 246 e në vijim, të këtij ligji, arkëtohen në një llogari qëllimore të Autoritetit, brenda 20 ditëve kalendarike nga data e marrjes së njoftimit, e përcaktuar në nenin 258 të këtij ligji.

2. Kur shuma e gjobës që duhet paguar nuk është shlyer brenda afatit, shoqëria e sigurimit dhe personi përgjegjës paguajnë një interes prej 0,01 për qind të gjobës për çdo ditë vonesë pas kalimit të afatit të parashikuar në pikën 1, të këtij neni.

3. Procedurat e konstatimit, shqyrtimit, ankimit dhe ekzekutimit të kundërvajtjeve administrative bëhen në përputhje me ligjin nr. 10 279, datë 20.5.2010, "Për kundërvajtjet administrative".

## **KREU XV**

### **DISPOZITA KALIMTARE**

Neni 260

### **Përshtatja e shoqërive të sigurimit**

1. Shoqëria e sigurimit e cila, në datën e hyrjes në fuqi të këtij ligji, ka licencë për të ushtruar një veprimtari sigurimi dhe është e regjistruar në QKR, vazhdon të ushtrojë veprimtari sigurimi sipas dispozitave të këtij ligji në klasat e sigurimit të përcaktuara në licencën ekzistuese.

2. Brenda një periudhe 1-vjeçare nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji, shoqëria e sigurimit, e përmendur në pikën 1, të këtij neni, duhet të përshtatë:

- a) strukturën aksionare të shoqërisë, në përputhje me nenin 14 të këtij ligji;
- b) organizimin e shoqërisë së sigurimit, në përputhje me nenin 19 të këtij ligji;
- c) anëtarët e këshillit të administrimit/mbikëqyrës, në përputhje me nenet 17, 20 e 22 të këtij ligji;
- ç) komitetin e auditimit, në përputhje me nenin 26 të këtij ligji;

d) çdo element tjetër të veprimtarisë së saj, në përputhje me dispozitat e tjera përkatëse të këtij ligji.

3. Shoqëria e sigurimit, e përmendur në pikën 1, të këtij neni, është e detyruar që, brenda 1 muaji nga data e përfundimit të afatit kohor, të përcaktuar në pikën 2, të depozitojë në Autoritet një raport për përshtatjen e shoqërisë, në përputhje me pikën 2, të këtij neni. Raporti shoqërohet nga:

a) statuti i shoqërisë së sigurimit;

b) një listë e aksionarëve, duke përfshirë informacionet individuale, si dhe emrin dhe adresën e selisë qendrore, shumën totale nominale të aksioneve dhe shumën e zotërimeve, të shprehura në përqindje të kapitalit të shoqërisë së sigurimit;

c) në rastin e aksionarëve si persona juridikë dhe të cilët kanë pjesëmarrje influencuese depozitojnë:

i) ekstrakt të QKR-së;

ii) kur aksionari është shoqëri aksionare, përveç informacionit të sipërpërmendur, një ekstrakt të regjistrimit të aksionarëve; në rast të aksionarëve persona juridikë të huaj duhet të përfshihen dokumentet e përkthyer në shqip dhe të noterizuara;

iii) pasqyrat financiare për 2 vitet e fundit financiare.

ç) lista e personave të lidhur me personat që kanë pjesëmarrje influencuese së bashku me një përshkrim të llojit të lidhjes së tyre.

4. Brenda një periudhe 6-mujore nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji, shoqëria e sigurimit, e përmendur në pikën 1, të këtij neni, është e detyruar:

a) të emërojë aktuarin e autorizuar, sipas përcaktimeve të nenit 223 të këtij ligji;

b) të krijojë sistemin e administrimit të rrezikut, në përputhje me nenin 27 të këtij ligji;

c) të krijojë sistemin e kontrollit të brendshëm, në përputhje me nenet 121 dhe 122 të këtij ligji.

5. Shoqëria e sigurimit, brenda 1 muaji nga data e përfundimit të afatit kohor të përcaktuar në pikën 4, të këtij neni, depoziton në Autoritet një raport për përshtatjen e shoqërisë, sipas përcaktimeve të pikës 4 të këtij neni.

6. Autoriteti miraton vazhdimësinë e veprimtarisë së shoqërisë së sigurimit nëse raportet e përmendura në pikat 3 dhe 5, të këtij neni, dhe dokumentacioni plotësues i tyre tregojnë që shoqëria e sigurimit është përshtatur.

7. Autoriteti mund të revokojë licencën e shoqërisë së sigurimit dhe të hapë procedurat e likuidimit, në përputhje me dispozitat e këtij ligji, nëse shoqëria e sigurimit, e përmendur në pikën 1, të këtij neni, nuk i përmbush kërkesat e përcaktuara në pikat 2 dhe 4 të këtij neni.

Neni 261

### **Përshtatja e shoqërisë së sigurimit, e cila ushtron veprimtari sigurimi jete dhe jo jete**

1. Shoqëria e sigurimit INSIG, sh. a., e cila në datën e hyrjes në fuqi të këtij ligji, në bazë të licencës ekzistuese, ushtron veprimtari sigurimi jete dhe jo jete, nuk është e detyruar të përshtatë veprimtarinë e saj, në përputhje me pikën 2, të nenit 6, të këtij ligji, deri në privatizimin e saj.

2. Shoqëria e sigurimit INSIG, sh. a., e cila ushtron veprimtari sigurimi, në përputhje me pikën 1, të këtij neni, është e detyruar:

a) të mbajë librat tregtarë/kontabël dhe të hartojë pasqyra financiare të ndara për veprimtarinë në klasat e jetës dhe klasat e jojetës;

b) të llogarisë kapitalin e shoqërisë, në përputhje me nenin 75, të këtij ligji, të ndarë për klasat e jetës dhe klasat e jojetës.

3. Pas privatizimit, shoqëria INSIG, sh. a., është e detyruar të përshtatë veprimtarinë e saj, në përputhje me pikën 2, të nenit 6, të këtij ligji.

Neni 262

### **Sigurimi i drejtpërdrejtë**

1. Dispozitat e këtij ligji, që lidhen me sigurimin e drejtpërdrejtë nga një shoqëri sigurimi e një vendi anëtar në Republikën e Shqipërisë, zbatohen vetëm në datën e anëtarësimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Europian.

2. Dispozitat e këtij ligji, që lidhen me sigurimin e drejtpërdrejtë të një shoqërie sigurimi vendase në një vend anëtar, zbatohen vetëm në datën e anëtarësimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Europian.

3. Deri në datën e anëtarësimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Europian, me “vend të huaj” nënkuptojmë edhe vendin anëtar dhe dispozitat përkatëse zbatohen rast pas rasti.

Neni 263

### **Investimet e lejuara të aktiveve në mbulim të provigjoneve teknike dhe matematike në një vend anëtar ose në një vend anëtar të OECD-së**

1. Duke filluar nga data e anëtarësimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Europian, shoqëritë e sigurimit mund të investojnë aktivet në mbulim të provigjoneve teknike në një vend anëtar ose në një vend anëtar të OECD-së, sipas llojeve të investimeve, të përcaktuara në pikën 1, të nenit 97, të këtij ligji, dhe kufizimeve të përcaktuara sipas pikës 5, të nenit 97, të këtij ligji dhe, si rrjedhojë, pika 3, e nenit 97, të këtij ligji, shfuqizohet.

2. Duke filluar nga data e anëtarësimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Europian, shoqëritë e sigurimit mund të investojnë aktivet në mbulim të provigjoneve matematike në një vend anëtar ose në një vend anëtar të OECD-së, sipas llojeve të investimeve të përcaktuara në pikën 1, të nenit 103, të këtij ligji, dhe kufizimeve të përcaktuara sipas pikës 5, të nenit 103, të tij, dhe, për rrjedhojë, pika 3, e nenit 103, të këtij ligji, shfuqizohet.

Neni 264

### **Përshtatja e shoqërisë së agjentëve dhe shoqërisë së brokerimit**

1. Shoqëria e agjentëve dhe shoqëria e brokerimit, e cila, në datën e hyrjes në fuqi të këtij ligji, ka licencë për të ushtruar një veprimtari ndërmjetësimi në sigurime dhe është e regjistruar në QKR, përshtat veprimtarinë e saj me dispozitat e këtij ligji brenda 6 muajve nga data e hyrjes në fuqi të tij.

2. Shoqëria e agjentëve dhe shoqëria e brokerimit, e përmendur në pikën 1, të këtij neni, është e detyruar që, brenda 1 muaji nga data e përfundimit të afatit kohor të



përcaktuar në pikën 1, të këtij neni, të depozitojë në Autoritet një raport për përshtatjen e veprimtarisë, në përputhje me këtë ligj, si dhe dokumentacionin shoqërues përkatës.

3. Nëse raportet e përmendura në pikën 2, të këtij neni, dhe dokumentacioni përkatës tregojnë se shoqëria e agjentëve dhe shoqëria e brokerimit janë përshtatur në përputhje me pikën 1, të këtij neni, Autoriteti miraton vazhdimësinë e veprimtarisë së shoqërisë së ndërmjetësimit.

4. Nëse shoqëria e agjentëve dhe shoqëria e brokerimit, referuar pikës 1, të këtij neni, nuk përmbushin kërkesat e përcaktuara në pikën 2, të tij, Autoriteti revokon licencat dhe hap procedurat e likuidimit, në përputhje me dispozitat e këtij ligji.

Neni 265

### **Përshtatja e agjentit dhe brokerit në sigurime**

1. Personat, të cilët, në datën e hyrjes në fuqi të këtij ligji, ushtrojnë veprimtari si agjent ose si broker në sigurime, brenda 6 muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji përshtatin veprimtarinë e tyre me dispozitat e tij.

2. Agjenti dhe brokeri, të përmendur në pikën 1, të këtij neni, janë të detyruar që, brenda 1 muaji nga data e përfundimit të afatit kohor të përcaktuar në pikën 1, të këtij neni, të depozitojë në Autoritet një raport për përshtatjen e veprimtarisë, në përputhje me këtë ligj, si dhe dokumentacionin shoqërues përkatës.

3. Nëse raportet e përmendura në pikën 2, të këtij neni, dhe dokumentacioni përkatës tregojnë që agjenti dhe brokeri janë përshtatur në përputhje me pikën 1, të këtij neni, Autoriteti miraton vazhdimësinë e veprimtarisë së agjentit dhe brokerit.

4. Nëse agjenti ose brokeri në sigurime, referuar pikës 1, të këtij neni, nuk përmbush kërkesat e përcaktuara në pikën 2, të tij, Autoriteti revokon miratimin apo licencën ekzistuese.

Neni 266

### **Përshtatja e procedurave**

1. Të gjitha procedurat për marrjen e licencës, miratimeve, lejimeve dhe autorizimeve, të cilat kanë filluar para hyrjes në fuqi të këtij ligji dhe në momentin e hyrjes së tij në fuqi nuk kanë përfunduar, kryhen në përputhje me dispozitat e këtij ligji.

2. Personat e licencuar si aktuarë dhe vlerësues dëmsh në sigurime përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji vazhdojnë veprimtarinë e tyre, sipas licencës ekzistuese, në përputhje me dispozitat e këtij ligji.

KREU XVI

DISPOZITA TË TJERA

Neni 267

### **Shndërrimi i degës së shoqërisë së sigurimit të vendit të huaj/anëtar**

1. Shoqëria e sigurimit e vendimit të huaj/anëtar, e cila ushtron veprimtari sigurimi në territorin e Republikës së Shqipërisë nëpërmjet degës së saj, në bazë të

licencës së lëshuar nga Autoriteti, mund të shndërrojë degën e saj në një shoqëri të kontrolluar, në formën e shoqërisë aksionare, nëpërmjet regjistrimit të kapitalit të dhuruar në aksione të nënshkruara nga shoqëria e sigurimit të vendit të huaj/anëtar.

2. Shndërrimi i degës së shoqërisë së vendit të huaj/anëtar në shoqëri të kontrolluar/shoqëri sigurimi vendase, e përmendur në pikën 1, të këtij neni, mund të ndodhë me kërkesë të vetë shoqërisë së sigurimit të vendit të huaj/anëtar ose, kur gjykohet e nevojshme nga Autoriteti, për arsye të administrimit të rrezikut. Kur shndërrimi kërkohet nga shoqëria e sigurimit të vendit të huaj/anëtar, kërkesa duhet miratuar nga Autoriteti, i cili mund të refuzojë të japë miratimin, nëse gjykon se shndërrimi mund të dëmtojë ekonominë kombëtare apo interesat shtetërorë, ose nëse çmon se nga shndërrimi mund të përkeqësohet gjendja financiare apo respektimi i normave mbikëqyrëse.

3. Në rastin e shndërrimit të degës së shoqërisë së sigurimit të vendit të huaj/anëtar në shoqëri të kontrolluar të shoqërisë së sigurimit të vendit të huaj/anëtar, kapital do të quhet shuma algjebrike e elementeve të mëposhtme të bilancit, të certifikuar nga shoqëria audituese:

- a) kapitali i dhuruar i paguar;
- b) provigjonet;
- c) diferenca rivlerësimi;
- ç) fitimet e pashpërndara;
- d) fitim/humbja e vitit ushtrimor.

4. Në rastin e shndërrimit, kapitali i shoqërisë së sigurimit ose pjesë të tij nuk duhet të bien nën nivelin e kapitalit minimal fillestar të kërkuar për licencimin e një shoqërie sigurimi.

5. Procesi i shndërrimit të degës së shoqërisë së sigurimit të vendit të huaj/anëtar në shoqëri të kontrolluar/shoqëri sigurimi vendase kryhet brenda 3 muajve nga miratimi i kërkesës së shoqërisë së sigurimit të huaj/vendit anëtar nga Autoriteti dhe brenda 6 muajve kur shndërrimi është kërkuar me vendim të Autoritetit. Ky afat mund të zgjatet me vendim të Autoritetit. Në rast të refuzimit të shndërrimit ose të mosrespektimit të afatit për kryerjen e procesit të shndërrimit, Autoriteti mund të marrë masat mbikëqyrëse të parashikuara në këtë ligj, si dhe mund të revokojë licencën e degës së shoqërisë të vendit të huaj/anëtar dhe ta vendosë atë në likuidim të detyruar.

6. Procesi i shndërrimit të degës së shoqërisë së sigurimit të vendit të huaj/anëtar në shoqëri të kontrolluar/shoqëri sigurimi vendase, me kërkesë të vetë shoqërisë së sigurimit, hyn në fuqi me regjistrimin pranë QKR-së të vendimit për shndërrim të asamblesë së përgjithshme ose organit tjetër përgjegjës të shoqërisë së sigurimit mëmë, së bashku me vendimin e Autoritetit për miratimin e shndërrimit.

7. Procesi i shndërrimit të degës së shoqërisë së sigurimit të vendit të huaj/anëtar në shoqëri të kontrolluar/shoqëri sigurimi vendase me vendim të Autoritetit hyn në fuqi me njoftimin e këtij vendimi përfaqësuesve ligjorë të degës së shoqërisë së sigurimit të vendit të huaj/anëtar dhe/ose shoqërisë së sigurimit mëmë ose në datën e përcaktuar nga kjo e fundit në vendimin për shndërrim. Ky vendim njoftohet pranë QKR-së dhe mund të publikohet pas realizimit të procesit të shndërrimit.

8. Regjistrimi i shndërrimit të shoqërisë pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit bën që:

a) shoqëria e sigurimit mëmë e degës së shoqërisë së sigurimit të vendit të huaj/anëtar, që shndërrohet, të marrë pjesë në kapitalin aksionar të shoqërisë së sigurimit, sipas kushteve të përcaktuara në këtë ligj;

b) të drejtat e shoqërisë së sigurimit mëmë dhe të personave të tretë ndaj degës së shoqërisë së sigurimit të vendit të huaj/anëtar, që shndërrohet, të vazhdojnë të zbatohen edhe për shoqërinë e kontrolluar.

Neni 268

### **Procedura e shndërrimit**

1. Dega e shoqërisë së sigurimit të vendit të huaj/anëtar, që shndërrohet, paraqet në Autoritet një raport të hollësishëm, ku shpjegohen bazat ligjore dhe ekonomike të shndërrimit të propozuar dhe/ose arsyet përkatëse. Raporti duhet të përmbajë dhe përshkrimin e vështirësive të veçanta të vlerësimit të shndërrimit që janë hasur, si dhe të përshkruajë efektin që parashikohet të ketë shndërrimi te normat rregullatore dhe mbikëqyrëse, si dhe te punëmarrësit e degës së shoqërisë së sigurimit të vendit të huaj/anëtar.

2. Vendimi për shndërrimin e degës së shoqërisë së sigurimit të vendit të huaj/anëtar, kur shndërrimi kërkohet nga shoqëria e sigurimit të vendit të huaj/anëtar, duhet të merret nga asambleja e përgjithshme ose organi tjetër kompetent i shoqërisë së sigurimit mëmë. Nëse shndërrimi ka si pasojë ndryshimin e të drejtave dhe të detyrimeve të veçanta të aksionarëve, atëherë vlefshmëria e vendimit për shndërrim i nënshtrohet miratimit të aksionarëve të prekur, sipas kërkesave të legjislacionit tregtar përkatës.

3. Për mbrojtjen e kreditorëve, zotëruesve të të drejtave të veçanta dhe titullarëve të interesave, të cilët e kundërshtojnë shndërrimin, zbatohen përkatësisht nenet 221, 222 e 223, të ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", të ndryshuar.

4. Për përgjegjësitë ligjore të anëtarëve të drejtorisë dhe administratorëve të tjerë të degës së shoqërisë së sigurimit të vendit të huaj/anëtar në shndërrim për dëmet e shkaktuara nga shkelja e detyrave të tyre, gjatë kryerjes së shndërrimit, zbatohen, përkatësisht, dispozitat e nenit 224, të ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", të ndryshuar.

Neni 269

### **Efektet juridike të shndërrimit**

1. Shndërrimi nuk sjell pasoja mbi të drejtat e detyrimet që dega e shoqërisë së sigurimit të vendit të huaj/anëtar ka marrë përsipër ndaj të tretëve. Shoqëria e kontrolluar e shoqërisë së sigurimit të vendit të huaj/anëtar trashëgon të gjitha të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga veprimtaria e degës së shoqërisë të vendit të huaj/anëtar që i nënshtrohet shndërrimit, përfshirë totalin e primeve të grumbulluara. Të gjitha të drejtat dhe detyrimet e degës së shoqërisë së sigurimit të vendit të huaj/anëtar që i nënshtrohet shndërrimit, në raport me palë të treta, para hyrjes në fuqi të procesit të shndërrimit, vazhdojnë të mbeten në fuqi për shoqërinë e sigurimit pas shndërrimit, sipas përcaktimeve në aktet apo marrëveshjet përkatëse me këto palë.

2. Kalimi i të drejtave dhe detyrimeve, sipas pikës 1, të këtij neni, kur shndërrimi ndodh, sepse gjykohet i nevojshëm nga Autoriteti, kryhet pa qenë e nevojshme të merret pëlqimi paraprak i depozituesve, kreditorëve të tjerë, aksionarë me të drejta të veçanta ose palëve të tjera, të treta.

3. Me hyrjen në fuqi të procesit të shndërrimit, të gjitha aktivet financiare dhe fizike në pronësinë ose administrimin e degës së shoqërisë të vendit të huaj/anëtar që i nënshtrohet shndërrimit vazhdojnë të mbeten në pronësi ose administrim të filialit.

4. Për efekt të regjistrimit tatimor, shoqëria e sigurimit vazhdon të mbajë numrin e NIPT-it që ka në përdorim dega e shoqërisë së sigurimit të vendit të huaj/anëtar që i nënshtrohet shndërrimit.

5. Shoqëria e kontrolluar, e krijuar si rrjedhojë e shndërrimit të degës së shoqërisë së sigurimit të vendit të huaj/anëtar nuk i nënshtrohet një procedure të re licencimi nga Autoriteti, por ky i fundit verifikon kushtet e përcaktuara në aktet ligjore dhe aktet e Autoritetit, duke miratuar ose refuzuar shndërrimin e degës së shoqërisë së sigurimit të vendit të huaj/anëtar në shoqëri sigurimi. Në rast se Autoriteti miraton shndërrimin, shoqëria e sigurimit trashëgon licencën e degës së shoqërisë së sigurimit të vendit të huaj/anëtar të shndërruar. Në këtë rast Autoriteti pajis shoqërinë e kontrolluar/shoqërinë e sigurimit vendase me formatin e ri të licencës që reflekton ndryshimin e emërimit nga degë e shoqërisë së sigurimit të vendit të huaj/anëtar në shoqëri sigurimi.

6. Pas realizimit të procesit të shndërrimit, shoqëria e kontrolluar regjistrohet në regjistrin tregtar të QKR-së, ndërkohë që dega e shoqërisë së sigurimit të vendit të huaj/anëtar çregjistrohet nga ky regjistër.

7. Shoqëria e kontrolluar i nënshtrohet mbikëqyrjes nga Autoriteti, në përputhje me përcaktimet e këtij ligji dhe aktet e Autoritetit të nxjerra në bazë të tij. Shoqëria e kontrolluar respekton të gjitha normat dhe kërkesat e parashikuara në këtë ligj dhe aktet e Autoritetit, të miratuara në bazë të këtij ligji.

8. Autoriteti mund të miratojë rregulla të mëtejshme në lidhje me shndërrimin, rregullimin dhe mbikëqyrjen e shoqërive të kontrolluara.

Neni 270

### **Miratimi i rregulloreve**

1. Autoriteti miraton aktet, sipas kompetencave të dhëna nga ky ligj, brenda 1 viti nga hyrja në fuqi e tij.

2. Deri në hyrjen në fuqi të akteve, referuar pikës 1, të këtij neni, aktet nënligjore në zbatim të ligjit nr. 9267, datë 29.7.2004, “Për veprimtarinë e sigurimit, të risigurimit dhe ndërmjetësimit në sigurime dhe risigurime”, të ndryshuar, zbatohen për aq sa nuk bien në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji.

Neni 271

### **Shfuqizimi**

Me hyrjen në fuqi të këtij ligji, ligji nr. 9267, datë 29.7.2004, “Për veprimtarinë e sigurimit, të risigurimit dhe ndërmjetësimit në sigurime dhe risigurime”, i ndryshuar, shfuqizohet.

Neni 272

**Hyrja në fuqi**

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

K R Y E T A R I

**Ilir META**

Miratuar në datën 22.5.2014

## Aneksi I

### Klasat e sigurimit

- A. Veprimtaria e sigurimit të jojetës përfshin klasat e mëposhtme:
1. Sigurimi i aksidenteve (përfshirë plagosjet industriale dhe sëmundjet profesionale) mbulon:
    - 1.1 pagesën e një shume të caktuar monetare (pagesa e menjëhershme e plotë);
    - 1.2 përfitim me natyrë rimbursimi (pagesa e shumës së sigurimit me këste);
    - 1.3 kombinimin e 1.1 dhe 1.2;
    - 1.4 pagesën ndaj dëmtimeve shëndetësore ose vdekjes së pasagjerëve.
  2. Sigurimi i sëmundjeve mbulon:
    - 2.1 të ardhura fikse financiare nga paaftësia shëndetësore;
    - 2.2 përfitime me natyrë rimbursimi;
    - 2.3 kombinimin e 2.1 dhe 2.2.
  3. Sigurimi i mjeteve tokësore (të ndryshme nga ato që lëvizin mbi shina) mbulon dëmtimet ose humbjet nga:
    - 3.1 mjetet tokësore motorike;
    - 3.2 mjetet tokësore jomotorike.
  4. Sigurimi i mjeteve lëvizëse mbi shina mbulon dëmtimet ose humbjet nga mjetet lëvizëse mbi shina.
  5. Sigurimi i avionëve mbulon dëmtimet ose humbjet e pësuar nga mjetet ajrore.
  6. Sigurimi i anijeve mbulon dëmtimet ose humbjet e pësuar nga:
    - 6.1 anijet lumore dhe të kanaleve;
    - 6.2 anijet e liqeneve;
    - 6.3 anijet detare.
  7. Sigurimi i mallrave në transport (përfshirë mallra, bagazhe dhe të gjitha llojet e tjera të sendeve) mbulon të gjitha dëmtimet ose humbjet e mallrave gjatë transportit ose bagazhet, pavarësisht nga mënyra e transportit.
  8. Sigurimi nga zjarri dhe forcat e natyrës mbulon dëmtimin ose humbjen e sendeve (të ndryshme nga ato të përfshira në klasat 3, 4, 5, 6 dhe 7), të shkaktuara nga:
    - 8.1 zjarret;
    - 8.2 shpërthimet;
    - 8.3 stuhitë;
    - 8.4 forcat e natyrës të ndryshme nga stuhia;
    - 8.5 energjia nukleare;
    - 8.6 shkarja e tokës dhe tërmeti.
  9. Sigurimi i dëmtimeve të tjera të pasurisë mbulon të gjitha dëmtimet ose humbjet në pasuri (të ndryshme nga ato që përfshihen në klasat 3, 4, 5, 6 dhe 7), kur dëmi është shkaktuar nga breshëri ose nga ngrica dhe çdo ngjarje e tillë, si vjedhja, të ndryshme nga ato të përmendura në klasën 8.
  10. Sigurimi i përgjegjësive nga përdorimi i automjeteve mbulon të gjitha përgjegjësitë që lindin nga përdorimi i automjeteve mbi tokë (përfshirë përgjegjësitë e transportuesit dhe mbulimin e përgjegjësive të detyrueshme).
  11. Sigurimi i përgjegjësive nga përdorimi i avionëve mbulon të gjitha përgjegjësitë që lindin nga përdorimi i avionëve (përfshirë përgjegjësitë e transportuesit).

12. Sigurimi i përgjegjësive për anijet (detare, të liqeneve dhe të lumenjve, si dhe ato të kanaleve) mbulon të gjitha përgjegjësitë që lindin nga përdorimi i anijeve ose barkave (anije të vogla), që lundrojnë në det, liqene, lumenj dhe kanale lundrimi (përfshirë përgjegjësitë e transportuesit).

13. Sigurimi i përgjegjësive të përgjithshme mbulon të gjitha përgjegjësitë, përveç atyre të përmendura në klasat 10, 11 dhe 12.

14. Sigurimi i kreditit mbulon:

14.1 rrezikun e mospagesës për shkak të paftësisë paguese (e përgjithshme);

14.2 kreditë e eksportit dhe rreziqe të tjera që shoqërohen me eksportin, tregtinë dhe investimet brenda dhe jashtë vendit;

14.3 kreditë e shlyera me këste;

14.4 kreditë hipotekore dhe huatë Lombard;

14.5 kreditë bujqësore;

14.6 kredi të tjera.

15. Sigurimi i garancive mbulon:

15.1 garancitë e drejtpërdrejta;

15.2 garancitë e tërthorta.

16. Sigurimi i humbjeve të ndryshme financiare mbulon humbjet financiare të shkaktuara si pasojë e:

16.1 rrezikut në punësim;

16.2 pamjaftueshmërisë së të ardhurave (e përgjithshme);

16.3 motit të keq;

16.4 humbjes së të ardhurave;

16.5 shpenzimeve të përgjithshme të vazhdueshme dhe shpenzimeve të tjera;

16.6 shpenzimeve tregtare dhe operacionale të paparashikuara;

16.7 humbjes së vlerës në treg;

16.8 humbjes nga qiratë ose të ardhurat;

16.9 humbjes indirekte nga tregtimi, të ndryshme nga ato të përmendura më sipër;

16.10 humbjeve financiare (të tjera nga ato tregtare);

16.11 llojeve të tjera të humbjeve financiare.

17. Sigurimi i mbrojtjes ligjore mbulon:

17.1 shpenzimet për shërbimet ligjore dhe ato gjyqësore, si dhe për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve jashtëgjyqësore.

18. Sigurimi i asistencës (ndihmës) mbulon:

18.1 ndihmën për personat që kanë vështirësi gjatë udhëtimeve ose në raste të tjera të largësisë nga shtëpia ose vendbanimi i përhershëm.

B. Veprimtaria e sigurimit të jetës përfshin klasat e mëposhtme:

19. Sigurimi i jetës mbulon:

19.1 sigurimin për vdekjen;

19.2 sigurimin për mbijetesë deri në një moshë të caktuar;

19.3 sigurimin për mbijetesë deri në një moshë të caktuar ose për vdekje të parakohshme;

19.4 sigurimin e jetës me kthim të primeve.

20. Sigurimi martesë - lindje mbulon:

20.1 shpenzimet që shoqërojnë martesën ose lindjen e fëmijëve;

20.2 përfundimi i kushteve të sigurimit, i cili ka lidhje me arritjen e një moshe të caktuar të fëmijës.

21. Sigurimi i jetës i lidhur me sipërmarrjet e investimeve kolektive mbulon:

21.1 sigurimin e jetës, në rastet kur pagesa e sigurimit lidhet në mënyrë të plotë apo të pjesshme me vlerën e aksioneve apo kuotave të sipërmarrjeve të investimeve kolektive, ose me vlerën e aktiveve të mbajtura në një fond të brendshëm nga siguruesi.

22. Anuitetet mbulojnë:

22.1 sigurim jete me elemente kursimi;

22.2 sigurim jete me afat të përcaktuar;

22.3 anuitete të shtyra;

22.4 anuitete të menjëhershme.

23. Sigurimi shtesë, i cili lidhet me kontratën e sigurimit të jetës, duke përfshirë një ose më shumë nga kombinimet e mëposhtme:

a) vdekje si rezultat i aksidentit;

b) paaftësi e përhershme në punë ose aftësi e kufizuar në punë, ose një lloj i caktuar dëmtimi si rezultat i një aksidenti;

c) paaftësi e përhershme në punë ose aftësi e kufizuar në punë, ose një lloj i caktuar dëmtimi si rezultat i një sëmundjeje;

ç) paaftësi e përkohshme si rezultat i një aksidenti;

d) paaftësi e përkohshme si rezultat i një sëmundjeje;

dh) paaftësi për të kryer profesionin apo punën si rrjedhojë e dëmtimeve trupore;

e) shërbimet spitalore;

ë) sëmundjet e pashërueshme;

f) shërbimet mjekësore.

C. Veprimtaria e sigurimit të jetës, gjithashtu, përfshin edhe operacionet e mëposhtme në sigurime:

1. Sigurimi i individëve të bashkuar për qëllime të kapitalizimit të kontributeve të tyre dhe shpërndarjes së aktiveve në raport me fondet e akumuluar midis personave që kanë arritur një moshë të caktuar (të mbijetuarve) ose midis përfituesve të sigurimit në rast vdekjeje të personave të siguruar.

2. Kthimi i kapitalit, i cili është një lloj sigurimi për një periudhë të caktuar, ku siguruesi, në këmbim të primeve, bie dakord në pagesën e një shume të caktuar në përfundim të periudhës së rënë dakord.

3. Administrimi i investimeve të fondeve të pensioneve dhe në veçanti të aktiveve, të cilat përfaqësojnë rezervat e subjekteve, të cilat kanë ndikim mbi pagesat në rast vdekjeje apo mbijetese apo në rast të mosvazhdimit ose përfundimit të veprimtarisë.



## **Aneksi II**

### **Emërtimi i licencës së dhënë për më shumë se një klasë sigurimi**

Nëse licenca për ushtrimin e veprimtarisë së sigurimit në klasat e jojetës mbulon në të njëjtën kohë më shumë se një klasë sigurimi emërtohet:

- a) klasat nr. 1 dhe 2, “Sigurimi i aksidenteve dhe shëndetit”;
- b) klasat nr. 1 (paragrafi i katërt), 3, 7 dhe 10, “Sigurime motorike”;
- c) klasat nr. 1 (paragrafi i katërt) 4, 6, 7 dhe 12, “Sigurimi i marinës dhe transportit”;
- ç) klasat nr. 1 (paragrafi i katërt) 5, 7 dhe 11, “Sigurimi i avionëve”;
- d) klasat nr. 8 dhe 9, “Sigurimi nga zjarri dhe dëmtime të tjera në pronë”;
- dh) klasat nr. 10, 11, 12 dhe 13, “Sigurimi i përgjegjësive”;
- e) klasat nr. 14 dhe 15, “Sigurimi i kreditit dhe i garancisë”;
- ë) të gjitha klasat emërtohen “Të gjitha klasat e sigurimit të jojetës”.

## **Aneksi III**

### **Rreziqet e mëdha**

1. Rreziqet e mëdha në sigurime, në kuptim të këtij ligji, janë si më poshtë:
  - a) rreziqet e klasifikuara në klasat 4, 5, 6, 7, 11 dhe 12, të aneksit I;
  - b) rreziqet e klasifikuara në klasat 14 dhe 15, të aneksit I, nëse i siguruari kryen veprimtari industriale ose tregtare ose është i vetëpunësuar dhe rreziqet në fjalë lidhen me këtë veprimtari;
  - c) rreziqet e klasifikuara në klasat 3, 8, 9, 10, 13 dhe 16, të aneksit I, nëse i siguruari përmbush të paktën dy nga kushtet e mëposhtme:
    - i) totali i bilancit është në vlerën 900 milionë lekë;
    - ii) fitimi është në vlerën 1 800 milionë lekë;
    - iii) ka të punësuar mesatarisht në një vit financiar 250 punonjës.
2. Nëse i siguruari është pjesë e një grupi, kushtet e përcaktuara në pikën 1, shkronja “c”, e këtij neni do të zbatohen duke u bazuar mbi pasqyrat financiare të konsoliduara.